Edith Pierpont Stickney
Sacramento Junior College
Ish instruktore e Historisë në Kolegjin Goucher

SHQIPËRIA JUGORE
ose
EPIRI I VERIUT
në
Çështjet Europiane Ndërkombëtare
1912 - 1923

Universiteti Standford, Kaliforni - USA
Shtëpia Botuese "KOHA" - Tiranë, 1998

Edith Pierpont Stickney

Sacramento Junior College
Ish instruktore e Historisë në Kolegjin Goucher

Shqipëria Jugore ose Epiri i Veriut në Çështjet Europiane Ndërkombëtare

1912 - 1923

Përktheu nga origjinali:
Mal Berisha

Universiteti Standford, Kaliforni

Titulli i origjinalit:

Southern Albania or Northern Epirus in European International Affairs
1912 - 1923

Copyright 1926 By
Standford University Press

All rights reserved

Published, December 1926
In the United States of America

Përktheu nga origjinali:
Mal Berisha
Stamboll, Gusht 1997

Ribotimi:
Shtëpia Botuese "KOHA"
Prill 1998

Recenzent: **Mero Baze**
Redaktor: **Enver Bytyçi**
Korektor: **Izet Duraku**
Në kompjuter: **Elvis Themeli**
Enkela Sheqeri

Parathënie

Ndërkohë që Lufta e Madhe po shkonte drejt mbarimit të saj, u bë e qartë se midis problemeve më ngulmuese, më të rëndësishme dhe më të vështira me të cilat do të ndeshej Konferenca e Paqes që po afrohej, ishin problemet e kombësive që përfshinin kërkesat e popujve të pakënaqur ndaj sundimtarëve dhe që kërkonin ose pavarësi ose bashkim me racat e tyre të afërta. Vetëvendosja e popujve, e shpallur prej aleatëve si njëri ndër qëllimet kryesore të luftës, hasi në një përgjigje të menjëhershme. Këto çështje ishin të gjitha probleme që shqetësonin popujt. E parë nga një pikë tjetër vështrimi, ato u përqendruan rreth zotërimit të territoreve, pra ishin ngatërresa kufijsh. Midis këtyre problemeve, çështja e Shqipërisë Jugore ose e Epirit të Veriut ishte njëra nga më të debatuarat ndër zonat që rrezikonin paqen në Europë e që përbëhej sa nga kërkesa rivalesh nacionaliste po aq edhe nga interesa të disa Fuqive të Mëdha.

Kjo ese synon të bëjë një studim të gjithanshëm e të plotë të historisë në fjalë nga viti 1912, kohë kur kjo çështje fillon e merr njëfarë rëndësie diplomatike

e deri në vitin 1923, duke e vënë theksin pikërisht tek aspektet më të gjëra europiane por edhe tek ato elemente lokale e kombëtare të cilët ndikonin në situatën ndërkombëtare.

Shumë material i vlefshëm në arkivat qeveritare është ende i pa publikuar dhe padyshim do të jetë për një kohë të gjatë i papublikuar dhe i pakapshëm. por praktikisht të gjitha materialet e shtypura janë në Bibliotekën e Luftës, Hoover në Universitetin e Standfordit, i cili zotëron ndoshta koleksionin më të plotë të materialit rreth kësaj çështjeje, një pjesë e mirë e të cilës është përdorur pikërisht në këtë studim.

Kjo ese është paraqitur në fillim si tezë për shkallën e doktorit në filozofi në Universitetin e Standfordit. Subjekti i saj është sygjeruar prej Dr.E.D.Adams, pa ndihmën dhe drejtimin e të cilit zor se mund të ishte shkruhej. Praktikisht i gjithë materiali ishte në koleksionin e papërdorshëm të Bibliotekës së Luftës Hoover në Universitetin e Stanfordit. Ndaj drejtorëve të asaj bibloteke e veçanërisht ndaj biblotekares Miss. Nina Almond dhe ndaj Mr.Robert C.Binkley, referent i bibliotekës, autorja është mirënjohës për ndihmën e pakursyer që ata i kanë dhënë. Mirënjohje e thellë i dedikohet gjithashtu dr.Percy A.Martin dhe Dr.Frank A.Golder të Universitetit të Standfordit për kritikën e plotë të dorëshkrimeve. Po kështu vlerësime të sinqerta për ish kolegen time në kolegjin Goucher, Dr.Mary Ë.Ëiliams, pa inkurajimin e së cilës kjo ese ndoshta nuk do ti të kishte çmimit "George Beer", të cilin Shoqata e Historianëve Amëriakne e dha në mbledhjen e saj në Ann Arbor me 1925. Falenderime të të veçanta shkojnë në adresë të Dr. Charles Seymor të Universitetit Yale, i cili ndihmoi me materialet që kanë të bëjnë me komisionin e çështjeve greke në Konferencën e Paqes, sikundër shihet edhe në biobliografi dhe në shtojcë.

Kësaj liste tashmë të gjatë të mirnjohjeve duhet t'i shtohet një fjalë vlerësimi për frymëzimin që autorja mori prej kolegjit Vassar nga ish mësuesit e saj atje, Miss Lucy M.Salmon, Miss Eloise Ellery dhe Miss. Dorothy Stimson, më vonë kolege të nderuar dhe miq në kolegjin Goucher. Falenderime të veçanta gjithashtu për kolegjin Vassar për dhënien autores të dekoratës Sutro Felloëship për vitet 1923-'24, i cili bëri të mundur përfundimin e veprës.

Edith P.Stickney
1 Dhjetor 1926

SHQIPERIA JUGORE OSE EPIRI I VERIUT NE ÇESHTJEN NDERKOMBETARE EVROPIANE GJATE VITEVE 1912-1923

1.Hyrje

Krahina, e cila njihet si "Epiri i Veriut" prej grekëve dhe mbështetësve të tyre dhe si "Shqipëria Jugore" prej shqiptarëve, italianëve dhe përkrahësve të tyre, nuk mund të jetë plotësisht e përcaktuar, përderisa kufijtë e saj të paraqitur prej këtyre pretendentëve ndryshojnë bashkë me ndryshimin e situatës ndërkombëtare. Në një përcaktim të përgjithshëm, bazuar në kufijtë e vendosur në vitin 1913 në Konferencën e Ambasadorëve, ajo zë atë pjesë të Shqipërisë që fillon në Jug të Vlorës që shtrihet drejt lindjes deri në Korçë. Kjo pjesë zë një të katërtën e Shqipërisë me një sipërfaqe me rreth dymijë e pesqind deri në tremijë milje katrore[1], pak gjë më e

1. Nuk është bërë ndonjë shqyrtim terrorial i përpiktë i Shqiprisë. Vlerësimet lëvizin nga 10.500 në 11.500 milje katrore. Albania, Peace Handbook Nr.17, faqe 1.

madhe se sipërfaqja e shtetit të Delaweres në SHBA ose sa një e treta e tërë sipërfaqes së Greqisë. Sipas statistikave zyrtare të qeverisë greke, Epiri i Veriut përcaktohet të jetë zona që zihet prej Korçës, Gjirokastrës dhe një pjese të Janinës ose e thënë ndryshe, kazatë[2] e Korçës, Starovës, Kolonjës, Gjirokastrës, Himarës, Delvinës. Leskovikut, Tepelenës, Përmetit, Pogonit dhe Filatit dhe vlerësohet të ketë një popullsi prej 228.000 banorësh[3].

Shqipëria Jugore zë një pozitë gjeografike të rëndësishme për arësye se ajo ndodhet përballë cepit lindor të çizmes italiane, pikërisht në pikën më të ngushtë të Detit Adriatik, prej ku kontrollohen tërë hyrjet dhe daljet në këtë det. Pozicioni i volitshëm, si ai që gëzon Shqipëria si një e tërë, dota bënte atë prej natyre një vend me rëndësi prej nga hyhet e dilet në pjesën më të madhe të vendeve të Ballkanit perëndimor. I vetmi gji është ai i Sarandës dhe bregdeti përgjithësisht është i ashpër dhe ka pak shtigje për të hyrë në pjesët e brendshme të

2. Perandoria Turke ishte e ndarë për qëllime administrative në vilajete ose provinca të cilat kishin nënndarjet e tyre në sanxhake, dhe këto në kaza ose kantone dhe kazate vetë në nahije ose komuna.

3. Shtabi i madh i përgjithshëm helen. Carte ethnographique de l'Epire du Nord en 1913, faqe 2

krahinës[4]. Mungesa e gjireve dhe vështirësitë për të zbatuar në tokë e karakterizojnë atë si zonë të rrezikshme bregdetare. Pjesa e brendshme është malore. Lartësitë zgjaten nga veriu në jug duke i dhënë mundësi komunikimit në këtë drejtim por duke e vështirësuar atë në drejtimin perëndim - lindje[5]. Rrugët natyrore përshkojnë lugiant e lumenjve ndër të cilat, Vjosa është më e rëndësishmja, që ka si degë të saj, ato që krijojnë lugina pjellore të Gjirokastrës dhe Përmetit. Rrugët për karroca në këto lugina afrojnë të vetmen mundësi për transport. Rruga kryesore e lidh këtë rajon të brendshëm me Vlorën, Janinën dhe nëpërmjet të Korçës edhe me Manastirin e Selanikun.

Raca dhe gjuha e banorëve të Shqipërisë kanë qënë për shumë kohë subjekt i shumë spekulimeve, por i pak studimeve serioze. Megjithatë kërkimet e fundit kanë treguar se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve të lashtë, pra të një populli indo- europian ose arian, që flisnin një gjuhë që nuk rrjedh prej asaj greke, por që afrohet me greqishten sa dhe latinishten, ose që gjendet midis të dyjave[6]. Ajo ka huajtur një

4. Newbegin, Aspekte gjeografie të problemeve Ballkanike f/64.

5. Lyde- Ferryman, Gadishulli i Ballkanit, f. 109.

6. Thumb, Greqia moderne dhe antikiteti i saj f.10; Dixon, Historia racore e njeriut, f.95.

përqindje të mirë në fjalorin e vet të kufizuar[7] edhe prej grekëve edhe prej sllavëve[8]. Hulumtimet e fundit kanë treguar se shqiptarët janë më të gjatë se sa grekët, por më të shkurtër se boshnjakët; lartësia e tyre mesatare është 167 cm; midis të gjithë banorëve ballkanas ata janë më së shumti

Brachycephalic[9] me një indeks prej 86. Në përgjithësi ata kanë flokë dhe sy të zinj[10].

Sikundër edhe në zona të tjera të diskutueshme të lindjes së Afërt, ku kufijtë etnografikë janë të vështirë për t'u përshkruar, popujt e këtij rajoni janë prej kulturash, besimesh fetare dhe gjuhësh të përziera. Askund tjetër në Evropë kriteri i gjuhës së folur nuk është aq i gabuar sa në kushtet ballkanike. "Një vëzhgues që simpatizon shqiptarët dhe që i mbështet vlerësimet e tij vetëm tek gjuha, mund të përshkojë të tërë vendin e të mos gjejë askënd tjetër përveç shqiptarëve, në një kohë kur një vëzhgues me prirje greke, duke proceduar në të njëjtën mënyrë nuk gjen

7. Rreth 5.000 fjalë. Shënime gjeografike mbi Ballkanin, f.16.

8. Huazimet e shqipes nga greqishtja, fjalë që i takojnë shtratit të vjetër të gjuhës së saj sipas Thumb "Altgriechische Elemente des Albanieesischen, " Indio Gemanische Forschungen Zeitschrift, XXXVI, 11

9. Pikpamja më e vjetër dhe më e kundërt është shprehur në Ripley, Racat e Europës, f.409

10. Pittard, popujt e Ballkanit, f.81 -84

askërkënd tjetër përveç grekëve"[11]. Me fjalë të tjera, popullsia është përdoruese e dy gjuhëve, por gratë dhe fëmijët dinë vetëm shqipen. Kristianët e këtij rajoni, të quajtur toskë, i takojnë kishës ortodokse greke, ku gjuha greke është gjuhë e përdorimit dhe e mësimit. Klasat e larta, në përgjithësi, pa dallim feje, myslimane apo kristiane, flasin greqishten, e cila, të paktën në kohën kur kemi filluar këtë studim, ishte gjuha e kulturës dhe e tregtisë. Ndonëse është e vërtetë se popullsia i takon kishave të ndryshme, lufta fetare është shumë më pak e ndjeshme në Shqipërinë jugore se sa në veri. Myslimanët këtu tregojnë më pak fanatizëm ndaj kristianëve se sa në ndonjë vend tjetër edhe për arsyen se ata janë vetë pasardhës të ish kristianëve, të cilët u kthyen në islam me forcë. Për më tepër, në kushtet e rritjes së lëvizjes kombëtare edhe vetë kristianët ortodoksë shqiptarë kanë arritur të kuptojnë se feja e tyre është shfrytëzuar prej kishës greke për qëllime politike dhe se nuk kanë pse të tremben prej myslimanëve.[12]

E parë nga pikpamja ekonomike, Shqipëria jugore, më pak e prapambetur se sa ajo veriore, është një

11. Young, në Revista bashkëkohore, CXV, 498.
Woods, Djepi i luftës, f.161

12. Woods, Djepi i Luftës, *f.161*

vend bujqësor dhe blektoral. Pronarët e vegjël kultivojnë më së shumti misrin, ndërsa pronarët e mëdhenj dhe bejlerët kultivojnë grurin.. Mbas drithërave vijnë ullinjtë si prodhimi më i rëndësishëm.

Duhani kultivohet në krahina të caktuara dhe më së shumti në Berat e Tepelenë. Malet janë të përshtatshme si kullota për gjedhe dhe dele. Blegtoria zë më shumë krahë pune se çdo punë tjetër[13]. Pyjet janë të paprekura, ndërsa mineralet, të cilat mendohet të jenë me bollëk, janë të pashfrytëzuara. Vendi është mbajtur në një sistem mesjetar, që haset edhe në vendet e tjera ballkanike. Beu, i cili e merr tokën prej sulltanit, rrallë e kultivon atë vetë por e jep tek qiramarrësit, prej të cilëve kërkon gjysmën ose një të tretën për vete, dhe një të dhjetën e merr si taksë për qeverinë[14]. Në rrethana të tilla fshatarëve shqiptare u ofrohet shumë pak interes për të vënë energjitë e tyre në shërbim të prodhimit bujqësor. Kjo ka bërë që, sidomos popullsia kristiane, të ketë një arsye të fortë për të emigruar[15]. Mallrat që prodhohen në vend janë shumë pak dhe thuajse të gjitha konsumohen në

13. Peace handbook No. 17, f.180-83; Markovich, Ekonomia ballkanike, f.53.

14. Po aty, No. 17. f86.

15. Zhurnali helenik, Shtator, 2, 1917.

tregun e brendshëm. Statistikat tregtare të dhëna nuk mund të përdoren vetëm për Shqipërinë jugore, pasi nuk ka të tilla; ato për Shqipërinë si një e tërë tregojnë se në vitin 1913, 55 përqind e mallrave që ajo importonte vinin nga Austro-Hungaria 25 përqind nga Italia dhe vetëm 5 përqind nga Greqia, ndërkohë që blerësi kryesor i mallrave shqiptare ishte Austro-Hungariae ndjekur prej Italisë[16]. Megjithatë për pjesën jugore pesha e Astro-Hungarisë ka qënë më e vogël, ndërsa ajo greke e pastaj italiane më e madhe.

Eshtë e natyrshme të pyetet se çfarë roli ka luajtur karakteri ekonomik i krahinës në grindjet për kufirin. Pjelloria apo mirëqenia e kësaj zone është përdorur si një pretekst prej grekëve për realizimin e dëshirave të tyre eksapansioniste, të nisura që në kohërat kur ata e krijuan shtetin e tyre modern që kanë më shumë një bazë idealiste se sa materialiste. Nga ana tjetër po tu referohemi kërkesave të shqiptarëve, karakteri ekonomik i tyre është një faktor më i rëndësishëm. Përderisa Shqipëria jugore është pjesa më pjellore dhe me mirqënie më të lartë në tërë territorin e banuar prej shqiptarëve, dëshira për t'u përfshirë në shtetin e tyre shqiptar i ka rrënjët thellë në karakterin ekonomik të rajonit. Nuk mund të mohohet ngjyra

16. Markovitch, vepër e cituar f.54.

nacioanaliste që shfaqet edhe tek kërkesat e shqiptarëve, por nuk mund të mos shihet se Shqipëria jugore ka një vlerë shumë më të madhe ekonomike për Shqipërinë në tërësi se sa për Greqinë. Sa u takon vendeve të tjera, si Italia dhe Austro-Hungaria,karakteri ekonomik i interesave të tyre ndaj Shqipërisë është i pa konsiderueshëm dhe qëndron vetëm në interesa strategjike.

II. Vështrimi historik deri më 1921

Një vlerësim i shkurtër i historisë së Shqipërisë Jugore përpara 1912-es është esencial për një kuptim adekuat të problemit gjatë periudhës së përshkruar në këtë ese. Vetëm nëpërmjet një studimi të tillë mund të kuptohet jo thjeshtë karakteri i banorëve dhe institucioneve të tyre sociale, por gjithashtu përplasja e interesave të fuqive të ndryshme të huaja. Për më tej, në pikpamje të referencave të shpeshta ndaj historisë së rajonit në literaturën propagandistike për çështjen në fjalë, një vlerësim adekuat i argumentave përfshin edhe kërkesën për një ide të mbështetur qartë në përvijimin e historisë së trazuar të këtij territori tejet të ngatërruar.

Në kohët antike emri Epir përdorej si nje emër i përgjithshëm, që kishte kuptimin tokëe që, kishte antitezë,konceptin ishull,në rastin konkret ishullin përballë, Korfuzin (Corcyra).Por po të shohim kufijtë që përmendin shkrimtarët antike për të,atëherë del se Epiri shtrihej prej Glossa Promontorit në veri,deri tek gjiri i Artës në jug.[1] Ky

1-Wing."Grindjet epirioto-shqiptare për çështjen e kufinjëve në kohët antike"(Anual Report of the American Historical Association,1919),I.307.

rajon ishte më shumë i helenizuar, se sa pjesa tjeter në veri të lumit Vjosa.[2] Adhurimi i Zeusit këtu u paraqit tek Dodona Pellazge,që u bë i famshëm nëpërmjet fjalës greke:për tek ky orakull i nderuar grekët dërguan misione të shpeshta, dhe, falë mbrojtjes që iu bë këtij tempulli nga shkatërrimi i aetlianëve më 219 p.e.r, ai vazhdoi të ekzistojë deri në kohën e pausnianëve.Rrasat e gurta, në të cilat janë skalitur pyetjet që iu paraqiten orakullit, janë gjetur pranë Janinës ashtu sikundër dhe një teatër grek aty pranë[3] .Në kohët klasike greke Epiri ruante mardhënje jo shumë të aferta me pjesen tjeter të Helladës. Ne dëgjojme veçanërisht për Admatus,i cili e mirëpriti Themistokliun e syrgjynosur dhe për Alcetasin,i cili u bë një vasal i Dionisit të Sirakuzes;me tej për martesën e Filipit të Maqedonisë me një princeshë epiriote,e cila e bëri atë të ndikonte në fatin e vendit[4]. Në shekullin e tretë p.e.r (295-289) lufta e Pirros së Epirit kundër romakëve në Italinë Jugore i dha krahinës një rëndësi të përkohëshme.Sido që të ketë qenë puna në periudhat e mëpërparshme, Epiri në kohën e Pirros

2-Po aty,f..313.
3.Gardiner,"Dodona",Enciklopedia Britanike,edicioni i njëmbëdhjetë;
4.Bury,Historia e Greqisë II,f.239,306-307.

ishte në përgjithësi i njohur si grek.[5]

Sundimi romak në fillim u shtri mbi Epirin e më pas mposhti Maqedoninë në betejën e Pydnes më 168 p.e.r. Udhëheqësi romak i asaj beteje, Aemilius Paulus, për të nënshtruar krahinën urdhëroi shkatërrimin e saj masiv,nga efektet e të cilit, Epiri nuk e mori veten kurrë. Sidoqoftë, atje më vonë u ndërtua një qytet i ri - qyteti Nikopolis - prej Oktavian Augustit për ndër të fitores së forcave të tij detare në Aktum. Nën Perandorinë Romake, Epiri dhe Shqipëria disa herë u bashkuan e disa herë u ndanë nga Maqedonia sipas nevojave të ngutshme administrative. Megjithatë vija ndarëse ishte më shumë politike se sa raciale apo gjuhësore. Justiniani ndërtoi shumë fortesa në Epir në përpjekjet e tij për të fortifikuar atë, por bregdeti mbetej prapseprapë një zonë plaçkitjesh prej ostrogotëve nën Totilën, i cili plaçkiti Nikopolisin dhe Dodonën. Gjatë periudhës antike vihet re një afëri raciale midis fiseve të jugut në vijën Glosa-Gramos dhe një dallim midis atyre dhe popullit ilir që shtrihej më në veri [6].

Gjatë mesjetës, me përjashtim të disa periudhavë

5. Wing. vepër e cituar, f.309.
6.Po aty, f.320; Finaly, Historia e Greqisë I.f.53.Bury, Perandoria e vonë Romake. I. XVII. 411; II, 24.

kohore, Epiri formonte pjesë të Perandorisë Romake të Lindjes ose të Bizantit. Ai u pushtua prej bullgarëve në shekullin e dhjetë dhe në shekujt e mëvonshëm prej normave, të cilët arritën të fusin këmbët atje përkohësisht nën Robert Guiskardin dhe djalin e tij Bohemond, por vetëm për katër vjet, sepse më pas do të binte nën sundimin e Perandorit Aleksandër Commenus[7]. Me kapjen e Konstandinopulit prej kryqëzatave më 1204 dhe ndarjen e Perandorisë, Epirit i erdhi një rast për pavarësi dhe u formua kështu një principatë greke, Despotati i Epirit. Despoti Michael e sundoi me dorë të fortë vendin, i cili ishte i mbrojtur nga goditjet prej barrierave të tij malore dhe ndërkohë banohej prej një amalgame racash-sllave, vllahe, shqiptare dhe greke-secila prej tyre në një shkallë të ndryshme qytetërimi, dhe secila me synimin për të mbrojtur zakonet dhe institucionet e veta kundër fqinjëve dhe kundër princit. Përkundër një alenance të pasuksesshme me zotërit francëzë të Greqisë kundër Perandorit Grek, despotati vazhdonte të mbështeste pavarësinë e tij në një aleancë me princat latinë të Greqisë Jugore[8].

7.Schevill, Historia e Gadishullit të Ballkanit, f.120. Oman , Perandoria e Bizantit, f.259-60.Finaly, vepër e cituar, IV, 28.

8. Finlay, vepër e cituar, ,f.304-308.

Më pak se një shekull më vonë, që nga viti 1350 luftrat civile në Epir i paraprinë një pushtimi të vendit prej serbit Stefan Dushan, i cili kapi kështjellën e Janinës. Pas këtij pushtimi, historia shënon përfshirjen në luftë të serbëve, shqiptarëve, frankëve dhe grekjëve në provincat fqinje deri sa i tërë vendi ra nën dominimin e turqve në shekullin e pesëmbëdhjetë[9]. Por përpara se Shqipëria dhe Epiri t'i nënshtroheshin zgjedhës turke, një rezistencë historike iu bë asaj nga heroi i madh kombëtar shqiptar Skënderbeu, i cili për vite të tëra i mundi turqit nga fortesat e tij malore. Me vdekjen e tij më 1468, vdekje e cila e gjeti vendin thuajse në fund të burimeve të tij, Epiri ra në duart e venecianëve, zotërve të detit. Por Venediku, i vetëm në luftën kundër turqve, u gjet i pamundur që të rezistonte gjatë e kështu në vitin 1501 u detyrua që të njihte sovranitetin e sulltanit mbi bregdetin lindor të Adriatikut[10].

Pushtimi turk u pasua nga jë dyndje masive nga Shqipëria dhe Epiri drejt Italisë. Shumë prej elementëve më të mirë në të vërtetë mbushën

9. Finlay, vepër e cituar, IV, 129.

10. Brown, epublika Veneciane, f.96. Bouracrt, L'Albanie et les Albanias, f.106

condottieret e të gjitha shteteve të Europës[11]. Nën pushtimin turk shumë shqiptarë e pranuan islamin, ndërsa të tjerët mbetën kristianë. Shqipëria ishte në të vërtetë i vetmi vend ballkanik ku feja në këtë epokë, nuk nënkuptonte tërësisht edhe kombësinë[12]. Kjo situatë, shpesh herë e kaluar pa u vënë re, është e një rëndësie të posaçme për t'i kuptuar lëvizjet kombëtare të shekullit të nëntëmbëdhjetë në Ballkan. Fakti që grekët, serbët dhe bullgarët ishin kristianë, i ndihmonte ata në krijimin dhe ngritjen e ndërgjegjies së tyre kombëtare dhe ishte një lidhje që i bashkonte ata. Kjo lidhje u mungonte shqiptarëve, ngaqë ishin të ndarë në fe të ndryshme ose mbanin të njëjtën fe që mbanin edhe sundimtarët e tyre pushtues. "Atje ku shqiptarët ortodoksë dhe grekë jetonin së bashku, siç ishin ata në pjesën më të konsiderueshme të Epirit të Veriut, fati i përbashkët si kristianë i ekspozonte njëlloj ndaj taksave duke fshirë kështu dallimet e racave të cilave u përkisnin [13].

Ajo që bie menjëherë në sy gjatë shekujve kur Shqipëria ishte tërësisht nën pushtimin turk është

11. Bourcart, vepër e cituar f.110. Iorga, Historia e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar, f.51. Shqipëria, 25 prill, 25 maj, 1918.

12. Bourcart, vepër e cituar, f111.

13. Finaly, vepër e cituar, VI, 40

radha e pasuksesshme, kjo për shkak të përçarjeve, e përpjekjeve për të fituar lirinë. Duke zbatuar maksimën *divide et impera*, përpjekja e turqve për t'i shtënë prijësit shqiptar kundër njëri tjetrit, çoi gati në një gjëndje fatale për vetë sundimin e tyre. Më i dalluari midis qeveritarëve të pavarur të shekullit të tetëmbëdhjetë ishte Ali Pashai i Janinës, i lindur në Tepelenë. Ambicioz për t'u bërë i pavarur nga sulltani, ai flirtoi me fuqi të ndryshme të Europës; një herë duke ndihmuar admiralin britanik, Nelson, që të fitonte betejën e Aboukir-it (1789) më pas, me rritjen e influencës franceze, duke kërkuar t'i hynte në zemër Napoleonit e kështu me radhë. Ai është veçanërisht i njohur për trajtimin mizor që iu bëri suliotëve kristiane ortodokse të Epirit, të cilët fituan admirimin e Bajronit. Ali Pasha ndihmoi sa në përshpejtimin e revolucionit grek, nëpërmjet nxitjes që u bëri grekëve kundër sulltanit, aq edhe në tërheqjen e përqendruar të forcave kundër tij, duke i afruar paqëllimshëm rastin Greqisë që t'i jepte një grusht turqve në luftën e saj për liri. Në revolucionin grek, banorët e Shqipërisë jugore qenë shumë aktiv; disa iu bashkuan atij për arsye se Greqia ishte një komb i krishtere që luftonte kundër sulltanit; të tjerë, pasonjës të Ali Pashait, për të marr hak kundër armikut të përbashkët mbas rënjes së

udhëheqësit të tyre; dhe një pjesë tjetër për inat të Aliut nga trajtimi i pamëshirshëm që u kishte bërë suliotëve.

Por cilado qofshin arsyet e pjesmarrjes, roli i rëndësishëm që ata luajtën në luftën e Greqisë për pavarësi, është i dorës së parë[14].

Duke shkuar drejt luftës për pavarësi, atëherë kur u mbajt Asambleja e katërt kombëtare greke, në korrik të viti 1829, deputetët u dërguan prej Epirit njësoj si edhe prej tokave të tjera greke, të cilat ende mbaheshin prej turqve [15]. Tashmë fuqitë e mëdha, Anglia, Franca dhe Rusia, të detyruara më në fund që të pranonin formimin e një mbretërie greke, në përpjekjen e tyre për të mbajtur aq sa të mundeshin status quo në dhe "integritetin" e perandorisë osmane, për shkak të interesave të tyre të rrezikuara, si dhe të xhelozive të ndërsjellta, lanë jashtë saj tërë Epirin si dhe Thesalinë e Kretën. Vënia e këtyre princave nën princin Leopold te Saxe -Coburg, kur atij iu afrua kurora greke, ishte e vetmja mënyrë e efektshme për pajtimin e Greqisë. Në të vërtetë që nga qeveria e parë helenike, Epiri përmendet qartë

14. Cherkezi, Shqipëria, e kaluara dhe e tashmja, f.39-40, 43-48.
15. Miller, perandoria Osmane, f.104.

si tokë greke [16]. Në Asamblenë kushtetuese të vitit 1843 delegatët nga Epiri ishin të lejuar të merrnin pjesë njësoj si ata që vinin nga territore të tjera të caktuara jashtë mbretërisë greke [17]. Parë në dritën e ngjarjeve të mëvonshme, del qartë se ndërtimi i një mbretërie më të gjërë në atë kohë, do të kishte sjellë tepër zhvillim dhe mirëqënie dhe irredentizmi nuk do të kishte luajtur rol aq të dukshëm në historinë mëvonshme të Greqisë.

Të përfshirë nga "megallos idea", prej së cilës rridhte ideja për restaurimin e Perandorisë Bizantine me anë të vendosjes së dominimit grek mbi rrënojat e Perandorisë Osmane dhe duke e besuar atë si një skemë të praktikueshme, burrat që e udhëhoqën Greqinë panë në Luftën e Krimesë një rast për të goditur Turqinë, meqë ajo i kishte duart e zëna diku tjetër, me qëllim që të aneksonin provincën aq të lakmuar të Thesalisë dhe të Epirit. Kjo skemë, e cila paraqiste avantazhe të qarta ndaj saj, ishte nxitur padyshim nga Rusia, e cila ndoshta bashkë me grekët, besonte se të gjithë ortodoksët që ishin nën sulltanin, do të ngriheshin në rebelim, në momentin kur ca burra të armatosur do të kalonin kufirin nga

16. Sergeant, Greqia në shekullin e nëntëmbëdhjetë, f/218.
17. Miller, vepër e cituar, f.174

Greqia dhe do të shfaqnin flamurin e kryqit.

Por kjo aventurë greke s'ishte asgjë tjetër veçse një dështim. Ca mijra burra kapërcyen vijat kufitare dhe plaçkitën, çfarë u doli përpara banorët e Thesalisë e të Epirit, të cilët, si rrjedhojë kuptuan se ky keqtrajtim i bërë nga grekët nuk mund të pranohej prej turqve... Mbas katër muajsh, turqit i dhanë fund kësaj ndërhyrje invazionit dhe si pasojë, sundimi turk u forcua në këto dy provinca[18].

Çështja e Epirit në fillim mori rëndësi të vërtetë europiane në Kongresin e Berlinit më 1878, në mbyllje të luftës ruso-turke. Gjatë luftës Greqia ishte akuzuar prej Turqisë për nxitje kryengritjesh në provincat otomane fqinjë. Në vitin 1877 lordi Derby me kërkesën e Turqisë i kërkoi qeverisë greke që ta autorizonte atë, të siguronte Portën se Greqia nuk do të godiste Turqinë ose do të bënte sikur nuk do t'i shihte përpjekjet për të nxitur kryengritjen në provincat greke. "Përgjigja e Greqisë ishte një zotim i kualifikuar, i kufizuar në kohën e "tashme" dhe një rrëshqitje e qartë për të "dekurajuar" kryengritjet"[19]. Opinioni publik grek kërkonte pushtime. Ministri grek M.Tricoupis deklaroi se ai mendonte se edhe

18.Finlay, vepër e cituar, VII, 219, 223.
19.Sergeant, vepër e cituar, f.276.

në se forca pushtuese greke do të mundej, kjo do të ishte më e mirë për Greqinë se sa të vazhdonte të përkrahte një qëndrim paqësor në luftë. Kabineti i ri grek shpalli më 2 shkurt 1878 se kishte vendosur që të pushtonte përkohësisht provincat greke në Turqi, por kjo nuk ndodhi pasi qe njoftuar armëpushimi ruso-turk [20].

Në kongresin e Berlinit, përfaqësuesi grek, M. Delyannis dhe M.Rhangale, paraqiten kërkesat për Thesalinë, Epirin dhe Kretën. Plotësimi i këtyre kërkesave, u tha atje, do të përmbushte dëshirat e popullatës së interesuar dhe do t'i jepte paqen mbretërisë. Përkundër premtimeve të njëmendta të Anglisë, se Greqia nuk do të ishte e humbur po të mbetej jashtë luftës, Lordi Salisbury, çmoi më shumë përfitimin e një vendi në Kongres, duke mos bërë asgjë për Greqinë.

I plotëfuqishmi francez, M.Waddington, nga ana tjetër, duke iu referuar faktit që Franca kishte qënë gjithnjë një lider kulturor në Lindjen e Afërt qysh në kohën e kryqëzatave, kërkonte t'ia bashkangjiste praktikisht Greqisë tërë Thesalinë dhe Epirin dhe në propozimet e tij ai kishte preferuar padyshim mbështetjen paraprake të italisë, Austro-Hungarisë

20.Po aty, f.278,79.

dhe të Rusisë. Megjithatë këto propozime nuk morën miratimin e Lordit Beaconsfield. Kështu, duke njohur karakterin e pakënaqshëm tëkufinjve të vitit 1831, ai kundërshtoi çdo përmirësim, bile edhe përfshirjen e rajoneve me përbërje të pastër greke me Turqinë jugore dhe deklaroi në mënyrë cinike se shtete si Greqia, të cilat kanë një të ardhme, janë në një pozitë të tillë që duhet të presin. Prandaj përballë kundërshtimit absolut të të plotfuqishmëve engleze, propozimet nuk ishin mbushamendëse dhe neni që merrej me çështjen e Epirit në Traktatin e Berlinit dha thjeshtë rekomandime për ratifikimin e kufijve[21].

Kërkesat e Greqisë në lidhje me kufijtë e saj u lanë në hije, ndaj dhe nuk u gjend ndonjë formulim për to në Traktatin e Berlinit. Aq më tepër që qeveria konservatore e Britanisë së Madhe, e dëshiruar për të rivënë në vend influencën e saj të zbehur në Kostandinopol, kundërshtoi ushtronte presion për një zgjidhje të kënaqshme të problemit të kufijve greke. Kjo indiferencë e Lordit Salisbury i dha dorë Portës në rezistencën që e saj ndaj ndonjë korigjimi të kufijve greke dhe prandaj çështja mbeti e

21. Sergeant, vepër e cituar f.286 -87; Hansard, seria e tretë, CCXLII, 532-33, 564-65.

pazgjidhur derisa Gladstone erdhi në fuqi në vitin 1880. Shpresat e mëdha të cilat u varën tek ai burrë shteti, të ngritura në zemrat e të gjithë kundërshtarëve të Turqisë, në rastin ekufijve greke u shkrehën tërësisht. Eshtë e vërtetë se lordi Granville, i cili e mori në drejtim Foreign Officin, iu drejtoi një qarkore fuqive duke kërkuar bashkëpunim midis tyre për zbatimin e atyre kushteve të Traktatit të Berlinit të cilat ishin neglizhuar [22], por kauza greke u dëmtua seriozisht prej situatës në Francë; përpjekje të bëra atje për të ndihmuar Greqinë ishin ndërprerë prej sekretarit të marrdhënieve me jashtë të politikës së jashtme franceze, më parë i predispozuar ndaj Greqisë, por tani i kthyer në drejtim të kundërt [23]. Për rrjedhojë, Porta, duke i gjetur Fuqitë të përçara, bëri një rezistencë më të vendosur, dhe nenet e Traktatit të Berlinit që trajtonin çështjen e Epirit mbetën thjesht në letër.

Në dy raste të tjera Greqia u përpoq të merrte Epirin: më 1885, kur u formua principata e Bullgarisë, të dyja, Greqia dhe Serbia, rivale të

22. Schmidtt, "Politika Britanike dhe Traktati i Berlinit", 1878-1887" në Universitetin e Eisconsit, I, f.143-45.

23. Miller, vepër e cituar, f.403; Hanotaux, Franca bashkëkohore, IV, f.573.

Bullgarisë kërkuan kompensime territoriale në llogari të Turqisë. Në Greqi tre anëatrë të kabinetit të Delyannis mbrojtën kapjen e territoreve të kufijve të propozuar në Kongresin e Berlinit; por politika e tyre nuk u adaptua [24]. Atëherë Franca kështilloi Greqinë që të pranonte gjithë çfarë dëshironin Fuqitë e Mëdha, duke premtuar në të njëjtën kohë se ajo do të kërkonte zgjidhje ndaj kërkesave greke në një rast të përshtatshëm në të ardhmen [25]. Në një rast tjetër, më vonë, në kohën e luftës fatkeqe greko-turke më 1897, Greqia bëri edhe një përpjekje për të siguruar marrjen e provincës së lakmuar. Trupat helenike u dërguan në Epir dhe Thesali, por aty u mundën. Disfata e tyre u përdor prej Italisë për t'i treguar popullsisë së Epirit pavlefshmërinë e kalimit nga dominimi turk në atë grek [26].

Periudha kohore pre Kongresit të Berlinit deri tek Lufta Ballkanike dëshmoi dy faza të reja të historisë së Epirit dhe të Shqipërisë; e para rritjen e nacionalizmit shqiptar dhe e dyta, rivalitetin kompleks në rritje të fuqive në këtë rajon. Këto dy

24. Miller, vepër e cituar, f.416.

25. Sergeant, vepër e cituar, f.316. Për të gjithë subjektin e rishikimit të Traktati të Berlinit, Historia e Europës Moderne, 1878, 1919, kapitulli I dhe IV.

26. Miler, vepëra e cituar, f.436 -37; Casanges, Revista Dyjavore, CI, 474, (Mars, 1914).

lëvizje, të ndërthurura në mënyrë tejet të koklavitur, formojnë plotësisht shtrembërimin dhe ndërthurjen e historisë shqiptare gjatë periudhës në fjalë dhe janë të një rëndësie të dorës së parë për të kuptuar zhvillimet e saj të mëvonshme.

Shkalla e parë në rritjen e nacionalizimit shqiptar mund të gjurmohet me formimin e "Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" në vitin 1878 për mbrojtjen e të drejtave të Kombit Shqiptar". Kjo lidhje që u formua për të kundërshtuar çdo lloj kalimi të tokave të banuara prej shqiptarëve tek shtetet e saj fqinje, kundërshtoi shpërblimin që iu bë Malit të Zi pre kongresit të Berlinit duke i dhënë një copë të vogël të territorit shqiptar. Porta, duke shpresuar në moszbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit, në fillim e favorizoi Lidhjen, por, kur sulltani konstatoi se ajo nuk ishte një vegël e përshtatshme për t'u përdorur, pasi përbënte bërthamën e një lëvizjeje të re kombëtare, e shpërndau atë me forcë[27].

Atëherë shqiptarët me qëndrim jashtë vendit, si në Itali, Rumani dhe Belgjikë, aq sa edhe në Athinë, formuan komitetet e tyre për të propaganduar idetë kombëtare. Këto organizata ia arritën të shpërndajnë fshehtas brenda vendit libra, pamflete dhe gazeta të

27, Schevill, vepër e cituar, f,464-65; Chekrezi, vepër e cituar, f.51-52.

ndaluara prej autoriteteve otomane, për shkak se ato ishin shtypur në gjuhën kombëtare. Deri në vitin 1908 efekti i këtyre lëvizjeve në vetë Shqipërinë ishte i papërfillshëm, kryesisht në sajë të mungesës së edukimit masiv, i cili do të përbënte bazën e rritjes së ndjenjave patriotike tek masat e gjera, kështu që ndalimi i shkollave kombëtare shqipe nga turqit ishte i efektshëm [28]. Në vitin 1904, u mbajt në Bukuresht e para asamble kombëtare shqiptare. Ajo adoptoi një listë rezolutash që u tregonin turqve se atje ishin fillimet e një lëvizje të cilën ata tashmë duhej ta llogarisnin. Vëmendja e Europës u tërhoq nga kjo lëvizje e re me anë të një memorandumi, të paraqitur prej shqiptarëve në Konferencën e Hagës të viti 1907, por pa rezultat [29].

Paralel me këtë rritje të nacionalizmit shqiptar pat dhe një tjetër zhvillim, të një rëndësie të madhe për Shqipërinë, i cili e solli këtë vënd në arenën e politikës ndërkombëtare europiane. Si rezultat i pushtimit të Bosnjës dhe Hercegovinës prej Austro-Hungarisë, pushtim ky i njohur prej Traktati të Berlinit, italia u bë xheloze nga frika se mos ekspansioni austriak në

28. Vilari, Çështja e Ballkanit, f. 161; Bourchier, "Shqipëria" Enciklopedia Britanike, edicioni i njëmbëdhjetë.

29. Larmerous, Politika e jashtme Austro-Hungarisë, 1875-1914, II, 392-401.

Ballkan mund të merrte aq shumë bregdet, sa të arrinte tek hyrja e Detit Adriatik, dhe kështu merrte fund dëshira e saj për ta kthyer Adriatikun në një liqen italian. Këto vite njohën formimin e Aleancës Trepalëshe, e cila u krijua për kundër ose, ndoshta pjesërisht për shkak të urrejtjes dhe rivalitetit austro-italian. Një pike tjetër e ndjeshme në këtë aleancë ishte pengimi që i duhej bërë çdo lloj fuqie tjetër për të futur këmbët në Shqipëri. Ruajtja e status quose në Adriatik ishte kështu një kusht themelor. Që prej viti 1902 ishte rënë dakort midis tyre se në qoftë se këto lloj rregullimesh të bëra do të provonin se ishin jo praktike, të dyja do të punonin për zhvillimet autonome të shteteve ballkanike. Që prej asaj kohe, çështja shqiptare ishte gjithnjë e më shumë një objekt i përcjellur me interes nga opinioni publik italian dhe, me dështimin e planit të saj kolonial, pas pushtimit të Tunizit nga Franca në vitin 1880, thirrjet për shtrirje të sferës së influencës italiane në bregdetin tjetër të Adriatikut u bënë më të forta, ç´ka solli që çdo hap i ndërmarrë prej Austro-Hungarisë të shihej me mosbesim prej politikanëve dhe gazetarëve italianë [30].

Përkundër një intervali të shkurtër, të kushtëzuar

30. Pribram, Traktati sekret i Austro-Hungarisë, II, f.114-15

prej Aleancës trepalëshe, dy fuqitë nuk ndenjën duarkryq ndaj dekadës që çoi në luftërat ballkanike. Veçanërisht rivalet u angazhuan në një "penetrimin paqësor" në Shqipëri. Austro-Hungaria kishte kohë që e kishte shtrirë influencën e saj atje, duke u bërë mbrojtëse e shqiptarëve katolike, falë privilegjeve të dhëna asaj që dy shekuj më parë [31]. Kështu, agjentët e saj bënin një propagandë të fuqishme katolike, duke shfrytëzuar priftërinë e fshatrave për të shpërndarë ndjenjat e këqia midis myslimanëve dhe kristianëve dhe nëpërmjet të kësaj ndërhyrjeje garantonte një pengesë serioze ndaj formimit të një nacionalizmi të fortë shqiptar [32]. Përveç kësaj influence fetare, Monarkia dualiste ushtroi kontroll në Shqipëri nëpërmjet subvencioneve sekrete për bejlerët më në zë të vendit [33] dhe nëpërmjet edukimit të studentëve në Austro Hungari për t'i kthyer pastaj në agjente të intrigave të saj.

Monarkia Dualiste duket besonte se duke inkurajuar çrregullimin publik, do të krijonte rrethana të tilla që t'i kërkohej që t'a pushtonte

31. Dillon, Revista bashkëkohore (1913) CIII, 732; për një listë të traktateve, etj. Polyvios, Shqipëria në Konferencën e Asambleve në Londër, f.27, shënime.

32. Woods, Zona e rrezikshme e Europës, f.92.

33. Schëertfeger, Politika Europiane, III, 256.

vendin, me qëllim për ta qetësuar atë, siç kishte ndodhur me rastin e Bosnje -Hercegovinës[34]. Në sytë e saj Shqipëria përbënte vetëm njërën prej hapave që duheshin ndërmarrë në rrugën e saj për në Selanik[35]. Në krahasim me penetrimin austriak, ai italian ishte më pak sistematik e më pak efektiv. Monarkia Dualiste zotëronte gjasa më të mëdha se sa Italia, siç bënte të njohur Ministri i Jashtëm italian San Giuliano, pasi kishte avantazh afërsinë territoriale, paratë e përdorura me bollëk, tregti më të mirë me të, marinë më mirë të organizuar dhe marrdhënie më të përzemërta me Vatikanin dhe klerin [36]. Metoda italiane e penetrimit ishte ushtruar nëpërmjet lidhjeve të personelit, drejtorëve të policisë nga njëra anë dhe banorëve me influencë të Shqipërisë nga ana tjetër, ose nëpërmjet emigrimit të shqiptarëve për në Itali pas trazitave të ndodhura në Maqedoni [37]. Kështu me hapjen e siparit të shekullit të njëzetë, San Guliano këshilloi rritjen e influencës italiane në Shqipëri nëpërmjet marinës tregtare, shërbimit postar, agjentëve tregtarë e

34. Braisfold, Maqedonia, Rracat dhe e ardhmja e saj, f.254-55.

35. Larmeroux, vepër e cituar, II, f.384.

36. Sosnosky, Politika Austro-Hungareze në Ballkan (gjermanisht) 1866, II, 253.

37. Larmeroux, vepër e cituar, II, f.388.

konsullore, shkollave, bankave, pra nëpërmjet një programi të tillë të pasur, i cili dukej i vështirë për t'u thënë e jo më për t'u realizuar. Ndoshta penetrimi më i suksesshëm mori formë nëpërmjet arsimimit. Numri i nxënësve, që ndiqnin shkollat italiane në Vlorë, Janinë dhe Shkodër, ishte rreth tre herë më shumë se sa numri i atyre që ndiqnin shkollat austriake në të njëjtat lokalitete [38], ndërkohë që Italia, kishte gjithashtu drejtimin në Shqipëri[39]. Ndërsa influenca austriake ishte më e fuqishme në Veriun e Shqipërisë ajo e Italisë dukej se ndjehej më shumë veçanërisht në Jug, gjë që dukej se diktohej nga pozitat gjeografike respektive të të dy vendeve [40]. Që nga kjo kohë, ishte Italia ajo që iu kundërvu influencës greke.

Pretendimet e Greqisë ndaj Shqipërisë Jugore, të cilat, duhet thënë se ishin më të forta se sa ato Austro-Hungareze dhe italiane, përbënin arsyen kryesore për të ushqyer zemërimin më të thellë tek nacionalistët shqiptarë. Ajo e ushtronte influencën e saj në Epir nëpërmjet të tri agjencive të saj: patriarkanes, shkollave greke dhe vetë mbretërisë

38. New York Times, 1 Shkurt 1914.

39. Braisfold, vepër e cituar, 283, shënime.

40. Cf. figurat e lundrimit të dhëna nga Larmeroux, vepër e cituar, II. 395, shënime.

helenike. Qëllimet e propagandës gjatë kohës që po shqyrtojmë ishin, së pari, të krijonin pakënaqësira tek shqiptarët ndaj Turqisë, dhe më pas ata të helenizoheshin. Në përpjekjet e tyre në këto drejtime, grekët ndihmoheshin prej turqve, të cilët u lanë dorë të lirë në Shqipërinë Jugore duke penguar kështu një kryengritje të bashkuar të shqiptarëve dhe duke e kundërvënë një pjesë të vendit ndaj pjesës tjetër. Kisha Ortodokse i ndiqte me vëmendje ngjarjet në këtë rajon, dhe shkollat e saj, në të cilat gjuha greke ishte gjuha e folur dhe e mësuar, praktikisht afronin të vetmen mundësi për tu arsimuar. Parë nga ky këndvështrim është e qartë se influenca helenike duhej të ishte e fuqishme. Shtrirja e kësaj influence, e cila formon bazën e kërkesave greke ndaj krahinës dhe që përbën themelin e të gjithë problemit, do të shfaqet më vonë.

Nën Sulltan Abdul Hamitin (1876-1909), shqiptarëve, megjithëse individualisht u ishte besuar të ishin anëtarë të qeverisë, nuk ishte bërë asnjë lëshim sa i takon nacionalizmit të tyre. Prej revolucionit të Xhon-turqve të 1908-ës, Shqipëria në fillim shpresoi për autonomi më të gjërë dhe gati sa nuk iu bashkua besnikërisht këtij

revolucioni[41], por shumë shpejt çdo gjë u bë e qartë për nacionalistët shqiptarë. Shqiptarët e koncpetonin perandorinë si një lloj federate të popujve autonome, ndërsa Komiteti "Bashkim e Përparim" kërkonte një qeveri tejet të centralizuar. Në përpjekjet e tyre për të përmbajtur dominimin mbi shqiptarët si popull mysliman, xhon-turqit dërguan katër ekspedita kundër Shqipërisë në më pak se dy vjet. Padyshim që politika agresive e Xhon turqve i përshpejtoi zhvillimet brenda nacionalizmit shqiptar duke e shtuar kundërshtimin në përmasa të papara ndonjëherë deri në atë kohë 42. Politika e mëparshme e shqiptarëve, për të zhvilluar autonominë e tyre brenda Perandorisë Osmane, si një gur kalimi për të arritur më pas tek pavarësia, tashmë nuk kishte vlerë dhe u gjet si variant i pamundshëm, sa nga kundërshtimi i politikës së xhon turqve aq edhe nga rezultatet e luftës ballkanike.[42]

41. Shih vlerësimin e deputetit të nderuar shqiptar Ismail Qemal Bey në The Quarterly Review, CCXXVIII, 150-52; Gjithashtu Delaji, Aspiratat autonomiste në Europë f.119, Peace Hendbook, nr.17,f93-95' Chekrezi, vepër e cituar, f.63

42. Ismail Kemal Bey, citim

III Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe Përcaktimi i Kufijve 1912-1914

Çështja shqiptare ishte shkaku kryesor që çoi në luftën e Parë Ballkanike pasi ajo veproi si pale direkt përgjegjëse për shpërthimin e konflagracionit. Kur më 1912, Shqipëria u nda përfundimisht nga Turqia nëpërmjet një traktati, sipas të cilit, katër vilajetet, ai i Shkodrës, Janinës, Manastirit dhe Kosovës do të përfshihen brenda saj, shtetet fqinje vendosën të kundërshtonin krijimin e një Shqipërie si e tërë, sepse ajo do të shkelte rëndë mbi shpresat e tyre[1]. Por shqiptarët nuk morën pjesë aktive në Luftën e Parë Ballkanike, pasi ata tradicionalisht kanë shprehur antipati ndaj turqve; kësaj i shtohej tashmë edhe frika se mos një fitore e turqve do të çonte në një përtëritje më të madhe të përpjekjeve osmanizuese ndaj tyre, nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, prej frikës që kishin nga grekët dhe serbët, të cilët donin ta ndanin këtë vend midis tyre, në se do t'ja arrinin dot. Në mes të Scyllas dhe Charybdis shqiptarët ushqyen të njëjtën urrejtje, si ndaj aleateve ballkanike ashtu edhe kundër Turqisë.

1. Schevill, Historia e Gadishullit Ballkanik, f.466.

Kështu, si një protestë kundër përpjekjeve serbe për të siguruar dalje në det në kurriz të Shqipërisë dhe me shpresë se kështu do të siguronin veten pa u kthyer në një plaçkë lufte, në vjeshtën e vonë të 1912-tës, shqiptarët e shpallën pavarësinë e tyre. Kjo ngjarje kuptmiplotë ndodhi në Vlorë, më 28 nëntor 1912[2]. Kryetari i Qeverisë së Përkohëshme Shqiptare të themeluar, u bë Ismail Qemal Bey siç e njoftonte më telegraf Kontin Bertold, Ministri Austriak i Punëve të jashtme:

Asambleja Kombëtare e përbërë prej delegatësh nga të gjitha anët e Shqipërisë pa dallim feje, e mbledhur sot në qytetin e Vlorës, ka shpallur pikërisht theelimin e Qeverisë së Përkohëshme, e ngarkuar të mbrojë ekzistencën e popullit Shqiptar, i rrezikuar sa prej shfarosjes nga ana e ushtrive serbe, aq edhe me dorëzim të tokave kombëtare ushtrive Aleate[3].

Përpara se të mbahej mbledhja, Ismail Qemal Beu e kishte diskutuar çështjen shqiptare me Bertoldin në Budapest. Burri i shtetit Austriak i kishte aprovuar pikpamjet e tij rreth çështjes Shqiptare dhe i kishte

2. Austria, Dokumente Diplomatike për Ballkanin, 1912-'13 Nr. 134, Lejhanec për për Berchtoldin.

3. Austria, Dokumente Diplomatike rreth Ballkanit, 1912-'13, Nr. 136. 28 nëntor 1912.

vënë atij një anije në dispozicion. Zgjedhja e tij si kryetar ishte paraprirë prej ngritjes dramatike të një flamuri të moçëm shqiptar të heroit shqiptar Skënderbeg dhe ishte shoqëruar me njoftimin e Fuqive dhe Portës për themelimin e shtetit të ri, bashkë me një kërkesë për njohjen e tij [4].

Përpara se të shikonin në se kjo lëvizje e shqiptarëve, e përkrahur nga Austrisa, ishte apo jo e qëlluar, hapat e marra prej fuqive Evropiane për të përfunduar luftën, rezultuan në firmosjen e një armëpushimi më 3 Dhjetor midis Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi nga njëra anë dhe të Turqisë nga ana tjetër. Arsyeja kryesore pse Greqia kundërshtoi të firmoste armëpushimin ishte se ajo kërkonte që të kalonte drejt Epirit e veçanërisht drejt fortesës së Janinës. Ky fakt ishteë shfaqur qartë në deklaratën e Ministrit grek, Romanos, në subjektin e refuzimit të tij; kushtet e aleatëve të cilat ishin të pranueshme për Greqinë, por jo për Turqinë, përfshin dorëzimin e Janinës [5]. Për Shqipërinë, rëndësia e rezistencës së

4. Vlerësimi i Ismail Qemal Beut në Dako, Shqipëria çelësi për në Lindjen e Afërt. f.117, -19. Flamuri i Skëndërbeut, tani flamuri i Shqipërisë.
Si një skifter në qiell që fluturon
Flamuri i Skëndërbeut valon
Shqiponja dykrenare kombin krenaron
"Nga Historia e Skëndërbeut"

5. Le Temps, 3 Dhjetor 1912.

zgjatur të Janinës, nuk mund të mos vlerësohet. Thuhet se rezistenca e Janinës dhe Shkodrës bënte të mundur që Europa të themelonte një Shqipëri autonome [6]. Edhe pse në një luftë të pandërprerë, Greqia megjithatë mori pjesë në Konferencën e Ambasadorëvet.

Londrës, në Dhjetor, e thirrur për të gjetur zgjidhje efektive ndaj luftës në Ballkan.

Nënshkrimi i armëpushimit ishte shoqëruar shpejt me një njoftim mbi karakterin zyrtar që kishte propozimi i Eduard Greyt për një konferencë ambasadorësh, gjë të cilën Franca e kishte pranuar[7]. Mbledhja e parë e Konferencës u mbajt më 18 Dhjetor, [8] nën drejtimin e Sër Eduart Greyt. Por përpara hapjes se konferencës, bisedimet midis fuqive të ndryshme kishin rezultuar në qëndrime të parapërcaktuara në çështjen më të rëndësishme që do të vendoseshin, përkatësisht mbi çështjen shqiptare.

Austro-Hugaria dhe Italia në veçanti, si dy vendet më të interesuara rreth problemit shqiptar, nuk kishin ndenjur duarkryq. Që me 5 nëntor Ambasadori Austro-Hungarez në Londër i kishte telegrafuar

6. Young, Nacionalizmi dhe lufta në Lindjen e Afërt, f.201.
7. Le Temps, 6Dhjetor, 1912.
8. Po aty, 20 Dhjetor, 1912.

Beogradit: "Në bisedimet e sotme Sër Eduard Grey tha që Shqipëria duhej të ishte autonome, gjë për të cilën është arritur marrëveshje e plotë. Tani mbetej vetëm zgjerimi i kësaj autonomie territoriale"[9]. Italia ishte gjithashtu aktive. Ministri Italian në Çetinjë e informoi mbretin e malit të Zi se integriteti dhe autonomia e Shqipërisë formonte bazën e politikës italiane [10]. Ky njoftim, ndonëse i përcjellë tek fqinji verior, në të vërtetë tregonte një princip të përgjithshëm të politikës italianë. Austro-hungaria dhe Italia në fakt përshkuheshin qartë prej Bertoldit si "...palë që janë duke punuar për Autonominë e Shqipërisë". [11]

Në bisedimet e bëra përpara se të hapej Konferenca, ashtu siç del nga korespondenca e Bertoldit me ministrat e Austro Hungarisë, kufijtë jugorë, ose më qartë çështja vitale e Vlorës, zuri një vënd të dukshëm. Kërkesat e Greqisë ndaj këtij rajoni, me një rëndësi të posaçme, gjetën një mbrojtje të zjarrtë prej, Venizellos. Ky i fundit u pajtua me propozimin e Ministrit Italian të Punëve të Jashtme, San Guiliano që Italia dhe Austro-Hungaria, duhej

9. Austro-Hungaria- Dokumente Diplomatike rreth çështjeve Ballkanike. 10. -1912-'13, Nr.75, Mensdorff përBercthold.
10. Po aty, nr.98. fon Giesel për Berchtold, 13 Nëntor 1912.
11. Po aty, nr 147. Berchtold për fon Braun, 3 Dhjetor 1912.



Harta 1 Harta 2 Harta 3

Harta 1 - *Propozimet Austro-Hungareze dhe Ruse, Dhjetor 1912.* **Harta 2.** - *Kërkesat Austro-Hungareze dhe Italiane, kërkesat e Venizellosit dhe linja e vendosur prej Konferencës së Ambasadorëve, Gusht 1913.* **Harta 3.** - *Kufijtë e propozuar prej Aleatëve Ballkanikë, Janar 1913. (Marrë nga Ministria e Punëve të Jashtme Austro-Hungareze)*

t'i deklaronin zyrtarisht qeverisë Greke pamundësinë e tyre për të lejuar aneksimin e Vlorës dhe ishullit të Sazanit prej kësaj të fundit[12]. Por në të njëjtën kohë ai kërkonte tërë gadishullin e Kepit Glossa dhe një port në gjirin e Vlorës për Greqinë. Megjithatë ai e njihte të drejtën e ekzistencës për një shtet shqiptar, të mbështetur në principet e nacionalitetit që jepte siguri se kufijtë e tij nuk do të shkelnin mbi sferën greke të interesave dhe kufijtë greke ku flitej kjo gjuhë. Këta kufij, siç pohonte ai, fillonin diçka në vri të Vlorës.[13] Në kërkesat e tyre lidhur me Vlorën dhe Sazanin, Roma dhe Vjena patën dhe mbështetjen e Berlinit [14]. Ndaj kërkesave të Venizellosit për marrjen e një pjese të gjirit dhe të një porti, Qeveria italiane ra dakort me 10 Dhjetor, me kusht që Vlora t'i mbetej Shqipërisë. Në të njëjtën ditë Bertoldi informoi ministrin Austro-Hungarez në Romë se ai kishte marrë vesh nëpërmjet ambasadorit italian në Vjenë, Dukës së Avarnës, se Consulta i ishte rikthyer propozimit të Poinkares në lidhje me kufijtë jugorë të Shqipërisë së re. Sipas këtij propozimi vija do të kalonte në

12. Austro -Hungaria, Dokumente Diplomatike rreth çështjeve ballkanike. 1912-'13, nr.75. Mensdorff per Berchotold.

13. Po aty, nr.154, Berchtold për fon Merey, 8 Dhjetor 1912.

14. Po aty, nr.155, Szogyeny për Berchtold, 9 Dhjetor 1912.

bregdetin e Butrintit. San Guliano, duke analizuar dëshirën greke për të përfituar rajonin bregdetar të Himarës si kërkesë të tejskajshme, por duke vlerësuar se Janina i duhej dhënë asaj për shkak të aspiratave ortodokse greke, favorizonte taktikat e kalimit të kufirit në Lumin Kallamas dhe kështu lejonte që Janina t'i dilte duarsh Shqipërisë. "Kjo do të përbënte një bazë për diskutim duke i lëshuar pe Greqisë, por Vlora kurrsesi nuk do t'i lihej Mbretërisë Greke."[15]

Ministri Austro-Hungarez në Athinë, von Braun, raportonte më 14 Dhjetor se ideja për pavarësinë e Shqipërisë nuk është pritur mirë në Athinë, megjithëse dukej se ishte hequr dorë nga ideja e copëtimit të saj.

Për më tepër burrat e shtetit grek vazhdimisht deklaronin se ata nuk dëshironin ndonjë pjesë të Shqipërisë, por nuk ishte e qartë se ç'farë kuptonin ata kur i referoheshin Epirit Grek. Von Braun e lejoi elasticitetin e kufijve të vërtetë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Venizellosi e përshkoi vijën kufitare nga burimi i lumit Vjosa pak më në veri të Përmetit duke e shtrirë atë më në veri të Korçës, Por në këtë pikë Von Braun shënoi se Venizellosi kishte lëshuar

15. Po aty, nr.161, Berchtold për fon Merey, 10 Dhjetor 1912.

tanimë pe sa i takon asaj që kishte të bënte me kursin e ultësirës së Vjosës, po të kemi parasysh heqjen dore prej kërkesave ndaj Vlorës [16].

Ndërsa, përpara se të hapej konferenca, qëndrimi i Austro-Hungarisë dhe Italisë favorizonte një Shqipëri të madhe dhe autonome, kurse Greqia punonte për shtrirjen e kufijve të saj drejt veriut, qëndrimi i Francës ishte thuajse i papërcaktuar. Në kundërshtim me aleancën treopalëshe, Poincare dëshironte t'i shikonte kufijtë e Shqiërisë sa të ishte e mundur më të cunguar[17].

Që në hapjen e Konferencës së Ambasadorëve u ra praktikisht dakort për autonominë dhe asnjanësinë e Shqipërisë. Në konferencë, instruksioni i dhënë i Mensdorffit, Ambasador i Austro-Hungarisë në Londër, e vinte theksin para së gjithash në një organizëm për Shqipërinë i cili do t'i lejonte asaj zhvillimin autonom. E një rëndësie të dorës së dytë ishte çështja në se a do të kishte pavarësi të plotë apo do të ruhej ndonjë farë kontrolli mbi të nga ana e sulltanit. Në të dyja rastet autonomia dhe neutraliteti i Shqipërisë do të duhej të deklarohej prej të gjitha Fuqive të Mëdha po aq sa edhe prej

16. Po aty, nr.164, Fon Broun për Berchtold, 14 Dhjetor 1912.
17. Schreiner, Diplomacia e Antantes në Botë, f.434.

Shteteve Ballkanike[18]. Ajo çfarë theksonte Franca ishte diçka e ndryshme. Poincare e këshilloi ambasadorin francez në Londër, Mr. Paul Cambon, që ai të mos pranonte një autonomi të plotë për Shqipërinë dhe ndjente keqardhje kur përmendej ky term dhe liheshin mënjanë referencat ndaj asnjanësisë dhe kontrollit prej Fuqive.

Kontrolli europjan mbi këtë çështje ishte i një rëndësie parësore për Francën.[19]

Veprimtaritë e fillimit të punës së Konfrerencës në takimet e saj të para u përmblodhën në një deklaratë zyrtare të lëshuar me 21 Dhjetor nga ana e Forein Ofisit Britanik:

"Ambasadorët u kanë rekomanduar Qeverive të tyre dhe më vonë i kanë pranuar principet e një Shqipërie autonome, me një klauzole që garanton ndaj Serbisë dalje për tregti në Adriatik. Të gjashtë qeveritë janë marrë vesh rreth principeve të atyre pikave"[20].

Gjatë një ndërprerjeje të shkurtër që u bë, Poincare u muar me çështje në pikat e tyre të përgjithshme

18. Austro-Hungaria, Po aty, nr.166, Berchtold për Mansdorff, 15 Dhjetor 1912.

19. Francë, Dokumente diplomatike mbi çështjen ballkanike, 1912-'14, nr.24. Poincare për Paul Cambonin.

20. The Times, (Londër), 21 Dhjetor 1912.

gjatë një fjalimi të mbajtur në Senatin Francez më 21 Dhjetor. Me atë rast ai veç të tjerash tha:

"Eshtë padyshim zgjidhja më e natyrshme dhe e paanshme zotërinj, që Ballkani që tani e tutje tu takojë popujve të Ballkanit, grekëve, serbëve, malazezëve, shqiptarëve. Kjo sjell atë që seicili të paraqesë garancitë më të mira të qëndrueshmërisë dhe stabilitetit.

Në bisedimet që po mbahen në Londër për këtë problem... unë shpresoj se kjo pikë do të adoptohet pa vështirësi prej të gjitha Fuqive. Që tani principet e një Shqipërie autonome nën kontrollin e të gjitha Fuqive të Mëdha duke përfshirë këtu edhe francën është pranuar... Mbetet përcaktimi i regjimit dhe kufijve të Shqipërisë. Në këtë përcaktim ne nuk do të harrojmë të marrim parasyshë interesat e grekëve, bullgarëve, serbëve dhe malazezëve" [21].

Përpara se Konferenca të fillonte mbledhjen e saj në Londër më 2 Janar 1913, shtetet ballkanike të interesuara rreth çështjes shqiptare dhe banorët e territoreve përkatëse u ngritën në veprim. Shqiptarët vetë ishin të etur për të njohur vlefshmërinë e përpjekjeve të Austro-Hungarisë dhe Italisë për

21. Francë, Documenta diplomatike mbi çështjen Ballkanike, 1912-'14, II, nr.472.

autonominë e Shqipërisë. Ismail Qemali i paraqiti vetë falenderimet konsujve të dy vendeve në Vlorë ndërsa Sër Eduard Greyt dhe Ministrave të tjerë të Punëve të Jashtme të Fuqive të Mëdha ua paraqiti ato me shkrim. [22]

Në mbledhjen tjetër të Konferencës shqiptarët paraqitën një momerendum tek Sër Eduard Grey. Kërkesat e paraqitura arsyetoheshin si më poshtë ".. përse Shqipëria e ngrinte zërin e saj për të kërkuar nga Fuqitë Europiane të drejtën për të jetuar dhe mundësinë e zhvillimit normal e paqësor", sepse ata formonin një grup etnik kompakt e homogjen; që prapambetja e tyre kishte ardhur për shkak të konditave jo favorizuese që e rrethonin dhe që nënshtrimi i tyre kishte qënë vetëm në dukje pasi ata kishin qënë vazhdimisht të angazhuar në luftë për mbrojtjen e lirisë së tyre. Duke u drejtuar me thirrjen "Ballkani për popujt e ballkanit" memorandumi vazhdonte: "Të vendosësh nën dominimin e huaj, territore ku popullata shqiptare është me shumicë dotë thotë të mbjellësh farën e përjetshme të çrregullimeve dhe trazirave. "Kufijtë e përcaktuar specifikisht nuk bën të përfshihen në

22. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-13, nr.190.Lejhanec për Berchtold, 22 Dhjetor 1912.*

Epirin e Veriut. Për të siguruar marrdhënie të përzemërta me fqinjët e tyre, shqiptarët sygjeruan një komision të përzier për përcaktimin e kufijve, me arsyetimin se një trup i tillë, duke qënë i pa paragjykuar, nuk do të nxiste kundërshtime midis vendeve fqinje. [23]

Qeveria greke gjithashtu i paraqiti kërkesat e veta në një meremendum për kufijtë e Epirirt. Greqia deklaroi me forcë se duke mos qënë e angazhuar në një luftë pushtuese, por çlirimtare, dëshironte një paqe të qëndrueshme, të cilën do ta siguronte shtrirja e kufijve gjatë vijave strategjike, ekonomike, dhe etnografike. Ajo shprehimisht hoqi dorë nga kërkesat e saj ndaj Vlorës por në të njëjtën deklaroi marrjen e Janinës si absolutisht të domosdoshme. Nëpërmjet Janinës duhej të shkohej natyrshëm drejt portit të Sarandës përderisa një linjë e mbetur në bregdetin përballë Korfuzit në dorë të një fuqie tjetër, do të krijonte një rrezik të përhershëm për Greqinë. Marrja e krahinës së rëndësishme të Gjirokastrës, të cilën gjithashtu e kërkonte Greqia, arsyetohej me faktin se ky rajon, si rezultat i faktorëve gjeografike, është i lidhur me Sarandën dhe në qoftë se do të ndahej

23. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike rreth çështjeve Ballkanike, 1912-'13, nr.190. Lejhance për Brchtold 22, Dhjetor 1912.*

prej atij porti, do ta mbulonte amullia.

Për më tepër, vazhdonte dokumenti, Lugina e Korçës do të ishte gjithashtu e domosdoshme. Duke komunikuar me detin vetëm nëpërmjet Janinës dhe Sarandës, ajo formonte bashkë me Janinën e Gjirokastrën një njësi të pandashme. Përkrah argumenteve strategjike dhe ekonomike të përdorua, memorandumi përligjte aneksimin e këtij territori nga Greqia edhe mbi baza etnografike, duke shpallur se dy të tretat e banorëve ishin grekë, bile edhe po tu referohej statistikave turke. [24]

Në drejtim të Konferencës së Ambasadorëve kishin vërshuar memorandume të panumërta të së njëjtës natyrë dhe qëllim nga banorë të qyteteve të ndryshme dhe krahinave të "Epirit të Veriut". Rërkeja e kërkesave për bashkim me Greqinë u derdh prej janarit deri në prill nga epirotët në Egjypt dhe Sudan, prej Korçës, Delvinës, Himarës, Kolonjës, Përmeitit dhe Leskovikut. Si model i tonit të këtyre kërkesave mund të merret ajo që paraqiti populli i Korçës në shkurt. Në të i kërkohej Konferencës të caktonte një komision special "për të shqyrtuar aspiratat dhe ndjenjat e popullsisë së krahinës sonë",

24. "Kujtime rreth vendosjes së kufijve të Epirit". Tekst i marrë nga Valley, Irredentizmi helenik f.199-211.

duke treguar në të njëjtën kohë se ndonjë vendim i marrë në kundërshtim me aspiratat e tyre për bashkimin me Greqinë do të shpinte në katastrofë[25]. Këto përpjekje për t'i bërë pikpamjet e njohura nëpërmjet kërkesave nuk qebnë aq të suksesshme, pasi Konferenca i kushtoi pak vëmendje atyre.

Ndërkohë, gjatë dy muajve të parë të vitit të ri, vëmendja e Fuqive u përqëndrua tek kufijtë veriorë të Shqipërisë. Por gjatë kësaj periudhe dy pikëpamje të rëndësishme u zhvilluan më tej. Që më 3 janar 1913, Bertoldi insistoi që kufijtë tanimë ishin përcaktuar prej konferencës në pikat e saj esenciale, dhe qe një komision kufijsh, nëqoftëse formohej, duhej të punonte në vënd vetëm për zbatimin e vendimeve të arritura që më parë [26]. Edhe më kuptimplotë ishte uniteti i vendosur prej Ausro-Hungarisë dhe Italisë për të kundërshtuar kërkesat greke.

Bertoldi e raportoi bisedën e tij me Dukën e Avarnës me këto fjalë:

"As kabineti i Vjenës e as i Romës nuk e dhanë pëlqimin e tyre ndaj përcaktimit që ekziston në pikpamjen e Qeverisë greke dhe që ka për tendencë

25. Valley, vepër e cituar, f.220, Teksti i rezolutave të tjera f.211-257.

26. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike mbi çështjet Ballkanike, 1912-'13, nr.207, Berchtold për Mensdorff.

të ndajë nga Shqipëria territore të cilat të dy qeveritë i konsiderojne esencialisht të domosdoshme për vitalitetin e shtetit shqiptar"[27].

Më 6 mars çështja shqetësuese e kufijve veriore të Shqipërisë u la mënjanë prej Konferencës, e cila vendosi të proçedonte me diskutime rreth përcaktimit të kufijve jugore dhe juglindorë. [28] Vendimi u arrit bash në momentin kur fortesa e Janinës ra në duart e grekëve.

Kapja e Janinës prej grekëve dhe rënia e Adrianapolit më 26 mars, bënë të mundur krijimin e një baze paraprake të paqes midis aleatëve ballkanikë dhe Turqisë në fund të marsit. Kështu u sigurua që Turqia do t'u lëshonte shteteve aleate të gjitha territoret që gjendeshin në perëndim të vijës Enos-Midia me përjashtim të Shqipërisë, përcaktimi i kufijve dhe regjimi i së cilës do t'i lihej në dorë Fuqive. [29]

Duke i pranuar këto kushte të fuqive, aleatët lanë për të shqyrtuar më vonë efektin që ata duhet të njihnin si një parakusht të domosdoshëm kufijtë e

27. *Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike mbi çështjen ballkanike, 1912- '13, nr.217, Berchtld për fon Braun, , 6 Janar 1913.*
28. *Po aty, nr.313, Mensdorff për Berchtold, 6 mars, 1913.*
29. *Franca, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14, II. 194, 31 Mars 1913.*

parashikuar të Shqipërisë, duke shpresuar që ata do të përshtateshin me ato që ishin propozuar në Londër.[30]

Atëherë, fuqitë u përgjigjën se "ato ishin gati për t'u bërë të njohur aleatëve përcaktimin e kufijve veriorë dhe verilindorë të Shqipërisë dhe përcaktimet në jug dhe juglindje do tu komunikoheshin atyre menjëherë sapo të vendoseshin"[31].

Por ndërsa Shqipëria u formua, me Maqedoninë, e cila po shkëputej si rezultat i dëbimit të turqisë nga më të shumtat e dominimeve të saj në Europë, shtetet ballkanike ndjenë natyrshëm një interes të fortë e të veçantë për përcaktimin dhe ndarjen e pjesëve që po shkëputeshin. Prandaj, në pranimin e ndërmjettësimit të fuqive atat rezervuan "të drejtën që gjatë zhvillimit të bisedimeve të bisedojnë me Fuqitë e Mëdha çështjet që kishin të bënin... me fiksimin përfundimtar të kufijve" [32].

Ndërsa bisedimet në Londër po vazhdonin, ende pa u marrë një vendim lidhur me kufijtë jugorë të Shqipërisë, u përhap një thashathemnaje sipas së cilës Austro -Hungaria dhe Italia po bënin plane për ta

30. *Poa ty, nr.214, Devile për Pichon për Bombard, 9 prill, 1913.*
31. *Po aty, nr.224, Pichon për Bombard, 9 Prill , 1913.*
32. *Po aty, nr.247, 21 prill 1913.*

pushtuar dhe për ta ndarë midis tyre [33]. Kjo e detyroi Francën që të merrte masa për të shmangur [34]. Franca shfaqi shqetësimin të thellë për faktin se çështja shqiptare po trajtohej si çështje, evropiane dhe jo si një çështje të Fuqive të Aleancës Trepalëshe. Kështu Ministri i Jashtëm Francez deklaroi: "Me kërkesën e Austrisë dhe Italisë, Fuqitë vendosën dhjetorin e kaluar që Shqipëria të kishte një shtet autonom nën garancinë dhe kontrollin e tyre. Asnjëri prej tyre nuk e ka denoncuar marrveshjen e arritur; atëherë ato duhet të procedojnë besnikerisht për zbatimin e saj". Por në rast se Austro-Hungaria dhe Italia do t'i zbarkonin trupat në bregdetin shqiptar ai shpalli se "Fuqitë e tjera duhet të marrin pjesë në veprime luftarake për të treguar karakterin Evropian dhe natyrën e përkohëshme të pushtimit"[35].

Me këtë trajtim të çështjes u pajtua edhe Rusia, besnike ndaj aleateve të saj, duke shprehur besimin se detyra e Fuqive duhej të ishte e kufizuar ndaj Shqipërisë Veriore, përderisa pjesa jugore nuk ishte përcaktuar ende dhe vazhdonte të ishte e pushtuar prej trupave greke.[36] Në një përpjekje të dëshpëruar

33. Po aty, nr. 271, Jules Cambon për Pichon, 30 prill, 1913.
34. Po aty, nr.287, Pichon për Paul Cambon, 3 May, 1913.
35. Po aty, nr. 289, Pichon për Paul Cambon, 4 Maj. 1913.
36. Po aty, nr.292. Notë për ambasadën ruse, 4 Maj, 1913.

për të parandaluar konflagracionin që të mos përhapej në drejtim të Evropës, siç kishte shumë të ngjarë të ndodhte, Ministri i Jashtëm Britanik, Sër Eduart Grey, nën kryesinë e të cilit u mbajt mbledhja e ambasadorëve në Londër, punoi i vendosur për një kompromis midis kërkesave të grekëve dhe italianëve në çështjet e kufirit jugor të Shqipërisë. Përpjekjet e Greyt u mbështetën prej Pichonit, por më vonë burri i shtetit deklaroi se shtypi zyrtar i Romës nuk e bëri detyrën e vet me kujdesin e duhur derisa Franca ishte paraqitur si kundërshtar i Italisë, një pikëpamje e cila, deklaronte ai, ishte dukshëm e ndryshme nga qëndrimi i tij.[37]

Fuqitë nuk kishin arritur ende të zgjidhnin çështjën shqiptare në një mënyrë të kënaqshme ndaj interesave të veta kur më 30 maj, traktiti i Londrës vendosi paqen midis Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi dhe Serbisë, nga njëra anë dhe Turqisë, nga ana tjetër, Neni i tretë i traktatit deklaronte që Aleatet Ballkanike dhe Turqia duhet të kalonin në sovranitetin e Fuqive të Mëdha "detyrën e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë dhe të gjitha çështjet e tjera që kishin të bënin me të" [38]. Paqja e

37. Francë, Dokumente Diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14. II, nr.300, Pichon për Deville, 21 maj, 1913.
38. Tekst në Çështjet Lindore, Peace Handbook, nr.15.f.132-33.

vendosur me atë rast u provua se ishte e pasigurtë. Një muaj më vonë shpërtheu Lufta e Dytë Ballkanike e cila erdhi si rezultat i mosmarrveshjes midis aleatëve ballkanik në grindje për ndarjen e Maqedonisë, por zgjati vetëm deri në dorëzimin e Bullgarisë më 31 korrik, për tu pasuar me nënshkrimin e Paqes së Bukureshtit më 10 gusht.

Sidoqoftë kjo luftë nuk ndikoi drejtëpërsëdrejti në situatën në Shqipëri por Fuqitë në Londër vazhduan përpjekjet e tyre për të përfunduar zgjidhjen e çështjes ne një mënyrë të kënaqëshme për veten e tyre. Traktati i Londrës nuk u nënshkrua derisa delegacioni grek i përbërë prej Skuloudis, Gennadius dhe Streit, dërgoi një deklaratë në Forein Offisin Britanik. Ky dokument kërkonte që kur Fuqitë të diskutonin çështjet që cënonin interesat vitale ë Greqisë, duhej të pranonin të dëgjonin përfaqësuesit e saj dhe që ata të merrnin në konsideratë dëshirat e popullsisë së çliruar. [39]

Përpara se të arrihej tek zgjidhja e tejshtyrë e çështjes së kufijve të Shqipërisë, Franca ndërmori bisedime në një orvatje për të arritur disa lëshime të favorshme ndaj kërkesave greke nga Austro-

39. Francë, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14, II. No.308,Paul Cambon për Pichin, 31 maj 1913.

Hungaria dhe Italia. Kur M.Paul Cambon dhe Sër Eduart Grey e diskutuan këtë çështje, ky i fundit shfaqi mendimin se ata do të fillonin në kepin e Stillos në Adriatik dhe një komision ndërkombëtar do të vendoste kufijtë do të mund të gjenin njëkompromis sipas të cilit kufijtë do të fillonin në kepin e Stillos në Adriatik dhe një komision ndërkombëtar do të vendoste kufitë nëdrejtim të Korçës. Këtë proçedurë, Grey ia sugjeroi ministrit të Greqisë i cili u duk de e miratoi atë. Franca gjithashtu i kërkoi Greqisë t'ia lente Gjirokastrën Shqipërisë me shpresën që Greqia të shpërblehej duke mbajtur Korçën. [40]

Nëqoftëse Greqia do të përfitonte përveç Korçës, Ishujt e Egjeut dhe me shpresë Imbron dhe Tenedon, Kamboni shprehu mendimin se se Franca në atë rast do të ishte " e aftë ta bindte atë të pranonte një zgjidhje, të cilën ajo do të konsideronte si të favorëshme [41]. Në fakt që prej asaj kohe çështja e Shqipërisë Jugore u lidh ngushtë me atë të ishujve Egje, të cilët ishin konsideruar si kompesim i mundshëm që i afrohej Greqisë si kusht për mospranimin nga ana e Aleancës Trepalëshe të

40. Po aty, nr;316, Pichon për ambasadorët francezë 6 Qershor 1913.
41. Po aty.

kërkesave të saj ndaj pjesëve të Shqipërisë të kërkuara për shtetin e ri. Në përputhje me rekomandimin francez, dhe me qëllim që të provonte shpirtin e saj pajtues, Greqia lëshoi pe. Nëqoftëse do të kënaqeshin kërkesat e Greqisë duke i dhënë asaj ishujt të cilët i mbante Italia, ajo do të hiqte dorë nga bregdeti deri në Kepin e Stillos. Por ajo e bëri këtë sakrificë të madhe vetëm me të drejtën që në këmbim të kësaj të mbante luginën e Drinos, Përmetin dhe Korçën dhe të merrte të gjithë ishujt duke mos lënë asnjë prej tyre, ose, në se lente ndonjë, ata mund të ishin Imbro dhe Tenedo.[42] Duke mos përfillur faktin që kjo vije kufitare i ishte komunikuar Skouloudisit[43], prej qeverisë Greke, Sër Eduart Grey i kërkoi ambasadorit francez dhe rus të konsultoheshin me qeveritë e tyre rreth një sugjerimi për vendosjen e një komisioni ndërkombëtar për të tërhequr një vijë kompromisi midis tyre propozimeve italiane dhe greke vijë e cila fillon prej kepit të Stillos, Në qoftë se Fuqitë do të binin dakort me këtë propozim, kabineti i Athinës duhej të ftohej për tu marrë vesh që të opranonte kufijtë e

42. Austro-Hungaria, Nota diplomatike për përfaqësitë në vendet ballkanike, 1912-14, II nr.335, Deville për Pichon.

43. Franca, Dokumente diplomatike mbi çështjet ballkanike, 1912-14, II. No.335, Deville për Pichon, 15 qershor 1913.

përkushtuar në këtë mënyrë [44]. Franca ishte gati të pranonte me kusht që e ardhmja e ishujve do të përcaktohej në fillim. Pichon gjithashtu e përsëriti mendimin që Korça i duhej lënë Greqisë [45]. Por në këtë pikpamje Austro-Hungaria qëndroi e vendosur, falë politikë së saj për një Shqipëri të gjerë. Refuzimi nga ana e Monarkisë Dualiste ndaj propozimit të Francës çoi në një situatë delikate, në të vërtetë aq delikate, sa e detyroi Cambonin të bënte thirrje për durim të mëtejshëm, :"për të mos lejuar në asnjë mënyrë ndërprerjen e Konferencës së Londrës"[46].

Franca si mbrojtëse e interesave greke dhe kundërshtare e Aleancës Trepalëshe përdori tërë fuqinë e saj për të mbajtur Korçën për Greqinë. Delcasse, në atë kohë ambasador i Francës në Shën Petersburg, ishte veçanërisht në të mirë të kësaj pikpamje; por i pyetur prej Ser Eduart Greyt në se Austro-Hungaria paraqiste kundërshtime të pakapërcyeshme apo jo, Pichon e njoftoi Deliccase-

44. Francë, Dokumente diplomatike, II, nr.337, Paul Cambon për Pichon, 16 janar 1913. Për tekstin e shpërndarë të kabinetit të Athinës tek Skoloudis, i cili komunikoi me parlamentin grek prej Venezillosit, 25 Nëntor 1913; Çështje greko-shqiptare f.123-24.

45. Poaty, nr 341, Pichon për Paul Cambon, 17 qeshor 1913.

46. Po aty, nr.348, Pichon për Delasse, 28 Qershor 1913; Austro-Hungarias, Nota diplomatike për përfaqësitë në Ballkan, 1912-'13, nr.667, Szecsen për Berchold, 5 Korik 1913.

në se një zgjidhje e tillë nuk mund të konsiderohej zgjidhje. [47] Në pikëpamjen e kundërshtimit nga ana e monarkisë Dualiste, Pichoni i propozoi Tittonit me 3 Korrik se Austro Hungaria dhe Italia duhej që në mënyrë të kushtëzuar të pranonin propozimet e Sër Eduart Greyt për një komision për përcaktimin e kufijve, duke ja lënë me çdo kusht Gjirokastrën dhe Korçën Shqipërisë. Pichon u detyrua të nënshtrohej dhe pranoi se ai nuk do të kundërshtonte një propozim të tillë, nëse ai do të vinte nëpërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë.[48]

Instruksionet që kishte marrë Comboni në dhjetë ditët e fundit për të mbështetur Greqinë në kundërshtimet e saj për të mos e lëshuar Korçën siguruan një veprim të tillë sa të mos shpërndahej Konferenca, edhe pse ajo shfaqte papajtueshmëri të thella [49].

Në punimet e Konferencës së Ambasadorëve më 1 gusht, Sër Eduart Grey shprehu mendimin se mund të arrihej një marrëveshje në pikat më të rëndësishme siç ishte krijimi i një komisioni ndërkombëtar për përcaktimin e kufijve juglindorë

47. Po aty, Nr.363.

48. Po aty.

49. Francë, Dokumente diplomatike rreth çështjeve ballkanike, 1912-'14, II nr,395, Pichon për Paul Combon, 15 Korrik 1913.

të Shqipërisë, i instruktuar që të linte Korçën, Stylosin dhe ishullin e Sazanit Shqipërisë si dhe të neutralizonte kanalin e Korfuzit [50].

Nisur nga këto sugjerime më 11 gusht, konferenca adoptoi një rezolutë diçka më të detajuar që merrej me çështjen e kufijve dhe punën e komisionit. Klauzolat më të rëndësishme të saj ishin si më poshtë:

1- Territori mbi të cilin do të shtrihej puna e komisionit duhej të ishte i përcaktuar qartë. Kufiri perëndimor do të ishin malet që ndajnë rajonin bregdetar të mbetur në territorin shqiptar përfshirë edhe Ftelian; po kështu lugina e Gjirokasrtrës që shkon drejt verilindjes duke kapur linjën kufitare të Kazase së vjetër otomane të Korçës. Midis këtyre dy rajoneve, linja e përcakuar dhe e paraqitur me memorandum nga M.Venizellos në Konferencë do të formonte kufirin jugor të provincës të paraqitur nga komisioni, ndërsa nisur nga jugu dhe juglindja ai do të shtrihej sipas linjës së propozuar prej Austro-Hungarisë dhe Italisë.

2- Ishte vendosur tashmë që krahina bregdetare e Ftelias përfshirë ishullin e Sazanit, rajoni i vendosur

50. Austro-Hungaria, Nota diplomatike për përfaqësitë në Ballkan, 1912-'13, nr.771, Mensdorff për Berchtoldin, 1 Gusht 1913.

në veri të vijës greke si dhe kazaja e vjetër otomane e Korçës, me perëndimin dhe bregun jugor të liqenit të Ohrit... të formonin një pjesë integrale të Shqipërisë.

3- Komisioni do të fillonte punën e tij më 1 shtator dhe do të mbaronte atë më 30 nëntor 1913.

4- Për drejtimin e punës së tij, komisioni do të proçedonte në seksione, duke marrë parasysh format natyrore të luginave.

5- Përcaktimi i kufijve do të bëhej mbi baza etnografike dhe gjeografike; gjuha e popullsisë do të ishte përcaktuese...; komisioni nuk do të merrte parasyshë përpjekjet për plebisht apo manifestime të tjera politike.

7- Evakuimi i trupave grek nga territoret e dhëna Shqipërisë do të fillonte një muaj pasi komisioni të përfundonte punën e tij. [51]

Më 12 gusht në Dhomën e Komunave, Sër Eduart Grey e diskutoi çështjen e Shqipërisë si njërën prej dy çështjeve kryesore mbi të cilat Fuqitë duhej të merreshin vesh "po qe se ato ishin për lidhje dhe miqësi me njëra-tjetrqën dhe lokalizim të luftës". Sa për çështjen e kufijve ato ishin ndeshur me

51. Austro-Hungaria, Nota diplomatike dërguar përfaqësive në Ballkan 1913.13, nr.809, Berchtold për fon Braun, 12 Gusht, 1913.

vështirësi të mëdha, por ata kishin arritur më në fund një marrveshje për një përcaktim të kufijve jugorë.

"Unë e kam të qartë (tha ai) se kur deklarata të përfundohet, ajo do të balafaqohet me kritikën e ashpër të çdonjërit që e njeh çështjen në terren dhe që e sheh atë vetëmn në kuadrin e e saj lokal.

Duhet mbajtur mirë parasyshë se duke bërë këtë marrveshje me një rëndësi të dorës së parë, qëllimi është të ruhet së pari marrveshja midis Fuqive të Mëdha dhe, nëqoftë se marrveshja për Shqipërinë e ka siguruar këtë, ajo ka bërë punën më esencjalje për interesat e paqes së Evropës".[52]

Në këtë mënyrë, Konferenca e Ambasadorëve në Londër e zgjidhi në pamje problemin e vështirë të kufijve greko-shqiptar. Austro-Hungaria dhe Italia arritën kështu një sukses duke ndërtuar një shtet të pavarur shqiptar.

Megjithatë politika e shtrirjes së kufijve, u ballafaqua me kundërshtimin e grekëve, të cilët

52. Debate parlamentare, 1913, LVI, 2282 ff.Për pjesën e Sër Eduard Greyt dhe për një përmbledhje të qëndrimit të marrë prej vendeve të ndryshme në Konferencën, Lichnoësky, Misioni im në Londër, f.6-11 ku ai tha se Franca e mbështet Greqinë, që Gjermania mori anën e Austro-Hungarisë dhe Italisë, ndërsa Sër Eduart Grey, për të mos i shtënë benzinë luftës, mbështeti fort kërkesat franceze dhe ruse.

kërkonin zgjerim teritoresh drejt veriut, kryesisht me arsyetime etnologjike dhe strategjike. Për këtë Greqia gëzonte mbështetjen e Francës. Një kompromis midis dy pikpamjeve ishte i domosdoshëm për të ruajtur paqen në Europë. Pikërisht për të përcaktuar me saktësi këtë vijë kufitare kompromisi, u ngrit një komision. Baza ku do të mbështetej puna e tij ishte gjuha e folur e banorëve, një bazë e cila në një vend ku fliten dy gjuhë ishte e mbushur plot me rreziqe, rrjedhojat e të cilave dolën shumë shpejt në pah.

Zgjidhja e problemit shqiptar u bë në Konferencën e Ambasadorëve duke arritur në përcaktimin e kufijve jugorë të këtij shteti të ri në aspektet e tij më të gjëra dhe formimin e një komisioni, i cili do t'i përcaktonte kufijtë në mënyrë të detajuar në vend. Çështja ishte zgjidhur nëpërmjet një kompromisi të pranueshëm, edhe pse jo krejtësisht të kënaqshëm për fuqitë që e kishin arritur atë. Tani ajo çfarë mbetej të bëhej ishte që vendimi të vihej në jetë. Fatkeqësisht, këtu Fuqitë po i bënin llogaritë pa hanxhinë, sepse piksëpari nuk kishin marrë parasysh dëshirat e popullsisë së interesuar për këtë çështje. Ky gabim dyfishohej po të kishim parasysh vështirësitë gati të pakapërcyeshme për të përcaktuar

gjuhën në atë vënd dygjuhëfolës.

Komisioni vonoi që të mblidhej. Mbledhja e hapjes u mbajt më 4 tetor, një muaj më vonë se sa ishte planifikuar. Instruksionet e detajuara të dhëna nga Vjena për delegacionin Austro-Hungarez, mishëronin pikëpamjet austriake për kufijtë gjuhësorë dhe ishin të shoqëruara me një hartë e cila paraqiste grafikisht territorin e lënë për punën e komisionit, një përshkrim të kufirit greko-shqiptar, ashtu siç e kishte kërkuar Greqia në memorendumin e Venizellosit dhe një deklaratë rreth linjës së kompromisit, siç ishte përpunuar prej Austro-Hungarisë dhe Italisë. Monarkia Dualiste përkrahte tërheqjen e kufijve të paktën 12 km në jug të Gjirokastrës. Argumentet e paraqitura në mbështetje të kësaj ideje arsyetoheshin kështu: së pari krahina bregdetare e premtuar për Shqipërinë do të ishte proporcionalisht tejet e ngushtë nëse Lugina e Gjirokastrës do t'i jepej një vendi tjetër; së dyti rruga prej Delvinës për në Gjirokastër duhej të mbetej shqiptare në tërësinë e saj dhe së treti që Gjirokastra është një qëndër industriale për luginën dhe Saranda, porti nëpërmjet të cilit i tërë territori komunikon me botën e jashtme.[53]

53. Austro-Hungaria, Nota diplomatike dërguar përfaqësive ë vendet ballkanike, 1912-'13, nr839.

Fuqitë e njoftuan Shqipërinë mbi vendimin për vendosjen e Korçës nën pushtetin e saj. Ata njoftuan gjithashtu Greqinë dhe kur grekën në Korçë u përpoqën të organizonin kundërshtime lokale ndaj përfshirjes në shtetin shqiptar, Austro-Hungaria dhe Italia e paralajmëruan Greqinë që të mos i mbështeste këto kundërshtime [54]. Greqia nga ana e saj e informoi Bertoldin, nëpërmjet ministrit Austro-Hungarez në Athinë, që ajo u kishte dhënë urdhëra shumë të rrepta autoriteteve lokale në Epir që komisioni i kufijve jugore të Shqipërisë të mos pengohej në punën e tij. [55]

Komisioni në mbledhjen e tij të parë më 4 tetor në Manastir vendosi rregullat proçedurale që do të ndiqeshin. Një ndër rregullat proceduriale ishte që

54. Po aty, nr.860, Bercthold për Ambasadorët në Berlin, Londër, Paris dhe Shën Peterburg. 8shtator 1913.

55. Po aty, nr.869, Fustenberg për Berchtoldin, 16 shtator 1913. Komisioni i kufijve përbëhej si më poshtë: Për Anglinë, Kolonel-leitnant Doughtly-Juile, ish konsull në Adana dhe mbajtjes i të njëjtës pozitë në Adis Abeba, i ndihmuar prej Captain King, R.E. për punë topografike; për Francën, Leitnant Kolonel Lellemend i aritlerisë franceze, dhe M.Krauer, zëvëndës-konsull në Volo, për Rusinë, Kolonel Gouten, atashe ushtarak në Athinë, për Gjermaninë, Leitnant Kolonel Tirrey i Shtabit të përgjithshëm; për Austro-Hungarinë, Herr Bilinki dhe herr Buchberger, të cilët kishin mbajtur postet e konsujve të përgjithshëm dhe zëvëndës konsujve respektivisht në Janinë; për italinë, sinjor Labia, iash konsulli itaslian në Janinë i ndihmuar nga kapiten Castoldi. Shih, Lidhja Anglo-Helenike, Muarry, Epiri i Veriut më 1913.f.4.

komisioni të refuzonte t'i vinte veshin ndonjë delegacioni grek ose shqiptar për çfardo që ata mund t'i paraqisnin komisionit; gjatë shqyrtimit në zona të ndryshme komisioni do të refuzonte të shoqërohej qoftë prej civilësh grekë ose shqiptarsë , qoftë prej ushtarakësh, dhe që ndonjë shoqërues i nevojshëm do të rrinte dhe të priste në hyrjen e fshatit ku ata do të futeshin; që shërbimi i personave privat nuk do të pranohej; vendimi për të vizituar qytetin tjetër duhej marrë pasi të largoheshin nga qyteti i mëparshëm; diskutimet që kishin natyrë dioplomatike duhej të mbaheshin sekret; qeveria greke duhej të informohej për këto vendime sipas procedurës së radhës; autoriteteve pushtuese iu duhej kerkuar që të mos e besdisnin komisionin.[56] Klauzola e fundit kishte parasysh Greqine dhe kishte frikë se mos mbreteria e saj e nxiste pjesen greke te popullatës të bente rezistencë ndaj perfshirjes së saj me Shqiperinë.Ankesat për veshtirësitë me te cilat ishte ballafaquar komisioni i bëri të njohura Greqisë me 31 tetor nga Austro-Hungaria dhe Italia me nota të posaçme. Me tone kercenuese të dyja Fuqitë e informuan Greqinë se perfaqsuesit e tyre ne

56. Austro-Hungaria, Nota diplomatike per perfaqësitë në vendet ballkanike,1912-1913, nr 896, Bilinski per Berchtoldin, 5 tetor 1913.

komision ishin instruktuar që të vlerësonin si shqiptare të tëra fshatrat ku do të ndesheshin me kundërshtime.[57] Ata shtuan se qeveritë i bashkoheshin kushteve te shtruara prej ambasadorëve ne Londër ne lidhje me qendrueshmerinë e komisionit dhe evakuimin e ushtrisë greke prej teritoreve,tashmë, të caktuara për Shqiperinë. [58]

Irritimi që shkaktoi kjo notë nuk mbeti vetëm në Greqi, pasi dhe Fuqitë tjera te Mëdha kishin qenë tërësisht të panjohura me idenë e nje veprimi të tillë të ndermarrë prej kolegëve austro-hungarezë e italianë.Alarmi ndaj këtij veprimi te pavarur nga palët e Ballplatzit dhe te Consultes ishin shprehur dhe prej Francës dhe prej Anglisë,kur "Times" e Londres e karakterozonte nje veprim të tillë si"jo të pershtatshëm e madje shqetësues",bazuar në atë qe kjo tregonte nje prirje per ta trajtuar Shqiperine si nje rezervat Austro-Hungarez.[59] Incidenti, theksohej gjithashtu, ngjyrosi raportet mbi dallimet serioze të opinionit midis anëtarëve të komisionit,perderisa ankesa Austro-Hungareze kunder zyrtarëve grekë kontrastonte çuditshëm me falenderimet e fundit te

57 New York Times, 2 nentor 1913.
58. Le Temps,3 dhe 4 nentor 1913; The Times,(Londer),3 nëntor 1913.
59. The Times (Londer)3 nentor 1913.

majorit Doghty-Wylie mbi lehtësirat që i ishin dhënë komisionit.[60]

Qeveria greke,nga ana e saj na terhoqi vemendjen Fuqive te Mëdha ndaj faktit se ajo, jo vetëm që nuk e kishte penguar komisionin ne punen e tij, por perkundrazi kishte berë gjithçka të mundur për ta ndihmuar.[61] Sadoqë pergjigja greke ruhej nga të qenit nje protestë e thatë kundër veprimit të njëanshëm të dy fuqive të Aleancës Trepalëshe,nota helenike e bentë atë të qartë, sipas The Times, qeveria Greke kujdesej më shumë ndaj instruksioneve të Konferencës së Ambasadorëve se sa ndaj atyre që vinin nga Roma apo Vjena. Për shtyrjen gjashtë javë për fillimin e punës së komisionit, qeveria greke, shtonte The Times, mund "të kishte përgjegjësi të rëndë"[62].

Komisioni nuk u largua prej Manastirit për të filluar punën deri në 14 Tetor [63]. Sipas vlerësimeve të bëra prej përfaqsuesve të shtypit, të cilët e shoqëronin komisionin, ky i fundit qëndroi në fshatin e Ersekës për njëzet e dy ditë, kohë gjatë së cilës ata vizituan vetëm gjashtë fshatra dhe takuan

60. The times, (Londër), 3 nëntor 1913.
61. Po aty, 4 nëntor 1913.
62. Po aty, 6 nëntor 1913.
63. Po aty

vetëm rreth nja njëzet vetë me qëllim që të verifikonin gjuhën që flisnin banorët e asaj anë. Nisur nga ato pak njohuri që gjenden rreth veprimtarisë së komisionit, del e qartë rruga pa krye ku kishte hyrë çështja; delegatët u rreshtuan në dy kampe; ata të Alencës Trepalëshe përkrahnin atë që krahinat shqiptare, ndërsa Treshja e Antantës mori kahje tjetër, pra megjithëse gjeneratat e moshuara në një numër fshatrash flisnin shqip, tërë gjenerata e re vlerësohej prej tyre si greke në jetën e vet intelektuale, në ndjenjat dhe aspiratat e tyre.[64] Ndërsa komisioni në një amulli të plotë priste në Leskovik, Major Doughty-Wyile i propozonte Londrës telegrafisht që bisedimet të proçedonin mbi një bazë tjetër. Kur propozimi i tij i parë, i cili në dukje caktonte pika të qarta ndaj Greqisë, dështoi të fitonte pëlqimin e Austro-Hungarisë dhe të Italisë, ai sygjeroi një kompromis të dytë sipas të cilit, me qënë se nuk kishte baza të plota gjuhësore, duhej vepruar mbi baza gjeografike, ekonomike dhe strategjike.[65]

Megjithëse vdekja e Bilinskit, , delegatit Austro-Hungarez, vendin e të cilit Vjena premtoi se do ta plotësonte me një njeri më të paanshëm, i dha më shumë mundësi adaptimit të një kompromisi, prapseprapë kompromisi i propozuar përjetoi keqas shumë ndryshime në Londër përpara se të arrihej deri tek një marrveshje.[66] Por prapseprapë një kompromis i thjeshtë nuk ishte i pranueshëm, për epiriotët; dhe, siç deklaronte një vëzhgues, pakënaqësia e tyre ishte e tillë sa që një ditë do të çonte në një rezistencë të pashmangshme. Venizellosi gjithashtu ishte i pakënaqur. Ai i deklaroi Parlamentit Grek se nuk ishte i lidhur me detyrime zyrtare ndaj Konferencës së Londrës, një argument ky i bazuar në faktin se ai u kishte thënë fuqive që më parë, në rrjedhat e bisedimeve në Londër, se kufiri ekstrem i lëshimeve greke në bregdet ishte mbajtja e Korçës, Gjirokastrës dhe Përmetit nga Greqia. Në vijim të saj, pak ditë më vonë, qeveria greke paraqiti nëpërmjet përfaqësuesve të vet jashtë vendit, një ekspoze të re, më të detajuar, të rezultateve shkatërrimtare që do të sillte kompromisi i propozuar [67].

Pas shtyrjes së mëtejshme, Sër Eduard Grey doli me një propozim përfundimtar lidhur në çështjet e Shqipërisë dhe të ishujve. Duke i kërkuar Konferencës

64. De Jessen, Le Temps, 13 nëntor 1913.

65. Le Temps, 9-15 nëntor 1913, Dillon, Revista Bashkëkohore. (1913) CIV, 879-80.

66. Le Temps, 24 nëntor 1913.

67. Po aty, 27-28 nëntor, 4 dhjetor 1913. Duhet kujtuar që shtypi francez në përgjithësi dhe le Temps në veçanti ishte fuqimisht pro-grek

së Londrësë vendimin që puna e Komisionit të përcaktimit të kufijve duhet të përfundonte më 30 nëntor dhe që territori i okupuar prej grekëve duhej evokuar një muaj më pas, ai sugjeroi që përderisa komisioni nuk e kishte përfunduar punën e tij dhe për rrjedhojë, evakuimi brenda një muaji ishte i pamundur, domosdoshmërisht duheshin arritur disa marrveshje. Pra sipas kompomisit të propozuar, vija kufitare do të shkonte bashkë me lumin Sarandaporos atu ku ai lidhej me lumin Vjosa dhe prej andej do të vijonte me kufirin jugor të zonës së debatueshme për t'ju bashkuar kufijve të vendosur që zgjateshin brenda territorit nga gjiri i Ftelias. Kjo vijë ia linte Korçën Greqisë por nuk përfshinte një numër fshatrash grekë, Në komunikimin me qeverinë Britanike rreth këtij subjekti, kabineti i Athinës pretendonte se Greqia në këtë mënyrë do të humbiste 140.000 greke dhe theksonte se kufiri i ri ishte tërhequr arbitrarisht në mënyrë të tillë që t'ja linte të gjitha pikat strategjike Shqipërisë, pa bërë vlerësimin e nevojshëm për kushtet lokale ose komunikimin; megjithatë nota greke nuk paraqiste ndonjë rezistencë të fortë ndaj dëshirës së Evropës [69].

69. Le Temps, 5 dhjetor 1913 (tekst i pathënë; korrespondencë nga Berlini) The Times (Londra), 5 Dhjetor 1913.

Ndërkohë komisioni e kishte lënë Shqipërinë Jugore dhe ishte larguar për në Itali. Më 20 dhjetor erdhi njoftimi se Komisioni kishte pranuar më 17 dhjetor linjën e propozuar prej Britanisë së Madhe in toto, Ky vendim njihet si protokolli i Firences dhe merr emrin nga qyteti ku u bë veprimi zyrtar[70]. Kufijtë, siç ishin përcaktuar tashmë, fillonin prej pikës më jugore të vijës së vendosur më 11 gusht; më pas ajo vijonte drejt jugperëndimit për tek Mali Kazan në vargmalin e Gramozit, kreshta e të cilit shkonte deri tek Mavripetra; prej këndej kufiri i ri përplasej kryq me lumin Sarandaporos (në veri të Korçës), rrjedha e të cilit formonte kufijtë deri ku bashkohej me Vjosën, prej nga vija përafërsisht shoqëronte kufijtë jugorë të zonës së debatueshme për tu bashkuar me fudin e kufijve të vendosur më 11 gusht. pra në brendësi të vendit duke filluar nga gjiri i Ftelias. Sipas këtyre kufijve, lugina dhe qyteti i Gjirokastrës, Leskoviku, Delvina, Saranda, Tepelena, Përmeti, Korça, dhe Kepi i Stillos përfshiheshin brenda Shqipërisë. [71]

Megjithëse Protokolli i Firencës i vendosi kufijtë jugorë të Shqipërisë, të cilët u kishin shkaktuar

70. Po aty.
71. Po aty, 20 Dhjetor 1913, Le Temps e të njëjtës ditë.

Fuqive shumë shqetësime, u deshën afro dy muaj derisa gjashtë Fuqitë të merreshin vesh për t'i dërguar një note qeverisë greke rreth çështjeve të ishujve të Egjeut dhe të Epirit. Kjo note njoftonte që afërsisht tërë ishujt do t'i jepeshin Greqisë në se trupat greke do të largoheshin prej territoreve të lëna për Shqipërinë, dhe që qeveria greke vetë, as të mos rezistonte e as të mos nxiste ndonjë lloj rezistence ndaj atyre çfarë ishin vendosur nga Fuqitë për Shqipërinë Jugore.

Evakuimi duhej të fillonte më 1 mars me tërheqjen e trupave greke nga kazaja e Korçës dhe do të proçedonte me mënyrë të njëpasnjëshme të gjitha pikat e tjera deri më 31 mars, kohë kur do të shënohej largimi i plotë i trupave greke nga kazaja e Delvinës.[72]

Në përgjigje të këtij komunikimi tejet të vonuar, qeveria greke shprehu gadishmërinë e saj për t'u pajtuar me vendimin e Fuqive dhe pranoi të urdhëronte trupat që të lëshonin territoret e dhëna Shqipërisë brenda kohës së caktuar. Greqia vendosi të mos kundërshtonte evakuimin, por sugjeroi që fshatra të tëra në luginën e Gjirokastrës i duheshin dhënë asaj, në këmbim të shtrirjes së territorit

72. Për tekst, shih Le Tamps, 15 shkurt 1914.

shqiptar gjatë bregdetit si dhe të një pagese prej 2.500.000 franga.

Nota shkonte edhe më tej kur sygjeronte që popullsia epiriote duhej të qetësohej nga frika e garantimit të institucioneve të saj. Gjatë proçesit të evakuimit dhe në periudhën e vështirë më pas, duheshin marrë masa për të risiguruar njerëzit që pasuria e tyre nuk ishte në rrezik. Një aneks përmbante një ratifikim të sygjeruar për kufijtë në Korçë. [73]

Shumë shpejt u përhapën thashetheme se elementë të caktruar në popullatën epiriote ishin duke bërë rezistencë me arme ndaj përfshirjes së tyre në Shqipëri. Më 16 shkurt qeverisë britanike iu kërkua të spjegonte në Dhomën e Komunave: "Nëqoftëse shihet se banorët e krahinës e kanë kundërshtuar një përfshirje të tillë dhe janë të vendosur për ta kundërshtuar atë me forcën e armëve, a është e pergatitur Qeveria e Madhërisë së saj që të pranojë shtrëngimin që rrjedh

73. Për tekst shih, po aty 23 Shkurt 1914. Disa prej këtyre sygjerimeve ishin rezultat i një turi nëpër kryeqytetet evropiane të Venizellosit në dhjetor të viti 1913. Shih The Times (Londër) 16 shkurt 1914. Gjatë tërë periudhës së diskutimit Lidhja Anglo-Helenike e themeluar në atë kohë për të forcuar ndjenjat tradicionale britanike për filohelenizmin-ishte aktive. Për shprehjen e opinionit në Dhomën e Komunave, shih ato të Mr.R.P.O'Connor, 29 Maj 1913; "A mund të ketë gjë më monstruoze ose absurde se sa të vendosësh këtë popullatë të gjërë greke nën kontrollin e një race tjetër?"

prej këtij kundërshtimi?" Nënsekretari i shtetit për punën e jashtme, duke iu referuar komunikimit të vazhdueshëm me qeverinë greke në përgjigje të kësaj pyetje besonte "se asnjë çështje për masa shtrënguese nuk do të ngrihej" [74]. Por popullsia e Gjirokastrës shpresonte tek rishikimi i kufijve të krahinës së saj, siç ishte kërkuar në notën greke të 21 shkurtit. Veçanërisht inkurajuese ishte vizita e Venizellosit në kryeqytetet evropiane, ku Ministrit grek i ishte lënë të shpresonte për mundësinë e një rishikimi të tillë që të plotësoheshin aspiratat greke me një numër të caktuar fshatrash afër Gjirokastrës. Kur ky lajm iu bë i njohur popullsisë, shpresat e saj u forcuan.[75]

Ndërkohë mori formë rritja e lëvizjes për rezistencë ndaj përfshirjes me Shqipërinë. Javët në vijim dëshmuan shpalljen e autonomisë së Epirit në Himarë, Gjirokastër, Sarandë dhe Delvinë, "përkundër keshillave për ta shtyrë atë, të afruara nga udhëheqësit shqiptarë."[76] Lëvizja autonomiste

Gjithashtu ajo e Mr. Walter Guiness, 8 maj "Greqia kërkonte territore të Shqipërisë Jugore ku raca shqiptare është në shumicë absolute" Debate parlamentare, (1913) LIII, 371; LII, 1304. Për opinionin francez bashkëkohor, shih le Temps, 8 dhjetor dhe 12 prill 1913 (në favor të plebishitit)

74. Debate parlamentare. Commons (1914) LVII, 550.

75. Le Temps, 4 ,ars 1914.

76. The Times (Londër) 25 shkurt 1914. Le Temps, 26 shkurt, 4 mars.

mori formën e vet të plotë, kur më 28 shkurt lajmi se udhëheqësi grek Zografos ishte emëruar si president i qeverisë provizore të Epirit autonom në një tubim publik në Gjirokastër i ishte bërë i njohur Durrësit, vendit ku ishte vendosur Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, organ i ngritur nga ana e Fuqive për të qeverisur Shqipërinë, me sundimtar të zgjedhur më në fund, princin gjerman Vilhelm Vidi [77]. Kur u shpall pavarësia e Epirit të Veriut më 2 mars në Gjirokastër, Zografosi mbajti një fjalim kur deklaroi pamundësinë e nënshtrimit ndaj zgjedhës së një populli barbar dhe shtoi, dramatikisht, se epiriotët, të pazot për të përmbushur endrrën pesë shekullore, kishin vendosur që të vdisnin për lirinë e tyre.[78]

Lëvizja e autonomisë në Epirin e Veriut u kryesua prej Zografosit dhe Karapanos, të cilët paraqitën vetveten "si një komitet ekzekutiv me funksionet e një qeverie provizore".[79] Politika e Zografosit në fillim ishte shpalosur nëpërmjet deklaratave të bëra në vigjilje të nisjes së tij nga Athina për në Gjirokastër. Lëvizja, deklarohet ai, ishte provokuar

77. Debate parlamentare. (1914) LIX, 852.

78. Le Temps, 5 mars 1914.

79. Lidhja anglo-helenike. Nr.10.f.7. Për shpalljen e bërë prej qeverisë autonome të Epirit, shih Le Temps, 9 mars 1914.

prej nevojës për të mbrojtur ekzistencën e popullsisë epiriote. Në pikpamjen e tij ekzistonin tre mënyra për mbrojtjen e popullsisë prej rrënimit fatal: e para, autonomi e plotë nën skeptrin e princit të Shqipërisë; e dyta, një autonomi shumë e gjërë administrative ose kantonale e bazuar në një xhandarmëri të rekrutuar posaçërisht midis njerëzve të krahinës në fjalë; dhe e treta, pushtim evropian dhe administrim plotësiosht i mjaftueshëm për të qartësuar të vërtetën mbi situatën dhe që duhej të zgjaste deri sa tërheqja të mos shkaktonte rreziqe. "Në qoftë se Europa dëshiron që të shmangë fatkeqësinë e të lenurit prapa të tymit dhe rrënojave të invadorëve shqiptarë, ajo duhet të ndërhyjë në kohë, për të marrë masa të cilat, pa modifikuar bazat e vendimiit të Fuqive, do të siguronte një popull dhe ruante principet e humanizmit".[80]

Pozita e qeverisë greke gjatë revolucionit në Epirin e Veriut ishte e një natyre të pa anshme. Me nxitim, më 9 mars, u deklarua një bllokadë e portit të Sarandës, "tani në dorën e kryengritësve"[81]. Qeveria greke, në fakt, ndaloi një demonstratë në Athinë të organizuar prej Partisë Punëtore në favor të

80. Le Temps, 3 mars 1914.

81. Gazetat shtetërore dhe të huaja britanike, pjesa e parë 1914. CVII, 137

epiriotëve; thuhet që ky përbën rastin e parë që demostrata të tilla të ishin ndaluar në Greqi [82]. Se sa larg shkoi qeveria greke në përpjekje për të ruajtur një qëndrim korrekt tregohet në deklaratën e Zografosit, i cili vetë tha se ai kishte shkaktuar armiqësinë e qarqeve zyrtare të Athinës dhe që qeveria kishte "keqkuptuar në mënyrë të çuditshme shkallën e detyrimeve të veta ndaj Fuqive. Ajo ka bllokuar Sarandën, duke penguar furnizimet dhe ardhjen e ushqimeve të ushtarëve tanë. Janë lëshuar urdhëra për ndalimin e oficerëve, ushtarëve dhe të tjerëve nga të ardhurit në ndihmë për ne. Tregtarët janë paralajmëruar që të mos na furnizonin me armë dhe municione. Dërgesat, madje edhe letrat private janë hapur e kontrolluar.[83]

Sa i takonte qëndrimit të qeverisë greke, shefi i shtabit i forcave epiriote kolonel Doulis, ia nënshtroi komisionin e tij ushtrisë helenike, përpara se t'i bashkoheshin revolucionarëve në Epir. [84] Ideja se mos qeveria greke kishte inkurajuar në ndonjë mënyrë lëvizjen revolucionare u kundërshtuá formalisht prej ministrit grek në Londër, Gennadius, i cili vepronte sipas istruksioneve të marra nga

82. The Times (Londër) 23 mars 1914

83. Lidhja anglo-helenike, nr.10.f.13.

84. Le Temps, 24 mars 1914.

Athina. Ai deklaroi se si rezultat i masave të marra prej qeverisë, ai i kishte tendosur marrdhëniet e tij me Zografosin deri në një pikë thyerje, pa përmendur këtu ndjenjat që zgjoi në vetë Greqinë. Kështu ai me së fundi theksoi konditat e vajtueshme, për të cilat kishte arsye të plota për tu frikësuar, e që do të bëheshin shumë shpejt edhe më keq, por që nuk do të ishin të tilla po t'u ishte kushtuar vëmendje sugjeimëve të bëra në notën greke të 21 shkurtit[85].

Njëra prej arsyeve kryesore të revoltës qëndronte padyshim tek pazotësia e dukshme e Fuqive për t'i dhënë një përgjigje përfundimtare kërkesave greke. Fuqitë, sado që ishin të informuara prej qeverisë greke që graviteti i situatës kërkonte një vendim urgjent dhe se metoda e evakuimit ishte e pakënaqshme po të kihej parasyshë paaftësia e xhandarmnërisë shqiptare për të ruajtur rendin, [86] vazhdonin të mos kthenin përgjijge. Ndjenjat në Epir ishin aq të forta sa evakuimi i ballafaqonte në të vërtetë ministrat grekkë me një seri problemesh; ata e konsideronin evakuimin e krahinave pa

85. The Times (Londër) 20 Prill 1914, rishtypur në Lidhjen anglo-helenike, nr.10 prill, f.1. Për më shumë mospranim të bashkëpunimit midis Gjirokastrës dhe Athinës shih de Jassen në Le Temps, 23 prill 1914; gjithashtu The Times (Londër), 17 prill, 1914.

86. Le Temps, 15 mars, 23 prill 1914

formalitetet e nevojshme, si një ballafaqim të trupave greke me mundësinë e dezertimit ose të goditjes mbi vëllezërit e tyre. Ndërkohë që të dyja, Korça dhe Moschopolis, iu kthyen xhandarëve shqiptarë nën komandën e oficerëve danezë [87], por evakuimi i krahinave të mbetura u shty në pritje të një përgjigje të favorshme nga Fuqitë. Një përgjigje Austro-Italiane, paraqitja e të cilës deklarohej se ishte bërë për shkak të një keqkuptimi, pasi Aleanca Trepalëshe nuk kishte patur për qëllim që të ndante veten nga ujdia me Evropën në këtë çështje, pranonte ratifikimin e Gjirokastrës, por jo të Korçës. E megjithatë karakteri i saj i përgjithshëm, thjeshtë iu konfirmonte ekstremistëve besimin e tyre që autonomia e plotë ishte e vetmja zgjidhje e mundshme. [88] Qeveria e Athinës edhe më tej shpërndau një note tek përfaqësuesit e Fuqive më 30 mars, duke kërkuar që në momentin kur trupat helenike të përqëndroheshin për t'u evakuar, Fuqitë nuk duhej të çmonin atë si një rast të volitshëm për të dhënë një përgjigje në lidhje me garancitë e kërkuara për popullatën epiriote në komunikatën greke të 21 shkurtit [89]. Shtyrja që Fuqitë i bënë

87. The Times, (Londër) 18 mars 1914; Le Temps, 4,18,19, mars 1914.

88. Le Temps, 14 mars 1914.

89. The Times (Londër) 31 mars 1914.

përgatitjes së kësaj përgjigje u kthye në një çështje politike në Domën e Komunëve të Britanisë, Sër Eduart Grey tha më 2 prill se evakuimi, për t'u kryer plotësisht deri më 31 mars, duhej të fillonte deri brenda pak ditësh, kur qeveria greke u sugjeroi Fuqive dëshirën për të shtyrë tërheqjen e trupave të tyre në interes të rendit publik, duke zgjatur kështu përfundimin e bisedimeve midis qeverive shqiptare dhe qeverisë së përkohëshme të "Epirit të Veriut". Deri sot asnjë përgjigje nuk iu kthye atij propozimi.[90]

Bisedimet që patën si subjekt përgjigjen vazhduan në një përpjekje për të ardhur tek një marrveshje midis Fuqive, dhe më së fundi, përgjigja e propozuar prej tre fuqive të Antantës, u pranua prej Aleancës trepalëshe, kështu që më 24 prill, Fuqitë i dhanë një përgjigje notës greke të 21 shkurtit.[91]

Kjo komunikatë deklaronte se Fuqitë ishin gati të ushtronin të gjithë influencën e tyre për të vënë në jetë principet e barazisë së plotë fetare dhe gjuhësore, tashmë të vendosura prej Komisionit të Kontrollit, dhe ishin të prirura për t'i rekomanduar Qeverisë Shqiptare që ajo të vlerësojë sugjerimin e Qeverisë Greke në lidhje me rekrutimin e elementeve lokale

90. Debate parlamentare (1914) LX, 1320.
91. Po aty, 9 prill 1914. Momerendumi për Epirin e Veriut. f.21

në xhandarmëri. Nota shkonte edhe më tej kur njoftonte se, nëse një marrveshje mund të zbatohej midis Fuqive të ndryshme dhe Greqise në rajonin e Gjirokastrës, ata ishin gati ta vinin atë në jetë, por duheshin bërë vëzhgime për të parë nëse dëshirat e Qeverisë greke mund të pajtoheshin me linjën e adaptuar prej gjashtë Fuqive për Korçën [92]. Rezultat i kësaj komunikate ishte përshpejtimi i menjëhershëm i evakuimit, i cili përfundoi me 28 prill, pesë muaj pas kohës së caktuar për këtë.[93]. Një përgjigje e shpejtë e Fuqive, do të ishte padyshim e efektshme për parandalimin e lëvizjes revolucionare, e cila kishte gjetur një terren të përshtatshëm pikërisht prej pasigurisë dhe ankthit të shkaktuara prej kësaj shtyrje.

Forcat revoluciste dhe ata të Shqipërisë vazhduan në luftë të parregullt, megjithëse Zografos i kishte dërguar më parë një paralajmërim Komisionit të kontrolli, duke kërcënuar se do të hakmerrej në qoftë se xhandarmëria shqiptare i tejkalonte kufijtë epiriote.[94]

Në fund të marsit qeveria shqiptare iu kërkoi formalisht Fuqive që të vinin në veprim influencën

92. Për tekst shih Le Temps, 26 prill 1914.
93. Po aty, 27, 28, 30 prill 1914.
94. The Times, (Londër) 12 mars 1914.

e tyre ndaj Greqisë për t'i dhënë fund "situatës së mjerueshme" që ekzistonte në Epir, duke tërhequr vëmendjen për konfliketet e fundit dhe njoftoi gjithashtu se, megjithëse trupat greke po tërhiqeshin, vendin e tyre po e zinin bandat e comitadijis, të organizuara dhe të armatosura prej autoriteteve greke.[95] Të dyja palët raportonin për grabitje dhe brutalitet [96]. Në prill ushtria epiriote, së cilës i shtoheshin çdo ditë rekrutë të rinj, thuhej se numëronte nja pesëmijë burra, shumica prej të cilëve ishin ish pjesmarrës në ushtrinë greke. Në mbështetje të këtyre trupave "të rregullt" ishin trupat e parregullta vullnetare në një numër thuajse të barabartë me ato "të rregulltat", me të cilat ato dalë nga dalë po shkriheshin.[97]

Programi për të cilin qeveria autonome e Epirit po luftonte, mishërohej në një listë kërkesash për garancitë dhe privilegjet e caktuara, që ia kishin paraqitur zyrtarisht qeverisë shqiptare. Këto kërkesa përfshinin administrimin prej dy drejtuesve të kombësisë zviceriane dhe daneze, ndërtimin e një asambleje formale të një modeli si ai i Kroacisë, përfshirjen e elementeve kristiane në xhandarmëri,

95. Po aty, 30 mars 1914.
96. Debate parlamentare (1914) LX, 5-6
97. Lidhja anglo-helenike, nr.10. f.10-11.

të cilët nuk do të duheshin të dërgoheshin jashtë Epirit, liri të plotë për shkollat greke, liri të plotë fetare, si dhe dhënia Himarës i të gjitha privilegjeve që ajo gëzonte nën sulltanin.[98]

Qeveria shqiptare ishte në prag të diskutimit me epiriotët mbi një bazë të garancve të kënaqshme, megjithëse jo autonomi, kur Esat Pasha, Ministri Shqiptar i Luftës, filloi mobilizimin kundër kryengritësve. Megjithatë, masat e represionit, të propozuara prej tij, nuk arritën që të marrin miratimin e Komisionit të Kontrollit, i cili këshilloi bisedime dhe garanci ndaj lëshimeve të domosdoshme. Komisioneri Britanik, Lamp, veçanërisht, vendosi përpara qeverisë shqiptare kokëfortësinë e një përpjekje të tillë përballë pengesave si: ushtria e stërvitur keq, gjëndje e pakënaqshme e financave të shtetit të ri dhe rreziku i komplikimeve me Malin e Zi. [99] Këto këshilla binin më shumë në sy po të kemi parasyshë pazotësinë e shqiptarëve për të shtypur kryengritjen në rastet e konflikteve të përsëritura midis forcave shqiptare dhe epiriote. Zografosi nga ana e tij, i impresionoi

98. Për tekst shih Le Temps, 28 mars 1914.
99. Le Temps, 29 mars 1914. Afati i propozuar u pranua prej delegatit epiriot. Po aty, 30 mars 1914. The Times (Londër) 8 prill 1914; Le Temps 10 prill 1914.

vëzhguesit me përmbajtjen dhe dëshirën për të bërë një zgjidhje me mënyra paqësore. Ai insistoi vetëm në një autonomi administrative, jo në bashkimin me Greqinë. [100]

Megjithatë duhet thënë se vetë përmbajtja e tij nuk hasej në të njëjtën trajtë tek pasuesit e tij, të cilët ishin shumë më agresivë.

Bisedimet midis Shqipërisë dhe kryengritësve epiriotë në të vërtetë nuk filluan deri në fillim të majit. Ndërprerja e armiqësive erdhi si rezultat i ndërhyrjes së Komisionit të Kontrollit, të cilët afruan një takim në Sarandë ose diku tjetër për të trajtuar garancitë e kërkuara, ekzekutimi i të cilave i duhej besuar Komisionit. Kur kjo ofertë u pranua, anëtarët e Komisionit u nisën për në Sarandë për tu takuar me Zografosin; por bisedimet përfundimtare filluan në ishullin e Korfuzit, larg prej skenëës së veprimeve të drejtpërdrejta.[101]

Epiriotët fillimisht luftuan për autonomi, Megjithatë përveç kërkesave të fillimit, ata tani kërkuan që qeveritari kryesor dhe zyrtarët e lartë në qytetet kryesore duhej të ishin kristianë ortodoksë, që epiriotët nuk do të ishin subjekt i shërbimit

100. De Jessen në Le Temps, 23 Prill, 1 Maj 1914.

101. Le Temps, 8,9 maj 1914; gjithashtu po aty, 10 maj për komente më të plota prej shtypit grek në këtë ndërhyrje.

ushtarak madje as në kohë lufte, që liria fetare dhe arsimore e grekëve duhej të shtrihej deri në Vlorë e Durrës, dhe që porti i Sarandës dhe Himarës duhej të deklaroheshin të lirë. Garancitë e afruara prej anëtarëve të Komisionit të Kontrollit, nga ana tjetër, përfshinin: së pari, lirinë e komunitetit ortodoks, lirinë e komuniteteve ortodokse për të përdorur gjuhën greke në shkolla, por nevojën e shqipes në shkollat fillore; së dyti, një xhandarmëri të përbërë me preferencë burrat e krahinës; së treti, konstituimi i Korçës dhe Gjirokastrës si kantone administrative me vetqeverisje lokale por me këshilla të kryesuara prej prefektësh që përfaqësojnë qeverinë qëndrore dhe të emëruar prej saj; dhe së katërti masa të caktuara për lëshimin përkohësisht, por menjëherë të Gjirokastrës..[102]

Frika, e cila kishte arritur deri në pasiguri se mos konferenca e Korfuzit do të shpërbëhej, apo së mos trupat austro-hungareze dhe italiane do të pushtonin Shqipërinë Jugore, i dhanë lehtësi të dyfishtë arritjes së një kompromisi. [103] Sidoqoftë, delegatët epiriotë

102. Po aty, 17 prill, 11 maj 1914.

103. Shih The Times (Londër) 12 maj 1914 për njoftimin e qeverisë greke nga ana e prefektit të Janinës ndaj këtij efekti. Shih gjithashtu Laoy, Dokumente sekreten f.71 për marrveshjen austro-italiane, lidhur me Shqipërinë, 8 maj 1913.

dhe Komisioni i Kontrollit që përfaqësonin një shtet të ri shqiptar, nënshkruan më 17 maj 1914 një marrveshje sigurimi ndaj kërkesave kryesore të epiriotëve.

Sipas pikave të marrveshjes së Korfuzit, epiriotët e përftuan autonominë për të cilën ata kishin luftuar. Ruajtja dhe zbatimi i organizimit paraprak iu besua komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, siç iu besua edhe organizimi i administratës publike dhe departamentit të drejtësisë e financës në provincën autonome të "Epirit të Veriut". Qeveria shqiptare, në marrveshje me Komisionin e Kontrollit, kishte fuqinë për të emëruar dhe shkarkuar qeveritarët dhe zyrtarët e lartë, të cilët duhej të zgjidheshin në përpjestim me përkatësinë fetare. Komisioni kishte gjithashtu për detyrë mbikqyrjen e përcaktimit dhe ndarjes së dy krahinave të Korçës dhe Gjirokastrës prej të cilave përbëhej "Epiri i Veriut"; nëse ndonjëherë do të zgjidhej çështja e këtyre kufijve, ajo nuk mund të modifikohej pa pranimin e Fuqive. Një klauzole e veçantë i kushtohej xhandarmërisë lokale, e cila duhej të përbëhej nga pjesëmarrës me fe të ndryshme në proporcion me numrin e tyre, dhe të shërbenin jashtë provincës vetëm për një periudhë të caktuar dhe, vetëm në raste force

majeure, siç cilësohej prej komisionit. Ndalohej përdorimi i njësive ushtarake jo-vendase në krahinat jugore, me përjashtim në raste lufte ose revolucioni; njihej e drejta e komuniteteve ortodokse; në këto komunitete, gjuha greke duhej të ishte gjuha e shkollës, por në të tria klasat e fillores shqipja duhej mësuar përkrah me atë greke me përjashtim të edukatës fetare, e cila duhej të ishte ekskluvizisht greke. Përdorimi i te dyja gjuhëve, asaj shqipe dhe greke duhej të ishte e sigurtë përpara të gjitha autoriteteve, duke përfshirë gjykatat dhe këshillat e zgjedhura. Nenet përmbyllëse të marrëveshjes siguronin një metodë specifike të punës, masa të posaçme përkrahje, amnesti të plotë për epiriotët, dhe një deklaratë të lëshuar si garanci për zbatimin e klauzolave të lartpërmendura prej Fuqive. Kësaj iu bashkangjitën dispozita të veçanta që kishin të bënin me Himarën, për të ruajtur privilegjet që gëzonte gjatë regjimit osman.[104] Marrveshja e Korfuzit u ratifikua prej përfaqësueseve të Fuqive të mëdha në Athinë më 18 qeshor dhe prej qeverisë shqiptare më 23 qershor. [105]

104. Për tekst shih Greqia, Propoganda, delegacioni, Memorandumi mbi Epirin e Veriut. Apendiks No; Greqia përpara Konferencës së Paqes, Shoqëria amerikano-helenike. XXVIII.

105. Frangulis, Çështja e Epirit të Veriut në Konferencën e Paqes f.17,18.

Duke garantuar të drejtat e pakicës greke në shtetin e ri shqiptar, marrveshja e Korfuzit siguroi në dukje, një zgjidhje të kënaqshme po të merren parasyshë vështirësitë që kishin kërcënuar paqen e Europës nga mundësia e përfshirjes së Fuqive të Mëdha në këtë konflikt. Pranimi i një periudhe të tillë paqeje në mënyrë që marrëveshja të zbatohej pa ndërhyrjen e Mbretërisë Greke, mund të sillte një farë qëndrueshmërie. Por përpara se sa ajo të ratifikohej dhe po kështu, përpara se të jepej një gjykim i shëndoshë për të, shpërtheu Lufta e Madhe.

IV. Shqipëria Jugore dhe Lufta e Madhe

Që prej qershorit, të 1914-ës çështja Shqiptare u bë një çështje shqetësuese për Evropën, kështu që shpërthim i luftës së madhe e gjeti Shqipërinë në një situatë tejet të paqëndrueshme[1]. Djegiet, ndjekjet, persekutimet, vazhdonin pa u ndaluar në "Epirin e Veriut". Qeveria qendrore shqiptare e princ Vidit, nuk ishte e zonja ta shtrinte autoritetin e saj jashtë Durrësit. Fatkeqësisht, në bashkëpunim me njerëzit e tij, për të cilën nuk është e nevojshme të flitet këtu, Princ Vidi, në fillim të shtatorit e la qetësisht vendin për të mos u kthyer kurrë. Si pasojë vendi ra në një ndarje, e cila i korespondonte konfiguracionit të saj gjeografik, secila pjesë për veten e vet nën një regjim të vetin dhe pikërisht siç përshkuhet më poshtë:[2]

1- Shkodra dhe rrethinat e saj nën një komision lokal.

2- Mirdita nën princin vendas, Preng Dode Biba.

3- Krahinat e banuara prej malsorëve nën prijësit

1. Jonescu, Disa përshtypje personale f.14.

2. Data e saktë është e dhënë në variante të ndryshme. 4.Shtator sipas Temperly- t (botues), Një histori e Konferencës së Paqeas në Paris, IV, 339; 3 Shtator, Pavarësia e Shqipërisë 1 Nëntor 1915.

e tyre.

4- Durrësi dhe rrethinat nën beun e krahinës, Esat Pashën.

5- Vlora dhe fqinjët përqark nën Komisionin e Kontrollit.[3] Gjatë viti të parë të luftës situata ndërkombëtare e Shqipërisë Jugore kushtëzohej nga fakti që Italia dhe Greqia, pra Fuqitë Mesdhetare, më të interesuarat për shtetin e ri, ishin neutrale. Interesi përqendrohej rreth përpjekjeve të bëra prej secilit nga të dyja kampet ndërluftuese për të mbajtur njërën ose tjetrën prej këtyre dy fuqive neutrale, jashtë luftës, ose për t'i tërhequr ato në anën e vet. Çelësi shpjegues i veprimit të Fuqive në Shqipëri gjatë kësaj periudhe të luftës gjendet tek vetë qëndrimi i tyre ndaj luftës në tërësi.

Në përpjekjet e dështpëruara, të bëra prej Monarkisë Dualiste për të mbajtur neutrale, ish aleaten e vet Italinë, Shqipëria pat një ndikim shumë të madh.

Marrëveshja Austro-Italiane që kishte të bënte me Shqipërinë dhe që siguronte një veprim të përbashkët për të ruajtur paasnjanësinë e saj[4], teorikisht ishte ende në efekt, por në fillim të

3. Manual paqe, nr.17, Albania f.72.
4. Shih supra, f.15

shtatorit 1914 pati bisedime rreth një pushtimi italian të ishullit të Sazanit.[5] Bertoldit i ishte dhënë të kuptonte tërthorazi se një deklaratë publike mbi këtë e lëshuar prej Aleancës Treshe do të sillte rezultate të shkëlqyera" duke i bërë Fuqitë e Antantës të kuptonin se- "ndoshta si rezultat i hutimit të tyre"- Aleanca Treshe ishte ende në veprim. Bertoldi ra dakort me një pushtim të tillë, i cili duhej të njoftohej njëherazi në Vjenë, Berlin dhe Romë, por dëshironte që Italia të vlerësonte mirëkuptimin, pasi opinioni publik Austro-Hungarez ishte "veçanërisht i ndjeshëm ndaj të gjitha çështjeve që kishin të bënin me Shqipërinë"[6].

Padyshim që Italia ishte duke kërkuar një pretekst për të pushtuar Vlorën, si mundësi për të kontrolluar Adriatikun. Në se mund të besohet në një raport Austro-Hungarez, Sgr.de Martino e diskutoi mundësinë e përdorimit të sulmeve të muhamedanëve mbi epiriotët për qëllime të provokimit të një pushtimi "epiriot" ose grek në Vlorë; në një rast të tillë qeveria italiane nuk mund

5. Austro-Hungaria, Ministri i Punëve të Jashtme. Dokumente diplomatike në lidhje me marrdhëniet e Austro-Hungarisë me Italinë nga 20 Qershori 1914 deri në 23 Maj 1915. Mercchio për Bertoldin, 11 shtator 1914; Gottifried Hohenlohe, për Berchtold, 12 shtator 1914.
6. Po aty, Bercthold për Hohenlohe, 6 shtator 1914.

të mos përfillte opinionin publik i cili ishte jashtë mase i ndjeshëm në atë pikë."[7]

Shtetarët e Monarkisë Dyshe panë tek një ekspansion i mundshëm italian në Shqipëri, rrugën që Italia kishte zgjedhur si kompesim ndaj një ekspansioni të mundshëm të Austro-Hungarisë në Ballkan. Një ekspansion i tillë ishte i lidhur me të dyja, Monarkinë Dyshe dhe Italinë si një rast për të ndryshuar drejtimi i opinionit publik italian nga demonstrimet e armiqësisë ndaj Aleancës Treshe [8].

Ballplatzi[9], veçanërisht frikësohej se kjo do t'i siguronte Italisë një rast për të futur një këmbë në Ballkan, gjoja për të ruajtur interesat e shteteve ballkanike nën drejtimin e saj në kohën e zgjidhjeve të mëdha të çështjeve [10]. Duke dëshmuar rrezikun e shkeljes së paasnjanësisë së Shqipërisë nga trupat Greke, *Consulta* i dërgoi një notë qarkulluese ambasadorit italian të akreditуar tek nënshkruesit e protokollit të Londrës, në të cilën Forein Ofisi Italian theksonte besnikërinë e plotë ndaj protokollit si dhe shprehte qëllimin e Italisë, si e vetmja fuqi

7. Po aty, Macchio për Berchtoldin, 6 Tetor 1914.
8. Po aty, Berchtold për Mercchio, 9 Tetor 1914.
9. Maccio për Berchtold, 6 Tetor; Berchtold për Maccio, 22 Tetor 1914.
10. Po aty, Maccio për Berchtold, 6 tetor 1914.

neutrale midis të tjerave e cila mund të parandalonte përpjekjet e ndonjë ekspedite për të zbarkuar atje[11]. Prandaj ishte vendosur që të kishte një flotë ushtarake lundruese italiane në brigjet e detit shqiptar me qëllim që të parandalonte importet e armëve dhe municioneve të huaja.[12]

Në këtë pikë, Sër Eduard Grey, tërhoqi vëmëndjen e qeverisë italiane nëpërmjet ambasadorit britanik në Romë ndaj skamjes dhe mizeries që i kishte kapluar muahamedanët në Epir dhe rrjedhojat e rrezikshme që sillte masakrimi i popullsisë kristiane; qeveria autonome nuk do të ishte e aftë që të përballonte këtë situtë. Në këto rrethana Sër Eduart Grey ndjeu që ajo çfarë mund të bënte Venizellosi nuk ishte asgjë më pak se sa të dërgonte një regjiment drejt Gjirokastrës për të mënjanuar masakrat, duke premtuar se ato do të tërhiqeshin atëherë kur do të dëshironin fuqitë; ai deklaroi gjithashtu se qeveria greke do të pajtohej me një pushtim italian të Vlorës. Kryeministri italian, Salandra, ndërsa refuzonte që të pranonte sugjerimet e një marrveshjeje direkte me Greqinë, qoftë edhe për një pushtim të përkohshëm prej trupave greke, tha se ai nuk do të

11. Po aty, Macchio për Berchtold, 19 tetor 1914
12. Po aty, Berchtold për Marcchio, 22 tetor 1914,

kundërshtonte dërgimin e një regjimenti grek për qëllime politike, duke përmendur premtimin e Venizellosit për t´i tërhequr ato në kohën, kur kjo do të kërkohej. Ai gjithashtu rezervoi të drejtën që të ndërmerrte në Vlorë operacione të tilla policore nga ato që do të mund të nevojiteshin për trajtimin e refugjatëve.

Por në të njëjtën kohë ai deklaroi se këto pushtime duhej të ishin të përkohshme dhe nuk duhej të ngatërroheshin me vendimet e Londrës sa i takon Shqipërisë, vendime të cilat do të mbeteshin në forcë.[13]

Vijueshmërisht, më 31 tetor u njoftua se Italia kishte ndërmarrë pushtimin e përkohshëm të ishullit të Sazanit me qëllim që të ruante paasnjanësinë e Shqipërisë.[14] Ndaj këtij hapi të ndërmarrë grekët u hakmorën menjëherë duke okupuar Sarandën, Përmetin dhe Gjirokastrën. Venizellosi deklaroi në Parlamentin grek se ky akt ishte një masë politike dhe nuk përbënte ndonjë lloj pushtimi. Qëllimi ishte të rivendosej rendi, të jepeshin mundësitë për kthimin e refugjatëve dhe të lejohej zbatimi i

13. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Berchtold per Macchio, 24 tetor, 1914.

14. Po, aty, Berchtold per Macchio.

marrveshjes së Korfuzit aq shpejt sa Fuqitë do të ishin në gjendje të krijonin konditat e nevojshme për zbatimin e asaj marrveshje.[15]

Pushtimi italian i Sazanit u prit nga Fuqitë e Mëdha në përgjithësi në mënyrë evazive, pasi të gjithë ishin aq të zënë me punën e luftës, sa nuk kishin kohë për ta kundërshtuar atë. Qëndrimi i Francës ishte në tërësinë e tij i kënaqshëm, po të kihet parasysh se vetë ajo kishte qëllime pushtuese njësoj siç kishin edhe kundërshtarët e saj. Ministri rus i punëve të jashtme, Sazanoff, u shpreh hapur në një intervistë dhënë korespondentit rus të Corriere della sera. Ai deklaroi se Rusia nuk kishte kundërshtime për të formuluar. Por motivi i një misioni sanitar i dukej atij të ishte i vetmi pretekst; ai nuk kuptonte se pse Italia e kishte lënë flamurin shqiptar që të valëvitej përkrah flamurit të të tjerëve. Për sytë e tij një shtet shqiptar nuk ekzistonte.[16] Gjermania dhe Austro-Hungaria raportohej ta kishin pranuar veprimin e Venizellosit, me kusht që pushtimi të mos binte në kundërshitm me vendimin e Konferencës së Londrës.

Dy muaj më vonë, duke arsyetuar mbi anarkinë

15. Vellay, Çështja e Adriatikut, f.102-103.

16. Le Temps, 31 Tetor, 1914

që mbizotëronte si dhe, sipas një thirrje të qeverisë së Durrësit (ndoshta nga Esat Pasha) për ruajtjen e rendit publik, Italia vazhdoi me pushtimin e Vlorës. Sidoqoftë, në rastin e Vlorës u deklarua se pushtimi do të ishte vetëm i përkohshëm dhe u bë e njohur se Italia nuk kishte qëllim të shkonte më tej në këtë pushtim.[18]

Një vështrim adekuat mbi zhvillimet në Shqipërinë jugore bënte të nevojshëm një vlerësim të qëndrimit, jo vetëm të Italisë, por gjithashtu të Greqisë në drejtim të luftës së madhe. Me shpërthimin e armiqësive, kishte shumë arsye për të supozuar se simpatitë greke shkonin në anën e Antantës; Anglia, Franca dhe Rusia mbronin Greqinë, shtete këto ndaj të cilave ajo kishte detyrime për ekzistencën dhe shtetin e saj të pavarur. Atë e bashkonte me Rusinë e njëjta fe edhe me Francën fakti se gjuha frënge është gjuha e mediumeve greke për shkëmbimin e ideve midis njerëzve të ngritur në atë vend, si kudo tjetër në Lindjen e Afërt. Greqia kërkonte nga Anglia mbrojtje si një fuqi detare, flota e së cilës mund të kontrollonte Mesdheun, rruga kryesore e përdorur prej saj. Përveç kësaj në përgjithësi besohej se ajo

18. Austro-Hungaria, Dokumente Diplomatike, Bechtoldi për Ambrozin. 26 Dhjetor 1914.

ishte e lidhur me Serbinë nëpërmjet një traktati mbrojtjeje mbështetur në aleancën e viti 1913, teksti i së cilës, nuk u bë i njohur deri dy vitet e fundit; bile as deri në vitin 1925 nuk ishte zbuluar që ky traktat ishte abroguar formalisht që më 1915, kohë kur ishte bërë e qartë se Greqia nuk do t'i hynte luftës në krahun e Antantës.[19]

Eshtë e vërtetë që, në muajt që pasuan luftën, u bënë përpjekje nga ana e shtetarëve vjeneze që të fitonin mbi Greqinë për ta lidhur atë me Fuqinë Qëndrore, por një *përtëritje e miqësisë* dështoi të realizohej për shkak të kundërshtimit ndaj kërkesave të grekëve në kryeqytetet e Bullgarisë dhe Turqisë. Megjithatë me vazhdimin e luftës ishte e qartë se prova e forcës drejtohej tek mbajtja e Greqisë neutrale; kryesorja ndër këto arsye ishte bindja e mbretit Konstandin që militarizmi gjerman kishte të ngjarë që të fitonte.[20]

Sejcili grup i ndërluftuesve ishte në ankth për të siguruar të paktën paasnjanësinë e Greqisë dhe po kështu secili prej tyre e ndillte atë me territore në

19. Publikuar më së pari në Le Temps, 15 Gusht 1916. Për teksin dhe bisedimet shih Britania e Madhe, Zyra e Luftës, Revista ditore e shtypit të huaj, shtesë speciale greke, f.4-20; New York Times Current History, Tetor 1925, zbulim për abrogimin e Ninchitchit.

20. Pribram, politika e jashtme austriake, 1908-'18, f.5051.

këmbim të kthimit të saj në aleate të vet. Në gusht të vitit 1914, Antantës iu afruan tërë burimet detare dhe ushtarake nga ana e Venizellosit, por ato u refuzuan nga ana e Sër Eduart Grey, i cili u frikësua se mos një pranim i tillë do të kalonte menjëherë Turqinë e ndoshta edhe Bullgarinë në anën e Aleancës Trepalëshe [21]. Kësaj i shtohej edhe rreziku i armiqësisë së Italisë me Antantën, përderisa politika greke synonte ekspansion mbi territore të lakmuara prej ish fuqisë. Eshtë pjesërisht kjo arsyeja, se pse shtetari freng i kërkonte Greqisë që të hynte në luftë pa ndonjë kusht të veçantë, duke e lënë çështjen e kompensimeve territoriale për kohën e zgjidhjes [22]. Për këtë arsye, aleatët menduan të bënin oferta konkrete ndaj Greqisë.

Sidoqoftë, më 22 nëntor 1914 Antanta i bëri një ofertë Greqisë për hyrjen e saj të menjëhershme në ndihmë të Serbisë. Duke vepruar nëpërmjet ambasadorëve të tyre në Athinë, Angli, Francë dhe Rusi, fuqitë anëtare i afruan Greqisë pjesën jugore të Shqipërisë dhe pikërisht Vlorën. Për hyrjen e menjëhershme, Venizellosi kërkoi një garanci të plotë nga Rumania që kjo e fundit të godiste

21. Churchill,Kriza Botërore f.529, Asquith,Gjeneza e Luftës,f.223.
22. Abbot,Greqia dhe Aleatët,1914-1922 f.231.

Bullgarinë në rast të një sulmi ndaj Greqisë. Kur kjo garanci nuk iu dha, Greqia për rrjedhojë nuk i dha ndihmë Serbisë dhe oferta dështoi.[23] Ministri grek, Repoulis deklaroi se veprimi i parashikuar për t`u kryer nga ana e Greqisë do të ishte i barabartë me vetevrasjen e saj.[24] Sipas deklaratës së Venizellosit një ofertë për shtrirje të teritoreve drejt Shqiperisë Jugore, ishte gjithashtu bërë prej Gjermanisë por edhe kjo si dhe ajo tjetra ishte refuzuar.[25]

Nderhyrja greke u bë subjekt i bisedimeve me Antanten ne verën e vitit 1915, në fillim të ekspeditës së dardaneleve. Në Mars, qeveria greke, nëpërmjet Zografosit, tani Ministri i saj i punëve të jashtme, njoftoi se ishte gati të asistonte Aleatët në se Bullgaria hynte në luftë, më konditë që integriteti grek te ishte i garantuar dhe po kështu t'i afroheshin kompesime.[26] Gjatë muajve që pasuan qeveria greke ishte më specifike në kërkesat e saj. Kabineti i Gounaris deklaroi gatishmërinë e tij për të hyrë në luftë menjëherë, nëqoftëse Fuqitë e

23. Lolay.-Dokumente sekrete, f.134-135, Hanson,Diplomacia sekrete,f 50.
24. Maccas f25 note 1.
25. Ne fjalën e tij me 26 gusht 1917,shih (Vinizellos) Mbrojtrja e politikës kombëtare greke,f.76.
26. Deville,Antana,Greqia dhe Bullgaria.Shenime historike f.142.

Antantës do të ishin gati të pranonin veprime ushtarake kundër Turqisë së bashku me trupat greke. Një ndërhyrje e tillë ishte bërë varësisht nga një garanci formale e dhënë për ruajtjen e integritetit territorial grek, përfshirë "Epirin e Veriut" gjatë të gjithë luftës dhe për një periudhë kohore të caktuar të saj. Propozimi dështoi. A erdhi ky dështim, siç deklaroi ministri francez në Athinë, për shkak të mungesës së sinqeritetit të qeverisë greke kur aleatët i pranuan këto komndita, apo, nga ana tjetër, siç deklaroi ministri grek i punëve të jashtme, prej dështimit të Antantës për të përtërirë bisedimet, kjo është e paqartë. Cilado qoftë arsyeja, Greqia e ruajti paanshmërinë e saj.

Ndërkohë, Greqia e kishte futur një këmbë në "Epirin e Veriut" nëpërmjet pushtimit ushtarak të autorizuar prej Aleateve. Ky pushtim, të cilin Venizellosi e deklaroi në parlament në Dhjetor të 1914-tës, do të mbahej nga një administratë ushtarake për aq kohë sa të ishte e nevojshme dhe për aq kohë sa "rrethanat e tashme ndërkombëtare" do të vazhdonin. Kështu ishte rënë

27. Tekst i plotë i traktatit të fshehtë siç zbulohet në Petrograd,ribotuar nga Neë Jork-u Evining Post, f.8

28. Deville,vepër e cituar,f.144

29. Tekst i plotë i traktatit të fshehtë, vepër e cituar.

30. Maccas, f.27 note 3

në ujdi në atë kohë të pushtimit grek dhe italian,që zgjidhja perfundimtare t'i lihej konferencës së ardhshme të paqes. Megjithatë në gusht të vitit 1915 Venizellosi i deklaroi Parlamentit te vet se "vetem gabimet kolasale" mund të ndajnë "Epirin e Veriut"nga Greqia.[31] Padyshim, që të dyja, Greqia dhe Italia, shpresonin që të mbanin teritore të okupuara secila për vete deri në zgjidhjen perfundimtare.[32]

Ndërsa Greqia po i zgjeronte keshtu interesat e saj drejt Epirit te Veriut, Austro-Hungaria dhe Italia vazhdonin bisedimet në perpjekje për të arritur një marrëveshje. Në këto bisedime pjesa që luajti Shqiperia tregon rendesinë e saj për këto fuqi.

Në janar, ministri italian i puneve të jashtme, Sonino, mbrojti pikpamjen se interesat e Italisë ne Shqipëri konsistonin vetem në pengimin e të tjerëve nga të perfituarit e një pikëmbështetje atje, por nuk kishte për qëllim që të vendosej vetë ne trojet shqiptare.[33] Austro-Hungaria argumentoi se

31. Fjala e Venezillosit e 26 gushtit 1927, shih mbrojtjen që i beri politikës kombetarë greke.

32. Il Giornale d'Italia,6 tetor 1916;"...ne kemi për qëllim që të sigurojmë për vetvetën dy garanci të fuqishme te cilat nesër do të kenë vlerën e tyre ne Konferencën e Paqes...për çeshtjen e Vlorës"-revista ditore e shtypit te huaj (Britania e Madhe),17 Tetor 1916.

33. Austro-Hungaria, Dokumenta Diplomatike, Marccio per Berchtoldin,6,Janar 1916.

pushtimi italian i Vlorës i dha monarkisë Dyshe të drejtën për kompnesime.[34] Por Ambasadori italian në Berlin, Duka i Avarnes, deklaroi se ai veprim nuk ishte një pushtim në kuptimin e plotë të fjalës, por ishte rendi publik që duhej vendosur, si dhe marrja në mbrojtje e integritetit të Shqiperisë, që i kishte detyruar ata të ndërmerrnin një aksion të tillë. Italia,duke qenë neutrale, ishte e vetmja fuqi që mund të përmbushte këtë detyrë në emër të Europës.[35]

Ai shkoi më larg, kur deklaroi se pushtimi ishte i përkohëshëm; Italia do të vazhdonte t'i përmbahej marrëveshjes me Austro-Hungarinë sa i takon Shqipërisë dhe Epirit, dhe te mbronte vendimin e Londres, veçanarisht ato pika që kishin të bënin me paasnjanësinë dhe kufijtë e Shqiperisë.[37]

Me 28 Mars Monarkia Dyshe i bëri Italisë një propozim perfundimtar. Sipas pikave të atij propozimi Italia duhej të angazhohej për të vëzhguar dhe ndihmuar në ruajtjen e pasnjanësisë për sa kohë do të vazhdonte lufta, ndërsa Austro-Hungaria, do t'i lëshonte asaj teritore në jug të

34. Po aty, Berchtold per Marccio,12 Janar 1915.
35. Po aty,Burian per Marcchio,Shkurt 1915.
36. Le Livre vert Italien, Sonnino per Avarnen,12 Shkurt 1915.
37. Po aty, Avarna per Sonninon,12 Shkurt 1915.

Tyrolit, përfshirë qytetin e Trentit, si shperblim ndaj lënies së duarve të lira nga ana e të parës në veprimet e saj ne Ballkan si dhe heqjen dorë paraprakisht prej të gjitha kerkesave për kompesim atje, me perjashtim të Shqipërisë, duke iu përmbajtur kështu vendimit te konferencës së Londrës si dhe marrëveshjeve ekzistuese midis Austro-Hungarisë dhe Italisë të cilat do të mbeteshin në fuqi.[38]

Këto propozime të Austro-Hungarisë, u deklaruan prej ministrit italian te punëve të Jashtme si shumë të pamjaftueshme dhe të paqarta. Italia nuk mund t'i jepte Monarkisë Dyshe liri veprimi në Ballkan pa një deklaratë të lëshuar prej saj ku të njoftohej se kjo e fundit ishte komplet e painteresuar per Shqiperinë. Për më tepër, Italia nuk mund të angazhohej më shumë se sa të vëzhgonte një paanësi strikte, përderisa një paanësi mirëdashëse në favor të Austro-Hungarisë, do të çonte në humbjen e dëshirës së mirë të Anglisë, me pasojë mbylljen e ngushticës së Gjibraltarit dhe një sigurim të pakët të lëndeve te para prej të cilave varesh shumë industria italiane.[39]

38. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Macchio, 28 mars 1915.
39. Po aty, Macchio për Burian, 31 Mars 1915; Po aty Burian për Macchio, 2 Prill 1915. Livre vert Italien, Sonnino për Avarnon. 31 mars 1915; Po aty, Avarno për Sonion, 2 Prill 1915.

Sonnino, nga ana tjetër, paraqiti pikat në të cilat Italia do të ruante neutralitetin e saj. Midis kushteve të pazevendësueshme për një marrëveshje të qendrueshme midis dy fuqive ishin dhe njohja prej Austro-Hungarisë e sovranitetit të pakufizuar të Italisë mbi Vlorën dhe gjiret e saj përfshirë Sazanin perfshirë dhe aq territore të brendshme sa mund të kerkonte mbrojtja e saj. Ndër to ishte dorëzimi pakushte e të gjitha interesave te Austro-Hungarisë ndaj Shqiperisë, siç ishte vendosur në konferencën e Londrës.[40]

Në përgjigje të këtyre prozimeve, Monarkia Dyshe u deklarua e gatshme që të diskutonte me Italinë interesat e tyre të ndërsjellta në Shqiperi, megjithese Ballplatzi nuk mund të hiqte dorë nga interesat e veta atje, në një vend kaq të afërt me sferën e interesave vitale të Austro-Hungarisë"

Tashmë çështja shqiptare ishte bërë një çështje evropiane. Vetëm me e një "përqasje të dëshirave të Fuqive të Mëdha mund të modifikohej situata politike në Shqipëri- gjë që ishte eventualisht e pamundur që të bëhej gjatë luftës së tashme"[41].

40. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Maccio, 11 prill 1915. Livre vert Italian. Sonnino për Avarnon, 8 prill 1915.

41. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burian për Macchion, 16 Prill 1915. Livre vert Italien. Avarvna për Sonnion, 16 Prill 1915.

Austro-Hungaria me të drejtë pa se Adriatiku do të kthehej me të vërtetë në një liqen italian, nëqoftëse Italia do të mbante zotërimin mbi Vlorën.[42]

Kështu më 20 prill, Salanda deklaroi se Shqipëria nuk do të bëhej shkak i një konflikti midis dy aleateve,[43] megjithëse kur u raportua se bisedimet me Antantën ishin në të mbyllur, Austro-Hungaria bëri përpjekjen e saj të fundit të dëshpëruar për të mbajtur Italinë asnjanëse. Ajo u tregua e gatshme që në rast të një nevoje ekstreme të deklaronte mosinteresimin e saj ndaj Shqipërisë, me të drejtë që të siguroheshin garancitë ndaj (mos) vendosjes atje të një fuqie të tretë [44]. Kufizimet e mëtejshme të lëshimeve të Austro-Hungarisë sikundër që ishin skicuar nga Vjena ishin që të përfshinin një deklaratë të mosinteresimit të plotë ndaj Shqipërisë, me heqjen dorë ndaj të gjitha rezervave dhe kufizimeve.[45]

Por ndërkohë bisedimet midis Italisë dhe Antantës po përparonin. Filluar në nivelin e ambasadorit italian në Londër, Marquis Imperiali, ato ishin drejtuar prej Sër Eduard Greyt, Mr.Paul Cambonit

42. Austro-Hungaria, Dokumente diplomatike, Burain për Mecchion, 16 prill 1915.

43. Po aty, Machio për Burian, Prill 1915.

44. Po aty, Burain për Macchio, 4 maj 1915.

45. Po aty, Burian për Macchio, 5 maj 1915.

dhe Cont Benckendorffit për Aleatet. Përparimi i tyre ishte penguar prej diversitetit të interesave të Fuqive të Mëdha në Londër. Franca, siç ishte raportuar i gjeti kërkesat e Italisë tejet të ekzagjeruara, veçanërisht në bregdetin juglindor të Adriatikut, ndaj u deshën gjashtë javë për të arritur deri tek marrveshja që për rregulllimin e detajeve të së ardhmes së ndarjes territoriale të Shqipërisë dhe Dalmacisë.[46] . Rezultat i këtyre bisedimeve ishte Traktati i Fshehtë i Londrës i 26 Prillit 1915, [47] në të cilin Italia iu bashkua Aleateve. Në nenin 7 që bënte fjalë për Shqipërinë thuhej:

Duke përfituar Trentinon dhe Istrian prej nenit 4, Dalmacinë dhe ishujt e Adriatikut prej nenit 5, e po ashtu gjirin e Vlorës, Italia, në rastin e një shteti të vogël autonom dhe neutral të formuar në Shqipëri, premton të mos kundërshtojë dëshirën e mundshme të Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë për të rindarë krahinat veriore dhe jugore të Shqipërisë midis Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë. Bregdeti jugor i Shqipërisë nga kufijtë e territorit italian të

46. Hanson, Diplomacia sekrete me një aneks plotësues të tekstit të dokumenteve sekrete në Rusi f.42.

47. Shih Britania e Madhe, Letra të Parlamentit, LI (1920, 261; Cocks, Traktatet e fshehta dhe marrveshjet. f.27-28; Temperley, vepër e cituar, V, 384-93.

Vlorës deri tek Kepi i Stillos do të ishin neutrale.

Italisë do t'i njihej e drejta e drejtimit të marrdhënieve të jashtme të Shqipërisë; për çdo rast, Italia do të detyrohej të siguronte për Shqipërinë një territor mjaft ekstensiv për të mundësuar që kufijtë e saj tu bashkoheshin atyre të Greqisë dhe Serbisë në perëndim të Liqenit të Ohrit.

Mbështetur në këtë pikë të paktit, Fuqitë e Antantës u morën vesh që t'i jepnin Italisë si një pjesë të çmimit për hyrjen e saj në luftë, futjen e një këmbë në Ballkan aq shumë e lakmuar prej saj. Bisedimet që çuan në këtë pakt të fshehtë e të poshtër nuk u publikuan dhe vendimet e tij mbetën të panjohura derisa bolshevikët zbuluan diplomacinë e Antantës në sytë e botës. Pikat e tij bënë të mundur që Aleatet të shpërblenin miqtë e tyre, Serbinë dhe Greqinë (në se kjo e fundit do të futej në luftë). Ndërkohë, meqë Italia ndjehej e kënaqur me pazarllëqet e bëra, pasi ajo do të gëzonte lëshime të mëdha territoriale, të cilat, është e vërtetë, se qeveritë e Antantës nuk i kishin në fuqinë e tyre që t'i jepnin, më 28 maj ajo i hyri luftës në anën e Aleateve.

Zhvillimi tjetër i rëndësishëm përfshiu vendin tjetër mesdhetar, Greqinë. Pushtimi grek i "Epirit të Veriut" i autorizuar prej Aleateve më 1914, pikërisht

në kohën e vendosjes së Italisë në Vlorë, zgjidhja e të cilit i ishte lënë shprehimisht Konferencës së Paqes, e që s'bën që të harrohet, u shfrytëzua prej pasuesve të Venizellosit. Duke e gjykuar atë kohë si të përshtatshme për një fait accompli ata nxitën shpresa tek popullsia e Vorio Epirit se ai do të mund të merrte pjesë në zgjedhjet e reja kombëtare.[48] Në dhjetor 1915, deputetë prej "Epirit të Veriut" u derguan në Parlamentin Grek për të kërkuar njohjen nderkombëtare të bashkimit të asaj provincë me Greqinë dhe në hapjen e parlamentit të ri më 11 janar 1916, qeveria iu dha atyre vendet. Në Shkurt ajo procedoi me zëvëndësimin e autoriteteve ushtarake të pushtimit me civile dhe në muajin pasardhës shtypi shqiptar njoftoi firmosjen e një dekreti mbretëror që ribashkonte plotësisht "Epirin e Veriut" me mbretërinë greke [49]. Kryetari i këshillit të ministrave, Skouloudis u shpreh hapur në parlamentit se "Epiri i Veriut" me kufijtë e tij të tashëm përbënte një pjesë integrale të mbretërisë Greke[50]. Ky veprim ishte karakterizuar prej Kiryxit, organi zyrtar i shtypit të Venezillosit, si akt që

48. Venezillos, Historia e Greqisë, 1912-1917, Diskurse në parlament, Gusht 1917, f17.
49. Laloy, vepër e cituar, f.141; Le Temps, 21,22 Mars 1916.
50. Laloy, vepër e cituar.

përbënte një sukses të klasit të parë për Greqinë.[51]

Megjithkëtë përfshirja e Epirit të Veriut në Greqi, nuk u pranua prej Fuqive të Antantës, siç shpresohej në Greqi. Kështu të zhytura në luftë këto Fuqi kërkuan një shpjegim. Qeveria greke iu përgjigj kundërshtimit të tyre se administrata civile konsiderohej si e domosdoshme për të zëvëndësuar atë ushtarake [52]. Një note e dytë e Aleatëve nënvizonte papajtueshmërinë e fjalëve të Skoulodisit në parlament, me faktin se rajoni në fjalë ishte përfshirë në principatën e Shqipërisë me vendim të Fuqive me 1913. [53]. Në përgjigjen që dha ministri helenik deklaroi se shkaku i pjesmarrjes së deputetëve epiriotë ishte domosdoshmëria e garantimit të zërit të epiriotëve në legjislaturë dhe votimi për taksat prej nga dilte mbajtja e administratës[54]. Sidoqoftë, si rezultat i protestave të Aleateve, qeveria greke u detyrua të mos lejonte edhe më tej pjesmarjen e deputetëve të Epirit të Veriut.[55]

Rënia në dorën e Fuqive Qëndrore e Fort Roupelit në maj, shënoi fillimin e një periudhe thuajse të

51. Maccas, Ainsi për Venezillosin f.28 nota 1.
52. Laoly, vepër e citar, Christian Sciense Monitor, 3 prill 1916.
53. Le Temps, 2 prill 1916.
54. Laoly, vepër e cituar.
55. Venezillos, Historia e Greqisë, f.17; Le Temps, 6 maj 1915.

hapur armiqësore midis qeverisë greke dhe Aleateve. Pasojë e humbjes së besimit ndaj Greqisë ishte ekspansioni i Italisë drejt Epirit të Veriut, i shoqëruar me një tërheqje të detyruar të Greqisë nga zona e lakmuar prej saj. Vetëm pak kohë më parë Greqia dukej sikur ishte e sukseshme në plotësimin e dëshirave të saj për ta shtirë atë përfundimisht në dorë [56]. Ministri i Greqisë në Romë raportoi se italianët ishin gati të mendonin se Greqia do tu lëshonte pe bullgarëve në Epir, sikundër kishte bërë edhe në Maqedoni dhe se kjo ishte e pavlefshme për të vendosur ndonjë besim në "garancitë e saj iluzive" [57]. Në këtë mënyrë, në fillim të Qershorit, italianët e pushtuan Janinën, [58] një qytet i zotëruar nga grekët, që nuk përfshihej në "Epirin e Veriut", një veprim ky i kundërt me deklaratën e shkruar të ministrit italian në Athinë, e cila përjashtonte përparimin e ushtrisë italiane të Vlorës tej kufijve veriore greke.[59]

Si rezultat i dorëzimit të Fort Roupel-it, Britania

56. Fjala e Venezillosit e 26 Gushtit 1917. Mbrotjtja e politikës kombëtare greke. f137.

57. Traktati i aleancës greko-sërbe; Pushtimi gjermano-bullgar i Maqedonisë. Coromilas për Skouloudis, 13-17 maj 1916

58. La Matin, 12 qershor 1917.

59. Le Temps, 22 mars 1916.

e Madhe, Franca dhe Rusia si mbrojtëse të Greqisë, i bënte një seri kërkesash qeverisë greke, kryesorja prej të cilave lidhej me çmobilizimin e ushtrisë. Kjo kërkesë u përsërit në një note të 21 qershorit 1916, në të cilën ishte marrë përsipër që çmobilizimi të kërkohej jo vetëm ndaj Mbretërisë Helenike, por gjithashtu ndaj "Epirit të Veriut"[60] Pak ditë më vonë, mbështetur në këtë kërkesë kryeministri i ri Zaimis, e informoi ministrin italian në Athinë se ushtria, përfshirë edhe njësi të Epirit të Veriut ishin vënë në një gjëndje paqeje.[61]

Veprimi i nxituar i qeverisë së Skouluodis-it, në përpjekjet e saj për të aneksuar Epirin e Veriut me 1916, solli në vend të pritjes për përfundimin e luftës ku do të konfirmoheshin zotërimet e saj, si dhe në vend të mosbesimit të qeverisë greke ndaj Aleateve pas dorëzimit të Fort Roupel-it, humbjen e "Epirit të Veriut" dhe pushtimi i asaj krahine prej fuqisë rivale, Italisë.

Shpresat greke ishin shkatërruar. Pushtimi italian u denoncua prej një gazete helenike (Nea Ellas) si një "thikë në zemrën e Greqisë", por në të njëjtën kohë ishte bërë e njohur se përgjegjësia e vërtetë

60. Po aty.

61. Po aty.

për humbjen qëndronte tek vetë Greqia. *Estia* gjithashtu vajtonte rreziqet që kërcënonin Epirin e Veriut, duke vënë ballë për ballë sigurinë e provincës nën regjimin e Venizellosit me atë të pozitës së saj të mëpastajme [62]. Gjithashtu ministri italian në Athinë siguroi Politisin, se i vetmi qëllim i pushtimit italian ishte të garantonte sigurinë e ushtrisë italiane në Vlorë, duke penguar kështu edhe kontrabandën dhe spiunazhin.[63] Aleatët premtuan në një note të shpërndarë nga fundi i dhjetorit, se nuk do të lejonin forcat e armatosura të qeverisë së mbrojtjes kombëtare (venizelloiste) që të përfitonin nga tërheqja e trupave mbretërore nga Thesalia dhe Epiri prej kalimit të zonës neurale të formuar në marrëveshje me qeverinë greke [64]. Prandaj rritja e veprimtarisë së italianëve tre muaj më vonë në përparimin e tyre drejt Janinës çuditi qeverinë greke. Përparimi i vazhdueshëm i trupave franceze në jug të zonës neutrale në Thesali dhe italianëve tek lumi Kalamas tërhoqi vëmëndjen e qeverisë helenike, por ndërsa përparimi francez nuk përbënte ndonjë shqetësim të madh, meqë ai nuk nënkuptonte

62. Kronika e përditshme e shtypit të huaj. (Britania e Madhe) 11 Shtator 1916.

63. Christian Sciense Monitor, 9 Tetor 1916.

64. The Times (Londër) 2 janar 1917.

pushtimin e krahinës, shtypja italiane mbi autoritetet dhe mësuesit grekë nga njëra anë dhe ankesat që flamuri italian po ngrihej në Epir në anën tjetër, çoi deri tek një protestë ndaj ministrit italian në Athinë, e cila mëshironte të tëra kërkresat për tërheqjen e italianëve prej pjesëve të Epirit të pushtuar rishtaz.[65]

Kur në fillim të Qershorit, italianët hynë në Janinë, qeveria Helenike iu dha urdhër autoriteteve civile dhe ushtarake të qytetit që të shprehnin protestën e tyre.[66]

Kjo çështje nuk u zgjidh derisa Aleatët e rrëzuan nga froni Konstandinin më 29 Qershor 1917 dhe Venizellosi u rikthye në fuqi. Ndërkohë ndodhi një zhvillim tjetër i rëndësishëm për Epirin e Veriut me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë prej gjeneralit Ferraro në Gjirokastër më 3 Qershor1917. [67] E gjithë Shqipëria u shpall e bashkuar dhe e pavarur "nën kujdësin dhe mbrojtjen e Italisë".

Kjo shpallje nxiti një furtunë protestash si brënda dhe jashtë Italisë. Ajo nxori në sipërfaqe divergjencat midis antarëve të ministrisë kombëtare italiane dhe

65. Shtesë e shtypit aleat (Britania e Madhe) 27 Qerhsor.

65. Po aty, 28 mars, 1917; Kronika e përditshme e shtypit të huaj. 5 prill 1917. (Athenai 24, 25, 26 Mars).

66. Le Temps, 7,13 Qershsor 1917.

67. Për tekst: shih Chekrezi, vepër e cituar f.161 ; Christian Sciense Monitor, 11 qershor 1917; Le Matin, 6 Qeshor 1917.

i bëri gazetat që të përcaktonin qëndrimet e tyre ndaj luftës nga njëra anë dhe metodave diplomatike nga ana tjetër. Veprimi i Soninos ishte një habi e madhe për gjithkënd, bile edhe për kolegët e tij. Si një protestë ndaj metodave të tij imponuese aq sa pjesërisht edhe për arsyetimin anti-imperialist, katër ministra, përfshirë këtu edhe atë të së majtës Demokratike Intervesioniste paraqitën menjëherë dorëheqjen e tyre, për të cilën, më vonë, ata u bindën që ta anullonin [68]. Gazetat italaine ndryshonin në reagimet e tyre. Të moderuarat kërkonin kufizimin dhe përcaktimin e kuptimit të kësaj shpallje, për ta bërë atë të pranueshme për Aleatët, gjë që do të lehtësonte justifikimin përpara opinionit rus e amerikan me synime nacionaliste. Nacionalistët ishin plotësisht të ekzaltuar, ndërsa Idea Nacionale deklaronte se Italia e kishte kërkuar këtë për dyzet vjet rresht, por ishte penguar prej Austro-Hungarisë të vendosej në Shqipërinë Jugore, çka do të bënte që sllavët dhe grekët, kërkesat e të cilëve tashmë e kishin humbur vlerën e tyre, të mbaheshin larg prej këtyre trojeve. Internacionalistët radikale shfaqën armiqësinë e tyre ndaj diplomacisë sekrete.[69]

68. Shtesë e shtypit aleat (Britania e Madhe) 27 Qershor 1917.
69. Daily Revieë of the Foreign Press, 12 Qershor 1917.

Pikpamja zyrtare italiane ishte se derisa lufta i kishte zhvleftësuar angazhimet e saj ndaj Austro-Hungarisë ajo ishte e lirë të rimerrte përsëri kursin e saj në politikën tradicionale të simpatisë ndaj kombit shqiptar.[70] Qëndrimi i shtypit francez ishte ai i një shtypi të dyshimtë, pasi ai nuk pajtohej me proklamatën italiane dhe as me erën e re të diplomacisë që kishte hapur revolucioni rus dhe ndërhyrja amerikane, në pikpamjen e nevojës për t'i përshtatur marrdhëniet e reja me marrdhëniet e kaluara dhe zgjidhjet e së ardhmes. Ishte kjo e fundit, sipas Le Temps që "i jep këtij fakti rëndësinë e vërtetë" [71] Në Rusi proklamata shkaktoi një sensacion. Terestchenkos, ministër i jashtëm në qeverinë e Kerenskit, pasi u këshillua me shefat e misioneve aleate, deklaroi në Kongresin e Sovjetëve se gjendja kërkonte domodoshmërisht vlerësime ushtarake; ai shtoi se qeveria ruse mendonte që fati përfundimtar dhe organizimi Shqipërisë duhej të lihej për t'u rregulluar plotësisht në mbarim të luftës duke zbatuar principet që popujt kanë të drejtë të rregullojnë vetë punët e tyre [72]. As Britania e Madhe,

70. Le Temps, 7 Qeshor 1917.
71. Po aty, Allied press Supplement, 21 Qershor 1917, f.151.
72. Përgjigjet e Balfourit në Dhomën e Ulët, 21, 27 Qershor 1917. Debate Parlamentare, Dhoma e Ulët, XCIV, 1944l; 356-57

por as Franca nuk ishin konsultuar më parë dhe asnjëra nuk dha ndonjë njohje zyrtare ndaj protektoratit italian.[73] Meqënëse deri në atë kohë, Traktati i Londrës i 1915-ës vazhdonte të mbetej sekret, papajtueshmëria e të dy programeve nuk u shpallën publikisht. Ndërkohë, me abdikimin e Konstandinit dhe kthimin në fuqi të Venizellosit, u bë krejtësisht e qartë se përderisa një siguri ushtarake nuk ishte edhe më tej e nevojshme, pushtimi italian duhej të merrte fund.[74] Bisedimet greko-italiane u ndërmorën menjëherë në mes të Venizellosit dhe të ministrit italian në Athinë, Bosdar, duke vendosur që në konferencën e korrikut në Paris aleatët të rregullonin tërheqjen e Italisë tërësisht nga territoret e okupuara, përveç zonës trekëndëshe të Greqisë e që formohej në kalimin e rrugës nga Saranda në Korçë dhe që Italia dhe Greqia duhej të pajtoheshin për rivendosjen e administratës civile nën autoritetin e një komisioneri të zgjedhur prej qeverisë greke [76]. Fill pas kësaj ky komisioner filloi nga detyra në këtë post. Evakuimi italian nga Janina dhe Epiri u vlerësua drejtpërsëdrejti si një fitore e Venizellosit.[77]

73. Le Journal des Hellenes, 1 Qershor 1917.
74. Le Temps, 1 Qershor, 1917.
76. Po aty, qershor 1917.
77. Po aty. 6 gusht 1917.

Italianët e trajtuan të ashtuquajturën "territor të sigurisë" se Vlorës dhe Himarës si një koloni të vërtetë italiane. Me t`u instaluar në Vlorë, Italia vendosi administratën financiare, juridiksionin kriminal, kontrollin e doganave dhe, me shtrirjen e kontrollit të saj në çdo fushë, kërkoi viza në pashaportat e të gjithë atyre personave, që dëshironin të hynin në Vlorë.[78] Punët publike u riorganizuan dhe u vunë në varësi të prefektëve; rrugët e hapura prej autoriteteve ushtarake u ndërtuan me qëllim përdorimi të përhershëm dhe përbënin një përfitim të madh për shqiptarët. Në kalanë e vjetër të Gjirokastrës u organizua një milici lokale, e instruktuar mirë dhe e armatosur, e drejtuar prej djelmoshash shqiptarë, nxënës të shkollave ushtarake italiane.[79]

Ndërkohë në pjesën juglindore të Shqipërisë, në ish kazanë e Korçës, kishin ndodhur ngjarje të një rëndësie të veçantë. Ky rajon që lidhej me Maqedoninë dhe i okupuar prej grekëve që prej 1914- ës, formonte pjesën e një zone neutrale në mes të Shqipërisë dhe Greqisë, të vendosur prej

78. Austro-Hungaria, Dokumente Diplomatike, Von Mayrhauser për Burian, 20 janar, 1 shkurt1915; Burian për Macchio, 4 shkurt 1915.
79. Chekrezi, vepër e cituar f.183-84; Bourcart, vepër e cituar f. 145.

aleatëve gjatë luftës për të izoluar Greqinë dhe për të mbrojtur frontin e tyre. Më 1916 kjo u bë qëndër e intrigave italiane, venizoliste, "esadiste", serbe, mbretërore-po aq sa edhe fushë e njohur e spiunazhit asutro-bullgar nëpërmjet të cilit mbahej komunikimi konstant me mbretin Konstandin.[80]

Në fillim të Dhjetorit 1916, gjenerali francez në Maqedoni, Sarrail dërgoi trupat nën kolonelin Descoins për të pushtuar Korçën, me qëllim qetësimin e vendit, pengimin e spiunazhit dhe kontrabandës dhe, mbi të gjitha, sigurimin dhe mbrojtjen e ushtrisë. Qeveria e përkohëshme e Venizellosit në Selanik e shqetësuar ndaj bashkimit të këtij rajoni me Maqedoninë, tashmë pak a shumë e mbledhur nën mbrojtjen e saj, dërgoi në Korçë prefektin M. Argyropulis.[81] Por Sarrail i kërkoi Venizellosit t'i thërriste rishtaz përfaqësuesit e tij, se prezenca e të tyre ndihmonte çrregullimin, duke shtuar edhe një luftë midis venizellozistëve dhe konstandinistëve ndaj intrigave italiane kundër pushtimit grek. [82] Rojalistët grekë në fuqi ishin progjerman të fuqishëm, ndërsa nacionalistët vendas

80. Sarrail, Mon commandement en Orient (1916-1918)f.220.
81.Vaucher, Ilustrime, 7 Prill 1917.
82. Borcart, vepër e cituar f.155.

shqiptarë, antigrekë të vendosur, në pjesën më të madhe të tyre proaustriake dhe antifranceze. Ky orientim i politikës së tyre vinte si rezultat i prohelenizmit të Francës në Konferencën e Londrës dhe të mbështetjes që kishin gëzuar prej Austro-Hungarisë. Me dorëzimin e kodrave në zotërim të bandave rivale shqiptare, në kohën kur trupat franceze arritën në Korçë, situata për Francën dukej kritike.

Udhëheqësi i kristianëve shqiptarë në Korçë, Themistokli Gërmenji, një nacionalist i bindur, deklaroi se farncezët do të gëzonin qetësi në terren, nëqoftëse ata do të shpallnin pavarësinë e Shqipërisë gjatë kohës së përpjekjeve për mbrojtje ushtarake.[83] Sipas kësaj, më 10 dhjetor 1916, delegatët shqiptarë përpiluan një protokoll të nënshkruar prej tyre dhe kolonelit Descoins, i cili e deklaronte Shqipërinë të pavarur nën mbrojtjen ushtarake franceze. Autoriteti qeveritar, si ai legjislativ ashtu edhe ai ekzekutiv përbëhej prej një komisioni prej katërmbëdhjetë antarësh, prej të cilëve gjysma ishin të krishterë dhe gjysma myslimanë. Autoritet ushtarake franceze ishin të mendjes se duhet të miratoheshin emërimet e drejtorëve të shërbimit publik. U krijua gjithashtu

83. Po aty.

një milici dhe xhandarmëri e cila, në rast të nevojave ushtarake, do të vihej nën komandën franceze. Gjuha shqipe u deklarua se do të ishte gjuha zyrtare dhe flamuri i republikës do të ishte ai tradicional i Skëndërbeut i kombinuar me flamurin tringjyrësh francez.

Sarrailit, kur iu kërkua një spjegim prej Quai D'orsey ndaj këtyre ngjarjeve, nën presionin e Romës, u përgjigj se ai kishte bërë çfarë ishte e nevojshme të bëhej për ushtrinë dhe duke ndjekur politikën e tij të mos ndërhyrjes në politikën e brendshme në Ballkan, kishte lejuar popullsinë të bënte çfarë asaj i pëlqente.[85]. Veprimi i Sarrailit për të mos i shërbyer politikës konstandiniste përbënte një shqetësim të madh për politikën imperialiste italiane[86]. Pushtimi francez ishte padyshim një rast i mirë për shtrirjen e italianëve në Epirin e Veriut, një tjetër rrjedhojë kjo e politikës progjermane e qeverisë rojaliste greke.

Përpjekjet e administratës franceze të Korçës qenë të suksesshme për t`u mësuar shqiptarëve të këtij rajoni disa prej leksioneve se si mund të vetë-qeverisej

85. Për tekstin e protokollit, shih Kolovani, Çështja e Korçës f.8-10. Shih gjithashtu nga gazeta shqiptare Adriatik në Aubry, Shqipëria dhe Franca f.45-46.

86. Për telegramet shih Sarrail, vepër e cituar f.221-22.

nën tutelën e atyre që kishin më shumë përvojë e që kishin prirje pozitive. Administrata qëndrore e vendosur në Korçë, u zvogëlua drejt një minimumi; tre territoret Korçë, Pogradec dhe zona neutrale greko-shqiptare brenda territorit grek) u vunë nën urdhër të një administratori rezident, secila duke patur nja shkallë të gjërë autonomie administrative, duke iu dhënë mundësinë që të drejtonin shërbimet dhe buxhetin e tyre. Të gjitha porositë nga Parisi, këshillonin paanësi strikte në marrdhëniet e francezeve me shqiptarët dhe grekët, ndërsa ministri francez, për të shmangur kundërshtimin grek, refuzoi dhënien e lejes për të hapur një lice francez në Korçë. Por me mbylljen e shkollave greke nja dyqind vendas u futën në shkollat ku shqipja dhe frengjishtja ishin gjuhët e mësimit. Qëndrimi i paanshëm në dhënien e drejtësisë nga ana e gjykatave u mirëprit si dhe u bënë punë të shkëlqyera në kontrollimin e ushqimit të popullatës, për realizimin e të cilave ishte marrë një konsensus.[87]

Një fakt shumë kuptimplotë, që nuk mund të mos vihej re, ishte se të krishterët dhe myslimanët punonin krah për krah.

87. Ancel, Ushtria orientale f.142, Bourcart, vepër e cituar, f.156. Italia dhe Bota f.300.

Mbasi Quai d´Orsay nuk kishte ndonjë dëshirë ta zhvillonte lëvizjen kombëtare shqiptare si tepër nën kontrollin francez, [88] më 16 shkurt 1918, kur Sarrail nuk ishte edhe më tej aty për të mbrojtur punën e bërë, trashëgimtari i tij gjenerali Salle, e abrogoi protokollin e viti 1916.[89] Korça vazhdoi të gëzonte në esencë të njëjtën qeveri, megjithëse ndryshimet ishin vetëm nominale. Flamuri shqiptar vazhdonte të valëvitej në Korçë, por autoriteti ushtarak vendoste tani mbi masat administrative që duheshin marrë [90]. Muaj më vonë, shkollat greke u rihapën si rezultat i influencës greke. Fakti që administrata franceze e qytetit ishte detyruar me urdhër nga Parisi të zbatonte masa në "kontradiktë flagrante me dëshirat e popullsisë", spjegohej me rritjen e influencës së Venizellosit, i cili duhej shpërblyer për lëvizjen e bërë prej tij duke iu bashkuar Antantës.[91]

Kur armëpushimi i mbylli armiqësitë, francezët italianët dhe grekët u lejuan që të mbeteshin në zotërim të përkohshme të krahinave të pushtuara prej tyre; francezët në Korçë, italianët në Vlorë dhe në një pjesë të konsiderueshme tokësore, dhe grekët në pjesën tjetër të Epiri të Veriut. Meqë në këtë rast zgjidhja përfundimtare u shty konsiderueshëm, pushtimi vazhdoi për disa kohë.

88. Bourcart, Shqipëria dhe shqiptarët, f.159-65; Kolovani, vepër e cituar f.10-11, 31-39.

89. Borcart, vepër e cituar f.159.

90. Për tekst, shih Kolovani, vepër e cituar f.72-73.

91. Po aty, f16.

V. KËRKESAT E GREKEVE DHE SHQIPTAREVE NE KONFERENCEN E PAQES.

Me zhvillimin e mëtejshëm të luftës, qëllimet e palëve ndërluftuese u bënë gjithnjë e më të qarta. Në çdo deklarim rreth luftës, principet e vetpërcaktimit ishin të pranishme. Në prill të vitit 1917, qeveria e përkohëshme e Rusisë deklaroi se qëllimi i i saj ishte "të ndërtonte një paqe të qëndrueshme mbi bazën e të drejtave të kombeve për të vendosur për të ardhmen e tyre". [1] Deklarata e Lloyd Xhorxhit e janarit 1918, duke vlerësuar kushtett që duheshin të përmbusheshin përpara se të shpresohet për një paqe të përhershme, tha se "një zgjidhje territoriale duhet të jetë e bazuar ose në vet-vendosjen, ose në marrveshjen midis qeverive"[2]. Një muaj më vonë më 11 shkurt, në një fjalim të famshëm, presidenti Uillson shpalli se "vetvendosja" nuk është një frazë e thjeshtë. Eshtë

1. Scott, Deklarat zyrtare për qëllimet e luftës dhe propozimet për paqe. f.95 (tekst për The New York Times, 11 prill 1917). Për përmbledhjen e qëllimeve të luftës shih gjithashtu Blagoyevitch, Principet e nacionalizmit f.158-204. Henderson, f.83.Labour Year Book, 1919 f.25-41.

2. Lloyd George, British War Aims f.15.

një imperativ i veprimit të burrave të shtetit, të cilët, që nga kjo kohë duhet të mos marrin parasyshë rreziqet që atyre u kanosen personalisht [3]. Këto janë veçse shembuj qëndrimi mikpritës që i referohen vetëvendosjes, të bëra në dy vjetët e luftës. Një shprehje stereotipe në buzët secilit, gjen një përgjigje zemre nga të gjitha popujt e vegjël ose të shtypur të të gjithë rruzullit. Fjalët e Lloyd Xhorxhit, të cituara më sipër, patën një jehonë të gjërë në zemrat e shumëkujt. Gazeta greke Patris shprehte besim në këto fjalë duke deklaruar se, "Kombi grek nuk ka dëshiruar kurrë më shumë se sa këtë... Ne nuk kërkojmë as aneksim e as ekspansion imperialist. Por ne nuk do të braktisim ato që na takojnë prej traditës historike dhe konstitucionit etnologjik"[4].

Qeveria italiane deklaroi, në përgjigjen e saj ndaj notës ruse të Majit se Italia kishte hyrë në luftë, për triumfin e principeve të shenjta të lirisë së popujve të shtypur... Të gjithë shpirtrat e pushtuar ose të dominuar ishin ekskluduar nga politika e saj.[5]

Shumë deklarata u bënë, nisur veçanërisht nga kërkesa që Konferenca e Paqes duhej të kishte

3. Wilson, "Kater principe të paqes" Fjala në Kongres 11 shkurt 1918, rishtypur në vende të ndryshme nga origjinali i kongresit, LVI,1937.

4. Shtesë e shtypit aleat, 13 shkurt 1918.

5. Le matin, 20 Qershor 1917

vepruar në lidhje me çështjen shqiptare. Midis tyre shquhej ajo e vitit 1914, e cila autorizonte pushtimin grek dhe italian; pastaj vinte ajo e bërë më 1917, mbas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë nga italianët, kur Sonino deklaroi se Fuqive në takimin që do të kishin për të diskutuar rreth traktatit të paqes i mbetej si detyrë e përgjithshme, përcaktimi i përpiktë i kufijve të shtetit Shqiptar ndaj shteteve fqinj të saj [6]. Balfour, duke u përgjigjur në dhomën e komunave, më 18 shkurt 1918 tha:

Rregullimet e bëra më 1913, ndaj të cilave Shqipëria nuk ishte palë, kanë pushuar së qënuri më forcë, pasi të gjitha Fuqitë nënshkruese tani janë të përfshira në luftë. Sa i takon të ardhmes... qeveria e madhërisë së tij do të ishte e kënaqur të shikonte principet e nacionalitetit të zbatuara sa më shumë të jetë e mundur, ashtu siç do të ishte e kënaqur të shihte çështjet e tjera të vështira të zgjidhura, të cilat i mbetën Konferencës së Paqes.[7]

Mbështetur në dy themele, vetvendosjea abstrakte dhe premtimie për një zgjidhje përfundimtare të çështjes shqiptare në Konferencën e Paqe, të dyja

6. Kronikë ditore e shtypit të huaj, 23 qershor 1917

7. Debate Parlamentare, Dhoma e Ulët (1918) CIII, 454. Shih gjithashtu deklaratën e Balfourit të 5 Dhjetorit 1917 në Dhomën e Komunave: Po aty (1917) C,400

palët, si grekët edhe shqiptarët ushqyen shpresa të mëdha me të cilat u nisën për në Paris.

Programi i Uillsonit, ku figuronte vetvendosja, ishte mishëruar në marrëveshjet e armëpushimit, marrveshje e cila nuk iu lejonte Aleatëve të paraqitnin pika të cilat binin ndesh me këto principe.[8]

Siç del edhe nga deklarata e bërë më vonë prej tij, Presidenti Uillson këto kushte i vlerësonte si të detyrueshme për aleatët, ndaj thoshte se ai "nuk ndjehej i lirë në se sugjeronte një bazë për paqe me Gjermaninë dhe një tjetër me Austrinë"[9] Kur kushtet e armëpushimit të Gjermanisë ishin në shqyrtim u paraqitën dy rezervime, njëra prej britanikëve mbi lirimin e deteve dhe një tjetër prej itlalianëve, të cilët e kundërshtuan dy herë pikën e nëntë e cila siguronte një "rishikim i kufijve të Italisë duhej të përmbushej bashkë me linajt e njohura qartë të kufijve nacionale". Kur e mori vesh se kjo pikë nuk ishte në diskutim, Orlando tha se në momentin më të përshtatshëm ai

8. Shih veçanërisht notën që qeveria e Austro-Hungarisë i dërgon sekretarit lansing, 29 tetor 1918. Buletini zyrtar i SHBA-ve 31 tetor 1918. Rishtypur me dokumente që kanë të bëjnë me të, në Intercional Conciliation, nr.133 (dhjetor 1918)

9. "Memorandum në lidhje mne çështj4et e kërkesave italiane në Adriatik", 14 Prill1919, dokumenti 35, në Baker, Woodroë Wilson and Wold settlement, III, 274.

do të ripërtërinte kundërshtimin që ai tashmë e kishte ndërmarrë; por kundërshtimi italian, ndryshe nga ai britanik, nuk u bë publik për shumë kohë deri sa erdhi një moment kur ishte tepër vonë (1 Maj 1919) [10] për të patur ndonjë efekt në diskutimet rreth tij.

Një zgjidhje e përshtatshme e bazuar në principet e nacioanlizmit dhe të vetvendosjes do të ishte mjaft e vështirë për t´u arritur. Përveç kësaj situata në Konferencën e Paqes nuk ishte e thjeshtë: Traktatet e fshehta në kontrakditë flagrante me qëllimet e pranuara dhe të shpallura hapur të Aleateve i komplikonin të tëra përpjekjet për një zgjidhje. Kushtet e Traktatit të Fshehtë të Londrës të cilat e futën Italinë në luftë ishin qartazi kundër principeve të vetvendosjes. Në të vërtetë, beteja e Konferencës së Paqes sillej rreth çështjes se sa peshë duhej t´i jepej traktateve sekrete. Duke iu referuar Traktatit të Londrës një autoritet ka thënë:

Ai ishte pengesa kryesore në Konferencën e Paqes. Për shkak të debateve të cilat vërtiteshin rreth tij, kësaj çështjeje iu kushtua më shumë rëndësi në diskutimet e Këshillit të të të Katërtve, këshillave të tjerë dhe komisioneve se sa ndonjë çështje tjetër të

10. The Times, (Londër), 2 maj 1919.

vetme të diskutuar aty.[11]

Publikimi i traktateve sekrete prej bolshevikëve në Nëntor të 1917-tës, megjithëse në krahasim me rëndësinë që kishin, iu kushtua pak vëmendje prej publikut të përgjithshëm, i vinte në pozitë të vështirë aleatët. Lloyd Xhorxh në fjalimet e tij në Konferencën e Tred Unioneve të 5 janarit 1918, në një përpjekje për të pajtuar kritikizmin radikal të luftës tha:

"Shumë është thënë rreth parapërgatitjeve të bëra me të cilat ne kemi hyrë së bashku me Aleatët tanë në këtë çështje, (coptimin e Turqisë) dhe çështje të tjera. Unë mund të them vetëm se rrethanat e reja siç janë kolapsi dhe bisedimet e veçuara ruse, kanë ndryshuar kushtet nën të cilat këto parapërgatitje ishin bërë; ne jëmi dhe gjithmonë kemi qënë plotësisht gati për të diskutuar me aleatët tanë.[12]"

Kur u hap Konferenca e Paqes, ky ishte ndoshta prononcimi më i qartë që ishte bërë e që meritonte t'i bashkangjitej traktateve të fshehta.

Dy muaj pas armëpushimit, në Konferencën e Paqes të mbledhur në Paris, në sesionin e parë plenar të saj të mbajtur më 18 janar 1918, Greqia ishte

11. Baker, vepër e cituar I, 52, 1919.
12.Lloyd George, vepër e cituar f.11-12.

njëra prej më të favorizuarave prej kombeve ndërluftuese, edhe pse kishte luajtur një rol krejt të vogël në këtë luftë. Asaj i ishin dhënë dy delegate, por meqënëse delegatet votonin si një njësi, kjo nuk përbënte ndonjë avantazh të veçantë; dhe megjithatë përpara se sesioni i parë plenar të mbahej, ishte vendosur tashmë që punët e rëndësishme të Konferencës të kryheshin prej përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha (Britanisë së madhe, Francës, Italisë, Shteteve të Bashkuara dhe Japonisë). të njohura si Këshilli i të Dhjetëve. Për më tepër ky këshill mbulonte një volum të madh pune ku shpreheshin dhe merreshin këshillat e specialistëve si dhe krijonte komisionet e ekspertëve të cilët vepronin me shumicën e çështjeve teritoriale. Në propozimin për themelimin e të parit prej këtyre komisioneve, Mr.Lloyd Xhorxh parashtroi vështirësi të mëdha për të vendosur "çështjen e kufijve në deklarata gjatë rrjedhës së bisedimeve, sado të qarta të ishin ato". Ai më pas propozoi një komision me dy ekspertë nga secila prej katër Fuqive të studjonin problemin dhe bile sygjeroi t'i autorizonte ata që të konsultoheshin me përfaqësuesit e popujve të interesuar. Në alarm, Orlando atakoi propozimin për përdorimin e specialistëve. Por presidenti Uillson

e mbështeti fuqinë e planit, duke sjellë plot argumente të tjerë. Në qoftë se rezoluta nuk ishte pranuar ai tha:

"ai mund ta gjejë veten të shtrënguar për të luftuar çështjen thjeshtë mbi pikpamjet e shprehura prej ekspertëve amerikanë; por ai do të preferonte që këto konkluzione të ballafaqoheshin me pikpamjet e specialistëve francezë, britanikë dhe italianë.

Duke folur rreth kërkesave të paraqitura prej delegatëve të shteteve të ndryshme, të interesuara për seicilin problem, Uillsoni tha:

"Duhet të kujtojmë se ... këta delegatë ishin thjeshtë avokatë që kundërshtonin kërkesat për të arritur në përfundime të mbështetura mbi fakte. Ata nuk përfaqësonin faktet e tyre në të njëjtën mënyrë e kështu gjithmonë do të mbetej diçka që nuk ishte krejt e qartë[13]".

Kërkesat greke u paraqitën përpara Këshillit të të Dhjetëve me 3 dhe 4 shkurt prej përfaqësuesve zyrtarë grekë, Venizellos dhe Politis [14]. Pasi u dëgjuan kërkesat prej tyre u adoptua rezoluta e mëposhtme e propozuar prej Lloyd Xhorxhit:

13. Proces-verbal sekret, Këshilli i të Dhjetëve, 1 shkurt 1919. Cituar prej Bejker, vepër e cituar I, 185-87

14. Le Temps, 3 shkurt 1919.

"Jemi marrë vesh që çështjet e ngritura në deklaratë prej Venizellosit mbi interesat territoriale greke në zgjidhjen paqësore do të referohen për shqyrtim në instancën e parë të një komiteti ekspertësh të përbërë prej dy përfaqësuesish prej secilit vend, pra SHBA-ve, Perandorisë Britanike, Francës dhe Italisë. Do të jetë detyrë e këtij komiteti që të zvogëlojë dyshimet për vendimin brenda limiteve më të ngushta të mundura dhe të bëjë rekomandime për zgjidhje të përbashkët. Komiteti është i autorizuar që të konsultohet me përfaqësuesit e vendeve të interesuara"[15].

Komiteti i themeluar në këtë mënyrë përbëhej prej:

Ameriaka: Dr.W.L Westermann dhe Mr. Clive Day

Britania e Madhe: Sir Robert Borden dhe Sir Eyre Croëe

Franca: M.Jules Cambon dhe M.Jean Gount.

Italia: Sinjor de Mortino dhe Sinjor Castoldi.[16]

Më 18 shkurt ky trup shqyrtoi kërkesat e Greqisë[17]. Më 24 shkurt këshilli i të Dhjetëve, pasi dëgjoi kërkesat e përfaqësuesve të shtetit shqiptar e referoi çështjen tek ky komitet [18].

15. Manchester Guardian, 5 shkurt 1919.

16. Konferenca e Paqes. f.-2.

17. Po aty

18. Manhester Guardian, 25 Shkurt 1919.

Pozicioni i Greqisë në Konferencën e Paqes ishte i kufizuar prej dy faktorësh. Së pari, qëndrimi dhe pjesmarrja gjatë luftës; dhe së dyti, zotësia dhe politika e udhëheqësit të saj, Venizellos. E parë në këtë këndvështrim, e para ishte e favorshme, por ajo mbulohej në një shkallë të lartë prej së dytës. Venizellosi ishte tejet i suksesshëm kur ishte fjala për shfrytëzimin e miqësisë me aleatët dhe me një mjeshtëri të përsosur ai bëri shumicën e ndërhyrjeve të Greqisë në anën e Aleateve, ndonëse kjo ishte shtyrë deri në kthimin e tij në fuqi.[19] Ç'është e vërteta, përdorimi politik i pjesmarrjes së tij në luftë për qëllimet e realizimit të aspiratave kombëtare greke mund të krahasohet lehtë me zotësinë në drejtimin e shtetit Cavour-it dhe përdorimin nga ana e tij të situatës evrpoiane në Luftën e Krimesë për të përmbushur kauzën për të cilën punonte,

Venizellosi ishte natyrisht përfaqësuesi i Greqisë në Paris. Atë e shoqëronte ministri i tij i punëve të jashtme, Politis, një shok i ngushte dhe bashkëpunëtor në qeverinë provizore të Selanikut [20]. Megjithëse që të dy ishin nacionalistë të zjarrtë,

19. Për qëndrimin e Venezillosit në Konferencën e Paqes si dhe për biografinë e tij shih Gibbons, Venizellos. Chester, Jeta e Venizellosit u shkrua përpara e fundit të luftës.

20. New York Times Current History, Prill 1919, f.21.

ata ishin të moderuar në kërkesat dhe qëndrimet e tyre.[21] Politis deklaroi se ai e konceptonte panhelenizmin jo si formën e aneksimeve absolute, por si autonomi për rajonet e caktuara dhe një regjim të garancive për të tjerët [22]. Ai deklaroi gjithashtu:

Aspiratat kombëtare të Greqisë mund të përmblidhen në një frazë të vetme: zbatimi pa kushte i principeve për të cilat u bë lufta, mbi bazën e të cilave do të vendosej paqja, pra principeve të mëdha të së drejtës së popujve për t'i prirë vetvetes.[23]

Venizellosi në mënyrë diskrete e la Athinën për në Paris pa zbuluar asgjë lidhur me kërkesat që do të paraqiste duke u frikësuar se mos ushqente shpresa që nuk përmbusheshin dot [24]. Ai u vendos në një banesë afër hoteleve britanike, por larg shtabeve të Fuqive të tjera tëMëdha

Ai kishte vendosur që të luante jashtë fushës me britanikët [25]. Më 20 Janar 1919 Venizellosi i deklaroi kërkesat e tij në faqet e "Le Temps" dhe një javë më vonë ai i paraqiti personalisht me gojë këto kërkesa përpara Këshillit të të Dhjetëve.

21. Woods, Djepi i luftës, f.171.

22. Christian Scinse Monitor, 18 tetor 1918.

23. Politis, në Kronikën Ballkanike, I, f.246; Politis, Aspiratat kombëtare të Greqisë, f.3.

25. Gibbond, Venezillos, f.332-33.

Në Konferencën e Paqes të vitit 1919 krejt ndryshe nga mbledhjet e mëparshme të këtij lloji, opinioni publik ushtroi një influencë shumë të madhe, pasojat e të cilit i dinin shumë mirë ata që kërkonin të përfitonin nga Konferenca. Për këtë, u vendosën atje shumë agjenci të rëndësishme për të ushqyer opinionin publik; shtypi i përditshëm, [26] mbledhje dhe fjalime, shoqëri të tëra me botimet e tyre, propagandë e llojeve të tjera, libra, pamflete, harta, statistika, -të shpërndara publikut prej delegatëve zyrtarë të ndryshëm. Të gjitha artificet e propogandës, aq të njohura e të gjithanshme për Ballkanin, i shërbenin në shkallë të ndryshme shpifjeve ndaj kundërshtarëve, mbürrjes së vetvetes, dredhive të qëllimshme dhe shtrëmbërimit të statistikave, të gjitha llojeve të presioneve personale, fallsifikimit të lajmeve, identifikimit mjeshtëror të mediokritetit të tashëm me gjenitë e të kaluarës, përsëritjes së të pavërtetave deri sa ato të bëheshin të besueshme.[27]

Prej shoqërive pro-greke nga më të rëndësishmet ishin lidhja anglo-helenike [28], shoqëria amerikano-

26. Për anën greke, veçanërisht Le Temps dhe Christian Sciense Monitor.

27. Lybyer, Jurnali i Marrdhënieve Ndërkombëtare, X, 412.

helenike [29], dhe unioni pan-epiriot i Amerikës [30]. Kjo e fundit mori pjesë aktive më 1919 në garën se kush do t` i mbronte më mirë pretendimet e Greqisë ndaj Epirit të Veriut.

Çdo delegacion paraqiti në Konferencë një ose më shumë memorendume duke parashtruar kërkesa zyrtare territoriale të qeverive të tyre. Përkrah këtyre dokumenteve propoganda e mirfilltë e delegacioneve e shpërndarë në publik përmbante në çdo rast një shumicë materialesh të mbledhura nga shumë burime, siç janë shoqëritë e njohura publike, rishtypje të periodikëve si bie fjala prej Revistës Ballkanike dhe Evropës së Re, pikpamjet e grupeve

28. Uthemelua në vitin 1913. Qëllimet e saj: Të mbronte drejtësinë e kërkesave dhe nderin e Greqisë; të zhdukte paragjykimet që ekzistonin dhe të parandalonte keqkuptimet në të ardhmen midis racave të tjera të Europës Juglindore; të shpërndante informacion që kishte të bënte me Greqinë dhe të nxiste interesin mbi çështjet helenike; të përmirësonte marrdhëniet sociale, arsimore, tregtare dhe politike; të nxiste udhëtimet për në Greqi dhe të siguronte përmirësimin e kushteve për këtë. (Deklaratë nga faqja e fundit e kopertinës së botimit të Lidhjes anglo-helenike).

29. U themelua më 1917 me president Nicholas Murray Butler. Qëllimi: "të bënte të njohur pozita, interesat dhe ambicjet e Greqisë dhe të nxiste simpatinë ndaj saj. (Parathënje e botimit të parë, Shoqëria Amerikano-Helenike, Gauvain. The Greek Question).

30. E organizuar në vitin 1918 "me qëllim kryesor ndriçimin e opinionit publik amerikan rreth aspiratave kombëtare të popujve të Epirit të Veriut për tu bashkuar me vendin e tyre nënë, Greqinë. (Brenda faqes së kopertinës, botimi i parë; bashkimi Pan-Epirot, Cassavetes. The Question of Northern Epirus at the Peace Conference; (Çështja e Epirit të Veriut në Konferencën e Paqes), për datën e organizimit shih f.117.

të veçanta, sikundër edhe ato të socialistëve grekë, libra që merreshin me historinë e re e nganjëherë edhe atë të largët, historinë e rajoneve të kërkuara si p.sh Brenga e Epirit e Puauksit dhe së fundi statistika dhe harta. Memorandumi zyrtar përbënte burime të dorës së parë për një studim të kërkesave të paraqitura, por pjesa tjetër e propogandës së delegacioneve të tjera vlerësohej si e ilustruar, e amplifikuar ose e mbushur me qëndrime dhe pikpamje ekstreme.

Memorandumi zyrtar grek i bazonte dukshëm kërkesat e tij në karakterin racial të popullsisë së interesuar.

Fitorja e plotë e aleatëve dhe shteteve përkrahëse të tyre mundësoi rastin që të fiksoheshin kufijtë politikë të shteteve evropiane në përputhje të plotë, ose aq të plota sa ishte e mundur, bazuar në karakterin e tyre etnik. Në këtë mënyrë do të formohej baza e Shoqërisë së Kombeve [31]. Prej kombit helenik që jetonte i shpërndarë jashtë mbretërisë së greqisë, vazhdonte dokumenti, 151.000 banorë grekë ishin pjesë e një popullsie prej 230.000 frymësh që përbënte popullsinë e

31. Greqi, Propoganda e delegacionit, Greqia përpara Kongresit të Paqes f.3.

"Epirit të Veriut". Me ndarjen e atyre krahinave, popullsia e të cilave është thuajse tërësisht shqiptare[32], ndaj të cilave nuk kishte pretendime, atje do të mbetej një popullsi e përzier prej 120.000 grekësh dhe 80.000 shqiptarësh. Këta dy elementë janë kaq shumë të koklavitur sa që një ndarje midis tyre e bazuar në vija gjeografike do të ishte e pamundur.

Greqia kërkonte që kjo popullsi e përzier duhej domosdoshmërisht t`i caktohej asaj. Për atë, do të ishte krejtësisht e papranueshme që në një popull të dhënë, një shumicë e cila zotëron një formë më të lartë civilizimi, t'i nënështrohej një pakice me një civilizim inferior. [33]

Momerandumi më tej shtonte se shteti shqiptar do të ishte i pazoti për kohën që po kalonte, "të ekzistonte si një shtet i pavarur përveçse nën kujdestarinë e huaj". Pra, vazhdonte arsyetimi, përse kjo popullsi e përzier të mos vihej nën shtetin grek, i cili tashmë gëzonte ekzistencë politike të pavarur, e jo nën një Shqipëri të pazonja për një qeverisje autonome. E nëse kjo kundërshtohej me faktin se një pjesë e konsiderueshme, bile dërmuese e

32. Kjo është pjesë e kazasë së Tepelenës dhe Përmetit, e cila gjindet në veri të Lumit të Vjosës dhe Kazasë së Starovës.

33. Po aty,

popullsisë greke e përdorte gjuhën shqipe si gjuhë të nënës atëherë: ... konceptet demokratike të Aleateve dhe Fuqive antare nuk mund të lejojnë ndonjë standart tjetër përveç atij të ndërgjegjes kombëtare. Vetëm koncepti gjerman mund të zëvëndësonte këtë, pra standarti i racës ose i gjuhës.[34]

Pavarësisht nga përdorimi prej tyre i gjuhës shqipe pohohej se këta grekë formonin pjesë të familjes greke prej një kohe shumë përpara se sa të krijohej, mbretëria greke. Për këtë ata i referoheshin udhëheqësve ushtarakë që morën pjesë në luftën për pavarësi të Greqisë si dhe valles së grave suliote, gjuha e nënës e të cilave ishte shqipja, por që u hodhën nga lartësia e maleve "që të mos binin në duart e shqiptarëve muhamedanë"*. Aq më tepër, vëmendja tërhiqej edhe nga fakti se sot shumë udhëheqës të shquar civilë, ushtarakë dhe detarë të Greqisë si dhe shumica e ekipeve të forcave detare greke e flasin shqipen si gjuhë të nënës. Konkluzioni ishte se përdorimi i gjuhës shqipe nuk ndikonte në

34. *Po aty.*

* *Duket se autorja është e keqinformuar rreth legjendës së hedhjes së vajzave shqiptare (e jo greke) nga shkëmbi për të shpëtuar invadorëve osmanë,. E njëjta legjendë gjendet edhe në Krujë e që njihet me emrin "Vajzat e Shkëmbit të Vajës". Po ashtu ajo gjendet edhe tek vajzat suliote. (Shën. i përkth.)*

kombësinë shqiptare.

Memorandumi grek shkonte më tej në kërkesa të veçanta ndaj Korçës ".. të cilën shqiptarët sot përpiqen ta paraqesin si qendër të lëvizjes së tyre intelektuale..." Për të provuar karakterin thellësisht grek të këtij qyteti, shkollat greke, të mbështetura prej bashkisë me 2.250 nxënësit e tyre përpara Luftës Ballkanike, krahasoheshin me një prej shkollave shqiptare e cila ndonëse me drejtim të shkëlqyer amerikan kishte vetëm rreth dyqind nxënës të regjistruar. Të dyja rastet ishin citime të legjitimitetit të refuzuar prej komitetit gjatë viteve të shkuara, në njërin rast pranimi i kërkuar i mësimit të shqipes në shkollat greke dhe në tjetrin fjala "grek" ishte lënë jashtë veprimit.[35]

Ndodhitë e fundit të rajonit nga Lufta Ballkanike po rishiheshin. Formimi i qeverisë së përkohëshme me 1914, kundërshtimi i Epirit të Veriut për t'ju nënshtruar administratës shqiptare dhe njohja e autonomisë së saj prej protokollit të Korfuzit përmendeshin për të treguar dëshirat e natyrshme të epirioteve për bashkimin me Greqinë. Si rezultat i rritjes së anarkisë në Shqipëri me largimin e Princ

35. *Greqia, Propaganda e delegacionit, greqia përpara konferencës së Paqes, f.4-5.*

Vidit pas shpërthimit të Luftës së Madhe, qeverisë greke iu këkua të ndërmerrte një pushtim të ri ushtarak në Epirin e Veriut për të rivendosur rendin.

Greqia e pranoi këtë kërkesë mbasi kishte marrë një miratim në heshtje nga ana e italianëve. Nën kujdesin e Britanisë së Madhe u arrit në një marëveshje nën të cilën Italia do të pushtonte Vlorën, ndërsa Greqia "Epirin e Veriut", pushtime këto të cilat u lanë të shpalleshin përfundimisht në Konferencën e Paqes. Por ishte taktikisht e kuptueshme se nëqoftëse në kohën e paqes së përgjithshme pushtimi i Vlorës prej italianëve ishte konfirmuar, ai i Epirit të Veriut prej Greqisë duhej po ashtu të përcaktohej. Gjithashtu, ndërsa duke njohur në Traktatin e Londrës të 26 Prillit 1915 të drejtën e Italisë për të pushtuar Vlorën, Fuqitë e Antantës kushtëzuan që caqet e këtij pushtimi drejt Jugut* nuk duhet të shkelnin "Epirin e Veriut". [36]

Në këtë mënyrë, i gjithë apeli i kërkesave zyretare greke, në të vërtetë ishte i bazuar në "ndërgjegjien kombëtare" që ishte një përpjekje e bërë për të treguar që shumica e banorëve të këtij rajoni janë

36. Po aty, f.5

** Shiko me kujdes pazarllëqet që bëhen dhe ku bëhen ato. (shën.i përkth.)*

me të vërtetë grek në ndjenja. Argumentat që bazoheshin në pikëpamje racore dhe gjuhësore deklaroheshin si të gabuara.

Në të vërtetë ishte vënë re se "hedhja poshtë e gjuhës si provë e përkatësisë kombëtare ishte tipari më i rëndësishëm i kërkesave helenike"[37]. Dëshira e popujve rridhte prej historisë së tyre. Frika e ekspansionit italian shfaqej në deklaratën përfundimtare të bazuar në pushtimin e autorizuar gjatë luftës dhe në përcaktimin e Traktatit të Londrës. Toni i moderuar i dokumentit bënte kontrast të plotë me atë të propagandës progreke, veçanërisht me Memorandumin mbi Epirin e Veriut i bërë prej qeverisë së përkohëshme të mëparshme. Ky dokument më vonë u bë shumë më i plotë. Argumentet duhej të shqyrtoheshin tashmë në disa detaje. Memorandumi fillonte me deklaratën që ishte përpiluar dhe paraqitur prej ish qeverisë, e cila vazhdonte luftën për pavarësinë e Epirit të Veriut, më 1914 pasi popullsia e dy provincave të Gjirokastrës dhe Korçës ishin... privuar nga dëshira e tyre për t`u bashkuar me Greqinë.

Duke i parqitur këto kërkesa veç e veç, nuk kishte

37. Gibbons, Venizellos, f.346.

Harta 4 - Hartë e Epirit të Veriut. (Nga Memorandumi mbi Epirin e Veriut, paraqitur në Konferencën e Paqes prej Qeverisë së Përkohshme të Epirit të Veriut.)

për qëllim që të zhvendoste punën e delegacionit grek por, ".... të paraqiste faktet që kishin të bënin me Epirin me më shumë liri se sa ato që do të mund të ushtronte qeveria helenike në rrjedhjen e zgjatur të bisedimeve.[38]

Principet e shpallura prej Uillsonit ishin ato që do të udhëhiqnin konferencën. Në memorandum shpallej se "e drejta e kombeve" nuk do të bazohej më në aktet e qeverive të cilat bënin rregullimet midis shteteve, por në njohjen e të drejtave të popujve për t`u vetqeverisur nga qeveri të zgjedhura prej vetë atyre.

Dëshirat e popullsisë së atjeshme, "... kanë qënë saktësisht të përcaktuara ... prej revolucionit të fundit epirot". Për të demostruar këtë fakt u shqyrtua historia e ngjarjeve të 1913-tës dhe 1914-tës. Proçedura e përcaktimit të kufijve nga komisioni, duke e bazuar vendimin e tij në gjuhën e folur e duke e përjashtuar "ndërgjegjien kombëtare të popullit" kishte hasur në protesta [39]. Revolucioni epiriot, vazhdonte dokumenti, ndodhi "pa ndihmën apo mbështetjen e kurkujt, por i shtyrë nga një

38. Greqia, Propaganda e delegacionit, Memorandum mbi Epirin e Veriut, f.3.

39. Po aty, f.4

ndjenjë kombëtare e përmbajtur. .."Zgjidhja që iu bë çështjes në Korfuz, tregonte se popullsia e revoltuar ishte epiriote e jo shqiptare"[40]. Ndjenja kombëtare ishte shfaqur edhe më tepër kur ata kishin zgjedhur dhe dërguar deputetët në Parlamentin grek më 1915, në një mision për të kërkuar njohje ndërkombëtare të bashkimit të Epirit me Greqinë. "Kështu, aspiratat për bashkim me Greqinë ishin manifestuar në përputhje të plotë me principet e përgjithshme të njohura".[41]

Memorandumi shënonte edhe një protestë kundër pushtimit italian të Epirit të Veriut. Ai deklaronte që evakuimi trupave "ishte bërë imperativ" tani që lufta kishte mbaruar.[42]

Dhe së fundi, memorandumi përshkuante persekutimin e grekëve nga italianët.[43] Administrata italiane ushtronte presion mbi grekët që të shqiptarizoheshin dhe në shkurt të vitit 1918 ajo i mbylli shkollat greke. Kësaj i shtohej edhe fakti që

40. Po aty, f.6

41. Po aty, f.7

43. Greqia, propaganda e delegacionit, Memorandumi mbi Epirin e Veriut, f.4. Për të njëjtën pikpamje, shih Le Journal des Hellens, 14 Dhjetor 1918. "me nënshkrimin e armëpushimit çfarë arsyesh mund të përligjin zgjatjen e pushtimit italian në Epir? Kur armiqtë tanë nxisin nacionalizmin e tyre si mundemi ne të tolerojmë një aleat që të përkrahë dominimin e saj?"

nën pushtimin italian, xhandarmëria ishte e përbërë krejtësisht prej shqiptarësh myslimanë. Grekët me ndjenja të pastra, shumica prej tyre nga Himara, u dërguan në Itali për shkak të influencës të cilën supozohej që ata do të ushtronin si dhe lidhjet e tyre me idenë helenike. Gjykata shqiptaro-italiane, ishte e pafuqishme të vepronte ndaj shkeljeve të ligjit të bëra më parë. Ndryshe nga amnistia e shpallur në Korfuz, asnjë rast gjykimi nuk dihej të kishte përfunduar në disfavor të myslimanëve. Në këto kushte, vazhdonte dokumenti, elementi kristian dëshironte natyrshëm të emigronte dhe emigrimi i tij ishte nxitur prej italianëve. Kështu shumë prej tregtarëve më të mirë grek prej krahinës u përzunë.[44] E vetmja fjalë e mirë që ishte thënë për regjimin italian ishte ajo për përmirësimin e rrugëve, të ngritjes së ndërtesave publike në Sarandë. Për punë të tilla publike prej të cilave vendi me të vërtetë kishte përfituar, sugjerohej që popullsia të paguante një farë shume në marrveshje me Greqinë.[45]

Veprimi antihelenik dhe tendencat e italianëve në krahinat nën kontrollin e tyre deklarohej se ishin

44. Tabelë e cila tregon dhunën dhe krimet e bëra kundër banorëe të Epirit të Veriut gjatë pushtimit italian, Memorendumi mbi Epirin e Veriut Shtojcë.

45. Po aty, f.8-10

nxitur prej veprimtarisë së francezëve në Korçë. Koloneli Desconis bëri një përpjekje për të organizuar një administratë lokale, kështu që duke mbajtur pranë vetes aventurierë politikë, pranoi persekutimin e elementit grek. ....Shqiptarizimi i tyre ishte bërë mbas një seri masash dhunuese dhe ky eksperiment vazhdoi për një kohë të konsiderueshme para se zëri i shumicës të arrinte të bëhej i dëgjueshëm.[46]

Eksperimenti i Republikës së Korçës u quajt "Besim i verbër i oficerëve në fushatë, të cilët nxitonin që të bindnin se një dialekt i folur nga shtresat e ulta nuk ndikonte domosdoshmërisht në kombësinë e tyre..." Për më tepër theksohej se Korça ishte nga ana ekonomike e varur prej Manastirit dhe

46. Po aty, f.11. I tërë toni i këtij dokumenti, veçanërisht në kriticizmin e tij ndaj administratës italiane të Epirit të Veriut edhe thuajse paralel me një protestë të epiriotëve ndaj parlamentit Grek, botuar në Le Journal das Hellens, 28 Prill 1918. Qeveria greke, megjithatë nuk e aprovoi atë pasi dokumenti nuk ishte komunikuar në parlament deri në Dhjetor. (Po aty, 15 Dhjetor 1918) 'Italia zbaton ndaj Epirit të Veriut një politikë të kundërt me programin e lirisë së kombeve të vogla duke kërkuar në të njëjtën kohë ribashkimin me mëmëdheun e vet të asaj popullsie të shtypur në Trentino dhe Trieste. "Konditat e vështira thuhej më tej, ishin imponuar prej italianëve duke përfshirë mohimin e gjuhës greke në shkolla, zëvëndësimin mes katolikëve dhe myslimanëve të klerikëve grekë, prerjen e komunikimit me Greqinë dhe plaçkitjen e kristianëve prej bandave shqiptare. "Autoritetet italiane ndenjën fare të ftohtë ndaj kësaj çështjeje duke shpresuar se përpara konferencës së paqes banorët do të zhdukeshin"

prej andej prej Selannikut. Këtë e vërtetonte edhe fakti se ajo ishte përfshirë në vilajetin e vjetër otoman të Manstirit. Kështu, nyjet e kufijve të Epirit dhe të Maqedonisë duhej të ishin ekonomike pa përmendur avantazhet strategjike.[47]

Për këtë qeveria provizore, nënvizoi në këtë memorandum, se Epiri nuk kishte dëshiruar kurrë të shkelte mbi fqinjët e vet, megjithëse një numër i madh i kristianëve, të ndjenjave greke i ishin bashkuar shtetit të ri shqiptar.[48]

Si përfundim ajo përshkruante me hollësi luftën e përhershme të epiriotëve për t'i sjellë fëmijët në një kishë kristiane ortodokse greke, një kishë e cila kishte ditur "... se si të hiqej mënjanë kur elementet etnologjike ishin zhvilluar aq efektshëm sa të lejonin krijimin e një shteti të pastër laik, "shkollat e të cilit"... të mos ishin kurrë institucione sektare.. por shtëpi refugjatësh...". "prandaj a është e arsyeshme", përfundonte deklarata, "të vendosej nën mbrojtjen e interesave egoiste një vend ku, për shekuj të tërë, nacionalizmi helenik ka bërë përpjekje që të vendosej nën një qeveri të vetme e cila do të përfaqësonte mendimin dhe vitalitetin e tij"?[49]

46. Memorendumi mbi Epirin e Veriut, f.12
47. Po aty, f.13
48. Po aty, f.14.

Vlerësimi i mësipërm i kërkesave zyrtare paraqiste pikpamjen e qeverisë. Këtyre kërkesave u shtohej edhe propaganda e delegacionit të mbetur i cili avancoi me fakte të tjera dhe argumente rreth kauzës se helenizimit në Epirin e Veriut. Disa prej këtyre argumenteve shtesë tani duhen vlerësuar.

Profesor Andre' Andreades i Universitetit të Athinës në një mision gjysmë zyrtar në Shtetet e Bashkuara i përmblodhi në përgjithësi kërkesat greke si më poshtë:

...Kërkesat e Greqisë justifikohen, pikësëpari, në bazë të principeve të vetë-vendosjes; së dyti, në premtimet e dhëna prej fuqive aleate; dhe së fundi, në vlerësimin e sakrificave të bëra prej helenizmit, si dhe në pjesën e rëndësishme që ushtria greke mori në arritjen e fitores së madhe të fundit të Tetorit. [50]

Epiri i Veriut ishte kërkuar në mënyrë të përsëritur prej Greqisë në bazë të principeve të vetvendosjes. Shumica e banorëve kishin shfaqur qartë dëshirat e tyre duke luftuar për bashkimin me Greqinë më 1914. Në se dëshirohej një evidencë e mëtejshme, mund të mbahej jo nën vështrimin e zyrtarëve dhe

49. Memorandumi mbi Epirin e Veriut, f.15. Një shtesë që përmban statistikat e populisisë sipas feve ashtu sikundër edhe shifrat e ndjekjes së shkollave dhe numrin e kishave dhe priftërinjve. (Po aty, f.17)

50. New York Times, 25 maj 1919.

ushtarëve italianë, por i çliruar prej çdo lloj influence, nga një komision i paanshëm i cili do të jepte mundësi që edhe ndonjë banor i cili e kishte lënë vendin gjatë dy viteve të fundit të lejohej që të kthehej për të votuar.[51]

Një plebisht i vërtetë i painfluencuar prej një fuqie të interesuar, do të ishte i mirëpritur në Greqi. Pra, a i nevojitej Italisë të kërkonte më shumë? Vetëm duke ua bërë të qartë vetë njerëzve se çfarë është ndjenja e tyre kombëtare, mund t'ju tregohen atyre faktorët që përcaktojnë kombësinë e një grupi të dhënë racën, fenë, kulturën, ekonominë, gjeografinë, shtypjen, simpatitë, ç´ka do të ishte elementi vendimtar në një kohë të dhënë. [52]. Zbatimi i principeve të tilla popujt duhet të jenë të lirë t'i prijnë të ardhmes së tyre, ishte deklaruar prej socialistëve grekë si e vetmja zgjidhje e problemeve që kishte Lindja e Afërt [53]. Një pasqyrë më e qartë e ndërgjegjes kombëtare të epirotëve gjendej tek disa shkrimtarë në prirjet e tyre publike ndaj Athinës dhe

51. Greqia, Propaganda e delegacionit, Reeves, Një thirrje për Çlirimin dhe bashkimin e racës helenike, f.23 Për një plebeshit në kondita të njëjta, shih Burrows, Bashkimi i racës greke, f.5; Chrussachi, Greqia e Madhe, f.11.

52. Burrows, Shqipëria dhe Greqia, f.5 (Europa e re) 19 dhjetor 1918.

53. Greqia, Propaganda e delegacionit, Çështja e lindjes për socialistët grekë, f.8.

Konstandinopolit.[54]

Raca dhe gjuha, argumentonin propogandistët grekë, nuk përbënin kriter të ndërgjegjies kombëtare. Kërkesa e Greqisë dukej kështu se ishte e njëjtë me atë të Francës ndaj gjermano-folësve të Alcasit [55]. Numri i madh i shqiptarëve në Greqi shihej qartë si mundësi për asimilimin e grekëve si dhe dëshmonte faktin se grekët vërtetë flasin shqip.

Problemi është se a dëshironin shqiptarët e Vorio Epirit të lidhnin fatin e tyre me një pjesë të shqiptarëve, shumica e të cilëve e simpatizonte Greqinë, apo me një Shqipëri të dominuar prej muslimanëve dhe kryesisht të pacivilizuar? Cilën do të preferonin ata, racën dhe gjuhën, apo kulturën dhe fenë? [56]

Superioriteti i pakundërshtueshëm i kulturës greke të Epirit të Veriut ndaj civilizimit të banorëve myslimanë përdorej shpesh e më shpesh si një mjet i vlefshëm për t'ja kaluar krahinën Greqisë.[57] "A

54. Përfitime të tilla të vëzhguara, Akademia, etj. janë përpiluar prej Andreades, Delegacioni grek në konferencën e paqes, f.5 shënimi2, dhe prej Reeves, vepër e cituar f.10.

56. Ne mund të adoptojmë epigramin e filozofit, i cili kur e pyetën në se e mohonte hyjninë e Krishtit, u përgjigje se ai mohonte hyjninë e njeriut. Në qoftë se nga ne kërkohet të dihet në se ne i mohojmë shqiptarët e Korçes, Atëherë në mund të përgjigjemi se ne mohojmë shqiptarizmën e jo greqishten. Shqipëria dhe Greqia. f.4-5.

duhet që ata (epiriotët) tu bashkohen kushërinjve të tyre raca e të cilëve vërtetë e civilizoi Evropën? Apo mos duhet që ata t`i dorëzohen një race, të cilën Europa nuk ka qënë e zonja ta civilizonte? [58]

Përveç këtyre argumenteve, grekët kërkuan me urgjencë vlerësime gjeografike, strategjike dhe ekonomike. Ata këmbëngulën se Epiri i Veriut ndahej nga Shqipëria prej malesh, vendosja e të cilëve e lidhte atë natyrshëm me Greqinë. Popullisa duhej të :"shkonte drejt grekëve në Epirin Jugor dhe Maqedoni në të gjitha çështjet tregtare. Ta shkëpusje atë prej Greqisë do të ishte ... një absurditet ekonomik"[59]. Por ç'farë ishte më e keqja ishte se po t'i jepej Shqipërisë Epiri i Veriut, Janina do të shkëputej prej tri arterjesh të rëndësishme tregtare: Korçës, Gjirokastrës dhe Sarandës, ndërkohë që Korça do të izolohej plotësisht prej dy tregjeve të saj kryesore , Janinës, Manastirit dhe Selanikut. [60] Atëherë, gjithnjë në pikpamje strategjike, këto barriera të shkëlqyera natyrale, Malet Acroceraunian, do të formonin kufijtë midis Shqipërisë dhe Epirit (grek).[61]

57. Politis, Aspiratat kombëtare të Greqisë, f.5
58. Reeves. Lutje për një Epir të civilizuar, f.11
59. Reeves. Një thirrje për çlirimin dhe bashkimin e racës helene f.46
60. Cassavetes, Epiri dhe Shqipëria, f.46

Në qotë se në sytë e helenëve, ndërgjegjia kombëtare, ekonomia, gjeografia dhe strategjia, të gjitha favorizonin bashkimin e Epirit të Veriut me Greqinë, këtë e kishte bërë historia, ndaj të cilave ajo kërkoi gjithmonë haraç. Epiri, shpallnin ata hapur, ka qënë vendi i kulturës greke në kohët antike. Ai e kishte ruajtur kulturën greke gjatë mesjetës e po kështu kishte vijuar edhe nën pushtimin turk, duke luftuar një shekull për t'u bashkuar me Greqinë.[62]

Shumë prej protagonistëve grekë sfiduan drejtpërsëdrejti kërkesat e shqiptarëve. Ata deklaruan se e ashtuquajtura mungesë e një gjuhe shqipe është pasqyrë e mungesës së ndërgjegjes kombëtare shqiptare, e cila sikur të ekzistonte "do të gjente shprehje në... këngët popullore dhe shkrimtarët e vet." [63].

Arsyet që jepnin shqiptarët rreth mbizotërimit të shkollave greke në Shqipërinë jugore ishin se shkollat shqipe nuk ishin lejuar të hapeshin prej qeverisë turke, se gjuha greke i tërhiqte ata prej kulturës që mbarte ndërkohë që gjuha shqipe ishte më pak e

61. *Cassavetes, Çështja e Epirit të Veriut në Konferencën e Paqes, f.87*
62. *Po aty, kap, III, f.9-36*
63. *Cassavetes, Epiri dhe Shqipëria, f.24-25*

zhvilluar dhe, që greqishtja ishte gjuha tregtare e përdorur në Lindjen e Afërt. Këto arsyetime grekët u përpoqën që t'i hidhnin poshtë duke thënë se turqit kishin penguar gjithashtu edhe kombet e tjera ballkanike.

Sikur shqiptarët të kishin qënë të frymëzuar prej shpirtit nacionalist, ata do të mund t'i detyronin lehtë turqit që tu lejonin mësimin e gjuhës shqipe... Nëqoftëse turqit dështuan për pesëqind vjet që të penetronin në Shqipëri, t'i rekrutonin dhe t'u vinin taksa shqiptarëve, sa naive duket të pranosh se shqiptarët ishin të privuar nga kultura për shkak të pushtimit turk.

Shtoi kësaj edhe arsyen tjetër se Austro-Hungaria dhe Italia kishin ushtruar çdo lloj nxitje për t'i tërhequr epiriotët nga shkollat greke. Ndaj arsyetimit të fundit të shqiptarëve, përgjigja ishte se gjuha greke nuk është aq e nevojshme në tregtinë e Lindjes së Afërt, sa ç'është gjermanishtja, frengjishtja, anglishtja apo italishtja.[64] Përveç kësaj pikpamja greke këmbëngulte në mënyrë të përsëritur tek ndarja fetare dhe fisnore në Shqipëri. Për të provuar "mungesën e ndonjë përpjekje apo ideali tek

64. *Cassavetes. The Question of Northern Epirus at the Peace Conference, f.79-81.*

shqiptarët" ata deklaronin se atyre u mungonte pikërisht "dëshira për të bashkëpunuar", e cila është esenca e nacionalitetit*. Për këtë ata citonin shënime udhëtarësh ose shkrimtarësh të bëra jo më vonë se pesëmbëdhjetë apo njëzet vjet më parë.[65] Linja e goditjes ndaj Shqipërisë plotësohej edhe duke e paraqitur atë si muslimane, pra një armike e aleatëve, e cila nuk meritonte të vlerësohej, por të ndahej nga konferenca.

Delegacioni grek për të ilustruar pretendimet e veta propogandoi fjalët e e një shkrimtari shqiptar i cili kishte thënë: "Falë shumicës muslimane të saj, Shqipëria e konsideron veten ende si një Turqi e vogël" [66]

Por le të kthehemi tani nga pozitat greke dhe kërkesat e saj në konferencë dhe të shohim kërkesat e Shqipërisë. Pozita e Shqipërisë kur u hap Konferenca ishte e vështirë. Territori i saj ishte thuajse i tëri nën pushtimin e huaj ushtarak, i cili vazhdoi edhe gjatë kohës së mbajtjes së Konferencës. Kjo ndarje artificiale pengonte bashkëpunimin e seksioneve të saj të ndryshme. Paraqitja e frontit të

* *Sa mirë e dinë dhe me sa mjeshtëri e shfrytëzojnë armiqtë tanë këtë dobësi të kombit tonë. (Shën i përkth.)*

65. Cassavetes, Epiri dhe Shqipëria, f.24-25.

66. Basri Bey, L'orient debalkanise et l'Albanie, f.5

bashkuar, prej të cilit vetëm Shqipëria mund të shpresonte që të fitonte ndonjë gjë nga Konferenca, ishte thuajse e pamundur. Në Dhjetor të vitit 1918 u mbajt një mbledhje e dyzet e tetë përfaqësuesve shqiptar në Durrës. U formua kështu një qeveri e përkohshme me kryetar Turhan Pashën dhe nënkryetar Prenk Bib Dodën së bashku me dymbëdhjetë anëtarë të kabinetit, që përbënin organin e ri qeveritar. Disa prej anëtarëve të kësaj qeverie u dërguan për në Paris, në përbërje të delegacionit shqiptar pjesmarrës në Konferencën e Paqes [67]. Pozita e qeverisë së përkohëshme të Durrësit ishte e vështirë që nga fillimi i punës së saj. Fuqia e vërtetë e saj ishte e vogël dhe shtrihej vetëm deri tek administrata e një pjese të zonës së pushtuar nën influencën italiane.[68]

Një punë të madhe në luftën për pavarësinë e Shqipërisë bënë shoqëritë e shqiptarëve që jetonin jashtë atdheut. Kryesorja prej tyre ishte Federata panshqiptare e Amerikës. E themeluar që më 1909, ajo deri më 1919 kishte arritur të ndërtonte shtatëdhjetë e dy degë në SHBA e Kanada dhe të

67. Për tekstin e aktit të themelimit të kësaj qeverie të përkohshme, e datuar 25 Dhjetor 1918, shih Albania. propaganda e delegacionit. Notes additionnelles relatives aux revenications albanses. f.7-9.

68. Eden, Shqipëria, pakënaqësia e saj dhe origjina e tyre, f.9

botonte një revistë mujore të quajtur The Adriatic Reviev.

Kjo shoqëri mbajti një delegat në Paris më 1919, Rev.C.Telford Erikson, ish misionar amerikan në Lindjen e Afërt. E dyta për nga rëndësia për kauzën shqiptare ishte shoqëria anglo-amerikane e themeluar pak para se të përfundonte lufta e që kishte si qëllim njohjen e pavarësisë së Shqipërisë. Kjo shoqëri britanike nuk publikoi pamflete nga ana e saj, por shpërndau botime të gjetura nga burime të tjera. Kështu i bënte përpjekjet e saj nëpërmjet mbledhjeve, komunikimit me shtypin dhe pyetjeve në Dhomën e Komunave. Nga më të shquarit prej tyre ishte i nderuari Aubrey Herbert, president, dhe Miss M.E. Durham, të dy miq të flaktë të Shqipërisë. Ndryshe nga organizatat amerikane kjo ishte e përbërë prej qytetarësh britanikë, të interesuar për Shqipërinë dhe jo prej shqiptarësh nga origjina.

Grupe të ndryshme të shqiptarëve brenda vendit dhe jashtë tij, vërshuan drejt Parisit. Delegacioni zyrtar shqiptar, siç ishte bërë e njohur tani, përbëhej prej Turhan Pashait, ish kryeministër në kohën e Princ Vidit, president i qeverisë provizore; Mehmet Konica, më vonë Ministër i Punëve të Jashtme, Dr.Mikel Turtulli nga Korça, specialist i sëmundjeve

tropikale; dhe Mgr.Luigj Bumci, prifti katolik i Alessios. Bashkë me delegacionin ishte një byro e "këshilltarëve ekspertë". Përkrah përfaqësuesit të federatës Pan- Amerikane të Amerikës ishin delegacione të tjera të përbëra prej përfaqësuesish të kolonive nga Konstandinopuli, Rumania dhe prej territorit të Korçës.[69] Delegacioni zyrtar shqiptar gjendej i sulmuar prej shumë anëve. Esat Pasha, më parë proitalian, por në këtë kohë proserb, deklaroi se qeveria e përkohshme dhe delegacioni i saj, ishin të paautorizuar dhe nën influencën italiane [70]. Këto insinuata patën jehonë tek grekët, të cilët ia mbërrinë të bëjnë përçarjen më të madhe tek shqiptarët;

Ata shkuan edhe më larg në shpifjet e tyre duke thënë se Turhan Pasha ishte i paguar i Gjermanisë dhe Austro-Hungarisë [71]. Këto mosmarrveshje arritën kulmin në prill të 1919-tës në kohën kur

69. Adritaik Revieë mars 19119, f.267-69

70. Vetmbrojtja e Esat Pashës. Ballkan Revieë, I.330-26. "Në disa qarqe pretendohet që në muajin dhjetor është instaluar një qeveri e re në Durrës... dhe që në lidhje me të unë isha i privuar nga pozicioni im si kryetar i Qeverisë Shqiptare... Turhan Pasha dhe kolegët e tij flasin vetëm në emër të një pakice të parëndësi; shih "Lettre addresee par Essad Pacha a la konference de la paix. "në Frangulis, Memorie sur l'Albaniet et l'Epire du Nord presentee devant le conseil de la societe des nations sa seance du 24 juin, 1921, f. 27-33. Shih gjithashtu Durham. revista Bashkëkohore, 1920, CXVIII, 207-215.

71. Buletini helenik, 28 Shkurt, 17 Mars 1919.

çarja u bë e plotë midis atyre të cilët besonin se mund të arrihej një marrveshje e kënaqshme me Italinë dhe, atyre që e vlerësonin atë tërësisht të pashpresë, bile nuk pranonin as afrimin me të sa kohë ajo i përmbahej Traktatit të Londrës. Kur këto mosmarrveshje iu referuan qeverisë së Durrësit, pjesa proitaliane u hodh poshtë; dy anëtarë të rinj dërguan në Paris duke e ripërtërirë delegacionin. Mgr.Bumçi u bë president, M.Konica dhe Dr.Tortulli vazhduan të mbeteshin, ndërsa Mehdi Frashëri, Luigj Gurakuqi dhe Lef Nosi përbënin pjesën tjetër të delegacionit.[72]

Ky ishte delegacioni shqiptar i cili i paraqiti kërkesat e Shqipërisë në Konferencën e Paqes në një seri memorandumesh. Zhvillimi i pikpamjeve të paraqitura në këto dokumente përbën një trajtim të veçantë të çdo memorandumi.

I pari prej këtyre, i datuar 12 shkurt 1919, shprehu besimin në drejtësinë e Konferencës. Ndaj "Areopagus të botës" Shqipëria erdhi "plot me besim se principet e nacionalitetit do të zbatoheshin plotësisht". Raca shqiptare, më e vjetra në gadishullin Ballkanik, deklarohej, kishte ruajtur identitetin e vet kombëtar dhe shpirtin e vet të lirisë përkundër

72. Adriatic Review, Gusht 1919, f.487-88

pushtimeve, pre e të cilave ajo kishte qënë gjithmonë. Gjatë luftës neutraliteti i saj, i garantuar prej fuqive ishte marrë nëpër këmbë; njësoj si Belgjika edhe ajo kishte njohur tmerret e pushtimit. Ajo luftoi në krah të Antantës, dhe ndihmoi në strehimin e serbëve [73]. Në rastin e Shqipërisë, principet e status quo-se si dhe bazat e kongreseve të mëparshme, nuk mund të ishin drejtime të kënaqshme për të arritur tek një vendim i saktë.

Kongresi i Berlinit dhe Konferenca e Londrës, të dyja "..... sanksionuan gjymtimin e territorit kombëtar shqiptar..." Një zgjidhje e pranueshme e problemeve territoriale të Ballkanit deklarohej se konsistonte në përfshirjen në shtetin e vet të çdo rajoni ku një nacionalitet i caktuar përbën një shumicë.

Mbështetur në këtë premtim, Shqipëria kërkonte "restaurimin e shtetit shqiptar të 1913-ës", pra të territoreve tashmë të grabitura respektivisht nga Mali i Zi, Serbia dhe Greqia. Nga jashtë thuhej se shtete të caktuara të Ballkanit po paraqisnin kërkesa të reja ndaj territoreve të përfshira në shtetin shqiptar të 1913-ës. Megjithëse këto ishin shpallur si të padrejta,

73. Albania, Propaganda e delegacionit, Rivendikimet e Shqipërisë, f.1-2

përsëri argumentet e tyre duheshin vlerësuar. Sa më larg shkonin predikimet greke, aq më të pabazuara dukeshin ato. Gabimi kryesor, mbi të cilin mbështeteshin këto predikime, qëndronte tek llogaritja si grek e të gjithë atyre të cilët i takonin kishës ortodokse greke. Ky gabim rridhte nga fakti se në statistikat turke të gjithë kristianët ishin të klasifikuar si grekë, duke mos marrë paarsysh origjinën e tyre greke ose jo greke. Feja dhe jo raca merrej si baza e klasifikimit.

Kërkesat e bëra prej Shqipërisë drejtoheshin ndaj atyre territoreve prej të cilave ajo ishte privuar prej Kongresit të Berlinit dhe Konferencës së Londrës. Shqipëria, thuhej, nuk kërkonte asgjë që nuk ishte shqiptare. Ajo nuk donte grupe të kombësive të tjera, të cilat do të provokonin trazira" [74]. Memorandumi gjithashtu kërkoi dëmshpërblimin për një numër të madh fshatrash të djegura prej grekëve në jug.[75] Në paraqitjen e parë të kërkesave, delegacioni shqiptar e kapi demin nga brirët. Nëse këto kërkesa ishin bërë në bazën e besimit të ndershëm që ata ushqenin apo ato do të të realizoheshin mbi principet e një veprimi të fortë, që do të mund të arrihej nëpërmjet

74. Po aty, f.2-4
75. Po aty, f.6

luftës kundër pazarllëqeve që bëheshin, kjo dukej të ishte çështje konjukture. Ndoshta të dy faktorët ishin prezent. Pika kuptimplote e kërkesave ishte restaurimi i Mbretërisë së Shqipërisë së 1913-tës, të bashkuar dhe të pavarur. Traktati i fshehtë i Londrës ishte injoruar. Kërkesat e Greqisë ndaj pjesës jugore të shtetit shqiptar u vlerësuan krejtësisht si të pavlefshme, të padrejta dhe të pabazuara.Qëllimi i vërtetë që kërkonte të arrinte delegacioni shqiptar ishte të siguronte një zgjerim të kufijve të saj të 1913-ës dhe jo vetëm të mbronte ekzistencën e tyre.

Më 24 shkurt kërkesat e shqiptarëve u paraqitën përpara Këshillit të Dhjetëve. Memorandum i dytë ishte më i detajuar se sa i 12 shkurtit dhe tregoi qartë faktin se do të duhej të merreshin parasyshë vështirësi edhe më të mëdha, se sa ato që ishin menduar të kishte. Pas vlerësimit të zakonshëm që iu bë principeve të presidentit Uillson, dokumenti vinte në pah faktin se Kongresi i Berlinit i keqkuptoi të drejtat e kombit shqiptar. Ky keqkuptim erdhi për dy arsye: e para, se Shqipëria nuk kishte patur kurrë një mbrojtës sikundër që e kishin vendet e tjera ballkanike; dhe së dyti, shtrirja e saj gjeografike ishte lakmuar gjithnjë prej fqinjëve të saj. Prandaj, Traktati i Berlinit e privoi Shqipërinë nga krahinat e

tjera të veta në pjesën e Shqipërisë jugore që shtrihet midis Gjirit të Prevezës dhe lumit Kalamas.[76] Pikërisht për të kundërshtuar këto shkelje mbi territorin e Shqipërisë, u themelua Lidhja e Prizrenit. Rezistenca energjike e saj i detyroi Fuqitë që të njihnin karakterin shqiptar të rajonit që ata kishin lejuar t'i jepnin Greqisë dhe i kthyen kufijtë grek mbrapsht deri tek Lumi Arta. Megjithatë ky gjymtim ishte i parëndësishëm, vazhdonte dokumenti, në krahasim me ato që u bënë në Konferencën e Londrës. Ky organ i lëshoi Greqisë rajonin e quajtur Çamëria, prej gjirit të Prevezës deri tek kepi i Stillos. Ajo krahinë kishte dyzet mijë Shqiptarë muslimanë, katërmbëdhjetë mijë shqiptarë kristianë dhe nëntë mijë grekë të cilët e flisnin greqishten si gjuhën e nënës.[77]

Memorandumi i dytë shqiptar u përpoq që të hidhte poshtë kërkesat greke ndaj Shqipërisë Jugore. Numri njëqind e njëzet mijë grekë dhe tridhjet mijë shqiptarëve i paraqitur prej grekëve u kundërshtua. Shqipëria i përmbahej asaj që popullsia greqishtfolëse ishte më e vogël se njëzet mijë dhe

76. Albania, Propaganda e delegacionit. Expoze des revendications albanaises devant le Conseil des Dix, f.1

77. Po aty, f.2

gjendej vetëm në luginën e Drinopullit dhe në fushën e Delvinës dhe që përbëhej vetëm prej fshatarësh që kultivonin tokat e shqiptarëve. Shqipëria, gjithashtu mbronte pikpamjen se ishte një fallsitet të vlerësoheshin si grekë të tërë ata që shkonin në kishën ortodokse greke. Kjo kërkesë, vazhdonte dokumenti, "ka bërë që klerikët grekë ta kthejnë fenë në një instrument të shtypjes dhe tiranisë". Kur shqiptarët ia arritën që të merrnin një leje nga qeveria turke për të hapur një shkollë shqipe në Korçë, klerikët grekë i shkishëruan ata prindër ortodoksë të cilët i dërguan fëmijët e tyre në atë shkollë dhe i denoncuan ata tek qeveria osmane për konspiracion. Kjo manovër shkaktoi largimin e shumë prej tyre dhe mbylljen e shkollës në fjalë. Kështu shqiptarët ortodoksë i dërguan fëmijët e tyre në shkollat greke, ndërsa ato të besimit mysliman e katolik të cilëve iu ishte mohuar e drejta për t`u arsimuar në gjuhën e tyre të nënës, frekuentonin shkollat turke, franceze, italaine, angleze dhe amerikane. Shkatërrimet e bëra prej grekëve më 1913 në Epir kishin për qëllim që të friksonin shqiptarët; qëllimi i tyre ishte t´i bënte ata të hiqnin dorë nga kërkesat e tyre ndaj Epirit të Veriut dhe veçanërisht ndaj krahinës së Çamërisë, qenësisht shqiptare. Shqipëria :"duket të ketë qënë

e ndjekur prej natyre"; vargu i maleve të Gramozit dhe Pindusit siguronte të vetmin kufi, i cili do të kënaqte nevojat mbrojtëse dhe ekonomike të një vendi të dobët si Shqipëria.[78]

Lëvizja tjetër e shqiptarëve në fushën e madhe të shahut në Paris, ishte kërkesa për një mandat amerikan të shoqëruar me një plebishit. Kërkesa për një plebishit u bë formalisht në një letër dërguar Clemenceau-t nga Turhan Pasha, më 7 mars 1919 dhe u përsërit dy muaj më vonë në një kërkesë të bërë nga një delegat i Federatës Panshqiptare, Mr.Erikson. Kërkesa e Turhan Pashës erdhi si rezultat, të paktën pjesërisht, si reagim ndaj atyre që dëgjoi përpara komisionit të çështjeve greke, më 27 Shkurt. Nxitimi me të cilin komisioni u duk se po vepronte, shkaktoi tek shqiptarët një ndjenjë tejet të pakëndshme.

Komisioni u kritikua për interesin e veçantë që i kushtoi kërkesave greke ndaj Shqipërisë, por aspak ndaj atyre të Shqipërisë ndaj Çamërisë, e cila ishte nën pushtimin grek. Në dritën e këtyre fakteve, delegacioni shqiptar i kërkoi konferencës që t'i jepte një mandat të përkohshëm qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të pushtuar dhe

78. Po aty, f.4-7

Harta 5. - Kufijtë etnografike të Shqipërisë sipas kërkesave zyrtare të shqiptarëve. (Marrë nga Temperley, botuar në librin: Një Histori e Konferencës së Paqes së Parisit)

administruar territorin e diskutueshëm për një vit ose dy, me qëllim që të shkohej drejt një plebishiti në fund të kësaj periudhe. Kështu e zhveshur ndaj të gjitha detyrimeve, populsisë do t'i mundësohej që të shprehte ndjenjat e saj dhe të vendoste për të ardhmen e vet [79]. Kërkesa e përsëritur e Mr. Erikson për një mandat të tillë iu drejtua fillimisht opinionit publik amerikan. Ky mandat, deklaronte ai, duhet pranuar mbi parimet morale mbi të cilat mbështeten principet amerikane, për të ndërmarrë një detyrë përfundimtare në rindërtimin e botës dhe mbi të gjitha në interesat e drejtësisë dhe paqes së qëndrueshme.

Nëqoftëse pushtimi italian, grek dhe serb i territorit të banuar prej shqiptarëve, kundërshtarë të betuar të dominimit të huaj, do të ligjërohej prej konferencës, atëherë ky akt do të dënohej nga gjykimi i shëndoshë i tërë botës. Amerika s'mund të jetë e sinqertë, piksëpari ndaj vetvetes, po që se pajtohet me një traktat të tillë paqeje.[80]

Delegacioni shqiptar hyri në një protestë formale ndaj konferencës kundër Traktatit të Londrës të vitit

79. Albania, Propaganda e delegacionit. Notes additionnelles relatives aux revendiciations albanians, f.1-2.

80. Erickson, Gjashtë arsye pse Amerika duhej bërë mandatorja për Shqipërinë.

1915. Mbas 17 marsit të 1919-ës ata shprehën pakënaqësi serioze lidhur me mungesën e plotësimit të kërkesave shqiptare dhe siguritë që u afroheshin fqinjëve të saj në rrugën për realizimin e synimeve të tyre. Këto fakte në mënyrë të paevitueshme sugjeruan zbatimin e Traktatit të Londrës. Së fundi ata shprehën protestën e tyre energjike kundër një mundësie të tillë për "shkëputje zemre" ... në kontradiktë flagrante ndaj principeve të kombësisë dhe deklaratave të bëra në disa raste prej aleatëve dhe Fuqive të Mëdha shoqëruese që i mbështetin ato.[81]

Një muaj më vonë, më 14 Prill, kjo protestë u përsërit bashkë me një deklarim të konditave nën të cilat Shqipëria do të pranonte ndihmën e njërës prej Fuqive të Mëdha. Ajo rezervoi të drejtën të zgjidhte Fuqinë, të cilës konferenca do t'i lëshonte mandatin. Kushtet e pranueshme ndaj saj përfshinin respektin për sovranitetin e pavarësisë së shtetit shqiptar, siç ishte administrimi autonom brenda vendit, e drejta e përfaqësimit jashtë vendit, si dhe ndalimi i kolonizimit sistematik, të organizuar nga fuqitë e huaja.[82]

Midis pengesave kryesore kundër të cilave

81. Albania, Propaganda e delegacionit. Po aty, f.4-5.

82. Albania, Delegation Propaganda. Notes additionnelles relatives aux revendications albanaises, f.10-11.

shqiptarët duhej të luftonin në konferencën e paqes ishin kërkesat greke ndaj Shqipërisë Jugore, të cilat ishin mbrojtur prej Venizellosit . Pikërisht për këtë Shqipëria u detyrua të bënte edhe më shumë kujdes ndaj kërkesave greke. Përgjigja e Shqipërisë ndaj Venizellosit është e shtjelluar mirë në një pamflet anonim, i cili i shqyrtonte argumentet greke një për një dhe jipte përgjigje të arsyeshme e të kujdesshme për secilën prej tyre. Së pari pamfleti sfidonte statistikat e Venezillosit mbi popullsinë e Epirit të Veriut. Statistikat franceze për Korçën dhe Starovën, thuhej në pamflet, japin një shumë të përgjithshme prej 122.315 vetësh prej të cilëve 41.070 janë kristianë dhe 82.245 muslimanë. Për pjesën tjetër të Epirit u përdor regjistrimi i bërë prej turqve më 1908. Ai jepte një numër prej 168.497 prej të cilëve 76.651 ishin kristiane dhe 91.846 muslimane. E tërë popullsia e "Epirit të veriut" u deklarua të ishte 290.812 vetë dhe jo 231.000 sikundër që kërkonte Venizellosi. Prej këtyre, muslimane shqiptare numëroheshin të ishin 170.784 dhe jo 80.000. Po çfardo që të ishte ky raport, për shqiptarët ai nuk kishte ndonjë domethënie. Në të vërtetë e gjithë popullsia ishte shqiptare, me përjashtim të një grupi prej 15.000 deri me 16.000 greke. [83] Duke adaptuar

kriteret greke të ndërgjegjes kombëtare, Shqipëria këmbëngulte në faktin që shumica e atyre që i takonin fesë greke ortodokse ishin në të vërtetë shqiptarë. Argumenti grek ndaj të kundërtës, i bazuar në situatën arsimore, zhvleftësohej me faktin se kur persekutimi i detyroi një numër të madh nacionalistësh shqiptarë që të emigrojnë për në Bullgari, Rumani dhe Amerikë, ku lejohej ushtrimi i nacionalizmit, shkollat shqiptare, librat, gazetat dhe kishat erdhën menjëherë në jetë. Shembull është edhe Korça, e cila, kur nën drejtimin e Francës, ju dha mundësia për shprehjen e ndjenjave kombëtare shqiptare, menjëherë shpërthyen shkollat shqipe. Kjo vërteton më së miri se në zemër epiriotët janë me të vërtetë shqiptarë.[84]

Ekzistenca e një numri të madh shqiptarësh në Greqi, vazhdonte ky pamflet, dhe pozita e lartë të cilën një pjesë e tyre e kishin arritur atje, nuk e justifikonte aneksimin e "Veriut të Epirit" nga Greqia.

A ishte e drejtë që si shpërblim ndaj shërbimeve që shqiptarët i kishin bërë Greqisë, tani kjo e fundit

83. Refutation des arguments de M. Venizelos pour etablir les droits de l'hellenisme en Epire du Nord, f.1-3

84. Refutacion des argum ents de M. Venezillos pour etablir les droits de l'hellensime en Epire du Nord, f.3-4.



Harta 6. - Shpërndarja e racave dhe feve në Shqipëri, sipas Ministrisë Franceze të Luftës, 1915.
(Nga Berati, Çështja shqiptare).

të dëshironte të zhdukte racën e tyre? Fakti që shqiptarët luftuan në revolucionin grek nuk përbënte argument. Heronjtë e asaj periudhe luftuan, jo për vethelenizimin, por vetëm kundër tiranisë turke " për kryqin kundër gjysmë hënës" [85]. Sa i takon argumentit grek qe një shumicë me qytetërimin më të lartë nuk duhet të vendoset nën një pakicë me një qytetërim më të ultë këto të dyja vlerësoheshin tërësisht si të pabaza. Në këtë deklaratë Venizellosi i referohej përkatësisht kristianizmit dhe islamit. Por nuk ka ndonjë ndryshim real në qytetërim. Elementi mysliman i popullsisë ishte po aq i edukuar dhe i stërvitur sa edhe rekrutët kristianë në profesionet e vështira. Aq më tepër, ndryshimet në fe nuk përbënin një ndryshim në qytetërim. Qytetërimi i Shqipërisë ishte qartësisht në përmbajtje vetëm një. Kësaj i ndihmon edhe fakti tjetër që Shqipëria kishte mundur tashmë të tregonte se myslimanët numëroheshin si shumicë në popullsinë e Veriut të Epirit. Argumenti se Shqipëria ishte e pazonja që të ruante pavarsinë e saj pa një drejtim nga jashtë nuk përbënte arsye për të aneksuar Epirin e Veriut nga Greqia. Në të vërtetë, bash fakti që Shqipëria do të kishte ndihmën e ndonjë prej Fuqive Aleate gjatë

85. *Po aty, f.5-6.*

viteve të saj të para, përbënte një garanci për një jetë më të mirë për të gjithë banorët e Epirit të Veriut dhe ishte shumë më e pranueshme se sa aneksimi i afruar në favor të Greqisë.[86]

I njëjti pamflet i kushtoi një vëmëndje të veçantë kërkesave greke ndaj Korçës. Ai përforconte deklarimet e mëparshme për shkollat si dhe vinte në dukje fakte të reja lidhur me trashëgiminë dhe mohimin e saj nga ana e grekëve. Tridhjet vjet kishin kaluar që nga mohimi i trashëgimisë, pikërisht periudha në të cilën ishte dëshmuar rritja e nacionalizmit shqiptar dhe zvogëlimi i numrit të helenofilëve në krahinë. Në të vërtetë nga Korça kishin dalë shumë prej udhëheqësve kombëtarë shqiptarë. Nuk kishte asgjë të çuditshme që shkollat greke ishin mbushur me nxënës përderisa shkollat shqiptare ishin të ndaluar. Ndjenjat kombëtare shqiptare në Korçë u shfaqën shumë më tepër me hapjen e shkollave shqipe nën francezët me 1917. Pra, sot, deklaronin shqiptarët, Korça nuk është greke, por shqiptare.[87]

Venizellos, duke iu referuar ngjarjeve të 1914-tës përpiqej të krijonte bindjen se "Epiri i Veriut"

86. Po aty, f.7-8
87. Po aty, f.8-10

dëshironte bashkimin me Greqinë. Por revolucioni i 1914-tës, i përgjigjej pamfleti, ishte drejtuar dhe mbështetur prej grekëve. Plaçkitja dhe djegja e fshatrave ishte dëshmuar në mënyrë të paanshme prej oficerëve hollandeze të cilët e ndoqën situatën nga afër, sikundër që ata dëshmonin pjesmarrjen e kretasve dhe peloponezëve në ushtrinë epiriote*. A do t'i kishin shkatërruar bandat greke fshatrat me të vërtetë greke? Aq më tepër kur dihej se anarkia në fillim të luftës, të cilën Venizellosi e spjegonte me largimin e Princ Vidit, ishte nxitur me qëllim prej autoriteteve greke me shpresën se kjo do të bënte që t'ju kërkohej ndihma për të qetësuar situatën e më pas, të pushtonin krahinën.[88] Sa i takon Traktatit të Fshehtë të 1915-ës, a duhej që aleatët, duke patur frikë që të braktisnin një marrveshje e cila ishte në kundërshtim të plotë me çdo normë drejtësie, ta kthenin Shqipërinë në një Poloni të dytë? [89]

Arsyet ekonomike të cilat kërkonin t'i shfrytëzonte Venizellosi si argumente e që përqëndroheshin në pronësinë mbi portin e Sarandës deklaroheshin jo

88. Po aty, f.11-13
89. Po aty, f.15
** Kujtoni këtu rrëmbyesit e anijeve luftarake në Sarandë gjatë marsit 1997 të cilët flisnin në gjuhën greke përpara kamerave të Euronews-it, dhe do të shihni se sa të ngajshme janë këto ngjarje. (Shën.i përkth,)*

bindëse. Por Greqia tashmë ka, deklaronte autori proshqiptar i këtij pamfleti, një numër të madh portesh dhe prandaj nuk duhet të ngatërrohet me Shqipërinë për daljet e pakta që ajo ka e prej të cilave ajo komunikon me pjesën tjetër të botës.[90]

Pasi u duk qartë qëndrimi i fuqive të mbledhura në Paris dhe vështirësitë me të cilat po ndesheshin, grupe shqiptarësh ndërmorën hapa të tjerë tek kreu i Këshillit të Dhjetëve, pra direkt tek presidenti Uilllson, të cilit ata iu adresuan si "apostulli i moralit politik", "mbrojtës i popujve të vegjël e të shtypur",[91] " kreu i respektuar i demokracisë më të fuqishme", dhe "burri që ka vendosur ndjenjën e drejtësisë mbi të gjitha interesat".[92] Ata vazhdonin:

"Sot Shqipëria është duke u përpëlitur dhimbshëm në duart e atyre të cilët dëshirojnë edhe një herë ta coptojnë atë, prej atyre të cilët dëshirojnë të marrin në zotërim territoret që nuk u takojnë dhe që kurrë nuk u kanë takuar. Për fatin e keq të saj, Shqipëria, ky vendi varfër, nuk ka gjetur ndonjë mbrojtje në Evropë që të marrë anën e saj. Vetëm disa njerëz, edhe ata të veçuar, nga padrejtësitë e bëra ndaj vendit tonë na kanë ndihmuar me fjalë e shkrime. Ato nuk

90. Po aty, f.15-16.
91. Albania, propaganda e delegacionit, f.18
92. Baker, vepër e cituar, If.7

duhet të kenë gjetur ndonjë jehonë në kancelaritë prej të cilave do të varej drejtimi i ardhshëm i një Europe të rigjeneruar që do të dëshironim të shihnim.[93]

Për të mbrojtur Shqipërinë ndaj "marrveshjeve dhe traktateve të plaçkitjeve dhe pushtimeve" presidentit Uilson iu kërkua që të pushtonte me trupa amerikane rajone të ndryshme të Shqipërisë nën kontrrollin e grekëve dhe jugosllavëve dhe të proçedonte drejt një shqyrtimi të lirë dhe të paanshëm të karàkterit kombëtar të atyre krahinave të diskutuara prej kundërshtarëve të saj. [94] Kërkesa të tilla, megjithëse nuk ranë në vesh të shurdhër, nuk u shoqëruan me ndonjë veprim nga ana e delegacionit amerikan.

Përpara se të trajtohen grindjet greko-shqiptare për kufijtë në Konferencën e Paqes, duket e nevojshme të krahasohen të dy pikpamjet e paraqitura nëpërmjet propagandës së delegacioneve dhe të përmbledhura më sipër, me qëllim që të zbulojnë, se cili prej argumenteve të ndryshëm të paraqitur bie në sy më shumë dhe cila lloj zgjidhje do të ishte më e drejta.

Kur të dy pikpamjet të ballafaqohen, një fakt bëhet

93. Po aty.
94. Albania, Propaganda e delegacionit, f.18

i qartë menjëherë dhe pikërisht që apelet e të dyjave mbështeteshin në të njëjtat principe: vetvendosje, nacionalizëm, dëshirë popullore, "ndërgjegjie kombëtare". Kështu, cilido që të jetë kriteri i vlerësimit të kësaj çështje, një gjë mbetet e qartë se të dyja palët shpreheshin hapur për një zgjidhje sipas dëshirave të popujve të interesuar për çështjen. Të dyja, si Greqia edhe Shqipëria ishin pajtuar me këto principe themelore. Dallimi qëndronte vetëm në mbrojtjen që i bënte secila palë variantit të vetë të zgjidhjes së problemit duke pretenduar secila, se e kishte popullin me vete. Atëherë problemi thjeshtohej vetëm në përcaktimin e dëshirave reale të popullsive. Për këtë kishte dy mënyra: e para, me një plebishit ose njohje të opinionit popullor të shprehur dhe e dyta, vëzhgim nëpërmjet një komisioni ekspertësh të paanshëm.

Megjithëse literatura progreke jepte sugjerime të ndryshme për një plebishit, qëndrimi zyrtar grek qëndronte i heshtur ndaj kësaj çështjeje; ndërkohë që propagana e delegacionit shqiptar bëri përpjekje të përsëritura për ta realizuar atë. Greqia e përkrahte një dëshirë popullore të shprehur zyrtarisht, dhe kjo nuk mund të kalohet pa u vënë re, por ajo u referohej dy ngjarjeve të mëparshme, revolucionit epiriot të

vitit 1914 dhe zgjedhjeve të deputetëve epiriotë në Parlamentin Grek më 1915. Siç mund të kuptohet, asnjëra prej tyre nuk mund të ishte e pranueshme për Shqipëinë, arsyetuar me influencën që padrejtësisht Greqia kishte ushtruar tek të dyja këto ngjarje. Një shprehje zyrtare e cila ka për qëllim përcaktimin e fatit të një populli të dhënë, që të jetë e vlefshme duhet pa dyshim të bëhet në kushtet e shprehjes së lirë pa qënë nën presionin e autoriteteve apo të palës tjetër të interesuar rreth çështjes për të cilën ky popull shprehet. Pra del krejtësisht e qartë se kjo nuk ishte një shprehje e pranueshme e opinionit publik. Në se konferenca nuk do të autorizonte dikë që të merrej me këtë punë, zgjidhja do të mbetej të bëhej mbi arsyetime të tjera. Metoda tjetër e zgjidhjes së një grindje të tillë e aprovuar prej një komisioni vëzhguesish të paanshëm ishte ndjekur prej një komisioni shqyrtues të paanshëm. Megjithatë, komisioni që merrej me çështjet greke, i plotësoi me vështirësi kërkesat hipotetike të paanësisë. Duke qënë se të gjitha fuqitë ishin të përfaqësuara në konferencë, çdo vendim i arritur prej komisionit ngjante të ishte në natyrën e një kompromisi. Si e tillë kjo çështje përbënte një rast të tillë kompromisi.

Në mungësë të një vendimi të bazuar në njërën prej këtyre dy metodave të pranuara, pra të ndjenjës përcaktuese kombëtare të një populli, duhej kërkuar që të vlerësoheshin ato çfarë ishin arritur duke patur parasysh edhe gabimet e bëra në argumentet e paraqitura.

Në radhë të parë, është krejt e qartë se asnjëra palë nuk e kishte monopolin e së vërtetës. Krahina e Verio Epirit është me të vërtetë shumë e përzier. E përzier nga gjuha, raca dhe feja, për të mos u marrë këtu me çështje të ndjenjave kombëtare. Ndonjë ndjesi e veçantë e shprehur ndaj këtij problemi do të çonte në përfundime të padrejta; ngado që të rrotullohej, aty do të gjendej "një pakicë". Por në cilin rast pakica do të mund të ishte më e vogël? Statistikat citonin se të dy anët ishin të vlerave të vogla, edhe pse asnjëherë nuk ishte bërë ndonjë regjistrim i besueshëm. Shifrat turke ishin të mbështetura tek besimi duke lënë mënjanë përkatësinë kombëtare. Megjithatë, pikërisht në këtë pikë, grekët treguan një mungesë sinqeriteti, duke pretenduar se ata që i përkisnin fesë greke, për rrjedhojë ishin edhe në ndjenja grekë. Gabimi i tyre për këtë u vu në dukje prej shqiptarëve. Përpjekjet e grekëve për të dëshmuar përkatësinë helenike të popullsisë, ishin

bazuar tërësisht tek historia, pak a shumë e vonë. Kundërshtimi ndaj arsyetimeve të tilla bazohej në faktin se grekët nuk kishin patur parasuysh ato që kishin ndodhur, pra e merrnin situatën në Shqipëri si të pandryshuar. Për rrjedhojë, nuk mund të gjindej një zbatim më statik e më falls. Argumentet që kishin qënë të zbatueshëm në1912, kishin rënë nga vlera tani më 1919.

Po t'i kthehemi faktit që nacionalizmi shqiptar kishte qënë gjithmonë i shtypur nga qeverisja me standarte të ndryshme e turqve, dhe që Greqisë i ishte dhënë dora që të shfrytëzonte çdo rast për të helenizuar popullsinë, duke përdorur piksëpari Kishën Ortodokse greke dhe shkollat greke të cilat jepnin mësim në gjuhën greke, ishte e çuditshme se si nacionalizmi shqiptar kishte bërë një përparim të tillë si ai që vihej re tashmë. Në këto kushte artificialisht të krijuara, as gjuha e as feja nuk mund të merren si një udhrrëfyes e aq më pak si një kriter përfundimtar. Po të jepej liria e nevojshme për t`u zhvilluar në këtë mënyrë të natyrshme, duke ruajtur vetëm ato gjërra që duhen ruajtur aq sa është e mundur ndër to të drejtat e pakicave, nuk ka dyshim se në pak vite "Epiri iVeriut" do të ishte plotësisht i shqiptarizuar. Në të kundërt, përfshirja e krahinës

Traktati i Londrës nuk mund të vlente më për zgjidhjen e kufijve lindorë të Italisë, ishte hedhur poshtë prej kryeministrit Italian, Orlando [4].

Ndërsa në rekomandimet e tyre bazë, lidhur me zgjidhjen që afronte Italia, ekspertët amerikanë kishin rënë dakort që kjo e fundit, nën mandatin e Lidhjes së Kombeve, ndoshta duhej të lejohej në Vlorë dhe rrethinat e saj më të afërta, [5] por më vonë, në një grindje me Orlandon, presidenti i mbështetur prej ekspertëve amerikanë, të cilët e nxitën atë të mos u vinte veshin kërkesave italiane, deklaroi se Italia kishte hyrë në luftë "për të plaçkitur", ndërsa Franca dhe Anglia nuk e manifestonin më.[6]

Duhet rithënë se çështjet që kishin të bënin me Greqinë, Konferenca e Paqes ia përcolli një komisioni të ngritur për atë qëllim [7]. Ky komision mbajti një seri takimesh duke filluar prej 18 shkurtit deri më 6 mars, kohë kur ai e dorëzoi raportin e tij. Secili delegacion, përfaqësues i të katër vëndeve dhe pikërisht, Britanisë së Madhe, Francës, Italisë dhe SHBA-ve paraqiti propozimin e vet. Prej këtyre

4.Po aty.

5.Po aty, III , 259, 262, Dokumenti 31 21 janar 1919.

6.Po aty, III, 278, Dokumenti 36, Leter e gjashtë ekspertëve amerikanë dërguar presidentit Uillson, 17 prill 1919.

7. Shih supra f.75

propozimeve, ai i bërë nga delegacioni italian duke iu përmbajtur linjës së shënuar në Protolollin e Firences, së 1913-ës. Propozimi amerikan i caktonte Greqisë pjesë nga jugu i Vorio Epirit. Por për pjesën veriore do të ndiqte linjën e Firences. Britanikët ishin pak më bujar ndaj Greqisë në seksionin jugor dhe mbaheshin në linjën e Firences në veri; ndërsa propozimi i Francës nuk ndryshonte shumë në esencë nga ai amerikan sa i takon pjesës jugore, por në veri i jepte më shumë Greqisë për arsye ekonomike- strategjike me qëllim që rruga nga Korça në Sarandë gjatë bregdetit të mbahej prej grekëve.

Për të mbrojtur variantin e tyre në Komision, italianët paraqitën një ekspert detar, kapitenin Konz (Conz) i cili argumentoi se tokat përballë Korfuzit nuk duhej t'i jepeshin Greqisë pasi kjo do t'i jepte mundësi asaj që ta kthente atë në një bazë të pathyeshme detare, duke e detyruar Italinë të bënte të njëjtën gjë në pozicionin e saj korespondues të Adriatikut. Ai u orvat të tregonte se Greqia dëshironte zotërimin e bregdetit afër Korfuzit, jo për arsye etnike e tregtare dhe as për shkak të frikës nga emigracioni; gjë që nuk përbënte arsye për kërkesat Greke. Ishte evidencuar, deklaroi ai, prej fakteve, se ajo po i zgjeronte territoret e saj gjetiu,

ndonëse ajo kishte plot dalje në dete, dhe që ky rajon bregdetar i kërkuar prej saj, as ishte i pasur dhe as kishte lidhje me pjesët e brëndshme. Më shumë se për çdo gjë, vazhdonte ai, ajo e kërkonte rajonin për arsye thjeshtë ushtarake. Po të përmendim vetëm ngjarjet e luftës së fundit del e qartë se çfarë rëndësie detare kishte kontrolli i plotë i Korfuzit mbi tokat e zotëruara prej fqinjit përballë. Përpara se sa Greqia t'i bashkangjitej Aleateve, Kaizeri kishte bërë një bazë nëndetësesh në Korfuz dhe kur Greqia iu bashkangjit Antantës, Korfuzi u bë njësoj i rëndësishëm për flotën franceze në ndihmën që ajo i dha Italisë kundër austriakëve në Adriatik.[8]

Në takimin e mëvonshëm, Komisioni dëgjoi pikpamjet e Venizellosit për Greqinë, të Turhan Pashait, Mehmet Bey Konicës, Dr. Turtullit për Shqipërinë dhe ato të Karapanos për ish qeverinë provizore të Epirit të Veriut. Diskutimet u sollën rreth çështjes së dëshirave të popullatës dhe kryengritjes së Vorio-Epirit të viti 1914.

Komisioni nuk mundi të arrinte në një vendim unanim mbi çështjen e Shqipërisë jugore, ashtu siç ishin rekomandimet për të. SHBA-të, Britania e

8. Raport (avex anexes prezente au Conseil supreme des Allies per la commision chargee d'etuider les question territoriales interesant la Greece. Annexe VI f.16,.



Harta 7. -Propozime të ndryshme të antarëve të komisionit mbi çështjet greke dhe kërkesat greke, 1919. Harta ishte e shoqëruar me raportin e Këshillit të Lartë të aleatëve për komisionin e ngarkuar me çështjet territoriale greke (krahasojeni me hartën nr8)



Harta8. Linjat e pozicionuara prej antarëve të komisionit mbi çështjen greke, 1919. Pas hartës nr.1 e cila shoqërohet prej raportit të Komitetit mbi kërkesat territoriale greke.

(krahasojeni me hartën 7).

madhe dhe Franca i pranuan kërkesat greke në pjesën jugperëndimore, por e tërhoqën vijën kufitare në mes të lumenjve Vjosa dhe Zrenos, ndërsa Italia votoi kundër këtyre kërkesave. Sidoqoftë, në pjesën verilindore, Britania e Madhe dhe Franca votuan që t`u jepnin udhë kërkesave greke, por vetëm për një vijë që kalonte pak në Veri të Korçës, ndërsa Shtetet e Bashkuara dhe Italia votuan që të ruhej kufiri i tashëm verior i Greqisë.

Vendimi i delegacionit francez dhe britanik në favor të Greqisë ishte bazuar në tre linja argumentesh. Së pari, ata ndjeheshin të detyruar të çmonin më tepër arsyet aktuale për shkak të së cilave kufijtë e 1913-tës , nuk kishin gjetur aprovimin e popullsisë, përderisa ata i vlerësonin statistikat e dhëna si statistika që afronin pak kritere praktike të dëshirave të popullsisë së interesuar për këtë çështje, megjithëse statistika të tilla mund të bazoheshin vetëm në prova fetare ose gjuhësore; ato fetare ishin të pa favorshme për shqiptarët ndërsa ato gjuhësore të padrejta për grekët. Rrjedha e ngjarjeve në Shqipërinë Jugore që nga përcaktimi i atij kufiri kishte prirjen të tregonte se ai ishte i pa pranueshm për shumë elementë të rëndësishëm në rajonet e përfshira në të. Së dyti, ata citonin evidencën e dhënë

prej Venizellosit dhe Karapanosit në lidhje me ndjenjat helenofile të pjesës më të madhe të popullsisë si dhe të mvarësisë ekonomike të krahinës së Korçës prej rrugës kryesore që të çonte për në Sarandë. Së treti, delegacioni britanik ishte edhe më tej i influencuar prej konsideratës që, ... në të vërtetë problemi është se a i duhej dhënë kjo krahinë Greqisë apo Shqipërisë, apo të vendosej ajo nën mbrojtjen e disa fuqive evropiane; ata janë të mendimit se për arsye politike dhe strategjike do të ishte padrejtësi ndaj Greqisë dhe Serbisë që një pikë kaq vitale siç ishte Korça të vendosej nën tutelën dhe kontrollin e një fuqie tjetër Evropiane.[9]

Delegacioni i Shteteve të Bashkuara gjithashtu i merrte parasysh ngjarjet e 1913-14 ës, por nuk mund ta pranonte historinë e atyre viteve të trazuara si provë të mjaftueshme, pasi fuqitë e huaja me intrigat e tyre kishin luajtur një rol aktiv, ndaj dhe dëshmitë e palëve ndaj këtyre mosmarrveshjeve ishin të paragjykuara.

1. Ndërtimi i rrugës nëpërmjet Përmetit për në Vlorë u jepte mundësi krahinave të Korçës dhe të Gjirokastrës të ndaheshin pa pësuar dëmtime ekonomike.

9.Raport i komitetit mbi kërkesat territoriale greke. 6.mars 1919.f.2

2.Në krahinat në jugperëndim të Lumit Vjosa, shumica e popullisisë dukej të ishte greke në ndjenjat dhe prirjet e saj politike; ajo është natyrshëm e lidhur me Greqinë në marrdhëniet e tregtisë dhe transportit.

3.Në krahinën në verilindje të lumit Vjosa shumica e popullsisë është shqiptare jo vetëm pse e flet gjuhën shqipe, por parë edhe në planin e ndërgjegjes së saj kombëtare. Asnjë aresye e mjaftueshme nuk ishte dhënë se përse kjo krahinë, në të cilën ndërgjegjia kombëtare dhe përkushtimi ndaj çështjes kombëtare ishin veçanërisht të forta, duhej ndarë nga Shqipëria.[10]

Delegacioni shkoi akoma më tej në favor të Shqpërisë, duke përkrahur atë që kufinjtë e 1913-ës duhej të mbeteshin në efekt.

Arsyet e detajuara të paraqitura prej saj shoqëronin ato të zakonshmet, të adoptuara prej protagonistëve të Shqipërisë dhe përfshinin argumentet që krahina ishte e banuar prej një shumice shqiptare, si nga ana racore ashtu edhe gjuhësore, sikundër që kjo ishte provuar prej Komisionit ndërkombëtar të 1913-ës; që muslimanët ishin në shumicë ndaj kristianëve; që ngjarjet e 1914-ës nuk mund të merreshin si tregues

10.Po aty.

i dëshirës popullore në favor të aneksimit nga Greqia; që dallimet fetare në Shqipëri nuk të çonin në një mospërputhje në pikpamjen kombëtare; që pjesa më e madhe e pasurisë mbi tokën ishte në duart e shqiptarëve muslimanë; që jeta ekonomike e vendit do të shkatërrohej plotësisht në qoftë se ajo do të privohej prej qendrave të saj, qytetet kryesore të krahinës; që argumentet arsimore dhe kulturore nuk ishin të vlefshme pasi që administrata osmane nuk u lejoi kurrë shqiptarëve të kishin institucionet e tyre arsimore; që pikpamja italiane ishte konfirmuar prej një harte të publikuar prej Ministrisë Franceze të Luftës 1915 e cila tregonte vetëm grupe të vogla banorësh grekë, fqinjë me Gjirokastrën dhe Delvinën[11]. Asnjë veprim nuk u ndërmor prej Konferencës ndaj rekomandimeve të Komisionit mbi çështjen greke të cilat kishin të bënin me Shqipërinë. Por në prill filloi një korespondencë e ethshme dhe e zjarrtë e ndërmarrë nga Esat Pasha, i cili kërkonte që të dëgjohej në Konferencë si përfaqësues i Shqipërisë duke zëvëndësuar Turhanin (Pashanë), i cili ishte i zgjedhur në mënyrë të rregullt qoftë nga vendi i tij Shqipëria, qoftë nga organizatat patriotike shqiptare

11.Frangulis, vepër e cituar, Shtojca e dytë f.7-8. Shih hartën 6 supra f.89.

jashtë vendit, duke zhvendosur kështu vëmëndjen e konferencës nga çështja kryesore shqiptare. Kërkesa e përsëritur e Esatit për t'u dëgjuar u shfaq në agjendën e takimit të Këshillit të Pestë gjatë javës së dytë të majit për t'u rishfaqur përsëri në agjendën e mëpastajme deri sa më 14 maj çështja u shty përfundimisht. Arsyeja padyshim duhet parë në konteksin e krizës në të cilën kishte hyrë çështja italiane në prill dhe maj, një krizë e cila rrezikonte që të shpërndante konferencën. Gjatë kësaj periudhe u sugjeruan propozime dhe kompromise të ndryshme për zgjidhje të ndryshme të problemit të Adriatikut, por asnjëra syresh nuk ishte e kënaqshme për të gjitha palët e interesuara.

Që nga kompromisi i 29 majit, kur Uillsoni aprovoi një zgjidhje të pranueshme për Orlandon, Italisë iu ofrua një mandat mbi Shqipërinë [12]. Por ky vendim nuk e favorizonte atë vetë ndaj jugosllavëve, pra një zgjidhje e kësaj çështje mbeti edhe më tej pezull, sikundër që një vëzhgues me kontakte të afërta me çështjen në Paris iu deklaroi përfaqësuesve shqiptarë, aq të shqetësuar, se asgjë nuk do të bëhej për Shqipërinë derisa çështja e

12.The Times (Londër) 28 janar 1920.

13.Herron MSS, Italia dhe Shqipëria, Dokumanti XVIII. Herron për Adamidin, 30 Mars 1919. (shih biografinë për komentet rreth këtij burimi).

Adriatikut midis Italisë dhe Serbisë të merrte një zgjidhje.[13]

Kur traktati i paqes me Gjermaninë u nënshkrua dhe shumica e konferencës u shpërnda, problemet e mbetura u lanë për zgjidhje në duart e delegatëve të Fuqive Aleate. Por kjo konferencë, jo zyrtare, përsëri nuk e ceku problemin e Adriatikut deri në dhjetorin e vitit 1919.

Ndërkohë dorëheqja e Orlandos si dhe formimi i një kabineti të ri në Itali, më 22 qershor të drejtuar prej Nitit, hapi një fazë të re në marrëdhëniet Greqi-Itali, lidhur me Shqipërinë jugore. Këto marrdhënie ishin karakterizuar si kritike gjatë periudhës së fillimit të Konferencës së Paqes. Italia kundërshtoi vendosmërisht çdo lloj shtyrje të territoreve greke drejt veriut; kështu që në Komisionin e çështjeve greke, mbajtur për kufijtë e Shqipërisë së 1913-tës,[14] kërkesat greke të paraqitura prej Venizellosit u gjykuan në përgjithësi si të tepërta nga ana e shtypit italian dhe veçanërisht prej gazetave të tilla si Giornale d'Italia, e cila mbështeste politikën e Soninos. Sidoqoftë, në disa qarqe ekzistonin shpresat

14. Raport për Frangulis, Memoire sur l'Albanie et l'Epire du Nord. aneksi 12. f.34.

15. Buletin periodiqiue de le presse italienne, 21 shkurt 1919.

mbi mundësinë e një marrveshje midis dy Fuqive.[15] Me ndryshimet në politikën e Italisë, një argument i tillë ishte konsumuar. Kjo marrveshje e njohur si marrveshja Tottoni-Venizellos u arrit më 29 qershor 1919 në mes të ministrit të ri italian të punëve të jashtme dhe kreut të qeverisë greke.

Sipas pikave të kësaj marrveshje të fshehtë, Italia pranonte të mbështeste në Konferencë kërkesat greke ndaj Thrakisë dhe Shqipërisë Jugore, ndërsa Greqia, në kthim të këtyre lëshimeve, angazhohej që të mbështeste një mandat italian mbi Shqipërinë dhe të njihte sovranitetin italian mbi Vlorën dhe një zonë të thellë, dhe si e tillë Italia mund të mendonte domosdoshmërisht për mbrojtjen e saj. Greqia ishte për kthimin e shpenzimeve të bëra nga ana e qeverisë italiane për punët publike të cilat kishin karakter të përhershëm, vlera e të cilave do të përcaktohej prej një komisioni italo-grek, e që do të zgjidhnin edhe një arbitër në rast mosmarrveshjeje. Italisë do t'i jepej një pjesë e portit të Sarandës për pesëdhjetë vjet. Nëse qeveria greke vetë nuk do ta lidhte këtë port me hekurudhë me pjesët e brëndshme të vendit, atëherë do tu jepej kompanive italiane e drejta për ta bërë këtë. Neutralizimi i ngushticës së Korfuzit, siç paracaktohej nga Konferenca e Londrës (1913)

ishte konfirmuar. Të drejtat e muhamedanëve që mbeteshin në Greqi dhe të grekëve që mbeteshin në Shqipëri merreshin në mbrojtje të veçantë. Si kthim për këtë, për të kënaqur orekset e saj ndaj Thrakisë dhe Epirit të Veriut, Greqia u zotua që të hiqte dorë prej kërkesave të mëparshme në Azinë e Vogël për të favorizuar Italinë. Qeveria greke deklaroi se do t'i konsideronte kushtet të përmbushura, bile në qoftë se si rezultat i kundërshtimit të mundshëm të SHBA-ve dhe përkundër mbështetjes së qeverisë italiane në favor të Greqisë, Korça do të përfshihej në territoret të cilat i kërkonte Greqia.

Marrëveshja duhej të mbetej gjithmonë sekret, përderisa nuk ishte një traktat i vërtetë por "vetëm përcaktim i një linje të drejtimit të përbashkët për t'u ndjekur në konferencë" [16]

E vetmja deklaratë që dy ministrat mund të bëjnë përpara Konferencës, është që ata janë të vendosur t'i trajtojnë me shpirt mirkuptimi çështjet e ndryshme që u interesojnë të dy vendeve.

Ishte arritur gjithashtu të suigurohej që ato pika të marrveshjes të cilat nuk do të përfshiheshin në traktatet e paqes, do të formonin subjektin e një konvente midis Greqisë dhe Italisë. I tillë ishte

16.Tekst, Frangulis, vepër e cituar, aneksi nr.14.f.40-42.

kompromisi prej të cilit dy Fuqitë Mesdhetare shpresonin të kënaqnin interesat e tyre në Lindjen e Afërt. Po edhe përkundër kujdesit të bërë për t'i mbajtur të fshehta pikat e kësaj marrveshje, ato shpejt u bënë të njohura.

Shpallja e marrveshjes midis Greqisë dhe Italisë shumë shpejt u reflektua në deklarimet e ministrave helenikë, ne zyrtarët grekë si dhe qytetarët, duke e paraqitur atë si një shenjë miqësie të manifestuar prej italianëve[17]. Edhe me rastin e vizitës së Venizellosit në Romë e cila u bë më vonë, komentet italiane ishin në favor të marrveshjes së re.[18] Në fjalën e tij të mbajtur rreth kësaj çështjeje në Parlamentin Italian më 27 shtator, Titoni, pasi njoftoi se ata kishin arritur një marrveshje për të ndjekur në konferencë një politikë të përbashkët në çështjet më të rëndësishme të interesave të të dyja palëve, Italisë dhe Greqisë, dhe pasi fitoi duartrokitjet e të pranishmëve, shtoi se kjo marrveshje kishte arritur tashmë rezultatin e vet ekonomik. Më 11 shtator, tha ai, ishte përfunduar një konvente për ndërtimin e një linje hekurudhore që do të lidhte Romën me Athinën, nëpërmjet ferriboteve që do të kalonin

17.The Times, (Londër),, 19 Gusht 1919.
18.Bulletin Periodique de la presse italiane. 10 Dhjetor 1919.

nëpër ngushticën e Otrantos. Kjo linjë e re, e cila do të binte nëpër Epir do të kishte rëndësi për zhvillimin e marrdhënieve tregtare midis të vendeve fqinje si dhe do t'i jepte asaj krahine lehtësira deri atëherë të pa përjetuara. Në Greqi, marrveshja u shoqërua me formimin e një Lidhje Greko-Italiane e cila kishte si qëllim intensifikimin e marrdhënieve ekonomike tregtare midis të dy Fuqive.[19]

Çështja e Korçës ishte e një vështirësie të veçantë. Megjithëse raporti i komisionit mbi çështjen greke nuk ishte bërë publik, pikpamja e delegatëve amerikanë në favor të Shqipërisë dihej. Kryetari i Komitetit Kombëtar Shqiptar, Dr.Adamidi, deklaronte në një letër dërguar presidentit, Uillson më 7 prill se komiteti dëshironte të shprehte "mirënjohjen e tij ndaj delegatëve amerikanë për mbrojtjen e shkëlqyer që i bënë të drejtës Shqiptare mbi Korçën" [20]

Pas muajsh zhagitje të kësaj çeshtje pa arritur në

19.Recent des Documents etrangeres, f.53, 359; Buletin quotidien de la presse etrangere, 18 nëntor 1919.

20.Herron Mss, Italia dhe Shqipëria, dokumenti XXIII, cf, dokument XII, Adamidi për Uillson nëpërmjet Herronit, 20 mars 1919. Ministri francez në Shqipëri, Viconte de Fontenay na siguroj dy herë hapur se "Korça është e Shqipërisë dhe do të mbetet e Shqipërisë". Të gjithë mjekët dhe zyrtarët franceze të cilët kanë qënë në Korçë pranojnë se kjo provincë është shqiptare.

një vendim përcaktues të fatit të tyre, dyshimi i banorëve u bë i padurueshëm. Frika se mos trupat franceze, që ende e mbanin të pushtuar qytetin, mund të tëhiqeshin para se fati i krahinës të vendosej, që do të rezultonte në një pushtim nga ana e trupave greke, e çoi situatën në gjendje revolucoini. Megjithatë përgatitjet për një kryengritje të tillë mund te nderpriteshin, sipas Dr.Adamidit, në qoftë se popullata do të sigurohej se delegacioni amerikan kishte vendosur që krahina do të ishte e shqiptarëve.[21] Ndaj një kërkese te tillë, për informim për statusin e çështjes shqiptare, përgjigja nga komisioni amerikan për bisedimet e paqes i datuar me 16 tetor ishte jo shumë i përcaktuar;

Në lidhje me Shqiperinë, është e vështire të jepet ndonjë pergjigje, por ju mund të thoni se nuk ka një vendim final ne lidhje më çështjen në tërësi ose në lidhje me Korçën në veçanti.[22]

Kur nje delegat amerikan i quajtur Polk, propozoi me 26 tetor që diskutimi i problemit

21. Herron MSS, Italia dhe Shqipëria,dokumenti xxxvi, Adamidi për Herron, 8 tetor 1919.

22. Po aty,dokumenti XXXVI, Dulles për Herron. Në trasmetimin e kësaj përgjigje për DrAdamididin, Herron tha:"Përshtypja ime është se nuk mund të arrihet në një vendim perfundimtar për Shqiperinë derisa të zgjidhjen çështjet që kanë të bëjnëme Italinë dhe Greqinë". Po aty, dokumenti XXXVII, 20 tetor 1919.

shqiptar të vihej në rendin e ditës për vazhdimin e mbledhjes, delegati anglez, Sër Eyre Crowe vërejti se zgjidhja e problemit ishte tejet e lidhur më atë të Adriatikut në përgjithësi, gjë që e bënte të mos diskutohej në mënyrë të pavarur.[23] Por një zgjidhje e çështjes së Adriatikut do të zgjaste. Praktikisht të gjitha palët kishin arritur një gjëndje kompromisi ndaj pengesës kryesore që frenonte zgjidhjen, Fiumes. Bisedimet midis Uashingetonit dhe Romës vazhdonin që nga Shtatori deri në Nëndor. Pikat për të cilat ishin marrë vesh presidenti Uillson dhe Sgr. Nitti ishin mishëruar në një memorandum Franko-Britaniko-Amerikan që iu paraqit Italisë me 9 dhjetor 1919, çka përbënte një sinjal për një rihapje tërësore të të gjitha polemikave. Kjo korespondencë duhej konsideruar tani e parë në detaje lidhur me Shqipërinë jugore.

Memorandumi i 9 dhjetorit përmbante një deklaratë me pikat kryesore mbi të cilat ishte arritur marreveshja me Italinë. Ato kishin të bënin me mandatin e Italisë mbi Shqipërinë dhe sovranitetin e plotë të saj mbi Vlorën "...me zona të tilla të thella që mund të ishin tejet të nevojshme për mbrojtjen dhe zhvillimin ekonomik ..." Në lidhje me këtë,

23. Bulletin quotidein de la presse e'trangeere,30 tetor 1919.

pikës së parë iu dha një shpjegim i plotë i pasuar me një memorandum te veçantë mbi konditat e një mandati të tillë. Gjithashtu citohej telegrami i dërguar Titonit nga ana e sekretarit amerikan te shtetit, Lansing me 12 nëntor i cili theksonte qëndrimin pajtues të SHBA-së. Pikërisht aty u morën fjalët të cilat u shfytëzuan si shprehje e miratimit nga ana e qeverisë amerikane ndaj një mandati të tillë: "Duke dashur të sillemi bujarisht, bile më shumë se bujarisht, ne i plotësuam kërkesat e Italisë për një mandat mbi Shqiperinë. Autorët e memorandumit duke paraqitur kushtet e propozuara nga Italia për Shqipërinë siguaruan, që më parë, për një komision të përbërë prej një përfaqësuesi të secilës palë, asaj italiane, Lidhjes së Kombeve, si dhe shtetit shqiptar, i cili do të privohej më vonë prej Aleatëve. Qëllimi i këtij komisioni ishte që të përpunonte me hollësi pikat e mandatit dhe ligjin,i cili përcaktonte të ardhmen e Shqipërisë. Pas pesë muajsh duhej bërë një raport për Këshillin e Lidhjes së Kombeve i cili do të përmbante rekomandimet, vetëm se vendimi përfundimtar i mbetej Këshillit i cili vendoste me shumicë votash. Kufijtë verior dhe lindor të Shqiperisë do të ishin ata të vendosur më 1913, por çështja e kufijve jugore mbetej ende për

t´u biseduar. Megjithatë, që të mos shtyhej një zgjidhje e përgjithëshme prej bisedimesh të tilla, mund të përshtateshin rregullime të përkohëshme, thelbi i të cilave ishte dhënia e Gjirokastres, Greqisë.[24]

Dhënia italianëve e një mandati mbi Shqipërinë hasi në kundërshtinë e delegatëve të shtetit Jugosllav,[25] të cilët i shprehen pikpamjet e tyre me një note dërguar me 8 Janar 1920. Delegatët thanë se kjo në mënyrë të paevitueshme të kujtonte mandatin mbi Bosnjë-Hercegovinën që iu dha Austro-Hungarisë më 1878, efektet e këqija të se cilës i kishin perjetuar jugosllavët. Kështu ata friksoheshin nga penetrimi i një fuqie të huaj, të madhe në Gadishulli e Ballkanit [26] i cili do të rezultanonte detyrimisht në rrjedhoja shkatrrimtare. Jugosllavët dëshironin një rregullim të kufijve verior te

24.Britania e Madhe, Letra parlamentare (1920)LI, "Korespondencë e lidhur me çeshtjen e Adriatikut"nr.1 Memorandum i përbashkët franko-britaniko-amerikan, 9 Dhjetor 1919.

25. Termi "Jugosllavia" është përdorur gjerësisht ndonëse emri zyrtar i saj është "Shteti serbo-krtoato-sllovën".

26. Jugosllavia atëherë do të ishte e kufizuar prej territoresh italiane si në veri ashtu edhe në jug. Frika e saj për një pozicion të tillë është ilustruar qartë në nj ëposter në Bibliotekën e Luftës Hoover. Ajo tregon një hartë në të cilën territori italian i ngjyrosur me të kuqe, prej të cilit zgjaten krahë dhe duar të përgjakura të cilat kapin fytin e sllavëve koka e të cilëve simbolikisht ngrihet nga toka nënë. (Poster kroat "Tako Bi Htjeli Talijani")"Të tilla janë disenjot e italianëve".

Shqipërisë në favorin e tyre. Por në pamundësi të saj ata preferuan zgjidhjen që do ta mbante Shqipërinë në limitet e 1913, si një shtet i pavaruar me një administratë autonome. Sipas tyre, pavarësia ishte më e mundshme të arrihej prej vetë Shqipërisë se sa prej një administrate të huaj. Megjithatë, në mungesë të kësaj zgjidhje dhe në rast se pjesa jugore do ti "jepej shteteve të tjera", Jugosllavia parashtroi kërkesat ndaj Shqipërisë së veriut, për territoret deri në lumin Drin[27].

Në përgjigjen e dhënë më 10 janar 1920, qeveria italiane paraqiti qëndrimin e saj rreth pikave të paraqitura në memorendumin e 9 dhjetorit. Nisur nga kjo, kufijtë caktoheshin nga Tepelena për në det, përfshinin një lëshim për Greqinë të territoreve ndaj të cilave më vonë Fuqitë nuk paraqitën kërkesa dhe prezantonte pavolitshmëri etnike dhe topografike, të cilat nuk do të viheshin re.

Më tej deklarohej se kërkesat greke do të plotësoheshin nëpërmjet një rregullimi të bazuar në ato fakte të cilat tashmë ishin paraqitur prej Venizellosit. Nga një përfaqësues prej Greqisë dhe

27. Adriaticus, La question adriatique, f.78-88. Note dërguar delegacionit të mbretërisë së serbëve, kroatëve dhe sllovenëve, 8 Janar 1920. Shih qëndrimin në hapjen e konferencës së paqes, Jugo-sllavia, Propaganda e delegacionit, Albania

Shqipërisë mund të paraqitnin argumentet përpara se sa përfaqësuesit e SHBA-ve, Anglisë, Francës dhe Italisë të cilët do të vinin në një vendim të përbashkët, i cili do të shqyrtonte ose dhënien e menjëhershme të territoreve të diskutueshme ose kërkesën e plebishitit për të gjitha palët, të cilat gjendeshin në atë territor. Sidoqoftë, pjesa e bregdetit shqiptar që mund t'i jepej Greqisë duhej neutralizuar. Një memorandum i veçantë iu bashkangjit marrëveshjes mbi formën e një mandati italian mbi Shqipërinë. Pavarësia e shtetit brenda për brenda kufijve, të cilët do të fiksoheshin, duhej njohur, ndërkohë që Jugosllavisë i akordoheshin të drejta të caktuara për komunikim. Qeveria italiane në konsultime me autoritetet shqiptare do të përpunonte hollësisht një marrveshje mbi konditat e mandatit dhe ligjet themelore të shtetit të ardhshëm shqiptar. Ky raport do t'i dorëzohej Këshillit të Lidhjes së Kombeve brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, ndërsa marrveshja do të duhej të bazohej në principet e më poshtme: së pari, mbrojtja e racës, gjuhës dhe fesë së minoriteteve; së dyti: organizmi i trupit legjislativ e administrativ në të cilin banorët do të duhej të prfaqësoheshin; dhe së treti, themelimi i forcave të policisë, eprorët e të cilëve mund të ishin të

kombësisë italiane, si fuqi mandatore. Përveç këtyre, Italia do të kishte të drejtën të mbante trupat e armatosura në vend për një periudhë prej pesë vjetësh nga data e dhënies së mandatit. [28]

Sipas pikpamjes italiane, Aleatët kishin bërë koncesione të ndjeshme në memorendumin e 14 janarit. Marrdhëniet e mëparshme të Italisë me Shqipërinë riafirmuam edhe të drejtën e saj mbi Vlorën, të siguruar nga Traktati i Londrës si dhe një mandat mbi Shqipërinë. Kufijtë veriore të Shqipërisë mbeteshin të rishikoheshin; zonat shqiptare që do të administroheshin prej shtetit Jugosllav do të përbënin një provincë autonome të njëjtë me provincën autonome të Ruthenisë në Çeko - Sllovaki. Kufijtë jugore të Shqipërisë do të përcaktoheshin nga propozimi i delegacioneve britanike e franceze në komisionin e çështjeve greke, sipas të cilës Gjirokastra dhe Korça i mbeteshin Greqisë. [29] Përgjigja jugsllave ndaj atyre propozimeve përsëriste bindjen se zgjidhja më e mirë qëndronte në një qeveri autonome lokale pa ndërhyrjen e fuqive

28. Britania e Madhe, Letra parlamentare, (1920) LI, Korrespondencë në lidhje me çështjen e Adriatikut, "nr.6, Memorandumi italian e 10 janarit 1920.

29. Great Britain, Parlamentary Papes (1920), LI, .Correspondence Relating to the Adriatic Question, "No. 7, "Revised Proposlas", January 14, 1920.

të mëdha. Por në rast se kjo zgjidhje nuk do të pranohej, atëherë do të pranoheshin propozimet e 14 janarit të cilat siguronin zbatimin e ratifikimit të mëtejshëm të kufijve juglindor. [30]

Në këtë stad të bisedimeve lidhur me Shqipërinë, sekretari amerikan i shtetit ngriti objeksione ndaj një zgjidhje në të cilën SHBA-ve nuk u ishte marrë mendimi. [31] Në përgjigje të kësaj Clemaceau dhe Lloyd George deklaruan se ata "... kurrë nuk kishin patur qëllim për të arritur në një zgjidhje përfundimtare... pa marrë parasysh edhe pikpamjen e qeverisë amerikane". Zgjidhja e propozuar ndryshonte nga ajo e 9 dhjetorit në të cilën SHBA-të kishin qënë palë vetëm në dy aspekte; çdonjëra prej të dyjave e favorizonte dukshëm Jugosllavinë. Në lidhje me një ndryshim që kishte të bënte me Shqipërinë, delegacioni francez si dhe ai britanik deklaruan:

Sa i takon Shqipërisë është bërë një përpjekje për të kënaqur kërkesat e të gjitha palëve të interesuara. Detajet e administrimit të këtij vendi prej Jugosllavisë, Italisë dhe Greqisë duhet të përpunohen

30. Po aty, No 8 Reponse de la delegation du royaume des Serbes, Croates, et Slovenes, January 20, 1920.

31. Po aty, No 9, Lansing për Wallace, 20 janar 1920.

edhe më tej. Por në përpjekjet për të mbaruar këtë punë nuk duhen nënvlerësuar ndjenjat dhe interesat e së ardhmes së popullit shqiptar, ndaj çdo hap i ndërmarrë duhet bërë në konsultim me të. [32]

Presidenti Uillson e kundërshtoi ashpër këtë akt nëpërmjet një memorandumi të gjatë ku ngriti në mënyrë të pashëmbullt zërin e protestës ndaj zgjidhjes së sugjeruar për çështjen shqiptare.

Ndërsa memorandumi i 9 dhjetorit "përkrahte gjërësisht unitetin e shtetit shqiptar", ai i 14 janarit kërcënonte ta ndante këtë popull midis tre fuqive aleate, [33] "përkundër protestave të tij të fuqishme". Pas rishqyrtimit të situatës ai deklaroi se çështja e Adriatikut, ashtu siç paraqitej tani, përbënte çështjen themelore dhe pikërisht atë se a do të vazhdonte qeveria amerikane të bashkëpunonte në ndonjë pikë me partnerët europianë në çështjen e tyre të madhe për ruajtjen e paqes në botë e cila tani kërcënohej prej të njëjtave shkaqe që e kishin sjellë atë.

Si konkluzion ai deklaroi:

Në qoftë se nuk do të shfaqet ndonjë mundësi për pranimin nga Italia të lëshimeve të drejta dhe bujare,

32. Po aty, No.10, "Clemenceau dhe Lloyd George dërguar ambasadorit të SHBA-ve për të njoftuar Uashingtonin. 22 janar 1920.

33.Po aty, No.12, President Wilson's note February 10, 1920.

të afruara prej qeverive britanike, franceze dhe amerikane në memorendumin e përbashkët të këtyre Fuqive të 9 dhjetorit të vitit 1919, të cilin Presidenti e ka deklaruar qartë si maksimumin e lëshimeve që qeveria e SHBA-ve mund të afrojë. Presidenti dëshiron të thotë se ai duhet të marrë seriozisht në konsideratë tërheqjen e traktatit me Gjermaninë dhe marrveshjen midis SHBA-ve dhe Francës të 28 qershorit 1919, të cilat janë tani përpara Senatit, duke i hapur rrugë zgjidhjes dhe zbatimit të pikave të afruara nga evropianët në mënyrë të pavarur prej qeverive anëtare.

Përgjigja franko-britanike ndaj kundërshtimeve të Uillsonit spjegonte veprimin e menduar të ndërmarrë për çështjen shqiptare duke tërhequr vëmendjen në faktin se e gjithë Shqipëria do të vihej nën një sistem mandator; e kështu "aspiratat e popullit shqiptar për bashkim dhe vet-qeverisje" eventualisht do të plotësoheshin. Ndërkohë, përderisa populli shqiptar nuk kishte qënë kurrë i zoti të themelonte një qeveri të fortë për vete, si dhe nisur nga fakti se pjesa veriore ishte thuajse e tëra kristiane ndërsa ajo jugore e përzier por në shumicë myslimane, përgjegjësia për qeverisje dhe zhvillim të këtyre dy pjesëve më së miri mund t'i

34.Po aty.

lihej në dorë respektivisht Jugosllavisë dhe Italisë.[34]

Me fjalë të tjera. "deklarata e Antantës spjegonte se ata nuk kishin qëllim të bënin atë çfarë thonin dhe vazhdonin rrugën për realizimin e planeve të tyre". [35]

Megjithatë presidenti Uillson qëndroi i vendosur në kundërshtimin e tij ndaj copëtimit të Shqipërisë. Duke kuptuar se kjo ndarje e trefishtë e Shqipërisë (midis Italisë, Greqisë dhe Jugosllavisë) mund të ishte më e pranueshmja për Jugosllavinë, Qeveria Amerikane ishte "... pikërisht aq kundërshtare e vendosur ndaj dëmtimit të popullit Shqiptar për përfitime nga Jugosllavia sa... ç'ishte edhe ndaj dëmtimit të popullit Jugosllav për interesa të Italisë."[36] Për më tepër, dallimet midis dy pjesëve të Shqipërisë do të theksoheshin më shumë nëse ato do të vendoseshin nën kontrollin e kombeve të ndryshme e aspak të ngjashme. Përveç kësaj, përderisa njëri seksion do të administrohej prej Italisë, pra prej një anëtari të Lidhjes së Kombeve, bile edhe përfaqësuese në këshill, dhe tjetra prej Jugosllavisë, e cila nuk i gëzonte këto atribute,

35. Great Britain, Letra parlamentare 1920, LI, "Korrespondencë në lidhje me çështjen e Adriatikut, "No.13. Mellerand dhe Lloyd George për Uillsonin, 17 shkurt 1920.

36.Gibbons, Europë që nga 1918-ta f.47.

ndryshimi në të ardhmen ose tërheqja e mandatit do të ishte i vështirë për të mos thënë i pamundur.[37]

Përfundimi i korespondencës rreth tërë çështjes së diskutueshme të Adriatikut ishte se Italia dhe Jugosllavia u lanë të zgjidhnin kundërshtitë e tyre, në qoftë se ato do të mundeshin, nëpërmjet bisedimesh direkte, me kusht që një marrveshje për rajonin e Fiumës të mos bëhej mbi bazën e kompensimeve në llogari të kombeve të një fuqie të tretë, respektivisht të Shqipërisë. Rezultatet e bisedimeve direkte të të dy fuqive të interesuara do të ishin të kënaqshme për presidentin Uillson përderisa ranë në fushën e principeve të vetvendosjes.[38]

Ky sugjerim i presidentit Uillson, pra që zgjidhja e çështjes të bëhej mbi bazën e meritave, u respektua. Traktati i Rapallos i 12 nëntorit 1920, midis Italisë dhe Jugosllavisë nuk e përmendi subjektin Shqipëri.

Sipas klaozolave të tij, rregullimet në traktatin e Londrës që kishin të bënin me Shqipërinë pushonin

37.Britania e Madhe, Letra parlamentare (1920), korespondencë ne lidhje me çështjen e Adriatikut."Memorandumi i Uillsonit, përfshirë në nr. 14.Davis per Earl Curson, 25 shkurt,1920.

38.Po aty: shih gjithashtu Nr 15, Memorandumi franko-britanik në përgjigje të atij të dërguar prej Uillsonit 26 Shkurt,1920.

së qeni, përderisa Italia nuk këmbëngulte edhe më tej që të merrte Dalmacinë dhe ishujt e saj. Meqënëse një zgjidhje e kundërshtive midis Jugosllavisë dhe Italisë u arrit më në fund pa përzierjen e Greqisë dhe Shqiperisë, çështja e kufijve midis këtyre dy të fundit humbi një pjesë të rëndësishme dhe u la pa u zgjidhur.[39]

Megjithatë sherri mbi Adriatikun nuk kalonte pa e goditur Shqipërinë. Kur Italia ishte dukur si e gatshme të lejonte Jugosllavinë dhe Greqinë të kishin pjesë të veriut dhe të jugut të Shqipërisë me qëllim që të merrete Fiumën, shqiptarët u bindën se Italia i kishte tradhëtuar ata. Dyshimet e tyre gjithashtu ishin ngjallur krye këput prej propozmit të bërë nga Greqia dhe Italia për ndërtimin e një linje hekurudhore nëpër Jugun e Shqipërisë, propozim i bërë ky pa u konsultuar me qeverinë shqiptare. Këtë ata e morën si një tregues i qartë asaj që Italia e konsideronte si provincë të saj Shqiperinë. Të shtyrë kështu prej zemërimit që kishte shkaktuar marrëveshja Tittoni-Venizellos, shqiptarët thirrën një asamble kombëtare në Lushnjë me 28 janar 1920 kur zgjodhën një qeveri të re duke e zëvëndësuar

39.Po aty.Momerandum i Uillsonit,bashkëngjitur me nr 14,Davis per Earl Curson,25 Shkurt,1920.

atë të Durrësit me qëllim që të kundërshtonin të gjitha nderhyrjet e huaja. U formua një këshill regjencial me fuqi te kufizuar ekzekutive, i përbërë prej katër antarësh që përfaqsonin degëzimet fetare në vend, katolik e romake, greko ortodokse dhe dy sekte muslimane suuni dhe bektashi. Vendvendosja e kësaj qeverie të re u bë Tirana një qytet i brendëshën larg nga influenca italiane e cila ndihej veçanarisht në zonat bregdetare të Shqiperisë.[40] Më pas vijuan muaj të qetë përgatitjesh dhe organizimi sistematik për të arritur qëllimin e tyre për ta liruar vendin qoftë nga qeverisja e ndonjerit prej fqinjeve qoftë prej të huajve në përgjithësi. Pas Italisë edhe Jugosllavia edhe Greqia duhej të përzeheshin nga territoret shqiptare.[41] Duke filluar nga muaji maj kjo revoltë mori formën e saj të plotë. Lufta tashmë zhvillohej afër Vlorës dhe që prej qershorit ngjarjet

40. Chekrezi, Current history XII, Current History, 600; Rush, Current History, XIX.249; Bourcart, op.cit., 230-33

41 Herron MSS, Italia dhe Shqiperia, Dokument XIV Herron per Count Sforza, 21 qershor, 1920. ne këtë leter Herronparaqet përmbajtjen e pikpamjeve te Komitetit Kombëtar Shqiptar. Shqiptarët e kuptuan se ata janë thjeshtë një subjekt trmi midis fuqive të mëdha...ata besojne tek vetevetja se janë të zotët...ta arrijnë autonomi të plotë/(Ata) nuk kanë ndjenja kundër Italisë...dhe janë gati...në të vertetë të bashkëpunojnë me politikën Italiane në Adriatik...Nëqoftese Italia do të marrë inisiativën për ta shpalluar Shqiperinë tëpavarur, nuk do të ketë shqetësime ose shtyrje për të arritur marrëveshje të kënaqshme rreth portit të Vlorës.

do të rrokulliseshin me shpejtësi duke sjellë mundjen e Italisë dhe afirmimin e çështjes shqiptare si çështje të një rëndësisë së dorës së parë për Italië. Në të vërtetë njeri prej akteve të para të kabinetit të ri italian të kryesuar prej Giolitit i cili i zuri vendin Nittit në qershor, ishte deklarata që Italia do t'i tërhiqte trupat e saj nga Shqipëria. Më 24 Qershor kryeministri i ri deklaroi në Parlament se qeveria "nuk ishte në favor të një protektorati mbi Shqipërinë, por dëshironte pavarësinë e atij vendi". Këtë deklaratë ai e zgjeroi në fjalën e tij më 27 Qershor, duke shpallur se Italia nuk mund të braktiste Vlorën derisa Shqipëria të bëhej aq e fortë sa të jepte garanci se porti nuk do të binte në duart e ndonjë fuqie tjetër.[42] Ky qëndrim në përgjithësi u mbështet prej opinionit italian, por shtypi insistonte në domosdoshmërinë e mbajtjes së Vorës. Sidoqoftë, socialistët, të cilët kishin arritur sukses të dukshëm në zgjidhjet e nëntorit 1919, e kundërshtuan hapur aventurën italiane në Shqipëri dhe e zunë qeverinë në pozitë

42. Bulletin periodique de la presse italianne, 8 Korrik 1920 (Corriere della Sera, 29 Qershor); Current History, XII, 784, Cf. deklaratë e Ministrit Italian të Punëve të jashte: "Sa i takon politikës italiane ndaj Shqipërisë a mund t'ju kërkoj ju të shihni shumë qartë deklaratat e kryeministrit Italian të dhëna ditët e fundit të Qershorit në Parlament. Ju do ti gjeni ato plotësisht të kënaqshme". Herron, MSS, Italia dhe Shqipëria, Document XIX, Sforza për Herron, Korrik 1920.

të vështirë me kundërshtimet që i bënë asaj. [43]

Në fillim të korrikut qeveria dërgoi Baronin Aliotti për të biseduar me shqiptarët. Në përgjithësi në Itali pritej se ai do të ishte i suksesshëm në misionin e tij sikundër kishte qënë në kohën e ushtrimit të detyrës së ministrit italian në Durrës gjatë rregjimit të princ Vilhelm Vidit. Por ai ishte jopopullor me shqiptarët në terren pasi ai kishte kompllotuar Esat Pashën kundër princ Vidit dhe po ashtu ishte pjesërisht përgjegjës për Traktatin e Londrës së vitit 1915. [44]

Ishin të gjitha këto që e bënë atë të kthehej më 14 korrik me duar bosh dhe të zëvëndësohej prej kontit Manzoni, [45] i cili arrit që të nënshkruante një marrëveshje me 2 gusht.

Pikat e këtij armëpushimi ose traktati nuk u bënë publike. Sidoqoftë në substancë ai garantonte braktisjen e Vlorës prej italianëve, por do të mbante ishullin e Sazanit të cilin mund ta fortifikonte. Përgatitje gjithashtu u bënë për një shkëmbim të burgosurish dhe një amnisti të përgjithshme, e mbi të gjitha për njohjen dhe garantimin prej Italisë të

43.Po aty, 20, 21 qershor 1920; 20 gusht 1920.

44. Herron MSS, Italia dhe Shqiparia, DocumentIII, Adamidi për Herronin, 20 Korrik 1920. Cf.Current History, XII, 781.

45. Herropn MSS, Italia dhe Shqipëria, Documenti IIV, Sforca per orsini, Ministri italian në Berne, 27 korrik 1920.

pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë.[46] Efekti i kësaj marrveshje shënoi një rritje të jashtëzakonshme të prestigjit të qeverisë së përkohshme Shqiptare të Tiranës. Në Itali nga ana tjetër shtypi dhe opinioni publik ishin gati unanim në keqardhjen për humbjen e Vlorës. Po ti referohemi komitetit të mëposhtëm do të kuptojmë ndjenjat italiane për këtë humbje:

Eshtë tejet brengosëse të përjetosh këtë shpartallim pas kaq shumë gjaku italian, fisnik e bujar të dhënë, dhe sa e sa milionave të shpenzuara për një punë të madhe civilizuese dhe për sigurimin e kufijve tanë.[47]

Një pengesë e madhe për mirëkuptimin midis Italisë dhe Shqipërisë u bë marrveshja Titoni-Venizellos. Me konsumimin e nja traktati italo-shqiptar, lëshimi i Shqipërisë jugore në duart e Greqisë me miratimin e Italisë nuk mund të ishte më kurrsesi e mundur; dhe në fakt, në dukje gjatë kohës së bisedimeve më Shqipërinë, Italia formalisht e hodhi poshtë këtë marrveshje me Greqinë. [48]

Ndërkohë çështja e Korçës ishte zgjidhur

46.Buletini periodique de la presse italienne, 13 Gusht 1920.

47.Bulletin quotiden de la presse etrangere, 6 gusht 1920; shih gjithashtu 9 gusht 1920.

48.Konventa u denoncua më 22 Korrik. Current History, XII, 1060; Buletin quatiden de la presse etrangere, 31 Korrik 1920.

përkohësisht. Trupat franceze të dërguara gjatë luftës mbetën atje me kërkesën e shqiptarëve, [49] deri në maj të vitit 1920, kohë kur ato u tërhoqën dhe e lanë administratën në duart e një komiteti shqiptar. Të frikësuar nga trupat greke të cilat ishin bërë gati për të hyrë, raportohej se shqiptarët myslimanë kishin kërcënuar se do të kundërvepronin me një masakër ndaj banorëve kristianë [50]. Për ti dalë përpara një të papriture të tillë, Greqia inicoi një takim me përfaqësues të Shqipërisë, i njohur si marrveshja e Kapshticës e 15 majit. Sipas kësaj marrveshje grekët nuk do të hynin në qytet derisa çështja të zgjidhej ose prej Konferencës së Paqes ose prej një marrveshje direkte midis qeverisë helenike dhe asaj shqiptare. Ndërkohë, ishin bërë përgatitje

Pikpamja greke ndaj revoltës shqiptare kundër Italisë ishte se raportet e luftës dërguar në të gjithë botën ishin thjeshtë një perde tymi; që Italia, duke pasë bindur Konferencën e Paqes së shqiptarëve, të pazotët për të vetëqeverisur, u nevojitej një mandat, nuk mudn të tërhiqet, por duhet bindur bota se shqiptarët ishin nj ëpopull i bashkuar me një sens të zhvilluar mirë të kombësisë, të cilët do të sihsin t ëzotët të pushtonin greqinë nëqoftë se kjo e fundit do të përpiqej q ëtë hynte në Epir; për të arritur në fund, Italia doprëzohej ndaj Shqiptarëve. Letër nga presidenti i shoqërisë së janinës, botuar në Christisn Science Monitor, 30 Korrik 1920.

49.Shqipëria, propagnda e delegacionit. Shënime shtesë. Turhan (Pasha) për Cleme nceau, 17 Prill 1919; "Dëshira jonë është që ju të mbani trupat tuaj në Korçë... bandat dhe trupat greke do të hynë në Shqipëri menjëherë sapo të largohen trupat franceze të cilat do të paralajmëronin çrregullime të mëdha".

50.Christian Science Monitor, 6 Korrik 1920.

për mbrojtjen e grekëve, të asaj ane, të cilët nuk do të ktheheshin në njerëz që të vuanin për shkak të bindjeve të tyre ndërsa kishat dhe shkollat e tyre do të funksiononin të lira. [51]

Në këtë mënyrë, vera e vitit 1920 e gjeti Shqipërinë me problemin e kufijve të saj ende të pazgjidhur. Sipas pikpamjes shqiptare ajo kishte fituar por fitoret e saj ishin të një lloji negativ. Konferencës së Paqes, e cila ishte hapur me dëshirat e zjarrta për një zgjidhje të kënaqshme në drejtim të vetvendosjes, i ishte hedhur një tis i errët që në fillim për shkak të besimit që ajo kishte treguar ndaj Konferencës së Londrës së vitit 1915.

Arsyeja e vërtetë se pse pikat e këtij pakti nuk arritën të zbatoheshin -ndonëse ato prapseprapë lanë një hapësirë për një zgjidhje të kënaqshme - vinte direkt prej përpjekjeve të bëra prej presidentit Uillson. Megjithatë duhet shënuar se italianët iu përmbajtën në këtë komision kufijve të 1913-tës. Në të vërtetë përshtatshmëria e këtyre kufinjve ishte

51.Tekst, Frangulis, vepër ecituar, aneksi nr,11,f33-34.

52.Për besimin e fdhënë Traktatit të fshehtë, shih deklaratën e Uillsonit për Komitetin e Senatit mbi punët e jashtme, 19 Gusht 1919. Ata (Britania e Madhe dhe Franca) e ndjejnë që nuk mund të shkëputeshin prej tyre... por kur i përfshinë në një interesat e tyre të përgjithshme... ishin krejtësihst të gatshëm, dhe në të vërtetë unë mendoj dhe dëshiroj se ata duhet të ishin rivlersuar nga konsensusi i pjestarëve të tjerë.

çështja e ditës me të cilin do të merrej komisioni.[52]

Megjithëse shqiptarët përbënin një shumicë në zonat perëndimore të Janinës, në fakt diskutimi nuk duhej të kthehej në atë që a duheshin shtyrë kufinjtë shqiptarë drejt jugut, por përkundrazi, në atë që duheshin shtyrë kufijtë greke drejt veriut. [53]

E prapëseprapë, Italia me qëllim që të përfitonte çfardo që të mundej qoftë edhe gjetkë, u pajtua për këtë çështje me Greqinë në marrveshjen Titoni-Venezillos.

Kur çështja aq e debatueshme e Adriatikut u muar përsëri në shqyrtim në dhjetor të vitit 1919, të gjitha palët ishin aq të shqetësuara lidhur me zgjidhjen e saj sa që gjetën si rrugë të vetme sakrifikimin e të drejtave të shqiptarëve duke përfituar edhe nga fakti që mandati italian nuk u garantonte atyre pavarësi të plotë. Por kur, me qëllm që të vinin tek një marrveshje me Jugosllavinë në pikat e tjera, Franca duke patur interesa të veçanta tek kjo e fundit ashtu si edhe Britania e Madhe, duke favorizuar Greqinë me dëshirën që t ë kompensonte mbretërinë Helenike për një luftë të papërcaktuar me Turqinë, u pajtuan për copëtimin e Shqipërisë, dhe ishte vetëm protesta energjike e presidentit Uillson ajo

53. *Temperley, vepër e cituar, IV, 342.*

që e shpëtoi Shqipërinë pa vuajtur të njëjtin fat që kishte pësuar Polonia nga duart e Aleatëve. Zgjidhja e grindjeve italo-jugosllave prej Traktatit të Rapallos, të paktën pati një të mirë, pasi nuk e implikoi Shqipërinë dhe për rrjedhojë e shtyu një vendim armiqësor që mund të ishte marrë ndaj saj.

Një qeveri e re Shqiptare e frymëzuar prej një politike të fortë kombëtare u tregua e zonja që t'i përzente italianët prej vendit të vet, duke detyruar në të njëjtën kohë edhe abrogimin e marrveshjes midis Greqisë e Italisë në dëm të Shqipërisë për të ardhur tek një marrveshje e përkohshme me Greqinë, lidhur me Korçën, duke i dhënë kështu vetvetesprestigj të jashtëzakonshëm sa brenda aq edhe jashtë vendit.

VII LIDHJA E KOMBEVE, 1920-1923

Midis atyre shteteve të cilat kërkuan për tu pranuar në të parën Asamble të Lidhjes së Kombeve ishte Shqipëria. Në atë kohë, Dhjetor 1920, statusit të saj i ishte dhënë vlerësim i kujdesshëm -pa harruar që të përfshinte edhe çështjen e kufijve.

Komisioni i ngarkuar me shqyrtimin e kërkesave për pranimet e reja e diskutoi çështjen e Shqipërisë në mbledhjen e tij të 4 Dhjetorit të viti 1920. Raporti i nënkomisionit për kërkesën e Shqipërisë i cili u lexua prej Lordit Robert Cecil, tërhiqte vëmendjen ndaj faktit se Qeveria Shqiptare që ishte atëherë në fuqi, nuk ishte njohur *de jure as de facto* prej ndonjë Fuqie, dhe që kufijtë shqiptarë nuk ishin përcaktuar ende prej traktateve dhe marrveshjeve ndërkombëtare. Meqënëse këta kufij ekzistonin de facto ata mund të merreshin si të fiksuar e të modifikoheshin më pastaj nga konventa pasardhëse". Përkundër këtyre fakteve si dhe përkundër stadit të dukshëm fillestar të makinës qeveritare të shtetit. Lordi Robert ishte në favor të pranimit të Shqipërisë, duke theksuar në mbrojtjen e tij faktin që Shqipëria përbëhej prej virtytit një komb me dëshirë unanime

të banorëve të vet [1]. Megjithatë komiteti adoptoi mocionin e M.Vivianit në favor të shtyrjes së pranimit të Shqipërisë derisa statusi i saj ndërkombëtar të fiksohej përfundimisht[2] dhe kështu iu bë e njohur Asamblesë raporti që mban datën 6 Dhjetor. [3]

Ky raport, midis çështjeve të tjera, merrej edhe me çështjen e "vendosjes së kufijve" të vendit. Raporti shënonte se Shqipëria kërkonte kufijtë e përçaktuar prej traktatit 1913-ës, ndërkohë që në jug, grekët mbanin nën pushtim pjesën e krahinës së Korçës.

"..... por përsëri (vazhdonte raporti) nuk duket qartë nëse është ndonjë kërkesë e drejtë në anën e tyre, megjithëse sipas një marrveshje të bërë midis grekëve dhe shqiptarëve rreth kësaj pike, pronësia përfundimtare mbi rajonin ishte lënë për bisedime të mëvonshme. Sipas klauzolave të kufinjve të Traktatit të Sevres, mbajtur në Gusht të viti 1920, kufiri jugor i Jugosllavisë është përkushtuar si një linjë e mbetur për tu përcaktuar më vonë, ndërsa

1. Proces verbal i komitetit të Asamblesë së parë të Lidhjes së Kombeve. No.13. 11 dhjetor 1920, f.12-13.

2.Po aty, 14-15.

3.Lidhja e Kombeve, protokolli i asamblesë së parë, mbledhja plenare, 1920. f.668.

bie në sy që Shqipëria nuk është përmendur asgjëkundi në atë traktat. Prandaj mund të vlerësohen anëtare të Lidhjes, të cilat ishin palë në atë traktat, u penguan pikërisht prej tij që ti konsideronin kufijtë e Shqipërisë si të fiksuar. Megjithatë mbase ata konsideruan se kufijtë ashtu siç kërkoheshin prej Shqipërisë mund të vlerësoheshin si kufi *de facto*, dhe të mbeteshin subjekt i ndryshimeve në veprimet e mëtejshme diplomatike.[4]

Opinioni i komitetit nuk ishte përkrahur prej Robert Cecilit. Në vend të tij ai burrë shteti përkrahu nëpërmjet një apeli të fuqishëm pikpamjen që ndihmonte pranimin e Shqipërisë në Lidhje. Gjatë fjalës së tij ai deklaroi se:

Njohja e parë sjell shtetin në familjen e kombeve e

4.Lidhja e Kombeve; Protokolli i asamblesë së parë, mbledhja plenare, 1920 f.669. Shih subjektin e njohjes së Shqipërisë, deklaratat e përfaqësuesit italian; "Në momentin e tashëm qeveria italiane nuk e ka njohur qeverinë shqiptare as de juro e as de facto... (Po aty, f.670).

Në çështjen e stabilizimit të qeverisë shqiptare raporti i Komitetit nr.5 dekaroi në mënyrë kuptimplotë: "Në tërësi ne jemi të mendimit se megjithëse Qeveria e Shqipërisë nuk është tërësisht në vendin që i takon, prapseprapë është një qeveri e cila ka një shkallë të caktuar autoriteti në të gjitha pjesët e Shqipërisë dhe ajo padyshim përfaqëson një ndjenjë shumë të fortë kombëtare e cila shpërfill të gjitha dallimet fetare. Duket gjithashtu qartë se vendi është i banuar prej një race të pastër shqiptare që flet si gjuhë të përbashkët atë shqipe".

mëpastaj ai vazhdon të ekzistojë po të mos zhduket prej ndonjë pushtimi apo ndonjë marrveshje të përgjithshme të atyre që e lakmojnë atë; Qeveritë kohë pas kohe arrijnë ose dështojnë në përpjekjet e tyre për të siguruar njohje por shtet i si shtet mbetet.[5]

Në opinionin e tij Lord Robert Cecil u përkrah prej Asamblesë dhe pas një vote unanime më 17 dhjetor, Shqipëria u antarësua në Lidhjen e kombeve[6]. Pas këtij akti, fati i saj ra përfundimisht në duart e lidhjes.

Megjithëse pranimi i Shqipërisë në Lidhjen Kombëtare bëri të qartë se ajo ishte një shtet plotësisht i vetqeverisur dhe që ajo kishte dhënë garanci efektive të qëllimeve të saj të sinqerta për të respektuar detyrimet e veta ndërkombëtare duhet shënuar se vendi ishte ende i panjohur prej Fuqive dhe që çështja e kufijve të tij ishte jo më shumë i zgjidhur se ç'ishte në kohën e armëpushimit.[7]

Për shkak të problemit të pazgjidhur të kufijve të Shqipërisë grindja me Jugo-Sllavinë po bëhej edhe më e padurueshme. Në një apel të paraqitur nga kryeministri Vrioni në Këshillin e Lidhjes së

5.Po aty, f.645
6.Po aty, f.651
7. Woods, Conteporary Review, CXXI, 43.

Kombeve, në fillimin e marsit të viti tjetër, ai kërkonte evakuimin me urgjencë të një pjese të konsiderueshme të Shqipërisë veriore, e cila aso kohe ishte nën pushtimin ushtarak Jugo-Sllav. Thirrja u përsërit prej Mit'hat Frashërit, president i delegacionit Shqiptar më 29 prill 1921 i cili pasi shtjellonte gjerësisht shqetësimet që kishin me Jugo-Sllavinë, tërhoqi vëmëndjen edhe për vështirësitë që haseshin me Greqinë. Kjo e fundit, deklaronte se ai, vazhdonte "të pushtonte një krahinë e cila kishte njëzet fshatra shqiptare në lindje të Korçës duke mbajtur peng një vendim të Fuqive të Mëdha në lidhje me evakuimin e saj prej andej [8]. Më 15 qershor, më së fundi në një thirrje të Vrionit, bazuar plotësisht në nenin11 të Marrveshjes, i kërkohej përsëri me urgjencë Lidhjes që të vlerësonte situatën ekzistuese midis Shqipërisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. [9] Si rezultat i kësaj, çështja e kufijve shqiptarë u diskutua

8. Lidhja e Kombeve, Official Journal, Qershor-Gusht 1921, viti i dytë, nr. 5-6, f.474.

9. Po aty, f.477. Neni 11 i marrveshjes thotë:

Ndonjë luftë eventuale ose rrezik për luftë e cila do të ndikonte menjëherë tek ndonjëri prej anëtarëve të Lidhjes, do të vlerësohet si një çështje që ka të bëjë me të gjithë Lidhjen, dhe Lidhja do të marrë çdo veprim që mund ta gjykojë të përshtatshëm dhe të efektshëm për të ruajtur paqen e kombeve. Në rast se do të ketë ndonjë urgjencë, atëherë, sekretari i përgjithshëm me kërkesën e ndonjë anëtari të Lidhjes do të thërrasë menjëherë mbledhjene Këshillit.

në Këshillin e Lidhjes së Kombeve në sesionin e tij të trembëdhjetë të mbajtur në qershor 1921. Në sesionin publik të 25 Qershorit delegatëve të Shqipërisë, Greqisë dhe Jugosllavisë iu dha mundësia që t'i shprehnin pikpamjet e tyre respektive rreth tyezës së këshillit.

Shqipëria përfaqësohej prej Arkipeshkvit Fan S.Noli i cili e kishte radhën të fliste i pari. Deklarata e tij në emër të qeverisë shqiptare ruante si bazë të kërkesës së tij atë që kufijtë e Shqipërisë ishin ato të vendosur në Londër dhe Firence më 1913, përderisa "traktatet" e atëhershme nuk qenë abroguar.[10] Sa i takon Shqipërisë së Jugut, qeveria shqiptare theksoi se ajo ishte në zotërim të të gjithë territoreve të caktuara më 1913, "me përjashtim të një zone që rrethonte Korçën, e cila ishte pushtuar prej trupave greke pas tërheqjes së trupave franceze në maj të 1920-tës". Prania e trupave të huaja në tokën

"Eshtë deklaruar gjithashtu si e drejtë e plotë e çdo anëtari të Lidhjes që të sjellë në vëmendje të asamblesë ose të Këshillit, çdo çështje të çfardo lloji qoftë ajo, që do të ndikonte në marrdhëniet ndërkombëtare të cilat rrezikojnë që të dëmtojnë paqen në botë ose marrdhëniet e mira midis kombeve tek të cilat varet paqa. (Handbook on the League of Nations, 1920-1923 në Fondacionin Botëror të Paqes. Lidhja e Kombeve, Vol. V, nr.4, 1 mars 1923. f.314).

10. Lidhja e Kombeve, Proces-Verbalet e sesionit te trembëdhjetë te Këshillit, 17-28 Qershor 1921. f.210.

Shqiptare këtu në jug e veçanërisht gjatë kufirit Jugosllavinë, deklaroi prifti Noli -paralizoi tërë politikën e brendshme të qeverisë" [11]. Në përfundim ai nguli këmbë që sapo Këshilli ta shqiptonte vendimin mbi çështjen vitale të evakuimit të territoreve shqiptare, Lidhja duhet të dërgonte një komision në vend për të realizuar dy qëllime; të shikonte zbatimin e vednimit dhe te njihej me situatën në vend. Në këtë mënyre do të përmbushej artikulli 15 i marrëveshjes, duke siguruar një hulumtin tërësor ndaj kërkesave të secilës prej palëve në grindje.[12]

Pikpamjet greke u paraqiten me mjeshtri nga delegati i tyre M.Fragulis i cili bëri një vështrim historik e ligjor të çështjes të "Vorio Epirit." Si fillim ai rishqyrtoi marveshjen e vitit 1913 dhe 1914 dhe theksoi se është e vertetë se Protokolli i Firencës së 17 dhjetorit të vitit 1913 i shënoi kufijtë e Shqiperisë por ata mbetën vetëm në hartë, dhe percaktimi aktual e tyre në terren nuk u plotesua kurrë.[13] Përveç kësaj delegati grek pohoi se marrëveshjet e 1913-ës dhe 1914-tës nuk mund të ishin edhe më tej efektive për dy arsye: së pari, sepse asnjanësia e Shqipërisë

11. Po aty, f.211
12. Po aty, f.212.
13. Po aty, f.213

është dhunuar pas pjesmarrjes së saj në Luftën e Madhe, përderisa, po t'i referohemi Esat Pashës, ajo u njoh prej Antantës si Aleate; dhe së dyti, sepse në pikat e fshehta të Traktatit të Fshehtë të Londrës së vitii 1915, në të cilat përmendet krijimi i një shteti të vogël neutral Shqiptar thuhej:

parë nga këndi i vështrimit të katër Fuqive të cilat e kishin garantuar Shtetin Shqiptar në Londër më 1913, kushtet *de facto* të cilat ishin ngritur që atë ditë e kishin bërë këtë marrveshje të pavlefshme. [14]

Duke rrëfyer ndërlikimet e çështjes shqiptare, siç kishin dalë ato përpara Konferencës së Paqes, M.Fragulis tërhoqi vëmëndjen në disa fakte tek të cilat qëndronin kërkesat greke. Midis tyre ishte marrveshja e Kapshticës e 15 majit, 1920 në të cilën të dyja palët pranuan të konfirmonin një vendim të Konferencës së Paqes për të respektuar kufijtë, duke njohur kështu juridiksionin e Konferencës [15]. Një fakt tjetër bazë i nënvizuar prej tij ishte raporti i Komisionit të Çështjeve Greke, në të cilin delegatët britanikë dhe francezë favorizuan kërkesat greke. E një rëndësie të dorës së parë për pikpamjen greke ishte nota e Aleatëve e dhjetorit të vitit 1919 sipas të cilës "linja kufitare midis

14. Po aty, f.215
15. Po aty, 216

Shqipërisë dhe Greqisë ishte vendosur", dhe ajo e 14 janarit të 1920-ës sipas të cilës vija e propozuar prej delegatëve francezë e anglezë në Komisionin mbi Çështjet Greke ishte vendosur si vijë kufitare [16]. Kjo letër-note kishte dalë prj një mbledhje të mëparshme në të cilën sipas M.Fragulis, kishte vendosur që, vija e shtrirë në marveshjen Venezillosi -Tittoni... duhej të ishte vija midis Shqipërisë dhe Greqisë.

Siç përmendet në proces-verbalet e Konferencës, presidenti deklaroi se çështja konsiderohej e zgjidhur.[17]

16. *Po aty, 210*

17. *Lidhja e Kombeve, Minutes of the Thirteenth of the Counicl, Qershor 17-28, 1921, f.210. Pretendimi se korrespondenca mbi çështjen e Adriatikut e dhjetorit të 1919-tës dhe janarit 1920-tës ishte në natyrën e vendimeve të ndërvarura, ishte një prej atyre gabimeve të bëra shpesh prej autoriteteve greke, pro-greke dhe anti-shqiptare. Shih veçanërisht Bearlein në: Under The Acroceraunian Mountains, f. 55-58; "Do të pyeste se përse Konferenca e Ambasadorëve veproi ashtu siç bëri me 1921. Ndofta vendimi i 1920-tës vlerësoi se ishte gabuar në llogaritjen e mos plotësimit të plotësimit të klauzolave që kishin të bënin me Fiumen. Por si mundi që dështimi i marrveshjes midis Italisë dhe shtetit serbo-kroato-slloven... të ndikonte në vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit Suprem midis Italisë dhe një shteti tjetër?" Autori i këtij libri duket injorant i natyrës së mirënjohjes së të gjithë korespondencës kur ai i quan "vendime" tentativat për të bërë propozime të kësaj natyre. Ai duket krejtësisht i panjohur me ato materiale që dilnin prej Forein Officit Britanik në shtator të vitit 1921, dërguar delegacionit grek në Londër për të cilat ai citon: "Ata e mbajtën këtë vendim të janarit 1920 nëse ai mund të quhet vendim apo vetëm një marrveshje nga ana e fuqive të tjera për të pranuar marrveshjen e Venizellos-Titoni të qershorit 1919.*

Kur traktati i Sevres u bë gati për tu nënshkruar, pra në gusht 1920, Venizellosi me "nderhyrjen" e delegacionit britaink siguroi prej të gjithë Fuqive Aleate, duke përfshirë Italinë, njohjen e natyrës detyruese të marveshjes Tittoni-Venezillos.[18]

Së fundi, vazhdoi M.Fragulis, pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve "në asnjë mënyrë nuk nënkupton që të gjithë kufijtë... janë përfundimisht përcaktuar. "Lordi Robert Cecili i ka "bazuar argumentet e tij në një situatë *de facto,* e cila duhej të zgjidhej më vonë me vendosjen e një situate *de jure*"[19]. Aq më tepër që Seksioni ligjor i Sekretariatit, raportonte se marrveshja e 1914-tës nuk ishte më në forcë.[20]

Prandaj konkluzioni i arritur prej M.Frangulis në lidhje me hyrjen e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve

Marrveshja sidoqoftë, ishte e pavlefshme për shkak të mospërmbushjes së kushteve të klauzolave të caktuara dhe me atë gjithashtu gaboi në vendimin e këshillit Suprem i cili ishte bazuar në vlefshmërinë e tij të vazhdueshme". Pikpamja e Berlinit në lidhje me të ashtuquajturin "vendim" të Dhjetorit të vitit 1919-tës dhe janarit të 1920-tës injoron faktin e njohur këtu se në janar të viti 1921 ne e gjejmë delegatin grek tek lidhja duke kërkuar në të vërtetë që kompetencat e këshillit Suprem (Ose Konferencës së Ambasadorëve) në këtë rast të njiheshin.

18. *Po aty, f.216-17. Në këtë pikë dokumentet e nevojshme janë të pamjaftueshme.*

19. *Po aty, f.216*

20. *Po aty, f.218.*

ishte që vendimet e Konferencës së Paqes të cilat kishin për qëllim përcaktimin e kufijve të Shqipërisë të mos paragjykoheshin në asnjë mënyrë. Pranimi i saj "nuk nënkuptonte edhe heqjen dorë prej Këshillit Suprem nga fuqia e tij në favor të një juridiksioni tjetër". Parë në dritën e këtyre fakteve, delegati grek i kërkoi Këshillit "të shpallte që ai nuk ishte kompetent që ta gjykonte rastin në fjalë. Duke vepruar kështu, Këshilli vetëm se do të zbatonte rregullin e përcaktuar i cili zgjidhjen e kufinjve e linte tërësisht brenda kompetencave të Konferencës së Paqes". [21] Kështu do të përjashtohej një konflikt juridik midis Lidhjes dhe Këshillit Suprem.

Delegati grek u pasua prej përfaqësuesit Jugosllavisë, M.Jaovanoviç. Ai iu bashkua mendimit të M.Frangulis duke deklaruar se "Konferenca e Paqes, (kupto Këshilli të Lartë të Aleatëve)" i përkiste fuqia që të vendoste kufijtë e Shqipërisë.[22] M.Jovanoviç u tregua i matur kur shtoi se ky opinion nuk përfshin një ndryshim të vendimit të viti 1913. Jugosllavia kërkonte që vetëm ai të zbatohej nga një trup kompetent".[23] Vëmendje iu kushtua

21. Po aty, f.219

22. Po aty, f.222

23. Po aty, f.223. Për të vërtetuar faktin që Jugo-Sllavia kishte dëshiruar në mënyrë konsekuente Shqipërinë e 1913-tës, është cituar deklarata e për në Konferencën e Paqes. Shih supra.

veçanërisht faktit se kufijtë e 1913-tës nuk ishin njohur prej Konferencës së Paqes si të detyrueshëm, gjë që dilte qartë jo vetëm në korespondencën në lidhje me çështjen e Adriatikut por më specifikisht nëpërmjet nenit 4 të traktatit, i cili kishte të bënte me kufinjtë, firmosur në Sevre më 10 gusht 1920. Ky nen deklaronte se kufiri i Jugosllavisë "me Italinë, dhe në jug (do të jetë) një vijë e cila do të përcaktohet më vonë".[24] Delegacioni jugosllav arsyetoi në mënyrë korrekte që shprehja "dhe në Jug" kishte parasuyshë Shqipërinë (sikundër) është provuar:

a) prej faktit që kufiri me Greqinë ishte shtrirë duke u mbështetur pikërisht në të njëjtin nen pra atë 2, (seksioni 2 i nenit 4) dhe që Greqia gjendej në Jug;

b) prej faktit se në hartën No.3 bashkëngjitur artikullit të përmendur si një pjesë integrale, kufiri me Shqipërinë është përshkruar si një kufi i vjetër.[25]

Delegatit shqiptar iu dha rasti për të shprehur më tej pikpamjet e tij. Në mënyrë të veçantë ai mohoi

24. "Traktati midis Perandorisë Britanike, krerëve të aleatëve dhe fuqive antare, Polonisë, Rumanisë, shtetit serbo-kroato-sllloven, shtetit Çekosllovak, të afërta me kufijtë e atyre shteteve". Sevres, 10 gusht 1920. Britania e Madhe, Foreign Office, Britsh and Foreign States Papres (1920) CXIII, 871.

25. Lidhja e Kombeve, Proces verbal i Sesinit të trembëdhjetë të Këshillit, Qershor 17-18, 1921, f.222

detyrimin ligjor ndaj Traktatit të Fshehtë të Londrës së vitit 1915. Jo vetëm se ai nuk ishte publikuar zyrtarisht, (një argument ky plotësisht i dyshimtë) por ai ishte zëvëndësuar prej Traktatit të Rapallos dhe Protokollit të Tiranës prej të cilit Italia hiqte dorë edhe nga Vlora edhe nga e drejta e një mandati.[26] Prandaj, arsyetoi ai, vendimi i 1913-tës mbetej në forcë. Sa i takon çështjes së juridiksionit të Konferencës së Ambasadorëve, kjo e fundit ishte e shqetësuar vetëm rreth marrdhënieve midis fituesve dhe të mundurve. Por Shqipëria kishte betur neutrale, ndërsa Esat Pasha as kishte qënë drejtuesi i njëmendtë i saj dhe as i njohur ndonjëherë prej Fuqive të Mëdha si një aleat. Nisur nga këto fakte Shqipëria nuk mund të njihte kompetencën e Konferencës së Ambasadorëve. Përderisa kufijtë e saj ishin vendosur që më parë në një "Marrveshje Europiane".[27] çështja duhej vendosur prej trashëgimtares së saj, dmth, Lidhjes së Kombeve, që do të thoshte sipas pikpamjes shqiptare, jo prej Konferencës së Ambasadorëve. Aq më tepër që kjo e fundit "ishte udhëhequr nga motive politike të një natyre kalimtare, ndërkohë që qëllimi i përhershëm

26. Po aty, f.44.
27. Po aty, f.45.

i Lidhjes së kombeve është ruajtja e paqes dhe harmonisë midis antarëve të saj."[28]

Në përgjigjen e dhënë priftit Fan S.Noli, delegati grek përsëriti deklaratën e mëparshme, duke mbyllur fjalën e tij me kërkesën që Lidhja të tërhiqte vendimin e saj."[29]

Delegati shqiptar atëherë vuri në dukje se arsyeja se përse Konventa e 15 majit 1920 nuk e përmendte Lidhjen e Kombeve ishte se Shqipëria në atë kohë ende nuk ishte bërë anëtare e saj.[30]

Kur të gjithë delegatët mbaruan së dëgjuari, Mr.Fisher si një *rapportuer*, e mbylli diskutimin në një sesion të hapur me deklaratën e mëposhtme:

(Ai tha) se në këtë greindje ishin tre palë, që të gjitha anëtare të Lidhjes së Kombeve. E pranuara e fundit ishte Shqipëria dhe në pranimin e saj Asambleja kishte pranuar shprehimisht se kufijtë e saj nuk kishin vendosur përfundimisht. Për këtë jemi marrë vesh që ajo të pranohej pa cënuar çështjen e kufijve.

Kjo çështje tashmë po merrej në shqyrtim prej Këshillit të Ambasadorëve të cilë propozuan që të prononcoheshin mbi të. Ai nuk ishte i përgatitur që

28. Po aty.
29. Po aty.
30.Po aty, f.46

të pohonte në se ishte Këshilli i Ambasadorëve apo vetë Lidhja, organi që e kishte kompetencën e nevojshme për të arritur në një përfundim, megjithëse ai vetë nuk dyshonte se Këshilli i Ambasadorëve ishte kompetenti për të fiksuar kufijtë e Shqipërisë. Neni 89 i Traktatit të San Zhermenit thotë: "Austria për këtë njeh dhe pranon kufijtë e Bullgarisë, Greqisë, Hungarisë, Polonisë, Rumanisë, shtetit Serbo-Kroato-Slloven dhe shteti Çekosllovak sapo ato kufij të jenë përcaktuar prej Aleatëve Kryesorë dhe Fuqive Anëtare".

Kufijtë e Greqisë dhe të shtetit Serbo-Kroato-Sllovene sidoqoftë nuk mund të përcaktoheshin pa qënë përcaktuar kufijtë e Shqipërisë. Si rrjedhim, ai nuk deshi që të vinte në dyshim kompetencën e Konferencës së Ambasadorëve. Mr.Fisher ishte duke folur shumë solemnisht në emër të qeverisë britanike dhe ndjehej e sigurtë që ai po shprehte pikpamjen e Këshillit kur në mënyrën më serioze u kërkoi që të tria palëve në grindje që të betoheshin se do të shmangeshin nga të gjitha aktet provokuese e armiqësore, derisa çështja e kufijve të zgjidhej përfundimisht. Ata duhej që të kujtonin këtë detyrim solemn të cilin e kishin ndërmarrë përpara syve të botës së qytetëruar si anëtarë të Lidhjes së

Kombeve.[31]

Fisher lexoi rezolutën e mëposhtme e cila ishte adaptuar prej Këshillit:

Këshilli i Lidhjes së Kombeve është informuar se Konfernca e Ambasadorëve e ka marrë në dorë çështjen shqiptare dhe që ajo nuk është duke e diskutuar atë në momentin e tashëm. Në këto rrethana Këshilli i Lidhjes së Kombeve e vlerëson si të pa këshillueshme që të merret njëkohëshisht me të njëjtën çështje.[32]

Gjatë zgjidhjes e cila do të komunikohet, Këshilli i rokumandon të tria palët që në përputhje me marrveshjen të mos ndërmarrin ndonjë veprim të pallogaritur i cili bie ndesh me proçedurën në zhvillim. Çështja do të shihet me kujdesin më të madh prej Lidhjes së kombeve e cila do t'i kushtojë tërë vëmëndjen e nevojshme mbrojtjes së popullit dhe kombit Shqiptar.[33]

Këshilli rekomandon që, në interes të qetësimit të përgjithshëm dhe zhvillimit normal të Shqipërisë, Konferenca e Ambasadorëve duhet të marrë një vendim në kohën më të afërt të mundshme.

31.Po aty.

32. Lidhja e Kombeve, Shënie nga sesioni i trembëdhjetë i Këshillit 17-18 Qershor 1921.f.48

33. Po aty.

Përfaqësuesi i Greqisë dhe Jugosllavisë u pajtua me këtë rezolutë, por përfaqësuesi i Shqipërisë kërkoi që çështja e kompetencave të Konferencës së Ambasadorëve ose të Lidhjes së Kombeve ti referohej një komiteti juristësh, dhe përsëriti kërkesat e tij që një Komision i Informatave të dërgohej në Shqipëri. Shqiptarët, tha ai, do të jenë më të gatshëm për të pranuar një vendim të Lidhjes së Kombeve se sa atë të dalë nga Konferenca e Ambasadorëve.

M.Fisher, për pasojë, tërhoqi vëmendjen e palëve tek neni 15 i marrveshjes. Sipas pikave të tij, nëqoftëse një raport i përgatitur nga ana e Këshillit miratohet unanimisht prej anëtarëve të tij, anëtarët e Lidhjes merren vesh të mos shkojnë në luftë përkrah ndonjë pale në grindje e cila vepron në përputhje me të tilla rokumandime. Këto kushte tashmë ishin plotësuar; si rrjedhojë anëtarëve të Lidhjes u ishte hequr e drejta *ipso facto* për të kaluar në luftë.[34]

Përfaqësuesi shqiptar u përgjigj se pas tre vjitesh diskutime të çështjes nga ana e Konferencës së Ambasadorëve, populli shqiptar e kishte humbur durimin. Qeveria shqiptare respekton vendimin e Këshillit, por ajo nuk ia njeh të drejtën Konferencës

34. Po aty, f.48-49.

së Ambasadorëve". Ai përfundoi duke deklaruar se qeveria e tij rezervon të drejtën që ta sjellë çështjen përpara Asamblesë së Lidhjes.[35]

Vetëm pak ditë pas fillimit të mbledhjes, dhe pikërisht me datën 29 Qershor, kryeministri shqiptar, Vrioni, i përsëriti po këto pikpamje nëpërmjet të një telegrami. Ai deklaroi se Shqipëria nuk ia njihte të drejtën Konferencës së Ambasadorëve për të rihapur çështjen e kufijve të vendosur me 1913, dhe tërhoqi vëmendjen e Këshillit "tek fakti se populli Shqiptar do të kundërshtonte fuqishëm çdo lloj vendimi që sillte gjymtimin" e kufijve të vitit 1913.[36] Më 4 korrik apeli i Shqipërisë u paraqit në Asamble.[37]

Megjithkëtë, përpara se ky apel të bëhej në Asamble, çështja shqiptare ishte shqyrtuar gjithashtu prej Këshillit të Lidhjes në sesionin e tij të katërmbëdhjetë. Në një takim privat të mbajtur më 2 shtator 1921, u adaptua një raport i mbajtur prej Mr.Balfour, përfaqësues i Britanisë së Madhe, duke u përmbledhur përgjithësisht në tri faza të veçanta

35. Po aty, f.49.

36. Lidhja e Kombeve. Official Journal, Qershor - Gusht 1921, viti i dytë, No.5-6, f.483.

37. Lidhja e Kombeve, Shqipëria, A. 6. 1921, VII, Kërkesë e bërë prej qeverisë shqiptare për përfshirjen e vendimit të Këshillit të datës 25 qershor në agjendën suplementare të asamblesë.

në të cilat, siç theksonte ai, qëndronte problemi Shqiptar në tërësinë e tij -në statusin e Shqipërisë; kufijve të saj; dhe në mbrojtjen e minoriteteve. Në fillim të gushtit Shqipëria kishte protestuar në Këshill kundër pushtimit të territoreve të saj prej bandave Jugosllave. Si rezultat i kësaj proteste dhe i apelit të bërë në Asamble, u bë e mundur siç deklaronte Mr.Balfour, që:

Asamblesë t'i kërkohej prej Shqipërisë që të vepronte në përcaktimin e kufijve të saj ndërsa Këshilli të parandalonte dhunimin e kuijve prej serbëve.

Të dyja subjektet janë dukshëm të lidhura intimisht me njëra tjetrën dhe duket absurde ti dërgosh njërën në Asamble dhe tjetrën në Këshill.

Prandaj u sugjerua që Asamblesë t'i kërkohej të vepronte me të dyja çështjet: sa për dhunimin po aq sa edhe për përcaktimin e kufijve.[38]

Çështja e statusit të Shqipërisë për të cilën opinionet ishin të ndara, vazhdonte raporti i Mr. Balfourit, ishte zgjidhur përfundimisht me pranimin e saj në Lidhje; por çështja e kufijve ende jo. Kjo e fundit, e cila prej vendimit të 25 qershorit ishte lënë

38. Lidhja e Kombeve, Proces-verbalet e sesionit të ktërmbëdhjetë të Këshillit, pert I, 30 gusht, 3 shtator, 1921, Anexi 239. f.35.

për tu zgjidhur prej Konferencës së Ambasadorëve, kishte qënë që në fillim të qershorit subjekt diskutimi prej një komiteti të emëruar prej Konferencës. Kështu ky kimitet të cilit i ishte kërkuar të arrinte në një marrveshje të plotë se në çfarë kufijsh territorial do të mbetej Shqipëria, nuk i kishte raportuar ende Konferncës rezultatet e punës së vet. Meqënëse ky komitet i kishte shtyrë çështjet deri në fund të Shtatorit, procedurat e mëtejshme në lidhje me kufijtë ishte paraqitur si përkohësisht e pamundur; por njoftimi mbi pikpamjen përfundimtare të konferencës mund të pritej sapo ajo do të mblidhej. Sa i takon mbrojtjes racore të pakicave, duhej bërë veçmas një raport. Megjithatë kjo çështje nuk duhej mishëruar në nja traktat midis aleateve kryesore, Fuqive Anëtare dhe Shqipërisë, por do të sihte më mirë të merrte formën e një deklarate të bërë nga Shqipëria për Lidhjen.

Arsyeja për këtë është se Shqipëria nuk është një shtet i cili u krijua prej Traktatit të Paqes, ndaj edhe detyrimet e saj të veçanta në drejtim të pakicave rrjedhin prej rezolutës së Asamblesë së Lidhjes.[39]

Pas një shkëmbimi pikpamjesh Këshilli aprovoi raportin e Mr.Balfour. Si pasojë M.Jobvanoviç kërkoi

39. Po aty, f.35-36.

të merrej një vendim mbi çështjen e dërgimit të një komisioni shqyrtimi në Shqipëri dhe M.Hymas, përfaqësuesi Belgjian. Në Këshill shprehu mendimin se kjo çështje duhej referuar në Asamble, pasi asaj i ishte besuar pikërisht detyra e vendosjes së çështjes shqiptare si një e tërë. Këshilli u pajtua me këtë pikpamje.[40]

Çështja shqiptare u muar në shqyrtim prej Asamblesë më 4 tetor. Rezoluta mbi subjektin e adaptuar në Komitetin No.VI u paraqit nga lordi Robert Cecil, njëri prej atyre që i rekomanduan Shqipërisë që të pranonte vendimin e ardhshëm të Aleatëve Kryesorë dhe Fuqive Anëtare për kufijte e saj. Propozimi tjetër ishte që Këshilli të dërgonte në Shqipëri një komision për shqyrtimin e përbërë prej tre personash të paanshëm për të raportuar mbi zbatimin e vendimit të Fuqive dhe mbi grindjet që kishin dalë në kufijtë e Shqipërisë. Lord Robert Cecil shprehu shpresën se Fuqitë d ta merrnin së shpejti vendimine premtuar, "pasi shtyrja e kësaj çështje përbënte një krim ndaj paqes në botë" [41].

Në diskutimin që pasoi, prifti Noli deklaroi se

40. Po aty, f.9

41. Lidhja e Kombeve, Journal of the Second Assembly, nr.26, 4 Tetor 1921, f.292.

Shqipëria do të pranonte vedimin e Konferencës së Ambasadorëve dhe do të mikpriste dërgimin e Komisionit të Shqyrtimit. Delegatët francezë e italianë, ndërsa e pranuan rezolutën, dyshuan se mos Komisioni do të dërgohej para se kufijtë të ishin fiksuar prej Konferencës së Ambasadorëve. Ndërsa Casangis sugjeroi se komisioni duhej shoqëruar prej një përfaqësuesi të çdo njërës prej tri palëve të interesuara, Greqisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Megjithatë, ndryshe nga lordi Robert Çeçil i cili pati kundërshtime ndaj një proçedure të tillë, Casangis e tërhoqi propozimin e tij. Rezoluta kaloi unanimisht dhe mënjëherë.[42]

Sipas kësaj, në vijim të mbledhjes së 6 Tetorit, Këshilli mori në shqyrtim dërgimin e Komisionit në Shqipëri. Mr.Balfour bëri një raport i cili pasi u diskutua në Këshill iu bënë modifikimet e nevojshme. Këto rezoluta mishëronin propozimin

42. Po aty, f.292-93. Rezoluta e dytë siç është adoptuar (pjesërisht) si më poshtë "Asambleja .. i kërkon Këshillit menjëherë që të emëronte një komision të vogël të përbërë prej tre personash të praanshëm për të proceduar menjëherë ndaj Shqipërisë dhe të raportonin plotësisht mbi zbatimin e vendimit të aleatëve kryesorë dhe fuqive anëtare aq shpejt sa ai të jetë dhënë si dhe mbi ndonjë shqetësim i cili mund të ndodhë në, ose afër kufijve të Shqipërisë. Komisioni duhej të ketë fuqi që të emërojë vëzhgues ose zyrtarë të tjerë të cilët të jenë të paanshëm për t 'i mundësuar atij që të shkarkojë nga funksionet e tij". Po aty. f.293-94.

e Asamblesë për emërimin e një Komisioni me fuqi."... të emëroheshin vëzhgues të paanshëm dhe të aftrë për të mbrojtur misionin e tyre e tyre nga ndërhyrjet e ndryshme." U sigurua që "... komisioni të arrinte në Shqipëri rreth datës 1 nëntor 1921, por ai nuk do të ndërmerrte vendime deri sa të jepej vendimi i Aleatëve Kryesorë dhe Fuqive Anëtare"[43]. Ky kushtëzim i mëvonshëm ishte rezultat i kundërshtimit nga ana e Marqiuis Imperiali ndaj draftit origjinal të rezolutës së Mr.Balfour i cili kishte lexuar: Këshilli është i mendimit se komisioni duhej të arrinte në Shqipëri duke filluar që tani e deri më 1 Nëntor 1921". Por përfaqësuesi italian frikësohet se në qoftë se një vendim nuk do të jetë marrë që prej 1 nëntorit, mund të ballafaqohemi me vështirësi serioze ndaj një Komisioni të dërguar në kondita të tilla. Lidhur me gjithë këto Mr.Balfour përfshiu ndryshimet në rezolutën e adaptuar, duke deklaruar se përmendja e një date më të hershme dhe të përcaktuar ishte esenciale.[44]

Ndërkohë Këshilli në mbledhjen e tij të 2 tetorit kishte dhënë vlerësimin ndaj një faze tjetër të çështjes së Shqipërisë, atë të mbrojtjeës së minoriteteve.

43. Lidhja e Kombeve, Proces-verbal i sesionit të katërmbëdhjetë të Këshillit, pjesa e II, 12 shtator, 12 tetor 1921. f.122-23

44. Po at, f.122.

Përfaqësuesi britanik, Mr.Fiher, bëri një raport mbi këtë çështje, i cili përmbante draftin e kushteve i cili mund të formonte subjektin e deklaratës që do të nënshkruhej prej shqiptarëve. Përpara se të paraqiste këtë draft, raporti i Mr. Fisher tërhiqte vëmendjen ndaj faktit se Asambleja e parë kishte adaptuar një rekomandim i cili kërkonte që Shqipëria, në qoftë se pranohej në Lidhje, duhej të mbështesë principet e trajtimit të pakicave, duke bërë rregullimet e domosdoshme me Këshillin.[45] Shqipërisë i ishin bërë të njohura këto rekomandime në kohën kur ajo ishte informuar për pranimin e saj. Kryeministri shqiptar në përgjigjen e tij shprehej i gatshëm për të përmbushur çdo rekomandim që mund të bënte Këshilli duke dhënë informacion të plotë mbi situatën në Shqipëri në lidhje me minoritetet, si dhe duke kërkuar njëkohësisht ndërhyrjen miqësore të Lidhjes në favor të shqiptarëve të përfshirë në Jugosllavi dhe Greqi.[46] Qeveria greke nëpërmjet

45. Në sesionin e tij të 15 dhjetorit 1920. Rekkomandime: Në rastin e shteteve ballkanike, kaukaziane dhe Shqiopërisë të cilat ishin pranuar në Lidhje, asambleja kërkon që ata duhet të marrin masa të domosdoshme për të forcuar principet e traktateve të pakicave dhe që ata duhej të rregullonin me Këshillin detalet e kërkuara për të mbajtur këtë objekt në veprim."-Po aty, f.159.

46.Po aty.

drejtorit të sekretariatit të delegacionit të saj në Gjenevë, propozoi që jo vetëm anëtarët e thjeshtë të Këshillit, por gjithashtu edhe Greqia, si një komb drejtpërdrejt i lidhur me çështjen t'i jepej e drejta të informonte Këshillin për ndonjë dhunim ose rrezik dhune që mund të vinte prej shqiptarëve në tajtimin e pakicave. Ky propozim ishte i ridërguar krejt natyrshëm si një ekuivalencë për ndërhyrjen e Greqisë në çështjet e saj të brendshme, një ndërhyrje të cilën, sido që të ishte, e hapur apo e maskuar nga Shqipëria nuk do ta toleronte kurrë. Dhënia e një të drejte të tillë Greqisë, deklaroi delegati shqiptar, do të rrezikonte seriozisht të kompromentonte marrdhëniet miqësore midis dy shteteve fqinje.[47]

Pikat e deklaratës së propozuar, të cilat do të përbënin ligjin themelor të vendit dhe që ishin vendosur nën Lidhjen e Kombeve, siguronin në mënyra të ndryshme specifike barazi të plotë. Mbrojtje e plotë u sigurohej të gjithë banorëve pa ndonjë dallim "feje kombësie, gjuhe, race, apo vendlindje". Sigurohej e drejta e ushtrimit të lirë të fesë. Shtetësia shqiptare iu afrua të gjithë atyre banorëve të zakonshëm që aplikonin brenda dy vjetësh e që kishin jetuar në Shqipëri përpara luftës.

47.Po aty.

Lejohej përdorimi i çdo gjuhe. banorëve jo-shqipfolës duhej tu jepeshin të gjitha lehtësirat për të përdorur gjuhën e tyre para trupit gjykues.[48] Pakicat duhet të gëzonin të drejta të barabarta për të ushtruar fenë, bamirësinë dhe institucionet arsimore në të cilat ata do të mund të përdornin lirshëm gjuhën e tyre. Klauzolë e veçantë iu kushtua sigurimint të fëmijëve jo-shqipflës që t'ju garantoheshin lehtësira në shkollat fillore për mësimin në gjuhën e tyre. Por pas të gjitha këtyre "ishte e kuptueshme se zbatimi i kësaj klauzole nuk do të thoshte se e përjashtonte të mësuarit e gjuhës zyrtare si një detyrim për të gjithë."[49]

Kjo deklaratë për mbrojtjen e paikcave u firmos nga prifti shqiptar Fan Noli i cili deklaroi se qeveria e tij i kishte garantuar gjithmonë këto të drejta të pakicave. Ai përsëri tërhoqi vëmëndjen e Këshillit ndaj çështjes së mbrojtjes së popullsisë shqiptare në Jugosllavi [50]. Përfaqësuesi i Greqisë, M.Dendramis, deklaroi se për pasojë Qeveria Greke kishte nënshkruar një traktat për pakicat në Sevres, i cili duhej të futej në forcë në të njëjtën kohë kur traktati

48. Lidhja e Kombeve, Minutes of the Fourteenth Session of the Council. pjesa e II, 12 Shtator-12 tetor 1921.f.160.
49. Po aty, f.161.
50. Po aty, f.115.

do të rregullonte statusin e Thrakisë, por që Greqia nuk ishte e përgjegjshme ndaj faktit se ky traktat ende nuk ishte ratifikuar. Pikpamja e Qeverisë Italiane siç spjegohej prej Sekretarit të Përgjithshëm i cili nuk mundi të merrte pjesë, ishte që, do të ishte e këshillueshme të ftohej Greqia pasi ajo nuk kishte ndonjë detyrim që rridhte prej ndonjë traktaati lidhur me pakicat të cilën ajo e kishte nënshkruar, dhe të bënte kështu një deklaratë ku të shfaqte gadishmërinë e saj për të zbatuar, ndaj rastit në fjalë, ato principe të cilat i kishte pranuar delegacioni shqiptar. Ky sugjerim u mbështet prej M.Fisher, i cili e bëri propozimin duke kërkuar të dinte prej qeveriasë greke nëse ajo ishte gati për të vënë menjëherë në jetë klauzolat e pakicave të Traktatit të Sevres. M.Dendramis u përgjigj se qeveria rezultonte tërësisht vendimin e vet në këtë pikë.[51]

Në mbyllje të konsideratave të tij për çështjen e pakicave, Këshilli adoptoi një rezolutë të cilën e lexoi M.Fisher, rezolutë e cila i vendoste deklaratat nën garancinë e Lidhjes, "deri në ratifikimin e tyre prej qeverisë shqiptare" duke ftuar këtë të fundit që të informonte sekretarin e përgjithshëm, sa më parë të ishte e mundur, rreth

51. Po aty, f.116

një ratifikimi të tillë.[52] Deklarata u ratifikua prej Shqipërisë më 17 shkurt 1922, dhe u regjistrua në Sekretariatin e Lidhjes më 22 shkurt 1922. Më 7 korrik 1922 Ministri Shqiptar i Punëve të Jashtme i dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm një raport në të cilin jepte informacion të detajuar mbi situatën e pakicave. Ky raport iu bë menjëherë i njohur Këshillit.[53]

Ishin shqetësimet serioze me trupat Jugosllave në kufijtë verior të Shqipërisë, të cilat paralajmëronin shpërthimin e një lufte, ato që e detyruan kabinetin britanik të influenconte mbi Konferencën e Ambasadorëve që të përfundonte diskutimin e stërzgjatur të kufijve të Shqipërisë, të cilat paralajmëronin shpërthimin e një lufte, ato që e detyruan kabinetin britanik të influenconte mbi Konferencën e Ambasadorëve që të përfundont diskuytimin e stërzgjatur të kufijve të Shqipërisë. Që në fillim të nëntorit, Britania e Madhe ndërmori një hap tjetër duke njohur qeverinë e Tiranës si qeveri de jure e të gjithë Shqipërisë.[54]. Konferenca nën

52. Po aty.

53. Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i tretë, nr.11 pjesa e II-të, f.1230-31. Shih gjithashtu Offical Journal, viti i 3 nr.6 pjesa e II-të f.523-84.

54. Debate Parlamentare, Dhoma e ultë (9121) CXLVIII, 29; Le Temps. 6,9,10 nëntor 1921; Woods, Contemprary Revew, CXXI, 46.

drejtimin e M.Cambonit arriti të vijë tek një marrveshje mbi kufijtë e Shqipërisë më 5 nëntor, dhe më së fundi më 9 nëntor u dha vendimi i premtuar dhe i shumëpritur i Konferencës së Ambasadorëve. Ky vendim konfirmoi kufijtë e 1913-tës me përjashtim të katër ndryshimeve shumë të vogla në veri, tri prej të cilave në favor të Jugo-Sllavisë dhe një në favor të Shqipërisë. Në vendim u njoh shprehimisht që kufijtë jugore të Shqipërisë ishin përcaktuar në vend prej komisionit i cili përpiloi Protokollin e Firences. Ndërsa për kufijtë jugore nuk nevojiteshin përcaktime të tjera, për kufijtë veriorë parashiheshin ndryshime pasi puna e bërë më 1913 ishte ndërprerë për shkak të shpërthimit të gjëndjes së luftës.

Përveç kësaj, qeveritë nënshkruese - Perandoria Britanike, Franca, Italia, dhe Japonia- e njohën Qeverinë e Shqipërisë (atë të Tiranës) si një shtet konstitucional, të pavarur e sovran.[55]

Ndaj këtij vendimi të Fuqive, Shqipëria e dha pëlqimin jashtë vullnetit të saj. Kryetari i delegacionit shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve, Mid'hat Frashëri, në një letër të datuar 16 nëntor 1921

55. *Lidhja e Kombeve, Official Journal, Dhjetor 1921, viti i dytë, nr.12, f.1195.*

deklaronte se:

delegacioni shqiptar, duke qënë i mendimit se pushtimi i huaj rrezikonte ekzistencën e vendit e gjente vetveten të detyruar ti nënshtrohej vendimit të marrë prej Konferencës së Ambasadorëve.[56]

Sidoqoftë, Shqipëria, në të vërtetë i kishte fituar të gjitha ato të cilat i kishte krkuar legjitimsht me disa përjashtime të vogla në veri.

Në të njëjtën ditë kur u muar vendimi i mësipërm prej katër Fuqive- 9 nëntor 1921- këto Fuqi arritën në një vendim tjetër të rëndësishëm për Shqipërinë, i cili u bë i njohur vetëm afro një vit më vonë.[57] Duke e ditur që çështja e kufijve të Shqipërisë të cilët sapo ishin vendosur, ishte e një rëndësie të posaçme, dhunimi i të cilave ose i pavarësisë së saj do të përbënte një rrezik pasigurie strategjike për Italinë". Fuqitë u muarën vesh: Së pari: që në rast të vështirësive për ruajtjen e paprekur të integritetit territorial, Shqipëria do të ishte "e lirë t'i drejtonte një kërkesë Këshillin e Lidhjes së Kombeve për asistencë të huaj", së dyti, që në ngjarjete

56. *Po aty, .1210.*

57. *"Deklaratë e bërë nga qeveria e Perandorisë Britanike, Franca, Italia, Japonia në lidhje me Shqipërinë". Nënshkruar në Paris, 9 nëntor 1921. Teksti i Lidhjes së Kombeve,* Treaty Series, *(1922), XII 383. Dokumenti është regjistruar në Lidhje me 2 Tetor 1922.*

sipërpërmëndura, përfaqësuesit e tyre do të instruktoheshin t'i rekomandonin Këshillit që "restaurimi i kufijve territoriale të Shqipërisë duhej ti besohej Italisë"; së treti që në rast të ndonjë rreziku ndaj integritetit të Shqipërisë, qoftë ky territorial apo eonomik, dhe në rast se Shqipëria nuk kishte përfituar brenda një kohe të arsyeshme të drejtën me kusht që ia siguronte neni 1 i (marrveshjes), qeveria e sipërpërmendur do të sillte situatën përpara Këshillit të Lidhjes së Kombeve; së katërti dhe së fundi që nëqoftëse Këshilli i Lidhjes së Kombeve vendos me shumicë votash se ndërhyrja nuk është mjeti i duhur, qeveritë e sipërpërmendura do të rivlerësojnë çështjen në pajtim me principet e shpallura në parathënien e kësaj deklarate, domethënë që çdo modifikim në kufijtë e Shqipërisë përbënte një rrezik për sigurinë strategjike të Italisë.

Pika e parë dhe e tretë e këtyre kushteve vetëm sa riafirmonte atë çfarë ishte e siguruar tashmë prej pikave të Marrveshjes së Lidhjes. Ajo çfarë ishte e re dhe kuptimplotë ishte marrveshja e këtyre Fuqive të mëdha -të cilat përbënin gjysmën e antarëve të Këshillit- që ata duhej t'i rekomandonin Këshillit, që Italisë t'i jepej e drejta e ndërhyrjes në rast se Shqipëria rrezikonte të humbiste territoret ose

pavarësinë e saj, duke njohur kështu atë që interesat e Italisë në bregun lindor të Adriatikut ishin supreme tani, po aq sa ato kishin qënë më 1914. Sidoqoftë edhe në rast se me gjithë influencën e madhe që gëzonin këto Fuqi në Këshill, nuk do të siguronin shumicën në favor të ndërhyrjes, ishte lënë hapur një shteg në klauzolën e katërt, i cili mundësonte një "rivlerësim" ndaj çfardo kuptimi të turbullt që mbarte fraza. Por ndoshta publikimi i thjeshtë i kësaj marrveshje ishte gjykuar i mjaftë për të qetësuar ndonjë lloj frike që mund të kishte Italia, sikundër që ajo padyshim e kishte shprehur. Në këtë mënyrë njohja që kishte Këshilli rreth një marrveshje të përhershme që ekzistonte për Shqipërinë mund të vlerësohej më së miri si e mjaftueshme në vetvete për t'i dhënë rrugë ndërhyrjes në rastet e lëna për tu kuptuar nga Deklarata.

Komisioni i shqyrtimit- i cili për kujtesë, Këshilli e kishte vendosur të emërohej që më 2 Tetor 1921, -u takua në Gjenevë në fillim të nëntorit dhe vijoi punën e tij në Tiranë. Prej andej më 28 dhjetor shkoi në Shqipërinë jugore ku vizitoi Vlorën e Përmetindhe bëri një qëndrim të zgjatur në Korçë. Komisioni, ashtu si në fillim përbëhej prej tre antarësh: majori Meinich (nga norvegjia), koloneli

Schaeffer (Luksemburg), M.Thesleff, (Finlanda), i cili shoqërohej prej një sekretari. Më vonë finlandezi bëri dorëheqje dhe u zëvëndësua më 1 dhjetor prej finlandezit tjetër prof. Sederholm. Ndërsa anëtari tjetër i komisionit, luksemburgasi vdiq gjatë janarit.[58] Megjithëse me një përbërje të re, komisioni e vazhdoi punën e tij, me një seri raportesh, i pari prej të cilëve iu paraqit Këshillit më 12 Maj 1922.

Komisioni e hulumtoi situatën në kufirin greko-shqiptar në vend. Ai vuri re se ishin disa pasigurira sa i takonin përcaktimit të saktë të kazasë otomane të Korçës, kufijtë e së cilës sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve, formonin vijën ndarëse midis Greqisë dhe Shqipërisë. Parë nga ky fakt. Komisioni propozoi që të formonte në kufirin Greko-Shqiptar një zonë neutrale, analoge me atë që tashmë ekzistonte në kufijtë Jugosllave. Me këtë propozim sipas kërkesës së Këshillit, Konferenca e Ambasadorëve ra dakort me datën 12 Janar 1922.[59]

Gjatë shqyrtimit të situatës së minoritetit helenofil

58. Raport i përgjithshëm i komisionit të Shqyrtimit, i paraqitur tek këshilli më 12 maj 1922, Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i tretë nr.6 pjesa II Proces-verbal i sesionit të tetëmbëdhjetë të Këshillit I, 11-17 maj 1992, f.572-73. Një raport paraprak ishte parashtruar më 18 janar 1922. (Po aty viti i tretë nr.3, f.261).

59.Po aty, viti i tretë, nr.6, pjesa e II-të, f.573. Gjithashtu, po aty, pjesa e II-të f.420-431.

në Korçë, komisioni vërejti mungesën e plotë të kombësisë greke. Megjithatë një pjesë e mirë e popullatës (më pak se një e treta) ishte vënë re që për arsye të ndryshme, ishte kundër regjimit aktual. Ky element friksohej veçanërisht se krijimi i një kishe Autoqefale Shqiptare mund të shkaktonte një shkëputje të plotë nga Patriarkana e Stambollit. Në lidhje me këtë gjatë shqyrtimit u pa se përzënia e Metropolitanit grek Jakapos nga Korça, i cili e kishte "përdorur influencën e tij ndaj pakicës helenofile për të filluar një fushatë të rregullt propagandistike politike në favor të Greqisë" ishte urdhëruar direkt prej qeverisë së Tiranës me kërkesën e shumicës së popullsisë pa u shoqëruar nga ndonjë demonstratë apo protestë [60].

Sa për marrdhëniet e Shqipërisë me Greqinë, raporti i komisionit vlerësonte se ato do të ishin gjithmonë të vështira, për aq kohë sa Greqia nuk do të njihte plotësisht kufijtë e shtrirë sipas vijës së vendosur nga Konferenca e Ambasadorëve dhe të drejtat e shqiptarëve në rajonin e quajtur "Epiri i Veriut",- i cili për shkak të kulturës së tij të avancuar dhe situatës më të begatë ekonomike, sigurisht që do të luante një rol të rëndësishëm në zhvillimin e

60. Po aty, viti tretë, nr.6 Pjesa II-të, f.573.

vendit.

Sa i takon mendimit që kishte komisioni, nuk ka dyshime se shumica absolute e popullsisë ishte në favor të regjimit të tashëm gjë që përbënte një faktor të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare shqiptare.[61]

Komisioni ishte i mendimit se me gjithë faktin se Shqipëria ishte pranuar në Lidhje, prapseprapë pavarësisë së saj i kërcënoheshin rreziqe serioze si ato që;

Shqiptarët trashëgimisht nuk qenkan një komb, se ata do të jenë gjithmonë të pazotët të ekzistojnë si një shtet modern dhe i pavarur, se ky vend me siguri, herët apo vonë do të ndahet midis fqinjëve të tij.[62]

Kjo pikpamje e dëmshme po ngulmuese u kundërshtua prej komisionit, studimet e të cilit rreth kësaj çështje arrinin në përfudnimin se "jo vetëm që kombi shqiptar ekzistonte si komb, por edhe se ekzistenca e tij ishte një nevojë." Raporti vazhdonte: Se (shqiptarët) janë të bashkuar prej zakonesh të përbashkëta, traditash të hershme, madje edhe prej një gjuhe, dhe se dallimi gjuhësor midis Gegëve e Toskëve nuk ishte asgjë më shumë se sa një dallim

61. *Po aty, f.578.*
62. *Po aty, f.574.*

dialektesh të së njëjtës gjuhë ... se ndjenja patriotike është më e fortë se sa divergjenca fetare. Për më tepër, vuajtjet që ata i kaluan së bashku gjatë luftrave ballkanike dhe Luftës Botërore, në të cilat Shqipëria u kthye në një teatër veprimesh luftarake, i dha një impuls nacionalizmit Shqiptar, i cili u shtri tek të gjitha shtresate popullsisë... [63]

Konferenca e Ambasadorëve që në fillim të prillit, duke patur një mandat prej Komisionit rreth çështjeve të sipërpërmëndura vendosi një zonë neutrale në kufijtë greko-shqiptar.[64] Ai gjithashtu e instruktoi komisionin e përcaktimit të kufijve që të përfshite në punën e tij (mbi kufinjë veriore dhe lindor) përcaktimi i kufijve të saktë të ish kazasë së Korçës. Ky kufi nuk njihej prej qeverisë shqiptare si kufi i kazasë së Korçës. Bazuar edhe në dokumente nga arshiva turke ai kërkonte që kufijtë e vërtetë të shtriheshin me në lindje. Një numër i konsiderueshëm fshatrash të kërkuara prej shqiptarëve por të përfshira në zonën neutrale, raportoheshin sikur ishin ende në duart e

63. *Po aty, f.575.*
64. *Për kufijtë dhe vendosjen e kësaj zone neutrale, shih, letër nga Presidenti dërguar Konferencës së Ambasadorëve (Poincare), 5 prill 1922. (Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i tretë, nr.6.pjesa e I-rë f.486-87).*

grekëve[65]. Ankesave të bëra nga qeveria shqiptare ndaj bandave të armatosura në zonat kufitare të cilat kishin për qëllim të ndikonin dhe ta friksonin popullsinë shqiptare, Komisioni u dha përgjigje se ai nuk ishte kompetent që t'i zgjidhte ato, përderisa përgjegjësia e plotë për zonën neutrale qëndronte mbi Komisionin e Përcaktimit të dërguaratje prej Konferencës së Ambasadorëve. Komisioni i shqyrtimit tërhoqi vëmëndjen e Këshillit mbi situatën duke deklaruar se një përcaktim i shpejtë do të çonte drejt eleminimit të rreziqeve.[66]

Ky raport i komisionit të shqyrtimit u paraqit në Këshill në një mbledhje publike, më 12 maj 1922, në prani të përfaqësuesve të Shqipërisë dhe të anëtarëve të Komisionit. Lordi Balfour si rapporteur, e solli raportin në mbikqyrjen e Këshillit duke kërkuar vëmëndje të posaçme ndaj faktit që Komisioni kishte vendosur që Korça, ku kishte pa dyshim një pakice helenike, ishte substancialisht një

65. Për hartën që tregon kufij të ndryshëm të kërkuar në rajonin e Korçës dhe fshatrat e pushtuar prej grekëve, shih Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i tretë, nr.3, f.265.

66. Raport suplementar i Komisionit të Shqyrtimit në Shqipëri, nënshtruar Këshillit me 12 maj 1922. (Po aty, viti i tretë, nr.6, pjesa II, f. 580-82).

qytet shqiptar. Ky duhej vlerësuar si një fakt përcaktues në të ardhmen. Ai përshkroi me hollësi suksesin e arritur nga Lidhja e Kombeve në zgjidhjen e çështjen shqiptare.

Për këtë të fundit ai tha se ka bërë atë që "asnjë burrë shteti, komb apo organizatë në botë" s'mund ta kishte bërë. Arsyeja sepse u arrit ky sukses, sipas tij, ishte se të gjitha shtetet e interesuara ishin të bindura se organet e ndryshme të Lidhjes po punonin me vetmohim për të arritur në një përfundim [67]. Në atë mbledhje, përfaqësuesi shqiptar, Frashëri, ndërsa theksoi se komisioni i kishte bërë Shqipërisë shërbimin më të madh duke i bërë faktet e vërteta të njohura, nënvizoi faktin tjetër se në Shqipërinë jugore kishte ende vështirësi. Qeveria shqiptare, deklaroi ai, dëshironte që Këshilli të dërgonte një komisioner në atë anë për të mbajtur komisionin e Përcaktimit të kufijve në korent të ngjarjeve si dhe për të zgjidhur vështirësitë që mund të paraqisin rreziqe.[68] Ditën tjetër të mbledhjes ky propozim u adaptua prej Këshillit i cili vendosi që të mbante hë për hë një anëtar të komisionit

67.Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i tretë, nr.6. Pjesa e II-të, f.522.

68.Po aty, f.523.

(profesor Sederholm) dhe një sekretar.[69]

Profesor Sederholm paraqiti në Këshillin e Lidhjes një raport të mëtejshëm të komisionit të shqyrtimit duke mbuluar periudhën nga qershori deri në dhjetor 1922 si dhe duke siguruar më tepër informacion për konditat në Shqipërinë Jugore dhe marrdhëniet me greqinë. Në qershor, deklaronte raporti, Greqia njohu pavarësinë e Shqipërisë, megjthëse, përfaqësuesit diplomatikë nuk ishin shkëmbyer ende. Kjo justifikohej, në dukje për arsye ekonomike. Qeveria greke bashkëpunoi, por ky bashkëpunim mbeti thuajse vetëm në kuadër të protestave ndaj komisionit të kufijve, duke e penguar atë në punët e tij, me qëllim që ta bënte të pamundur përcaktimin e kufijve përpara dimrit [70]. Përveç kësaj, meqënëse zona neutrale e propozuar nuk ishte evakuar ende, as prej trupave greke e as shqiptare, dukej më mirë të lihej ashtu se sa të rrezikonte, parë kjo në prizmin e kushteve që ekzistonin në Ballkan, duke krijuar një krahinë pa sovranitet.

Qeveria greke, përveç kësaj, nëpërmjet përfaqësuesve të Komisionit të Kufijveu përpoq, të sillte në veprim përsëri marrveshjen e Korfuzit të

69.Po aty, f.434.
70.Po aty, Viti i katërt, nr.1, Pjesa II-të, f.113.

majit të vitit 1914. Një ngjarje e tillë do të thoshte të shkelej mbi sovranitetin e qeverisë shqiptare. Këto grindje dhe pretendime se gjoja popullsia e cila shkonte në kishën ortodokse greke në jugun e Shqipërisë na ishte persekutuar prej autoriteteve atje, vazhdonte raporti, dëmtonte fqinjësinë e mirë midis dy vendeve. Por meqënëse nga njëra anë dukej të mos kishte konflikt të interesave jetësore midis tyre, shihej si e mundur vendosja e themeleve të shëndosha për një të ardhme miqësore të largët duke lënë mënjëanë të gjitha shkaqet e parëndësishme të mosmarrveshjeve.[71]

Për këtë qëllim në përpjekjet për të eleminuar të gjitha shkaqet e mosmarrveshjes midis Greqisë dhe Shqipërisë të cilat ende ekzistonin Komisioni dëshiroi ta fillonte shqyrtimin brenda kushteve në Shqipërinë Jugore. Mbi vizitën e sekretarit të komisionit, Coun Moltke në Athinë në Gusht, Qeveria greke e paraqiti veten komplet në favor të kërkesave të propozuara dhe shprehu gadishmërinë e saj që të dërgonte një delegat grek si vëzhgues si dhe një avokat i cili do të mbronte pikpamjet greke. Kështu, sipas kësaj në shtator, M.Casanges erdhi në

71.Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i katërt, nr.1 pjesa II.të, f.144.

Tiranë po për atë qëllim. Por njëndryshim i menjëhershëm në situatën politike në Greqi, si rezultat i së cilës M.Casanges humbi mbështetjen brenda vendit të tij, si dhe në Shqipëri, ku qeveria kundërshtoi prezencën e një vëzhguesi grek brenda territorit të saj, shkaktoi shtyrjen e hulumtimeve.

Komisioni vërejti që rreziku i një përçarje midis Patriarkanes dhe Kishës Autoqefale Shqiptare ishte e mënjanuar pas dërgimit të një eksarku nga Konstandinopuli i cili u muar me rregullimet e nevojshme rreth kishës së re.[72]

Ky raport u plotësua me një telegram nga Komisioni dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes i datuar 30 Dhjetor. Populsia e kazasë së Korçës, ende nën pushtimin e trupave greke, vuajti shumë nga kushtet e pazgjidhura, kryesisht për shkak të vështirësive në komunikimin me qëndrat e saj të natyrshme tregtare, qytetet e Korçës dhe të Manastirit. Ose duhej formuar një zonë neutrale, ose duhej përshpejtuar përcaktimi i kufijve. Komisioni përkrahu kërkesat e popullsisë për ndërhyrjen e Lidhjes për t'ju drejtuar Konferencës së Ambasadorëve.[73]

72.Po aty, f.115. Për një vlerësim të zhvillimeve të lëvizjes për formimin e një Kishe Ortodokse të pavarur shqiptare, shih raportin e mëvonshmë të Komisionit të Shqyrrtimit të, Official Journal, viti i katërt, nr.5 f.492-93.

73.Po aty, Viti i katërt, Nr.1, pjesa e II-të, f.117-18.

Për këtë arye, Këshilli i Lidhjes, në mbledhjen e tij të 3 shkurtit 1923, vendosi që t'i paraqesë Konferencës së Ambasadorëve rokumandimin e komisionit të tij të shqyrtimit, duke kërkuar marrjen e një vendimi sa më parë të ishte e mundur për çështjen e kufijve. [74]

Një raport i lënë pas dore (i datuar më 1 shkurt 1923) nga Komisioni i Shqyrtimit në Shqipëri mishëronte rezultatet e kërkimeve të mëtejshme prej prof. Sederholm, i cili konsistonte kryesisht në bisedimet jo formale me njerëzit që u takonin shumë palëve të ndryshme. Marrdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë në të njëjtën kohë pësuan thyerje për shkak të këmbënguljes së qeverisë greke për të mos i njohur Korçën dhe Gjirokastrën si shqiptare duke rekrutuar për apsojë vetëm burra nga Jugu i Shqipërisë, por që ishin rezident në Greqi. Megjithatë siç merrej vesh, vetëm rekrutë të tillë, ishin mbajtur në shërbim pasi ata nuk mund të merrnin shtetësinë shqiptare. Kishte shumë e shumë gjëra në marrdhëniet midis dy vendeve por veçanërisht pengonte shtyrja e vendimit përfundimtar mbi vijën kufitare që ndante Korçën

74.Po aty, Viti i katërt, No.3 (Proces-Verbal i sesionit të njëzet e dytë të këshillit, 29 Janar -3 Shkurt 1923). f.241-42.

nga Maqedonia greke. Pjesë të këtij territori ishin ende nën pushtimin e trupave greke, mądje edhe Komisionit i ishte refuzuar leja për të hyrë aty. Megjithatë që nga shkurti, shkëmbimi i përfaqësuesve diplomatike hapte një erë të re në marrdhëniet midis Greqisë e Shqipërisë, deklaronte me entuziazëm komisioni.[75]

Sa i takon çështjes së problemit të përgjithshëm politik të Shqipërisë jugore, Komisoni vërejti se ndërsa shumë prej opinioneve të vëzhguesve ishin të ndryshme për shkak të njëanshmërisë në vlerësimin e çështjes prej tyre, në më të shumtën e rasteve kjo mospërputhje vinte edhe prej kushteve tejet të vështira që zotëronin atje. E gjithë çështja errësohej edhe nga fakti se shumë persona ende nuk arrinin të kuptonin se statusi i Shqipërisë jugore ishte vendosur në mënyrë të parevokueshme dhe përfundimtare me vendim të Konferencës së Ambasadorëve dhe se as Lidhja e Kombeve dhe as Komisioni nuk mund të merrnin në konsideratë asnjë përpjekje e cila synonte që të ndryshonte këtë status. Sidoqoftë, Komisioni nuk mund të mohonte

75.Po aty, Viti i katërt, Nr.5, "Raporti i Komisionitë Shqyrtimit në Shqipëri mbi veprimtarinë nga 19 dhjetori 1922 deri më 2 shkurt 1923."f.491-92.

ekzistencën e një pakënaqësie të fortë dhe në rritje midis popullsisë kristiane në jugun e Shqipërisë. Shkaqët më të përhapura të kësaj pakënaqësie ishin rënia e theksuar ekonomike që po përjetonte Shqipëria, depresioni në tregun shqiptar si rezultat i rënies së të ardhurave prej emigrantëve të saj në Amerikë, prej çmimeve të larta të sendeve më të nevojshme, prej taksave të larta dhe doganave të zbatuara për miellin, kripën dhe sheqerin, prej shtyrjes së pagesave të borxheve, çka përbënin një pengesë serioze për tregtarët kristianë të cilët ishin kreditorë, si dhe prej faktit se ndërsa provincat jugore i paguanin pjesën më të madhe të buxhetit të shtetit shqiptar, vetëm një pjesë e vogël e këtyre parave shpenzohej për nevojat e tyre. [76]

Në këto situara vihej re edhe një zhgënjim politik. Helenofilët, duke shpresuar për ndryshime në të ardhmen në statusin politik të krahinës, u tërhoqën së marri pjesë në politikën shqiptare, ndërsa nacionalistë shqiptarë të fesë orthodokse gjithashtu mbetën më larg jetës publike se sa dëshirohej. Pjesa më aktiv përbëhej prej të "ri-emërguarve" prej Amerikës. Në qytetin e Korçës, p.sh, prej më shumë se shtatë ose tetë mijë votuesish kristianë, vetëm

76.Lidhja e kombeve, Official Journal, viti i katërt, nr.5, f.497.

dyqind e njëzet syresh morën pjesë në zgjedhje. Megjithëse ishin dhënë sigurimet në lidhje me këtë, dukej qartë se ky kushtëzim i çështjeve do të mbetej të përmirësohej në zgjedhjet e tjera. Ajo çfarë shkaktonte zhgënjim tek popullsia kristiane ishte edhe ndarja ekzistuese e zonave elektorale e cila i linte pakicat kristiane në mëshirën e shumicës myslimane.

Një sistem i përfaqësimit përpjestimor shihej i nevojshëm me qëllim që të përmirësonte situatën, duke u dhënë mundësi kristianëve që të zgjidhnin përfaqësuesit e tyre.[77]

Shumë prej pikave, të cilat deri tani kishin formuar subjektin e debatevë, ishin hulumtuar prej Komisionit dhe konkluzionet e tij mund të arsyetoheshin si arritja më e paanshme. Lidhur me çështjen e gjujhës, Profesor Sederholm tregoi se sindikatat e Zografosit ishin tepër të fryra pasi qe vetëm një e gjashta (35.00-40.000) e të gjithë popullsisë së Shqipërisë së jugut ishin gjetur si greqisht folës në shtëpitë e tyre.[78] Por kushtet gjuhësore atje ishin shumë të ndryshme nga ato të zonave të tjera. Populsia kristiane e këtij rajoni duke

77.Po aty, f.498
78.Po aty, f.49.

pas përdorur shqipen kryesisht si gjuhë të marrdhënieve të përditshme e kishte përdorur greqishten për një kohë të gjatë si një gjuhë të fesë, të letërsisë dhe tregtisë duke bërë kështu që kjo e dyta të mund të konsiderohet si një gjuhë e dytë e nënës për toskët kristianë të Jugut.[79]

Sa i takon raportit numerik të myslimanëve me kristianët, dukej qartë se ata ishin gati të barabartë në rajonin që po shqyrtojmë.[80] Vëmendje u tregua ndaj faktit që "ndjenjat helenike të shumicës së popullsisë ortodokse të Shqipërisë jugore nuk mund të përshkruheshin si nacionaklizëm grek." [81]

Vëmendje e posaçme iu kushtua çështjes së edukimit në Shqipërinë jugore si dhe marrdhënieve të saj lidhur me të drejtat e pakicave gjuhësore dhe fetare.

Kurrë ndonjëherë nuk kishte patur një numër më të madh fëmijësh nëpër shkolla, por puna që bëhej në ato ishte e dobët dhe shkollat ishin të tejmbushura. Ndryshe nga çfarë deklaronin pakicat, oferta greke për të pranuar më shumë mësues ishte

79.Po aty, f.496.
80.Po aty, f.500. Shih diskutimin e mospërputhjes së numrit të kristianëve dhe myslimanëve në propagandën e pamfleteve të të dy planeve të ndryshme. (Po aty, 499-500)
81.Po aty.

refuzuar. Kur u bë raporti, mësimi në të gjitha shkollat zhvillohej në gjuhën shqipe.[82]

Komisioni arriti në përfundimin se nevojat arsimore të Shqipërisë duhej të gjenin ndihmë adekuate prej një eksperti të huaj për arsimin si dhe duhej eleminuar politika në procesin arsimor.[83]

Raporti i Komitetit merrej gjithashtu edhe me situatën e përgjithshme në Shqipërinë jugore. Ai nënvizonte mungesën e fanatizmit fetar dhe ndjenjave raciste në vend. [84] Përveç kësaj, Komisioni ishte i sigurte se po përgatitej një lëvizje revolucionare brenda Shqipërisë jugore. Ndjenjat e popullsisë kristiane ndaj Greqisë përshkruheshin sikur të ishin "jo ndjenja irredentësh , por vetëm ndjenja për një vend i cili kishte qënë burim i kulturës së tyre dhe armik i regjimit turk". Atëherë lëvizjet kryengritëse, mbeteshin të ishin ato që do të mund të fillonin prej panepiriotëve në Greqi, duke supozuar se Greqia do të parandalonte përpjekje të tilla.[85]. Në tërësi, vendimi i Fuqive lidhur me kufijtë jugore, ishte deklaruar të ishte një vendim i drejtë dhe i zgjuar.

Kjo përforconte bindjen (thuhej në raport) se

83.Lidhja e Kombeve, Official Journal, viti i katërt, nr.5 f.493-95.
84.Po aty, f.496.
85.Po aty, f.500.

ekzistenca e një shteti të pavarur shqiptar ishte një nevojë për paqen në atë pjesë të Evropës, dhe se një Shqipëri e pavarur mund të ekzistojë vetëm duke patur të përfshira në të krahinat e jugut.[86]

Raporti përfundimtar njoftonte se kishin mbetur "pak çështje të pakryera në lidhje me marrdhëniet midis Shqipërisë dhe fqinjëve të saj të cilat mund të nxisnin zemërimin në procesin e vazhdimësisë së mardhënieve të mira me to". [87]

Faktet që bien në sy e që kanë të bëjnë me çështjen e Shqipërisë jugore përpara Lidhjes së Kombeve janë të një rëndësie të madhe për historinë e kësaj çështje të veçantë si dhe për çështjen dhe punën aktuale që Lidhja ka përmbushur. Pas antarësimit të Shqipërisë në Lidhje, problemi i kufijve të saj u paraqit përpara Këshillit dhe Asamblesë, por vendimi përfundimtar për to iu la Konferencës së Ambasadorëve si trashëgimtare e Konferencës së Paqes, e cila nuk kishte arritur deri tek zgjidhja e këtij rasti.[88] Vendimi i Konferencës së Ambasadorëve në favor të kufijve të 1913-tës u shoqërua me një deklaratë të aleatëve e cila u bë në të njëjtën ditë e që synonte të mbronte

86.Po aty, f.501.
87.Po aty, f.502.
88.Raporti përfunduar i Komisionit të Shqyrtimit, Po aty, f.505.

interesat e veçanta strategjike që Italia kishte në Shqipëri. Kur çështja e kufijve u zgjidh, Këshilli i Lidhjes dërgoi një Komision të Shqyrtimit i cili bëri një hulumtim të paanshëm të kushteve të vendit në një përpjekje, në dukje të suksesshme, për të eleminuar lenien prapa të ndonjë shkakur për mosmarrveshje midis Shqipërisë e Greqisë.

VIII. Përfundim

Shqyrtimi i historisë së Shqipërisë Jugore përpara vitit 1912 jep fakte kuptimplota, jo vetëm të rritjes së ndërgjegjies kombëtare shqiptare, por edhe të intresave të fuqive evropiane në atë vend. Midis këtyre interesave spikaste rivaliteti i Austro-Hungarisë me Italinë për të kapur secila për vete më shumë pozita kontrolluese mbi territorin strategjik të grykës së Adriatikut; megjithatë, një marveshje e Aleancës Trepalëshe kushtëzonte ruajtjen e statusquosë në Adriatik dhe nëse kjo ishte e pamundur, atëherë mbetej bashkëpunimi i dy aleatëve në punën për formimin e një Shqipërie të pavarur, E njëjta periudhë dëshmon përpjekjet e ethshme nga ana e Greqisë për të shtrirë kufijtë e saj drejt veriut me qëllim që të përfshinte brenda territorit të saj popullisn e asaj ane e cila ishte në shumicë shqiptare.

Lufta ballkanike të cilat kishin të bënin aq shumë me çështjen shqiptare dhanë mundësi të ndryshme të cilat Shqiptarët, Austro-Hungaria dhe Italia nuk hezituan që t'i shfrytëzonin. Në mbledhjen e konferencës së Ambasadorëve në Londër për të sjellë

paqen, rivalitetet e Fuqive Evropiane rezultuan në themelimin e një Shqipërie autonome nën kontrollin Europian, ndonëse greqia, padyshim e kundërshtoi një masë të tillë. Franca nga ana e saj bëri ç'ishte e mundur që të ndërpriste bisedimet, t´i lihej Korça Greqisë, por Aleanca Trepalëshe këmbënguli për përfshirjen e saj në shtetin e ri.

Megjithëse e lindur në të tilla trazira rivalitetesh ndërkombëtare, shteti i ri shqiptar i përmbushi kërkesat reale të nacionalizmit të shprehur si asnjëherë. Austro-Hungaria dhe Italia e kërkuan bregdetin deri në Kepin e Stillos për Shqipërinë, me qëllim që të asnjanësonin bregdetin përballë Korfuzit për interesate e veta. Por përcaktimi i saktë i kufijve tokësore të jugut që nga kufiri detar iu la në dorë një komisioni në të cilin secila prej Fuqive të Mëdha kishte përfaqësuesit e vet, të cilët u instruktuan që të përcaktonin kufijtë mbi bazën e gjuhës së folur. Pas shumë pak hulumtimesh dhe shumë mosmarrveshjesh të tilla midis anëtarëve, komisoni adaptoi një kompromis të propozuar prej delegatit britanik, sipas të cilit dy krahinat ajo e Korçës dhe e Gjirokastrës i ishin dhënë Shqipërisë, megjithëse jugperëndimi ose krahina e shumicës së Gjirokastrës ishte e banuar prej një shumice greke.

Fuqitë nuk u ngutën që t'ia bënin të njohur Greqisë një vendim të tillë të marrë në Firence. Shtyrja për shkak të paaftësisë së tyre për të vepruar në bashkërendim ishte një faj, siç ishte dhe faktori që shkaktoi revolucionin fatkeq të verës së vitit 1914, kur pakica progreke e popullsisë së krahinave të dikurshme, duke patur shpresë tek një rishikim në favor të tyre, më në fund bëri rezistencë ndaj përfshirjes së saj në shtetin shqiptar. Megjithëse qeveria greke mbeti teknikisht në prapaskenë gjatë kryengritjes, shqiptarët me të drejtë e ndjenë se përderisa ajo ishte tërësisht e inskenuar nën drejtimin (jo zyrtar) grek, rrjedhojat e saj nuk shprehnin dëshirën e popullit. Revolucioni ishte i mbarsur me rrjedhoja të këqia, për shkak të një mase shkatërrimesh të pasurisë* që la prapa, si dhe ndjenjën e hidhur që e shoqëroi atë. Epiriotët e shtrënguan Komisionin e Kontrollit i cili po punonte për Shqipërinë që të garantonte dhe të zbatonte autonominë për të cilën ata kishin luftuar. Nëqoftëse marrveshja e Korfuzit e majit 1914, e cila i siguronte shqiptarët, do të ishte vënë në jetë, ajo do të kishte siguruar për minoritetin grek garanci të tilla si ato

Nga ky libër del se shkatërrimet si formë revolte në Shqipëri kanë bazë më të thellë dhe autore jo vetëm shqiptare. (Shën. i përkth.)

që do të afronte vetë Lufta e Madhe e që ishin esenciale në krahina ku popullsia ka një karakter të tillë të përzier. Por për fat të keq, shpërthimi i Luftës së Madhe e bëri atë të pamundur që të zbatohej. Eksperimenti për të patur një shtet shqiptar të pavarur pat si rezultat një konfuzion të përgjithshëm, i cili zgjati deri në mbarimin e luftës dhe vendosjen e paqes.

Dy fuqitë mesdhetare, më të interesuara rreth fatit të Shqipërisë, duke ndjerë diferencën e fuqive të tjera ndërluftuese të Luftës së Madhe, përfituan nga rasti për të futur nga një këmbë në atë pjesë aq të lakmuar prej tyre të Shqipërisë jugore: Italia pushtoi përkohësisht ishullin e Sazanit dhe më vonë Vlorën, ndërsa Greqia, Sarandën dhe Gjirokastrën. Në bisedimet e të dy grupeve ndërluftuese me Italinë rreth hyrjes së saj në luftë, Shqipëria luajti një rol të spikatur. Italia i kërkoi Monarkisë Dyshe njohjen e sovranitetit të saj të plotë mbi Vlorën dhe Sazanin si dhe të deklaronte se nuk kishte edhe më tej asnjë lloj interesi të Austro-Hungarisë në Shqipëri.

Këto kërkesa, Ballplatzi, nuk ishte i gatshëm që t'i garantonte. Ndërkohë Fuqitë e Antantes arritën të tërheqin Italinë në anën e tyre duke i dhënë një pjesë të territorit të Adriatikut si ryshfet për këtë. Pikat e

Traktatit të Fshehtë të Londrës së 1915-tës për të cilin u arrit të fitohej edhe mbështetja e Italisë rezultuan në ndarjen e Shqipërisë midis Sërbisë, Greqisë dhe Italisë si dhe neutralizimin e bregdetit jugor. Ndërkohë Greqia dështoi në një përpjekje për të përfshirë "Epirin e Veriut" në mbretërinë helenike për shkak të mosbesimit të Aleatëve ndaj saj pasi ajo i kishte dhënë ndihmë Aleancës Trepalëshe duke u dorëzuar Fort Roupelin. Më vonë, me kthimin e Venizellosit në krye të çështjeve greke, pjesa më e madhe e "Epirit të Veriut" u okupua përsëri prej trupave greke, duke detyruar italianët që të tërhiqeshin nga pozicionet e avancuara që ata kishin zënë...

Një zhvillim kuptimplotë gjatë Luftës së Madhe ishte praktika e vetqeverisjes të cilën shqiptarët e arritën nën drejtimin francez në Korçë dhe në një shtrirje më të vogël nënitalianët në Gjirokastër. Në rajonet e zëna nga italianët më 1917, një gjeneral italian kishte shpallur një protektorat italian mbi një Shqipëri të pavarur, edhe pse një veprim i tillë nuk ishte miratuar as nga ana e ministrisë italiane si një e tërë dhe as prej Fuqive të Mëdha. Italianët, nëpërmjet veprimtarive të tyre të pasuksesshme me vendasit, i acaruan ata kundër vetes edhe pse kishin

bërë mjaft punë me vlerë. Kjo ndjenjë e fortë antitaliane pati rrjedhoja të rëndësishme pas luftës, kur shqiptarët u bënë të zotët që t'i përzinin armiqtë e vet-italianët. Në tërësi periudha e Luftës së Madhe dëshmoi rritjen e shpirtit nacioanalist shqiptar.

Çështja e Shqipërisë përpara Konferencës së Paqes ishte shumë e komplikuar nga të qenurit e lidhur me çështjen e Adriatikut dhe me të gjitha problemet e traktateve fshehta. Në konferencën e Parisit theksi mbi principet e vetpërcaktimit, duke shoqëruar prononcimet përfundimtare të Balfourit dhe të tjerave gjatë luftës në favor të Shqipërisë, i drejtoi shqiptarët drejt një mbibesimi që shteti i tyre do të rindërtohej. Komisioni mbi çështjet greke i dëgjoi përfaqësuesit e delegacioneve të interesuara dhe pranoi memorandume, por ishte i paaftë që të merrte një vendim. Përfaqësuesi italian në këtë komision, i shqetësuar jo për mirëqënien e popullsisë por për problemin strategjik të sigurimit kombëtar të vendit të tij, favorizoi kufijtë e viti 1913. Francezët dhe britanikët, në përputhje me Traktatin e Londrës dhe me dëshirën për t'i shpërblyer Venizellosit për besnikërinë e tij ndaj kauzës së tyre gjatë luftës, do t'i kishin dhënë më shumë territore Greqisë. Ndërsa amerikanët do t'i kishin caktuar bregdetin Greqisë,

për Korçën shqiptarëve. Pjesërisht për shkak të opinioneve të ndryshme, nuk u ndërmauar ndonjë veprim prej Konferencës së Paqes. Ajo situatë pa mbështetje në të cilën u gjetën shqiptarët në Paris, bëri që zgjidhja e çështjes së tyre të shtyhej. Sidoqoftë, është e vërtetë se kjo shtyrje kaq e madhe i dha kohë asaj për të organizuar një lëvizje kombëtare shqiptare për unitet për të përdorur atë në momentin e përshtatshëm.

Pas mbarimit të Konferencës, në verën e vitit 1919, Italia dhe Greqia arritën në një marrveshje të quajtur marrveshja Titoni-Venezillos prej të cilit Greqia duhej të merrte "Epirin e Veriut" dhe si kthim për këtë Italia do të kishte një mandat mbi Shqipërinë. Këto pika u adaptuan prej aleatëve në memorendumin e 9 dhjetorit 1919, në rrjedhat e korespondencës së tyre mbi zgjidhjen e çështjes së Adriatikut. Çështë e vërteta, Shqipëria do të ishte coptuar pa as më të voglin dyshim, megjithëse ishte nën sistem mandator, sikur presidenti Uillson të mos ushtronte tërë fuqinë e tij, duke e detyruar Italinë dhe Jugosllavinë që ta lenin atë mënjëanë gjatë kohës së përpjekjeve për zgjidhjen e çështjeve të tyre. Por përpara se kjo zgjidhje e përkohëshme të arrinte në Rapallo, shqiptarët duke formuar një qeveri nacionaliste, e

vendosur për të luftuar kundër të huajve, i përzunë me forcë italianët prej bregdetit të tyre dhe siguruan njohjen e vendit nga Italia si një vend të pavarur duke rritur kështu në mënyrë të jashtëzakonshme prestigjin dhe duke përligjur të drejtën e tyre për ekzistencë. Shqiptarët në vitin 1920 gjithashtu arritën një marveshje të përkohëshme me Greqinë për krahinën e Korçës.

Kur njohjes nga ana e Italisë iu shtua edhe pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve suksesi i luftës së saj për pavarësi u sigurua. Por kufijtë mbetën edhe më tej të papërcaktuar. Shqetësimet serioze në të dyja anët e kufijve, atyre veriore dhe jugore e çuan atë në drejt një thirrje bërë Këshillit të Lidhjes. Fakti që çështja i kaloi Asamblesë më parë se sa Këshilli të vepronte, është shprehje e forcës që kishin kombet e vegjël në Asamble ashtu si kundër fuqitë e mëdha ndjeheshin të forta në Këshill; kështu nuk mund të mos vihet re fakti që Britania e Madhe ishte një forcë e fuqishme për një trajtim të kënaqshëm të çështjes Shqiptare në Lidhje. Greqia dhe Jugosllavia ishin treguar deri tani të suksesshme në mbrojtjen e pikpamjeve të tyre që kufijtë e deklaruar prej Këshillit të mos shtriheshin brenda provincave shqiptare por të ldhej më tepër me Konferencën e Ambasadorëve

si trashëguese e Konferencës së Paqes po aq sa edhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër ishte në favor të kërkesave të Shqipërisë, ai ishte arritur vetëm në sajë të një deklarate të përbashkët të firmosur njëherazi për mbrojtjen e interesave italiane. Ndërsa çështja që kishte rëndësi të dorës së parë, ajo e kufijve pra, i ishte lënë Konferencës, shumë probleme më të vogla u përpunuan në Lidhje. Midis këtyre ishte një deklaratë për minoritet, e bërë për të siguruar trajtimin e drejtë ndaj grekëve që mbeteshin në Shqipëri. Lidhja gjithashtu bëri një pjesë të shkëlqyer të punës duke dërguar komisionin e Shqyrtimit në Shqipëri i cili studioi probleme të ndryshme në vend e që u tregua gjithashtu i suksesshëm në zbutjen e shumë vështirësive të vogla që dilnin, që po të lejoheshin të zmadhoheshin, fare mirë mund të provokonin rreziqe për paqen.

Megjithëse e ndjekur këmba këmbës prej vështirësive, çështja e Shqipërisë jugore nuk është e pazgjidhshme. Popullsia është vërtetë shumë e përzier në karakter, nga ana racore, gjuhësore dhe fetare; por këto dallime nevojiten të mos e errësojnë faktin që shumica e banorëve sidomos që nga koha e Luftës është e një ndjenje të fortë kombëtare shqiptare. Adaptimi i kufijve jugorë të vitit 1913

do të provonte një zgjidhje të përshtatshme, megjithëse ratifikimi në favor të Greqisë fare mirë mund të kishte qënë bërë gjatë rajonit bregdetar ku shqiptarët janë pakicë. Minoriteti grek i cili u përfshi në mënyrë të paevitueshmenë Shtetin Shqiptar duket të jetë i mbrojtur mjaft mirë nën garancitë e Lidhjes së Kombeve.

Përkundër disa ankesave të mëtejshme të bëra, kriza e Korfuzit e vitit 1923 dhe ngjarjet e 1924-ës guxonin të jepnin shpresën se problemi ishte në rrugë të mbarë për tu zgjidhur me kalimin e kohës dhe së shpejti ai do të pushonte së qëni një problem ekzistues për paqen në Ballkan dhe në Evropë.

SHTOJCE

Pjesët e raportit të Komitetit mbi kërkesat territoriale greke që vepron në çështjet e Vorio Epirit janë riprodhuar bashkangjitur nga një kopje e dhënë aq bujarisht nga bibloteka e Universitetit Yale falë mirsjelljes së Dr.Seymour. Deri tani ky raport nuk është përdorur nga studentët. Për shkak të rëndësisë dhe paarritshmërisë së përgjithshme që ajo mbart është parë e nevojshme që t'i bashkangjitet këtij libri.

RAPORTI I KOMITETIT MBI KERKESAT TERITORIALE GREKE

1."Epiri i Veriut" (Shih hartën 1.)

Propozim:

Delegacioni britanik dhe ai francez pajtohen me vijën e blertë të treguar në hartë.

Delegacioni i SHBA-ve është përgatitur për të pranuar vetëm vijën e modifikuar siç tregohet në hatë.

Delegacioni italian dëshiron të ruajë kufijtë ekzistues.

Argumenti:

Delegacioni britanik dhe ai francez e bazojnë vendimin e tyre në arsyet e mëposhtme:

I. Në rastin e Shqipërisë jugore statistikat e përdorshme ofrojnë kritere të pakta praktike të dëshirës së popullit të interesuar. Statistika të tilla mund të bazohen vetëm mbi prova fetare ose gjuhësore. Teksti i mëparshëm është i pafavorshëm për shqiptarët, ndërsa i fundit është i padrejtë për grekët. Prandaj delegacioni britanik dhe ai francez ndjehen të obliguar që të marrin paraprakisht në konsideratë arsyet e vërteta për të cilët kufijtë e vitit 1913 nuk kishin gjetur miratimin e popullsisë së interesuar. Kursi i ngjarjeve në Shqipërinë jugore që prej përcaktimit të kufijve të mësipërm (shih përmbledhjen historike të dhënë në aneskin 1) pritet të kërkojë se ky përcaktim është i papranueshëm ndaj shumë elementeve të rëndësishëm në krahinat e interesuara.

II. Në të njëjtën kohë delegacioni britanik dhe ai frncez janë të impresionuar nga evidenca e dhënë prej M.M.Venezillos dhe Karapanos në lidhje me ndjenjat helenofile të pjesës më të madhe të popullsië

si dhe rreth mvartësisë ekonomike të krahinës së Korçës nga rruga kryesore që të shpie në Saradë.

II. Delegatët britanikë janë gjithashtu të influencuar nga fakti se problemi në të vërtetë qëndron se a duhet ti jepet krahina Greqisë apo Shqipërisë, apo duhet vendosur nën protektoriatin e disa Fuqive Evropiane. Ata janë të mendimit se për arsye politike dhe strategjike do të ishte një padrejtësi ndaj Greqisë dhe Serbisë që një pikë kaq vitale siç ishte Korça të vendosej në tutelën dhe kontrollin e një tjetër Fuqie Evropiane.

Delegacioni i SHBA-ve nuk mund t'i pranonte si të kënaqshme as ato të dhëna të cilat vinin nga historia e viteve të trazuara, 1913-14, gjatë të cilave intrigat e huaja ishin aq të pranishme as dëshmitë e palëve kundërshtare. Ata i bazuan përfundimet e veta në raportin e vëzhguesve, të vërtetuara prej evidencave statistikore dhe deklaruan si më poshtë:

1.Ndërtimi i rrugës në Përmet- Vlorë i jep mundësi krahinës së Korçës dhe asaj të Gjirokastrës që të ndaheshin pa dëmtime ekonomike.

2.Në krahinën jugperëndimore të lumit Vjosa, shumica e popullsisë duket të jetë greke në ndjenja dhe në prirjet politike dhe është e lidhur në mënyrë të natyrshme me Greqinë për shkak të rrugëve të

transportit dhe veprimtrisë tregtare.

3.Në krahinën jugore të lumit Vjosa, popullsia shqiptare përbën shumicën e padiskutueshme jo vetëm pse flet shqip por parë edhe në ndërgjegjien e saj kombëtare. Nuk ka arsye bindëse për shkëputjen nga Shqipëria të kësaj krahine ku ndërgjegjia për bashkimin e kombit dhe denoncoi ndaj akuzës shqiptare janë në mënyrë të veçantë të fuqishme.

Delegatët italianë janë të shqetësuar që kufiri ekzistues duhet të ruhet për arsye të detajuara të dhëna në Aeksnin 2.[Shënim: Anekset janë pjesë e raportit.]

Aneksi 1

PERMBLEDHJE E NGJARJEVE TE KOHEVE TE FUNDIT NE "EPIRIN E VERIUT"

Përcaktimi i kuufirit greko-shqiptar me 1913-Duke e krijuar kështu Shqipërinë si një principatë të pavarur, autonome dhe të trashëgueshme, Konferenca e Londrës ia beson punën e fiksimit të kufijve greko-shqiptar një Komisioni Ndërkombëtar të përbërë prej delegatësh të cilët përfqsëonin secilën

nga të gjashtë Fuqitë nënshkruese të Marrveshjes së Londrës. Kërkesat e këtij Komisioni shkuan vetëm deri tek gjuha e folur brenda shtëpisë së secilit banor të zonave në shqyrtim. Ata i përjashtuan të gjitha vlerësimet që mund të bëheshin mbi bazën e ndërgjegjies apo dëshirave të banorëve.

